RAPORT PËRFUNDIMTAR

Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë

të ushtruar në

BASHKINË MALLAKASTËR

Tiranë, 29 maj 2022

PËRMBAJTJA

SHKURTIME **3**
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE **4**
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit 4
2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore 4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit 28
II. HYRJE **31**
1. Objekti i Auditimit 31
2. Qëllimi i auditimit 31
3. Identifikimi i çështjes 31
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 32
5. Përgjegjësitë e audituesve 32
6. Kriteret e vlerësimit 32
7. Standardet e auditimit 35
8. Metodat e auditimit 35
9. Dokumentimi i auditimit 36
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT **37**
1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Mallakastër 37
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit 39
   2.1. Auditimi mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm 39
   2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit 54
   2.3. Vlerësimi i Raportimit Financiar 77
   2.4. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik 115
   2.5. Mbi Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit 187
   2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV. 192
   2.7. Të ndryshme të dala gjatë auditimit 195
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET **196**
A. MASA ORGANIZATIVE 196
B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI 209
C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE 210
D. MASA DISIPLINORE 216

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare eKontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	KomisioniiProkurimit Publik
KVO	KomisioniiVlerësimittëOfertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me PërgjegjësitëKufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet për një qeverisje të mirë, në përmbushje të objektivave të institucionit të Bashkisë Mallakastër dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe tëkontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga baza e të dhënave të thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 ñpagaò, 602 ñshpenzime operativeò dhe 230-231 ñinvestimeò, u audituan prokurimet publike të zhvilluara nga Bashkia Mallakastër nga data 01.01.2018 deri në datën 30.06.2020, etj.

2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, gjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra nëLigjin nr. 10296, datë 8.7.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò i ndryshuar, Manualin e MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.	*Pika 2.1,faqe 44-45*	E mesme	**1.** Nga Titullari i Bashkisë Mallakastër, me atributet e Kryetarit të GMS dhe të Nëpunësit Autorizues të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin strategjisë së risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. **2.** Nga Bashkia Mallakastër, të kryhen investime në programe kompjuterike të liçencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryhen procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimesh për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve për realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Të vendoset një sistem komunikimi, i cili të

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
				ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë. **3.**Të kryhen ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit, për ato funksione të cilat me ligj janë kompetencë e institucioneve të tjera duke rishikuar edhe strukturën e bashkisë me qëllim alokimin eficient të burimeve njerëzore.
2	Nga auditimi i aktivitetit të Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Mallakastër, gjatë periudhës 2018-2021, u konstatua se struktura e njësisë, sa i përket numrit të punonjësve dhe certifikimit të tyre në periudha të caktuara nuk ka qenë në përputhje përcaktimet ligjore, të cituara më sipër rast pas rasti, nuk janë kryer auditime të zbatimit të rekomandimeve, të teknologjisë së informacionit dhe prokurimeve, në raste të caktuara nuk janë zbatuar planet e auditimit, rreth 60% e fushave të aktivitetit të Bashkisë Mallakastër, të vlerësuara me risk të lartë nuk janë mbuluar me auditim. Veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën ñçò në nenin 6, nenin 13, shkronjat ñcò dhe ñçò në nenin 14, shkronja ñeò në nenin 16 të Ligjit nr. 114/2015 ñ*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*ò; Pikën 3 të VKM nr. 83, datë 3.2.2016 ñ*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*ò; Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë ñ*Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016*ò.	*Pika 2.1, faqe 44-45*	E mesme	**1.**Njësia e Auditit të Brendshëm, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut, ku të planifikojë auditime tematike për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, si dhe të kryejë proçesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim. **2.** Të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.
3	Nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA të hartuara gjatë periudhës 2020-2021, u konstatua se: - Përvitin 2020, buxheti vjetor nuk është miratuar me vendim të veçantë, në kundërshtim me përcaktimin e bërënëpikën 9 tëKreut I nëUdhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afat mesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*ò; - Për PBA 2020-2022 dhe PBA 2021-2023 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interest të Bashkis Mallakastër, nëkundërshtim me përcaktimin e bërënëshkronjën ñçò tënenit 5 nëLigjin nr. 68/2017 ñ*Përfinancat e VetëqeverisjesVendore*ò;	*Pikat 2.2 dhe 2.3, faqe 39-54*	E mesme	**1.**Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Mallakastër. **2.**Për çdo vit buxhetor të kryen

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	- Për PBA 2020-2022 dheBuxhetinvjetor 2020 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 tënenit 33 tëLigjit nr. 68/2017 ñ*Përfinancat e Vetëqeverisjes Vendore*ò, sivijon: *"Kryetari i njësisë së vetë qeverisjes vendore* ***përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afat mesëm dhe të buxhetit vjetor****, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standard përpërgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afat mesëm qendror e vendor"*; - Nuk administrohet dokumenti përfundimtari PBA për periudhën 2021-2023, por në dosje administrohet vetëm VKB që kanë miratuar buxhetin vjetor 2020, PBA 2020-2022 dhe buxhetin vjetor 2021. Lidhur me PBA 2021-2023 nga Bashkia Mallakastër na u vendos në dispozicion dokumenti në formatin EXCEL përpasqyrat e PBA 2021-2023, në kundërshtim me pikën 6 nëKreun I tëUdhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standard të përgatitjes së program t buxhetor afat mesëm të njësive të vetë qeverisjes vendore*ò; - Për PBA 2020-2022 dhe 2021-2023 nuk administrohet VKB për miratimin e tavaneve përgatitore dhe përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, në kundërshtim me përcaktimin e bërëpikën 6 nënenin 34 dhepikën 1 nënenin 37 tëLigjit nr. 68/2017 ñ*Përfinancat e Vetëqeverisjes Vendore*ò; - Për PBA 2020-2022 dhe 2021-2023 nuk ka gjetur zbatim për caktimi i bërë nëpikën 1 tënenit 35 të Ligjit të mësipërm, pasi nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit; - Për PBA 2021-2023 nga Kryetari i Bashkisë nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit Brenda njësisë së vetë qeverisjes vendore, ne kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 29 nëUdhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*ò. - Për PBA 2020-2022 dhe 2021-2023 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e përcaktuara në shkronjat ña-hò tëpikës 38 nëUdhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive te vetë qeverisjes vendore*ò, përdrejtuesit e ekipit të menaxhimit të			konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Mallakastër.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	programeve buxhetore të Bashkisë Mallakastër, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë proçesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Mallakastër, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse; - Në PBA 2020-2022 dhe 2021-2023, si dhe buxhetet vjetore të vitit 2020 dhe 2021, nuk janë planifikuar fonde për investime në fondin pyjor , në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 5 tënenit 23 nëligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 ñ*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*ò, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe në pikën 3 tënenit 13 nëLigjin nr. 57/2020 ñ*Përpyjet*ò, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020.			
4	Nga auditimi i kontratave për investime të Bashkisë Mallakastër, financuar nga Ministria e linjës, konstatohet se, në 4 raste në vlerën 1,113,601,009 lekë, Titullari i Bashkisë ka ndërmarrë angazhime buxhetore duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me operatorë ekonomik, për investime në punë publike, pa pasur në dispozicion fondet e plota për realizimin e kontratës. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 1, 9, 10, 14 dhe 38 të nenit 3, nenin 40, nenin 50, nenin 51 në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar; Pikën 2 të VKM nr. 807, datë 16.11.2016 ñ*Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore*ò, i ndryshuar; nenin 70 dhe nenin 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, i ndryshuar; pikat 81, 142, 155, 165 në Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar.	*Pikat 2.2 dhe 2.3, faqe 39-54*	E lartë	Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse.
5	Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli, konstatohet se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele të ulta në vitin 2020, konkretisht në masën 30% dhe në vitin 2021 në masën 54%. Ky mosrealizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Mallakastër në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore	*Pika 2.2, faqe 54-91*	E lartë	Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masa që planifikimi i fondeve për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave në vitin paraardhës dhe jo të planifikimit të tyre.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	të miratuara me të ardhurat e realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën ñaò në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò; nenin 47 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar.			
6	Gjatë periudhës 2020-2021 konstatohet se, në 5 raste Bashkia Mallakastër ka ndërmarrë angazhime të reja buxhetore përtej datës 15 tetor, me vlerë totale 17,693,545 lekë, duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me operator ekonomik, për kryerjen e punimeve publike të ndryshme. Veprime e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 51 në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar.	*Pika 2.2, faqe 54-91*	E lartë	Titullari i Bashkisë Mallakastër, nërolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masat e nevojshmepërtëeleminuarpraktikat e ndërmarrje ssëa ngazhimeve buxhetor epërtej afatit ligjor.
7	Nga auditimi I zbatimit të buxhetit lidhur me likujdimin e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Mallakastër, konkretisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, u konstatua se, në 5 raste përvlerën 1,190,000 lekë, nuk është respektuar rradha e likujdimit të tyre, sipas parimit ñ*hyrje e parë-dalje e parë*ò, nuk janë kryer likujdimet e plota të detyrimeve, megjithëse Bashkia Mallakastër në fund të viteve 2020-2021 ka patur disponibilitete në thesar. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari I Bashkisë, si dhe në urdhrin e likujdimit nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që në përmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime të Bashkisë Mallakastër ndaj palëve të treta.Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme bien nëkundërshtim me përcaktimet e bëranëpikat 8 dhe 60 tëUdhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit*ò, I ndryshuar; Udhëzimi nr. 1, datë 04.06.2014 ñ*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit*ò.	*Pika 2.3, faqe 54-91*	E lartë	**1.**Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit. **2.**Titullari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet. Gjithashtu për çdo rast të likujdimit të detyrimeve të vendimeve gjyqësore, në urdhrin e autorizimit të shpenzimit, të evidentohet dhe të kërkohet

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
				nxjerrja e përgjegjësisë administrative, të punonjësit përgjegjës.
8	Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimii tyre nëlidhje me respektimin e afatit**30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumenta cioni nshoqërues në Degën e Thesarit Mallakastër, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se përperiudhën 2020-2021, ky afat nuk është respektuar në 49 raste përvlerën 183,825,766 lekë. Gjithashtu sa I përket likujdimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, u konstatua se, në 36 raste nuk është respektuar rradha e likujdimit të tyre, prafatura e pare likujdohet më parë. Veprimet e mësipërme bien nëkundërshtim me përcaktimet e bëranëpikat 8 dhe 184 tëUdhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standard të zbatimi ttë buxhetit*ò, i ndryshuar.	*Pika 2.3, faqe 54-91*	E lartë	Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përjashtuar kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë dhe duke respektuar rradhën e likuidimit sipas parimit ñ*hyrje e parë – dalje e parë*ò.
9	Nga auditimi, u konstatua se *<u>për vitin 2018</u>,* të ardhurat nga 336,716 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën 322,925 mijë lekë ose 95.9%, pra me një mosrealizim në shumën 13,791 mijë lekë. *<u>Për vitin 2019</u>*, të ardhurat nga 353,552 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën 156,564 mijë lekë ose 44%, pra me një mosrealizim në shumën 198,988 mijë lekë. *<u>Për vitin 2020</u>*, të ardhurat nga 341,975 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën 117,205 mijë lekë ose 34.3%, pra me një mosrealizim në shumën 224,770 mijë lekë. Për vitin 2021,të ardhurat nga 350,904 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën 209,997 mijë lekë ose 60%, pra me një mosrealizim në shumën 140,907 mijë lekë. Mosrealizimi ka ndodhur kryesisht si pasojë e mospagesës nga ana e kompanive naftënxjerrëse dhe përpunuese të cilat zënë peshën më të madhe të të ardhurave në Bashkinë Mallakastër, përkatësisht gjatë vitit 2018 për shumën 13,791 mijë lekë, gjatë vitit 2019 për shumën 198,988 mijë lekë, gjatë vitit 2020 për shumën 224,770 mijë lekë dhe gjatë vitit 2021 për shumën 140,907 mijë lekë. Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Përmenaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò indryshuar, ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 ñ*PërFinancat e VetëqeverisjesVendore*ò indryshuar, neni 5, ñ*Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksione vevendore*ò, neni 54, ñ*Raportimi financiar*ò nënpika c, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për Sistemin e Taksave Lokale*ò,	*Pika 2.3, faqe 54-91*	E lartë	Bashkia Mallakastër, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit, sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	indryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, indryshuar; UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV ñ*Procedurat standard për menaxhimin e të ardhurave*ò pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñ*Përprocedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore nënjësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b.			
10	**1.** Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Mallakastër, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në Bashki, vlera është 2,215,499,987 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 1,989,157,450 lekë, me një diferencë prej 226,342,537 lekë më shumë në PF në subjekt. Në vijim, në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra, në PF në Bashki, vlera është 348,120,020 lekë, ndërsa në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra në PF në sistemin e Thesarit vlera është 111,203,912 lekë, me një diferencë prej 236,916,108 lekë më pak në PF në sistemin e Thesarit. Llogaria 520 ñ*Disponibilitete në Thesar*ò, në PF në subjekt ka vlerën 223,825,807 lekë, ndërsa në PF në sistemin e Thesarit ka vlerën 0. Për sa më sipër, këto llogari nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë. **2.**Llogaria 468 ñ*Debitorë të ndryshëm*ò në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën debitore 60,528,690 lekë. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari është pakësuar për vlerën 927,617 lekë dhe është shtuar për vlerën 98,599 lekë, me një rritje neto në vlerën 387,002 lekë, shumë e konstatuar nga debitorët për pagesat e tarifave të kopshtit dhe çerdhes. Nga auditimi i të ardhurve, u konstatua vlera totale debitore 1,255,994,680 lekë, e cila është e pakontabilizuar. **3.**Gjendja e llogarisë 210 ñ*Toka, Troje, Terrene*ò në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 309,970 lekë e pandryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Për këtë llogari në Bashkinë Mallakastër nuk disponohet analizë. **4.** Gjendja e llogarisë 211 ñ*Pyje kullota plantacione*ò në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 8,560,400 lekë e pandryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Për këtë llogari në Bashkinë Mallakastër nuk disponohet analizë. **5.** Gjendja e llogarisë 212 ñ*Ndërtime e konstruksione*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 791,244,840 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 752,534,178 lekë, me një pakësim në	*Pika 2.3, faqe 54-91*	E lartë	**1.** Drejtoria Ekonomike dhe e Çështjeve Sociale në Bashkinë Mallakastër, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të llogarive dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike. **2.** Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. **3.** Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 ñ*Toka, troje terrene*ò; 211 ñ*Pyje, Kullota, Plantacione*ò; 212 ñ*Ndërtime e konstruksione*ò; 213 ñ*Rrugë, rrjete, vepra ujore*ò; 214

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	vlerën 38,710,662 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është **774,449,870** lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 21,915,692 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. **6.** Gjendja e llogarisë 213 ñ*Rrugë, rrjete vepra ujore*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 1,015,556,796 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 850,018,562 lekë, me një pakësim në vlerën 165,538,234 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 834,188,729 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 15,829,833 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. **7.**Nga verifikimi i regjistrave, u konstatua se për llogaritë 214 ñ*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*ò dhe 215 ñ*Mjete transporti*ò, etj., paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikat 30 dhe 74 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò. **8.**Gjendjae llogarisë218 ñ*Inventarekonomik*ò nëdatën 31.12.2020, ka qenë në vlerën20,174,831 lekë, ndërsanëdatën 31.12.2021 gjendja e kësajllogarie ka qenë 20,646,231 lekë, me një pakësim në vlerën 471,400 lekë. Pakësimet në këtë llogari janë për vlerën e amortizimit. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 20,639,700 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nën vlerësuar për vlerën 6,531 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.			ñ*Instalime teknike, makineri e pajisje*ò dhe 215 ñ*Mjete transporti*ò. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivit përkatës. **4.**Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 ñ*Debitorë të ndryshëm*ò duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 ñ*Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit*ò.
11	Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe QKB-së, u konstatua se Bashkia Mallakastër, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2021 paraqitet si:	*Pika 2.3, faqe 91-175*	E lartë	**1.**Nga Bashkia Mallakastër, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive: **1.** ñ*UKM Sh.a.*ò, me

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	- Aksionare me 100% të aksioneve të shoqërisë U KM Sh.a., me NUIS J77517803S, me objekt ñ*U k*ò, e themeluar në datën 28.02.1997, aktualisht me status ñ*Aktiv*ò. Numri i aksioneve është 19,600 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 19,600,000 lekë. - Aksionare me 100% të aksioneve të shoqërisë ñ*UK M Sh.a.*ò, me NUIS K47605804N, me objekt ñ*...a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm..., etj.*ò, e themeluar në datën 15.04.2004, me Vendimin nr. 31633 të Gjykatës Tiranë, aktualisht me status ñ*Aktiv*ò. Në aktin e themelimit të kësaj shoqërie anonime, përcaktohet se kapitali themeltar ka qenë 19,600,000 lekë, e ndarë në 19,600 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion. Numri i aksioneve është 621,858 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën **621,858,000 lekë**, e gjitha në pronësi të Bashkisë Mallakastër. Nga sa më sipër, rezulton se kjo shoqëri rrjedh nga shoqëria e mësipërme, e cila nuk funksionon, por nga ana e Bashkisë Mallakastër nuk janë marrë masat për mbylljen dhe fshirjen e shoqërisë fillestare në regjistrin e bizneseve. - Aksionare me 25% të aksioneve të shoqërisë ñ*B*ò Sh.a., me NUIS L18407801Q, me objekt ñ*Krijimi i ekipeve zinxhir për sportin e futbollit...*ò. Numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale 20,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 2,000,000 lekë. Partner me 75% të aksioneve është shoqëria ñ*Gj*ò. Vlera e kapitalit të zotëruar nga Bashkia Mallakastër është **500,000 lekë**, vlerë e cila nuk është pasqyruar në llogarinë 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ò. Këto të drejta, Bashkia Mallakastër i ka trashëguar nga Bashkia Ballsh. - Në datën 09.01.2020 është regjistruar në organet tatimore si ent publik ñ*NShP, Mallakastër*ò, me NUIS M07509871Q, me objekt ñ*Shërbime publike, pastrim, gjelbërim, transport...*ò, e cila zotërohet nga Bashkia Mallakastër. Kjo ndërmarrje është krijuar me VKB Mallakastër nr. 97 datë 27.11.2019, me nr. 2913/1 regj., datë 02.12.2019. Nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB-së, u konstatua se kjo shoqëri nuk figuron në regjistrat *online* të QKB-së dhe rrjedhimisht nuk mund të ekstraktohen të dhënat për zotërimin e aksioneve dhe vlerën e kapitalit, por nga Pasqyrat financiare të shoqërisë, konstatohet se vlera e aktiveve është **67,105,362 lekë**. Për sa më sipër, llogaria 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e*			NUIS K47605804N, për 100% të aksioneve, në vlerën 621,858,000 lekë; **2.** ñ*B*ò Sh.a., me NUIS L18407801Q, për 25% të aksioneve në vlerën 500,000 lekë; **3.** ñ*NPM*ò, me NUIS M07509871Q, për 100% të aksioneve, në vlerën 67,105,362 lekë, si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive prej **689,463,362 lekë**në debi të llogarisë 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*ò dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	*veta*ò nuk paraqet vlerën reale për shumën **689,463,362 lekë** (621,858,000 lekë nga shoqëria UKM Sh.a.; 500,000 lekë nga shoqëria ñBò Sh.a. dhe 67,105,362 lekënga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Mallakastër), në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 ñ*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*ò, me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñ*Aktivet afatgjata materiale dhe Aktivet afatgjata jo materiale*ò pikat 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 ñ*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*ò.			
12	Vlera e prokuruar për investimet në proces gjatë vitit 2021 ka qenë 1,259,818,211 lekë, nga të cilat 1,125,017,874 lekë me fonde të deleguara dhe 134,800,337 lekë nga të ardhurat e veta. Vlera e kontraktuar (me Tvsh), për investimet në proces gjatë vitit 2021 ka qenë 1,177,981,840 lekë, nga të cilat 1,101,002,753 lekë me fonde të deleguara dhe 76,979,087 lekë nga të ardhurat e veta. Planifikimi total për vitin 2021 ka qenë 278,451,257 lekë, nga i cili 198,785,588 lekë me fonde të deleguara, me realizim në vlerën 189,552,711 lekë dhe 79,665,669 lekë nga të ardhurat e veta, me realizim në vlerën 42,501,126 lekë. Si rregull, këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 ñ*Aktive afatgjata materiale*ò. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Sektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021, sipas aneksit nr. 9 pika 2. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò, kreu II, pikat 6 dhe 15-18, kreu III, pika 33, 36, Aneksi 1, pika 2, ñ*Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël)*ò, ñ*Aktive afatgjata materiale*ò, etj. Për sa më sipër, zëri ñ*Investime në proces*ò, i përbërë nga llogaritë 230 ñ*Investime për aktive afatgjata jo materiale*ò dhe 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò, në datën 31.12.2020nuk paraqet vlerën reale, janë nënvlerësuar për 991,143,896 lekë, pasi duhet të pasqyronin vlerën 1,177,981,840 lekë, e cila	*Pika 2.4, faqe 91-175*	E lartë	Drejtoria Ekonomike dhe e Çështjeve Sociale në Bashkinë Mallakastër të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 ñ*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*ò deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, tâi kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	përbëhet nga shuma e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Mallakastër.			
13	Gjendja e llogarisë 466 ñ*Kreditorë për mjete në ruajtje*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 37,245,475 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 48,822,037 lekë ose me rritje në vlerën 11,576,562 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, nuk është bërë zhbllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit, pavarësisht se është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 ñ*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*ò i ndryshuar, Kap II ñ*Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit*ò, të VKM nr. 3, datë 15.2.2001 ñ*Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit*ò i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2001 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike*ò i ndryshuar pikat 42 ï 50 të tij, UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 ñ*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*ò i ndryshuar, Kap. II, pika 10.	*Pika 2.4, faqe 91-175*	E lartë	Kryetari i Bashkisë Mallakastër në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuara.
14	Për vitin 2021 kanë qenë në zbatim 17 kontrata, të lidhura gjatë vitit dhe në vitet ushtrimore të mëparshme, në vlerën totale 1,177,981,840 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Qeveria, FZHR dhe financime të huaja. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit	*Pika 2.4, faqe 91-175*	E lartë	**Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës** së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debitë llogarisë 520 ñ*Disponibilitetenëthesar*ò dhe në kreditë llogarisë 476

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për të paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2021 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 ñ*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*ò. Për këto investime nuk janë kryer veprimet kontabël sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò Aneksi 1 ñ*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*ò, Kreu I, ñ*Të përgjithshme*ò, pika 8, Kreu II, ñ*Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, ñ*Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, pika 32.			ñ*Tëardhuratëcaktuarapërt'upër dorur*ò. **Me konstatimin e shpenzimit,** (mbërritja e faturës shoqëruar me situcion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò dhe në kredi të llogarisë 404 ñ*Furnitorë për investime*ò. **Në momentin e pagesave** të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 ñ*Furnitorë për investime*ò dhe në kredi të llogarisë 520 ñ*Disponibilitete në thesar*ò. **Në fund të vitit ushtrimor,** për fondet e përdorura për investimet e papërfunduara/në proçes, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 ñ*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*ò, në kredi të llogarisë 720 ñ*Grant korrent i brendshëm*ò dhe në kredi të llogarisë 4342, ñ*Operacione me shtetin (të drejta)*ò për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues. **Me përfundimin e investimit,** të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 ñ*Aktive afatgjata materiale*ò dhe në kredi të llogarisë 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò. **Me kapitalizmin e aktivit,**(për aktivet e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
				debi të llogarisë 476 ñ*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*ò, në kredi llogarisë 105 ñ*Grante të brendshme kapitale*ò për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 ñ*Shtesa të fondit bazë*ò dhe në debi të llogarisë 105 ñ*Grante të brendshme kapitale*ò për vlerën e aktiveve të blera.
15	Në auditimin e 15 procedurave me vlera të larta, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kritereve, jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP, ku kriteret nuk janë në përputhje me zërat e preventivit, si dhe nuk janë argumentuar në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò me ndryshime.	*Pika 2.4 faqe 175-188*	E lartë	Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mallakastër, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve, duke dhënë argumente për secilin kriter, të cilat të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kritere të përshtatshme me procedurën dhe duke dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.
16	1) Gjatë auditimit të procedurave të prokurimit për punë publike, u konstatua se në shumicën e tyre është vendosur kriteri për mjekun e ndërmarrjes, duke mos qenë në kushtet e kërkuara sipas përcaktimit të VKM-së nr. 632, datë 15.07.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 09.02.2011 ñ*Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë në punë*ò, ku përcaktohen grupet e punëdhënësve dhe numri i punonjësve për të kërkuar mjekun e ndërmarrjes. Në asnjë nga rastet e audituara, nuk plotësohet numri i punonjësve për të kërkuar mjekun e ndërmarrjes.	*Pika 2.4, faqe 39-54*	E lartë	Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit, Bashkia Mallakastër, të marrë masa për shmangien e kritereve të tilla, të cilat nuk mbështeten në bazën ligjore, por krijojnë pengesë dhe kufizojnë numrin e operatorëve ekonomikë për të konkurruar në procedurat e prokurimit publik.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	2) Gjatë auditimit të procedurave të prokurimit për punë publike, u konstatua se në shumicën e tyre është vendosur si kriter për punonjësit, dëshmia e sigurimit teknik, bazuar në ligjin me nr. 8734, datë 01.02.2001 ñ*Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike*ò i ndryshuar, ndërkohë që objekti i punëve publike dhe stafi i nevojshëm për kryerjen e këtyre punimeve, nuk është në kushtet për të qenë i pajisur me këtë dëshmi, pasi nuk ka zëra punimesh që lidhen me objektin e ligjit.			
17	Në auditimin i procedura vetë prokurimit për blerj e mallrash (karburanti, mjetetransportietj), komisioni i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike dhe për llogaritjen e fondit limit, nuk ka dokumentuar për llogaritjen e fondit limit, por ka hartuar preventivat papërcaktuar metodikën e ndjekur përcaktimin e vlerës së fondit limit të kontratës. Në disa raste, mungon urdhri i titullarit përngritjen e këtyre komisioneve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 56, sidhe me pikën 2 tënenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik*ò indryshuar me pikën 1 tënenit 73, dhe me pikën 1 tënenit 76 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 ñ*Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik*ò.	*Pika 2.5, faqe 39-54*	E mesme	Titullarii AK, të krijojë komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, duke angazhuar personel të kualifikuar dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nën ligjore për prokurimin publik. Në çdo rast, komisionet e përfshiranëprocedurat e prokurimit publik, tëngrihen me urdhër titullarit.
18	Në auditimin e 2 procedura vetë prokurimit për blerje mjetesh, rezulton se specificimet teknike të vendosura janë me diferenca minimaliste apo fikse, në lidhje me parametrat teknikë. Specifikimet teknike për mjetet, të cilat nuk duhet të kenë qenë të targuara, në funksion pune ose shërbimi Brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për vitin 2019, janë kërkesa të cilat pengojnë konkurrencën dhe janë në kundërshtim me nenin 23 tëligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dheligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ñ*Për prokurimin publik*ò.	*Pika 2.6, faqe 39-54*	E lartë	Titullarii AK, të marrë masa qënë komisionet e ngritura për procedurat e prokurimit publik, të vendosen persona me kualifikimin e duhur. Të merren masa për vendosjen e specifikimeve teknike të duhura dhe përkrijimin e kushteve për konkurrim të paanshëm ndërmjet kandidatëve ofertues.
19	Në auditimin e procedurave të prokurimit publik, në 4 raste janë evidentuar mangës i lidhur me komisionin e shqyrtimit të ankesave. Titullarii AK, ka ngritur KSHA me personeli cili ka qenë i angazhuar në hartimin e kritereve dhe njëkohësisht ka trajtuar edhe shqyrtimin e ankesave, veprime këto në kundërshtim me pikën 6, germa (a), paragrafi i dytë i nenit 78 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, ndryshuar me pikën 1 tënenit 101 të VKM-në nr. 285/2021.	*Pika 2.6, faqe 39-54*	E lartë	Titullari i AK, në çdo rast kur administrohen ankesa të cilat lidhen me procedurat e prokurimit publik, të marrë masa qënë komisionet për shqyrtimin e tyre, të angazhojë personel i cili nuk ka qenë i përfshirë më pare në vendimmarrje për të cilën janë paraqitur ankesat.
20	1. Nga testimi i 25 procedurave për blerje të vogla gjatë periudhës 01.01.2018-31.12.2021, rezulton se Komisioni i Blerjeve të Vogla, nuk ka argumentuar në	*Pika 2.4, faqe 91-175*	E lartë	1. Titullari i AK, në komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, të angazhojë

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	të gjitha rastet përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar. 2. Në 2 raste, konkretisht procedurat me objekt ñBlerje kamion vetëshkarkues me vinxhò, dhe ñBlerje korrëse bariò, specifikimet teknike janë vënë në mënyrë jo konkurruese, të cilat janë ndikuese në trajtimin e ofertuesve, veprim në kundërshtim me pikën 2 të nenit 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar. 3. Në 2 procedura, me objekt blerje produkte ushqimore, nuk është bërë përshkrimi i plotë i mallrave që prokurohen, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 23 të cituar më sipër. 4. Në procedurën me objekt ñBlerje tonerë për printer dhe fotokopjeò, OE i shpallur fitues me të cilin është lidhur kontrata, Nexhat Mehoniqi, rezulton 2 muaj debitor, duke mos përmbushur pikën III/1. d të Ftesës për Ofertë. 5. Në procedurën me objekt ñShërbim interneti dhe telefonieò, në kriteret apo specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, rezulton se AK ka kërkuar nga OE ofertues të disponojë si pjesë të stafit teknik, minimalisht 5 punonjës inxhinierë telekomunikacioni/ elektronik ose informatikë. Ky kriter është i ekzagjeruar dhe i paargumentuar nga KBV. Është një numër relativisht i lartë duke marrë parasysh llojin dhe vlerën e kontratës prej 500,000 lekë pa TVSH. 6. Në 11 procedura blerje të vogla, rezulton se likuidimet për faturat tatimore të shitjes janë kryer tej afatit 30 ditor, veprim në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2009 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò.			persona të kualifikuar dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik. 2. Në procedurat e ardhshme, të merren masa që hartimi i specifikimeve teknike të mundësojë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët, të rrisë konkurrencën ndërmjet tyre dhe njëkohësisht të bëhet përshkrim sa më i saktë dhe i plotë i objekteve që prokurohen. 3. Komisioni për blerjet e vogla, të hartojë kriteret në përputhje me objektin e kontratës, duke shmangur kriteret të cilat ulin konkurrencën dhe përbëjnë kufizim për operatorët ekonomikë. 4. Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Mallakastër, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve të faturave brenda afatit ligjor 30 ditor.
21	Në auditimin për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, në 3 raste personat përgjegjës që administrojnë procesin në sistemin e-leje, kanë miratuar lejet pa kërkuar mendimin paraprak nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për miratimin e VNM-ve, pasi objektet konsiderohen të klasifikueshme për tu pajisur me VNM, sipas ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 ñPër vlerësimin e ndikimit në mjedisò Shtojca II, pika 10. Detyrimi për të kërkuar mendimin e këtij institucionit, përcaktohet në pikën 6 të nenit 21, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 ñPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò i ndryshuar.	*Pika 2.4, faqe 91-175*	E lartë	Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Mallakastër, të marrë masa për shqyrtimin e lejeve të ndërtimit, ku të bashkërendohet puna me të gjitha institucionet e tjera publike brenda kompetencave që u njeh ligji, duke përfshirë edhe kërkesën drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nëse objektet për të cilat është aplikuar për leje ndërtimi, duhet

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
				tõ nënshtrohen apo jo Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
22	Nga auditimi i veprimtarisë së Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, u konstatuan mangësitë si vijon: 1. Nuk është aplikuar në 2 raste konstatimi i ndërtimit pa leje, vendimi për pezullimin e punimeve, veprim ky në kundërshtim me nenin 5 germa ç) dhe nenin 13 germat a), b), c) dhe ç) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ñPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeò, i ndryshuar, si dhe pikës 5 të VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 ñPër unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendoreò. 2. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se k/inspektori nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5, germa a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ñPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeò, i ndryshuar, nenin 51, ñInspektimiò, të ligjit nr. 107/2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 ñPër unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendoreò. 3. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se k/inspektori nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 mujor për masat e marra nga IKMTV, në kundërshtim me nenin 5, germa f), të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ñPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeò, i ndryshuar. 4. Nga kontrolli i dokumentacionit, u konstatua se disponoheshin fotot e konstatimit të shkeljeve, të cilat janë të nevojshme për dokumentimin e kundërvajtjes së kryer. Mungesa e fotografive të kundërvajtjes, është veprim në kundërshtim me nenin 41 ñTë drejta të tjera të inspektoritò, germa a), të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në Republikën e Shqipërisëò. 5. Për një gjobë në vlerën 500,000 lekë ndaj subjektit G&L shpk, rezulton se është bërë kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, e cila është pranuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 460 regj., datë 29.07.2019. Lidhur me këtë vendim, rezulton se nuk është dërguar pranë zyrës përmbarimore për kryerjen e veprimeve për arkëtimin e saj, veprim në kundërshtim me nenin 9 të ligjit me nr.	*Pika 2.6, faqe 91-175*	E lartë	1. Kryeinspektori i IMTV-së, të marrë masa për plotësimin e procedurave, duke vendosur masat e pezullimit për ndërtimet që kryhen pa lejet përkatëse. Të administrohet në dosjet e tyre praktika, duke bashkëlidhur fotografitë e kundërvajtjes ku të pasqyrohet fakti i evidentuar në procesverbalet e konstatimit. Të mbahet korrespodencë me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, ku çdo 3 muaj të përcillet informacioni periodik i aktivitetit të tyre. 2. Kryeinspektori i IMTV-së, të marrë masa për kontrollin e objekteve të pajisura me leje ndërtimi dhe në çdo rast të mbajë aktet e kontrollit ku të pasqyrohet situata e objektit në ndërtim dhe evidentimi i shkeljeve në rast konstatimi. 3. Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMT në vlerën 750,000 lekë.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò. 6. Për dy gjoba në vlerën 200,000 lekë total me kundërvajtës ñò shpk dhe ñM ï Koò shpk, rezulton se nuk është kryer asnjë veprim për arkëtimin e tyre. 7. Për një gjobë në vlerën 50,000 lekë me kundërvajtës ñA MKò, rezulton se është bërë kërkesë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, kërkesë e cila është rrëzuar nga kjo gjykatë. Kundër këtij vendimi është bërë ankimim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Gjithsesi, konstatohet se ky kundërvajtës ka marrë përsipër në vijim kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve për punët e prokuruara pranë Bashkisë Mallakastër dhe rrjedhimisht janë krijuar të gjitha kushtet për arkëtimin e këtij detyrimi, por rezulton se nuk janë kryer veprime nga punonjësit e kësaj bashkie. - Sa më sipër, vlera prej 750,000 lekë, përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Mallakastër, si rezultat e mosarkëtimit të tyre apo ndjekjes së procedurave për të bërë të mundur arkëtimin e tyre.			
23	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñNdërtim shëtitore nga shkolla ñOdiseaò deri tek varrezat e qytetitò, Bashkia Mallakastër, me vlerë të kontratës (me tvsh) 27,131,706 lekë, realizuar nga BOE ñShò Shpk, & ñAò Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 621,602 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1604 prot., datë 17.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër dhe BOE ñShò Shpk, & ñAò Shpk.	*Pika 2.2, faqe 91-175*	E lartë	Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 621,602 lekë pa tvsh nga BOE ñShò Shpk, & ñAò Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1604 prot., datë 17.07.2019, me objekt ñNdërtim shëtitore nga shkolla ñOdiseaò deri tek varrezat e qytetitò, Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
24	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñRikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja ñ5 Shkurtiòò, Bashkia Mallakastër, me vlerë të kontratës (me tvsh) 30,874,884 lekë, realizuar nga OE ñAò Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 225,914 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 462 prot., datë 15.02.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër dhe OE ñAò SHPK.	*Pika 2.2, faqe 91-175*	E lartë	Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 225,914 lekë pa tvsh nga OE ñAò Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 462 prot., datë 15.02.2019, me objekt ñRikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja ñ5 Shkurtiò, Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
				dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
25	Sipas të dhënave nga Drejtoria e Financës, ka pasur 5 raste të punonjësve që kanë ankimuar në gjykatë ndaj Bashkisë Mallakastër për largime nga puna pa shkaqe të arsyeshme ligjore, për të cilët ka përfunduar gjykimi dhe vendimi ka marrë formë të prerë për shumën 1,190,000 lekë, një pjesë e të cilave i përkasin periudhave të para këtij auditimi. Për likujdimin e detyrimit të mësipërm janë kryer pagesa pjesore në vlerën 839,199 lekë, që përbëjnë efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Mallakastër duke ndikuar në performancën financiare dhe funksionale të institucionit.	*Pika 2.2, faqe 91-175*	E lartë	Titullari i Bashkisë Mallakastër të marrë masat e nevojshme për analizimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, duke identifikuar personat përgjegjës dhe vendosjen e masave administrative ndaj tyre, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin Juridik të bashkëveprojnë për shmangien e penalizimeve të tilla financiare.
26	Nga auditimi, u konstatua se në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, Bashkia Mallakastër nuk ka krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku të përcaktohet numri i familjeve dhe sasia e sipërfaqes së banimit që ka secila familje, kujt viteve i përket banesa, para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, nuk është plotësuar rregullisht njoftimi i detyrimit për çdo familje, si për taksën e ndërtesës edhe për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit. Nga auditimi i taksës së ndërtesës, u konstatua një vlerë debitore prej 18,491,172 lekë, deri në datën 31.12.2021. Nga auditimi i tarifës së pastrimit, u konstatua një vlerë debitore prej 7,216,205 lekë, deri në datën 31.12.2021. Nga auditimi i tarifës së shërbimit vaditje+kullim, u konstatua një vlerë debitore prej 4,726,474 lekë, deri në datën 31.12.2021. Në total, vlera e paarkëtuar nga taksat dhe tarifat vendore të familjarëve, e cila përbën të ardhurave të munguara për Bashkinë Mallakastër është 30,433,851 lekë. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar. Nga auditimi, u konstatua se me ligjin 7501 ñPër tokënò, janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 7,402 familje dhe 10,270 hektarë tokë, për të cilat është planifikuar pagesa e taksës së tokës. Mesatarisht, për të gjithë periudhën objekt auditimi, taksa e tokës është arkëtuar rreth 52%. Nga 7,402 familje të trajtuara me tokë bujqësore, 4,880 familje janë debitore për këtë lloj takse. Shumë pak pagesa bëhen në mënyrë vullnetare, por kryesisht paguajnë familjet të cilat janë paraqitur në zyrat e bashkisë për probleme të ndryshme	*Pika 2.2, faqe 91-175*	E lartë	1. Bashkia Mallakastër, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. 2. Bashkia Mallakastër, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar/vjelë detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës debitore prej 30,433,851 lekë. 3. Bashkia Mallakastër, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK dhe Qarku Fier). Për familjet fermere debitore të nxirren

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	administrative dhe u është kërkuar kryerja e pagesës në këmbim të marrjes së shërbimit. Nga auditimi i taksës së tokës, rezultoi vlera totale debitore 68,669,251 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar. Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, nenet 4, 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj., ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, kreu VIII ñVlerësimi tatimorò, ligjin nr. 139/2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, ñPër Taksat Kombëtareò, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, ñPër Taksat Kombëtareò, etj.			njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë periudhën/vlerën e papaguar, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës debitore prej 68,669,251 lekë.
27	Nga auditimi i dokumentacionit të disponueshëm në zyrën e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Mallakastër u konstatua se për vitet 2018-2021 janë arkëtuar të ardhura në formën e tarifave të qirasë nga 211 subjekte që shfrytëzojnë toka bujqësore mbi bazë kontratash, akt-marrëveshjesh dhe kërkesash të depozituara pranë Bashkisë Mallakastër, kryesisht të mbartura nga ish komunat përpara reformës territoriale. Për vitin 2018 ka pasur gjithsej 211 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave publike, për një vlerë totale prej 1,384,087 lekë, nga të cilat janë pa likuiduar 83 subjekte, në vlerën progresive 1,641,750 lekë. Për vitin 2019 ka pasur gjithsej 210 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave publike, për një vlerë totale prej 1,370,087 lekë, nga të cilat janë pa likuiduar 98 subjekte, në vlerën progresive 1,987,751 lekë. Për vitin 2020 ka pasur gjithsej 210 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave publike, për një vlerë totale prej 1,370,087 lekë, nga të cilat janë pa likuiduar 88 subjekte, në vlerën progresive 1,935,270 lekë. Për vitin 2021 ka pasur gjithsej 211 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave publike, për një vlerë totale prej 1,384,087 lekë, nga të cilat janë pa likuiduar 88 subjekte, në vlerën progresive 2,218,252 lekë. Nga auditimi i të ardhurave të krijuara nga përdorimi i	*Pika 2.2, faqe 91-175*	E lartë	Bashkia Mallakastër të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 2,218,252 lekë, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave, (sipas normës së interesit të Bankës së Shqipërisë, plus tetë pikë përqindje) për të gjitha rastet e detyrimeve të paarkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	aseteve, u konstatua se vlera debitore progresive në datën 31.12.2021 është 2,218,252 lekë, e cila përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Sa më sipër, është në kundërshtim me: ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 ñKodi Civil i Republikës së Shqipërisëò i ndryshuar; ligjin nr. 48/2014 ñPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtareò; ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 ñPër tokënò, i ndryshuar; ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 ñPër tokat bujqësore të pandaraò, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 ñPër tokat bujqësore të pandaraò, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për tôu lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 ñPër procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandaraò, etj.			
28	Nga auditimi, u konstatua se për periudhën objekt auditimi, janë dhënë 864 leje legalizimi, për sipërfaqen e ndërtimit 178,768 m2 ndërtim, e cila duhet të paguante TNI në vlerën totale 28,242,660 lekë. Nga kjo shumë është likuiduar vlera prej 16,707,716 lekë, duke mbetur pa shlyer 381 posedues të lejeve të legalizimit për një sipërfaqeje prej 73,014 m2 me vlerë 11,534,944 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar. Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, ñPër legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeò i ndryshuar, neni 23, me VKM-në nr. 860, datë 10.12.2014 ñPër përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizimò, pika 5, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 27 ñTaksa e ndikimit në infrastrukturëò, pika 2/1, si dhe me VKB vjetore përkatëse për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Mallakastër. etj.	*Pika 2.2, faqe 91-175*	E lartë	Bashkia Mallakastër nëpërmjet bashkëpunimit institucional tôi kërkojë ASHK-së, Drejtoria Fier, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Mallakastër. Drejtoria e administrimit, zhvillimit të territorit dhe kadastrës, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e vlerës 11,534,944 lekë nga të gjithë individët e listuar si debitorë në Pasqyrën A15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, bazuar në legjislacionin tatimor.
29	Nga auditimi, rezultoi se në Bashkinë Mallakastër ka	*Pika 2.4,*	E lartë	Bashkia Mallakastër, të marrë

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	290 subjekte debitore nga biznesi (18 nga biznesi i madh, 263 nga biznesi i vogël, 2 institucione dhe 7 nga kompanitë e shfrytëzimit dhe përpunimit të naftës). Numri i debitorëve nga biznesi si në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hotelit, truallit, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie dhe kamatëvonesat përkatëse), në fund të vitit 2017 numri i debitorëve ka qenë 327 subjekte në vlerën totale 860,658,401 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 numri i debitorëve ka qenë 290 subjekte dhe vlera progresive ka qenë 1,137,138,382 lekë, (përfshirë vlerën 57,230,150 lekë, që është në proces gjyqësor dhe kamatëvonesat) e cila përfaqëson taksat dhe tarifat vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Nga auditimi, u konstatua se nuk është llogaritur dhe kontabilizuar vlera e gjobës (kamatëvonesës) për tatimpaguesit, në masën 0,06% për çdo ditë vonesë, deri në 365 ditë, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 114 ñMospagimi në afat i detyrimit tatimor apo ' kontributitò, pika 1. Kjo vlerë debitore, së bashku me kamatëvonesat, është e pakontabilizuar. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñPër sistemin e taksave vendoreò, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimoreò, me ndryshime, Kreut XI, ñMbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguaraò, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 ñKodi Penal i RShò me ndryshime neni 181, Ligji nr. 139/2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, i ndryshuar neni 9 ñTë drejtat dhe përgjegjësitëò pika 1.3., neni 35, ñTë ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendoreò, me ligjin nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 ñPër sistemin e taksave vendoreò, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.	*faqe 91-175*		masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pavjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura ndaj 290 subjekteve debitore në vlerën prej 1,137,138,382 lekë (sipas Pasqyrave bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit), duke ndjekur rrugët e mëposhtme: a. Tâı dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare. b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme). c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i tatim-taksave të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar. d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë Ekonomike e Çështjeve Sociale dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Mallakastër, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
30	Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Mallakastër ushtrojnë aktivitetin 12 subjekte të cilat tregtojnë hidrokarbure, karburante. Subjekte të liçencuar për tregtimin e	*Pika 2.4, faqe 91-175*	E lartë	Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet,

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	lëndëve djegëse nuk ka. Aktualisht, detyrimet për pajisjen me autorizim i kanë shlyer sipas përcaktimit në aktet nënligjore subjektet: N Shpk për dy pika shitjeje, L Shpk, K Shpk dhe B P Shpk. Për subjektet B Shpk, Sh 07 Shpk, B Shpk, A, O Shpk dhe E Shpk, është llogaritur pagesa në masën 200,000 lekë, për një periudhë 1 vjeçare, gjë që është e gabuar, pasi pavarësisht se nga autoriteti vendor përcaktohet kohëzgjatja e licencës së tregtimit, pagesa për licencimin nuk ndryshon. Nga auditimi i pagesave për pajisjen me licenca për tregtimin e hidrokarbureve, u konstatua se nuk është tarifuar ose është tarifuar gabim vlera totale 6,000,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa ñbò, pikat 9, 15.1 dhe 15.2.			vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifat e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej 6,000,000 lekë, sipas Anekseve bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Pasqyra A22. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.
31	Nga auditimi i 39 procedurave me vlerë kontrate 1,615,821 mijë lekë, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 7 procedura me vlerë kontrate 197,346 mijë lekë ose 12% e vlerës së kontratave të lidhura, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E-të) në vlerën 197,346 mijë lekë, respektivisht: 1. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ñShtresë tapeti i rrugëve të lagjes ñBò, të bulevardit qendror deri te shkolla ñOdiseaò, viti 2018, me fond limit 55,360 mijë lekë, me fitues BOE ñBò shpk & ñAò shpk me vlerë të ofertës 52,805 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave të DST për kualifikim, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E-të) në vlerën 52,805 mijë lekë. 2. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ñSistemi i ngrohjes dhe infrastruktura e bashkisëò Viti 2018, me fond limit 9,514 mijë lekë, me fitues OE ñShò shpk me ofertë 8,956 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet,	*Pika 2.4, faqe 91-175*	E lartë	Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E-të), 276,094 mijë lekë pa TVSH.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	eficencë dhe efektivitet (3-E-të) për vlerën 8,956 mijë lekë. 3. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ñNdërtim shëtitore nga shkolla ñOdiseaò deri te varrezat e qytetitò Viti 2019, me fond limit 26,665 mijë lekë, me fitues BOE ñShò shpk & ñAò shpk me ofertë 22,609 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave të DST për kualifikim, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E-të) për vlerën 22,609 mijë lekë. 4. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ñMateriale të ndryshme, çakull, stabilizant për mirëmbajtje rruge në fshatraò Viti 2019, me fond limit 25,000 mijë lekë, me fitues OE ñB 93ò shpk me ofertë 21,990 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave të DST për kualifikim, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E-të) për vlerën 21,990 mijë lekë. 5. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ñRehabilitimi i rrjetit ujitës Çorrushò Viti 2020, me fond limit 28,320 mijë lekë, me fitues BOE ñK.M.Kò shpk & ñ2 Nò shpk me ofertë 21,641 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave të DST për kualifikim, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E-të) për vlerën 21,641 mijë lekë. 6. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ñBlerje materiale të ndryshme, çakull, stabilizant, rërë bituminoze për mirëmbajtje rruge në fshatra, për nevoja të NSHPò Viti 2021, me fond limit 40,833 mijë lekë, me fitues OE ñShò shpk me ofertë 34,359 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave të DST për kualifikim, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E-të) për vlerën 34,359 mijë lekë. 7. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ñRikonstruksion i rrugës Bejar ï diga e rezervuaritò Viti 2021, me fond limit 59,394 mijë lekë, me fitues BOE ñKò shpk & C Mò shpk me ofertë 34,986 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave të DST për kualifikim, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E-të) për vlerën 34,986 mijë lekë.			

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 1 ñObjekti dhe qëllimiò pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 ñParimet e përzgjedhjesò shkronja (a), (b) dhe (c), nenin 46 ñKualifikimi i ofertuesveò pika 1, dhe nenin 55 ñShqyrtimi i ofertaveò pika 3.			
	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñNdërtim shëtitore nga shkolla ñOdiseaò deri tek varrezat e qytetitò, Bashkia Mallakastër, realizuar nga BOE ñShò Shpk, & ñAò Shpk, rezultoi se pemët e mbjella, të cilat në projektpreventiv janë përcaktuar ñFV pemë bliri me d=18 cm h>5 mò dhe në ofertë dhe situacion me vlerën 1,440,000 lekë pa TVSH, rezultojnë të jenë me diametër rreth 10 cm dhe mesatarisht me h ╔4 m. Vlera e mësipërme është shpenzim pa efektivitet i fondeve të Bashkisë Mallakastër.	*Pika 2.4, faqe 91-175*	E lartë	Kryetari i Bashkisë Mallakastër, në cilësinë e Titullarit të AK, të nxjerrë përgjegjësitë për marrjen në dorëzim të objektit jo sipas projektpreventivit dhe pa plotësuar specifikimet teknike të miratuara dhe të marrë masa që në ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim të objektit, të përcaktohen qartë detyrimet dhe përgjegjësitë për secilin anëtar, në mënyrë që objektet e ndërtuara me financim nga Bashkia, të shërbejnë sa më mirë komunitetit.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

I. Opinion iModifikuar (Kualifikuar) mbiPasqyratFinanciare:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Mallakastër, për vitet ushtrimore 2020 dhe 2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700, ISSAI 1705 dhe ISSAI 1200, shprehim një Opinion të Modifikuar për llogaritë vjetore e vitit ushtrimor 2021 të Bashkisë Mallakastër, duke arritur në përfundimin se anomalitë e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë përmbledhëse vjetore të vitit 2021, të cilat justifikojnë dhënien e **Opinionit të Modifikuar.**

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin ñ*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*ò, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10, ñ*Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t*ò, si dhe ISSAI 30 ñ*Kodi Etik*ò apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 ñ*Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare, Udhëzues për SAI-n*ò. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kualifikuar të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

1. Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Mallakastër, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në Bashki, vlera është 2,215,499,987 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 1,989,157,450 lekë, me një diferencë prej 226,342,537 lekë më shumë në PF në subjekt.

2. Në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra, në PF në Bashki, vlera është 348,120,020 lekë, ndërsa në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra në PF në sistemin e Thesarit vlera është 111,203,912 lekë, me një diferencë prej 236,916,108 lekë më pak në PF në sistemin e Thesarit. Llogaria 520 ñ*DisponibilitetenëThesar*ò, në PF në subjekt ka vlerën 223,825,807 lekë, ndërsa në PF në sistemin e Thesarit ka vlerën 0.

3.Llogaria 468 ñ*Debitorë të ndryshëm*ò në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën debitore 60,528,690 lekë. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari është pakësuar për vlerën 927,617 lekë dhe është shtuar për vlerën 98,599 lekë, me një rritje neto në vlerën 387,002 lekë, shumë e konstatuar nga debitorët për pagesat e tarifave të kopshtit dhe çerdhes.

Nga auditimi i të ardhurve, u konstatua vlera totale debitore 1,255,994,680 lekë, e cila është e pakontabilizuar.

4.Gjendja e llogarisë 210 ñ*Toka, Troje, Terrene*ò në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 309,970 lekë e pandryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Për këtë llogari në Bashkinë

Mallakastër nuk disponohet analizë.
5. Gjendja e llogarisë 211 ñ*Pyje kullota plantacione*ò në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 8,560,400 lekë e pandryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Për këtë llogari në Bashkinë Mallakastër nuk disponohet analizë.
6. Gjendja e llogarisë 212 ñ*Ndërtime e konstruksione*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 791,244,840 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 752,534,178 lekë, me një pakësim në vlerën 38,710,662 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 774,449,870 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 21,915,692 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.
7. Gjendja e llogarisë 213 ñ*Rrugë, rrjete vepra ujore*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 1,015,556,796 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 850,018,562 lekë, me një pakësim në vlerën 165,538,234 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 834,188,729 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 15,829,833 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.
8.Gjendja e llogarisë 218 ñ*Inventar ekonomik*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 20,174,831 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 20,646,231 lekë, me një pakësim në vlerën 471,400 lekë. Pakësimet në këtë llogari janë për vlerën e amortizimit. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 20,639,700 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 6,531 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.
9. Llogaria 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ò nuk paraqet vlerën reale për shumën **689,463,362 lekë** (621,858,000 lekë nga shoqëria UKM Sh.a.; 500,000 lekë nga shoqëria ñBò Sh.a. dhe 67,105,362 lekënga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Mallakastër)
10. Zëri ñ*Investime në procesò*, i përbërë nga llogaritë 230 ñ*Investime për aktive afatgjata jo materiale*ò dhe 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò, në datën 31.12.2020nuk paraqet vlerën reale, janë nënvlerësuar për 991,143,896 lekë, pasi duhet të pasqyronin vlerën 1,177,981,840 lekë, e cila përbëhet nga shuma e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Mallakastër.
11. Gjendja e llogarisë 466 ñ*Kreditorë për mjete në ruajtje*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 37,245,475 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 48,822,037 lekë ose me rritje në vlerën 11,576,562 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme, Për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, nuk është bërë zhbllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit, pavarësisht se është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës.
12.Për vitin 2021 kanë qenë në zbatim 17 kontrata, të lidhura gjatë vitit dhe në vitet ushtrimore të mëparshme, në vlerën totale 1,177,981,840 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Qeveria, FZHR dhe financime të huaja. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për tâu paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2021 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet nëllogarinë 476 ñ*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*ò.

II. Opinion i Modifikuar (Kualifikuar) përpërputhshmërinë:

Ne kemi audituar planifikimin e nevojave për investime, përputhshmërinë ligjore për zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin në terren të kontratave të punimeve të lidhura midis autoritetit kontraktor dhe operatorëve të shpallur fitues. Në opinionin tonë, përsa i takon shkallës së zbatimit të kuadrit rregullator për fushën e prokurimeve publike nga Bashkia Mallakastër, referuar kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 ñ*Për Prokurimin Publik*ò, i ndryshuar, ligjit nr. 162/2020 ñ*Për prokurimin Publik*ò, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, i ndryshuar, duke përjashtuar disa anomali materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar për fushën e zhvillimit të procedurave, ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme[1] për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 400 & ISSAI 4000), si më poshtë:

- Nga auditimi i **39** procedurave tenderimi për periudhën 01.01.2018-31.12.2021, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, **7** procedura, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë Prokurim të fondeve publike pa Ekonomicitet, Eficencë dhe Efektivitet (3-E-^{të}) **197,346 mijë lekë** pa TVSH.
- Në **15** raste, kriteret e vendosura nga NJP nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumet e punës.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Mallakastër:

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 08, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ò, i ndryshuar, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe këto çështje përshkruhen në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

[1] ISA 500-ISSAI 1500, kucilësohet se: ñ*Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mund të sigurojë evidence auditimi të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme*ò

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 57/1, datë 18.01.2022 ñ*Auditim financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Mallakastër*ò, i ndryshuar me shkresën nr. 57/2, datë 07.03.2022,të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Mallakastër nga data 19.01.2021 deri në datën 25.03.2022, u krye ñ*Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë*ò, për periudhën nga 01.01.2018 deri më 31.12.2021, nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. J. P, *Përgjegjës Grupi*
2. K. K.
3. Sh. H; dhe
4. A. Z, *anëtarë*.

Titulli: Auditim financiar dhe përputhshmërie.

Marrësi: Raporti i drejtohet subjektit të audituar, Bashkia Mallakastër.

1. Objekti i Auditimit

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitet 2020 dhe 2021, transaksionet financiere dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbime e investimeve për periudhën 01.01.2018 ï 31.12.2021.

2. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me: realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim; Auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e procedurave ligjore në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Planit të detajuar vendor; Auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e regjistrit të territorit. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në marrjen e vendimeve për leje zhvillimi, ndërtimi dhe përdorimi, etj.

Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Mallakastër, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë, z. Q. I, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. A. R, Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, ñ*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH*ò, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Mallakastër, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

6. Kriteret e vlerësimit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò;

<u>Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:</u>

- Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò

- Ligji nr. 99/2018, datë 31.12.2018 ñ*Për buxhetin e vitit 2019*ò, Ligji nr. 88/18.12.2019 ñ*Për buxhetin e vitit 2020*ò dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje.
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 ñ*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*ò
- Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 ñ*Per pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.903.2015;
- VKM 783 datë 22.11.2006 ñ*Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël*ò;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 ñ*Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore*ò;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 ñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*ò;
- UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*ò, etj;
- Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar;
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ò;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 ñ*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*ò ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
- Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 ñ*Për përgatitjen e buxhetit vendor*ò;
- Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 ñ*Për buxhetin e vitit 2018*ò, pikat 82-91 ñ*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*ò,
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*ò,
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 ñ*Për buxhetin e vitit 2019*ò, pikat 106-110, ñ*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*ò, dhe pikat 116-117- *Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore''*.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave, Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, ñ*Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive*ò), Fletore zyrtare 196/2014;

<u>Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:</u>

- Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar me ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006*ò, aktualisht i shfuqizuar;
- VKM nr. 248, date 10.4.1998 ñ*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre*ò i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñ*Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*ò;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ñ*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*ò;
- Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 ñ*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj*ò;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ò, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj;

- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 ñ*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*ò.

<u>Në fushën e prokurimeve publike:</u>

- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñ*Për Prokurimin Publik*ò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 ñ*Për Prokurimin Publik*ò;
- VKM 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020;
- Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 ñ*Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla*ò, i ndryshuar;
- Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 ñ*Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë*ò.

<u>Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:</u>

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në RSH*ò, i ndryshuarò;
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 ñ*Për Sistemin e Taksave Lokale*ò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, i ndryshuar
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre*ò, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, ñ*Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*ò;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar;

<u>Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:</u>

- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, ñ*Për kundërvajtjet administrative*ò;
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 ñ*Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë*ò;
- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, ñ*Për lejet e mjedisit*ò;
- Ligji Nr. 107-2014, ñ*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*ò;
- Ligji nr. 44/2015 ñ*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*ò;
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015, ñ*Për miratimin e manualeve të ndërtimit*ò;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ñ*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*ò, e përditësuar;
- VKM nr. 894, datë 4.11.2015 ñ*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*ò;
- Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

<u>Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:</u>

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 ñ*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*ò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, ñ*Për Nëpunësin Civil*ò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, ñ*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve*ò, i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, ñ*Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë*ò, i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, ñ*Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore*ò, i ndryshuar;

▪ *Rregullore e brendshme "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH";*

- *Rregullore e brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së";*
- *Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.*
- *Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;*
- *Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.*

7. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 ñ*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*ò, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 ñ*Udhëzues të Auditimit Financiar*ò;
- ISSAI 2300 ñ*Planifikimi I auditimit të pasqyrave financiare*ò;
- INTOSAI GOV 9100 ñ*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik"* si dhe INTOSAI GOV 9110 ñ*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*ò;
- ISSAI 400 ñ*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*ò, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 ñ*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*ò; si dhe ISSAI 4200 ñ*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*ò;
- INTOSAI ñ*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*ò; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiardhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktikatëmiratëfushës, simanualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

8. Metodat e auditimit

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

<u>Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin:</u>

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për tû audituar.

<u>Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:</u>

- ***Kontrolli aritmetik***

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

- ***Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese***

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò, i ndryshuar.

- ***Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese***

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

- ***Kontrolli i vlerësimeve***

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- ***Konfirmimi nga të tretët***

Transaksionet e përzgjedhura për tõju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- ***Kontrolli sipas një treguesi***

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna ñjashtë normalesò, të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- ***Intervista***
- ***Raporte dhe Informacione***
- ***Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK***

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimet e mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Projektraport Auditimi.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

- ***Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim***

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.
Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.
Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.
Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.
Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

- ***Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës***

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.
Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.
Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.
Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

- ***Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese***

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.
Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Mallakastër

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Zona Gjeografike: Mallakastra kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Fier, në jug me bashkitë Selenicë dhe Memaliaj, në lindje me bashkitë Poliçan dhe Berat, ndërsa në veri me bashkitë Patos dhe Fier. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Ballshit.

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia e re ka një popullsi prej 27.062 banorësh ndërsa në regjistrin civil rezultojnë 43.033 vetë si popullsi. Sipërfaqja e bashkisë së re është 329.19 km^2. Në bazë të censusit, densiteti i popullsisë është 82.45 banorë për km^2, ndërsa në bazë të regjistrit civil densiteti është 130.72 banorë për km^2.

Të dhëna të tjera: Zona e Mallakastrës është kodrinore me lartësi mbizotëruese 200-300 metra mbi nivelin e detit ndërsa pika më e lartë e krahinës është maja e Shëndëllisë në nivelin 712 metra.

Mallakastra është një zonë e rëndësishme e industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të naftës, si dhe një zonë bujqësore e blegtorale me përqendrim te drurët frutorë si ullinj, qershi, dardha e fiq.

Pas ndërtimit të superstradës së re Levan-Tepelenë disa vite më parë, Zona e Mallakastrës humbi funksionin e saj si zonë tranzitore në aksin nga Fieri drejt Gjirokastrës.

Për shkak të kushteve të vështira ekonomike gati gjysma e popullsisë së zonës ka migruar Shqipërinë qendrore ose ka ikur në emigrim. bashkia e re e Mallakastrës do të jetë pothuajse tërësisht një zonë rurale pasi qyteti i vetëm, Ballshi, kishte në censusin e vitit 2011 vetëm 7600 banorë ose vetëm 28 për qind të popullsisë të të gjithë bashkisë së re. Disa prej njësive administrative, si Ngraçani apo Selita, kanë popullsi të vogël prej pak qindra banorësh.[2]

Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

EmriiNjësive	Qytetetdhefshatratnëpërbërjetëtyre
Ballsh	QytetiBallsh
QëndërDukas	Visokë, Belishovë, Belistan, Drenovë, Drenovë Fushë, Kash, Usojë, Ngraçie, Lavdan, Lapulec, Lofkënd, Dukas
Greshicë	Greshicë, Greshicë e Re
Aranitas	Aranitas, Panahor, Kalenjë, Cfir, Metoh, Çyçen
Hekal	Hekal, Klos, Mollaj, Rromës
Ngraçan	Ngraçan, Riban
Kutë	Kutë, Drizar, Anëbreg, Çorrush, Poçëm
Fratar	Behaj, Damës, Gadurovë, Malas, Kremenar, Ninësh
Selitë	Selitë, Gjerbës, Kapaj, Çërrilë

Forma dhe mënyra e organizimit:

Struktura organizative aktuale është miratuar me Vendimin nr. 10, me nr. 2802 prot., datë 14.12.2020 ñ*Për miratimin e strukturës organizative dhe niveleve të pagave të Bashkisë Mallakastër dhe institucioneve në vartësi për vitin 2021*ò të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, sipas VKB nr 51, datë 25.11.2020 ñ*Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Mallakastër dhe institucioneve në varësi për vitin 2021*ò të KB Mallakastër, në numrin total 213 punonjës, së bashku me funksionet e deleguara dhe 168 punonjës të Ndërmarrjes së shërbimeve publike, e cila funksionon si njësi ekonomike e pavarur. Struktura e punonjësve është miratuar nga Prefekti Fier me shkresën nr. 1295/1 prot., datë 28.12.2020.

Kuadri ligjor:

Bashkia Mallakastër e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore për se cilën fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuara në programin e auditimit dhe në

[2] **Burimi:**https://portavendore.al/bashkia-mallakaster/

aneksin bashkëlidhur.
Kryetari Bashkisë Mallakastër është z. Q.I dhe Këshilli Bashkiak I Mallakastrës përbëhet nga 21 anëtarë, të cilët janë mandatuar në datën 30 korrik 2019.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditimi mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike:

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Mallakastër, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: ñ*Mjedisi i Kontrollit*ò, ñ*Menaxhimi i Riskut*ò, ñ*Aktivitetet e Kontrollit*ò, ñ*Informimi dhe Komunikimi*ò si dhe ñ*Monitorimi*ò, sipas përcaktimit të nenit 19 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 ñ*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, proçedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.
Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti "*Mjedisi i Kontrollit*":

Në lidhje me parimin 1: ñ*Angazhimin për integritet dhe vlerat etike*ò
Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

- Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.
- Për periudhën 2018-2021 ka pasur dy Rregullore të Brendshme, përkatësisht Rregullore e Brendshme miratuar me Vendimin nr. 04, datë 11.07.2018, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me Vendimin nr. 01, datë 18.05.2020. Nuk është miratuar Kodi i Etikës, por rregullat mbi etikën përshkruhen në rregulloren e brendshme. Nuk ka urdhër të titullarit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi, komunikimi mbi rregulloren e brendshme është kryer verbalisht.
- -Për ndëshkimin e rasteve korruptive ndiqen proçedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.
- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e

Sektorit të Marrdhënieve me Publikun), duke iâu adresuar strukturave të bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga Drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën. Kjo proçedurë është përcaktuar në nenin 16 të Rregullores së Brendshme.

- Ka proçes vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Nga drejtuesi i institucionit, duhet të sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin punonjës, në mënyrë që të sigurohet si duhet integriteti personal dhe etika profesionale, duke përjashtuar konfliktin e interesit në kryerjen e detyrave funksionale, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",* i ndryshuar, në lidhje me ñndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, dhe kontrollinò.

Në lidhje me parimin 2: ñ*Titullari demostron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje*ò

- Për vitet 2019-2021 nuk ka plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit, mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.
- Për periudhën 2018-2021, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit nuk janë hartuar çdo 4 - muaj, nuk ka raportime periodike por vetëm vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analizat faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe Këshillit Bashkiak. Për vitet 2019 ï 2021 raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar periodikisht dhe janë paraqitur pranë Këshillit Bashkiak si dhe në MFE. Ka Raportime periodike vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analizat faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe Këshillit Bashkiak.
- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për përformancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ndërsa nga shoqëritë e përbashkëta, ku bashkia është aksionere dhe nga ndërmarrjet në varësi të saj, bashkia merr raportime ne lidhje me vendim-marrjen e këshillit drejtues, por mungojne raportimet periodike për përformancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi subvencioni.
- Titullari merr opinione për përformancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe Njësia e Harmonizimit në MFE si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.
- Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3: ñ*Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë*ò

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se në 2 rregulloret e brendshme të Bashkisë Mallakastër ka mbivendosje të detyrave, kryerjen e funksioneve të caktuara që me ligj i ngarkohen strukturave të tjera, konkretisht:

- Në rregulloren e brendshme miratuar me Vendimin nr. 04, datë 11.07.2018, përgjegjësi dhe specialisti i burimeve njerëzore kanë mbivendosje të detyrave, si psh hartimin e programeve të trajnimit/planin e rekrutimit, në raste të caktuara parashikohet kryerja e detyrave të tjera që ngarkohen nga drejtuesi/përgjegjësi i sektorit, por pa i specifikuar detyrat përkatëse (me qëllim që mos të krijohen hapësira për interpretim/subjektivizëm), në rastin e detyrave të specialistit të kadastrës, ku parashikohet që mund të raportoj direkt në Këshillin

Bashkiak, pra duke anashkaluar hierarkinë e institucionit, përgjegjësin e sektorit, drejtorin e drejtorisë, në rastin kur ky specialist ngarkohet që të japë përgjigje ligjore dhe teknike për probleme të ndryshme të sektorit, ndërkohë që ka një strukturë mbështetëse (sektori juridik) i cili është i ngarkuar me ofrimin e shërbimit të këshillimit ligjor; Specialisti i zyrës në sektorin juridik, i cili ngarkohet me konfirmimin e bazës ligjore për çdo shkresë që del nga zyra, ndërkohë që specialisti jurist ka si detyrë ñ*Jep përgjigje ligjore dhe teknike për problemet specifike që mbulon sipas detyrave që i ngarkohen Brenda sektorit, si dhe përgatit propozime lidhur me trajtimin e cështjevë të ndryshme me karakter professional dhe teknik, sipas fushave që mbulon sektori*ò; Në emërtesën e Drejtorisë Juridike dhe marrëdhënieve me publikun, nuk parashikohet funksioni i menaxhimit të burimeve njerëzore, gjëndjes civile, sektori i IT, ndërkohë që këta sektorë janë në varësi të drejtorisë së mësipërme; Për specialistin në sektorin e statistikave parashikohet si detyrë hartimi i programeve vjetore, ndërkohë që këto detyra parashikohen për nivelin drejtues dhe jo zbatues; Specialisti i Buxhetit ka mbivendosje detyrash me Përgjegjësin e Sektorit të Financës, konkretisht në hartimin e kërkesave për shtesë fondesh buxhetore; Për llogaritarin përcaktohet si detyrë ñ*Mban evidencen e plotësimit organik të institucionit dhe në çdo rast që kërkohet nga eprorët raporton për këtë tregues*ò, ndërkohë që kjo detyrë duhet të përcaktohet për sektorin e burimeve njerëzore; Në drejtorinë e çështjeve sociale, përcaktohet si detyrë për drejtorin e drejtorisë, hartimi i planit të punës, por nuk parashikohet në bashkëpunim me përgjegjësat e sektorëve, të cilët janë më afër problematikave që krijohen gjatë zbatimit të planit të punës; Parashikohet si funksion ñ*Specialist për problemet e shëndetësisë*ò, ndërkohë që është funksion, i cili ushtrohet nga shërbimi parësor spitalor, si dhe bazuar në pikën 13 të nenit 23 në ligjin nr. 139/2015 ñ*Për Vetëqeverisjen Vendore*ò, i ndryshuar, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë si funksion: ñ*Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj*ò, pra në asnjë rast nuk parashikohet kryerja e funksioneve si: ñ*Krijon dosjen ligjore për çështjet e shëndetësisë. 2. Ndjek problematikën shëndetsore sipas ligjeve në fuqi*ò; Parashikohet pozicioni dhe funksioni i Inspektorit Pyjor Bashkiak, duke i dhënë të drejtën e marrjes së masave administrative, ndërkohë që sipas përcaktimit të bërë në nenin 6 dhe 7 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 ñ*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*ò, i ndryshuar (në fuqi për periudhën kur është përgatitur rregullorja e brendshme), shërbimi pyjor ndahet në funksione menaxhuese dhe kontrolluese, si dhe funksioni i kontrollit dhe marrjes së masave administrative ushtrohet nga policia pyjore, pjesë e inspektoratit përgjegjës për pyjet; Nuk parashikohen rregulla për raportimin e urdhërave të kundërshtuar.

- Në rregulloren e re miratuar me Vendimin nr. 01, datë 18.05.2020, konstatohet se ka mbivendosje të detyrave të përgjegjësit të sektorit të burimeve njerëzore me specialistin (të cituara edhe më sipër), përcaktohen si detyra për specialist të sektorëve të ndryshëm, ngarkimi i tyre për realizimin e detyrave të tjera që i kërkohen nga eprori, por të cilat nuk janë shprehur specifikisht; Për specialistin e kadastrës parashikohet kryerja e veprimeve kadastrale si: ñ*Pajis qytetarët, në bazë të ligjeve dhe rregullave, me vërtetime faktesh që kanë të bëjnë me posedim të sipërfaqeve të pronës private dhe tokës bujqësore*ò, ñ*lëshon kopje të hartave, plan-vendosjeve të objekteve sipas kërkesave të qytetarëve*ò, ndërkohë që këto funksione mbështetur në ligjin nr. 111/2018 ñ*Për Kadastrën*ò, neni 2, neni 3: ñ*Aktet kadastrale janë dokumentet zyrtare unike që Agjencia Shtetërore e Kadastrës lëshon për çdo pronar të pasurive të paluajtshme ose titullar të të drejtave reale mbi to. Këto akte përfshijnë: certifikatat, vërtetimet, ekstrakte të kartelës kadastrale, hartës kadastrale dhe akte të tjera të parashikuara në këtë ligj", "Hartë kadastrale" është harta shkresore dhe digjitale, në të cilën pasqyrohen kufijtë, përmasat, pozicioni gjeografik, në përputhje me rregullat dhe*

*standardet zyrtare për pasuritë e paluajtshme, si dhe tregues të tjerë. "Veprimtari kadastrale" është tërësia e akteve dhe veprimeve administrative, në bazë të këtij ligji, që kryhet nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e përditësimin e të dhënave kadastrale të çdo pasurie, si dhe për lëshimin e akteve kadastrale*ò; Për sektorin e AKU dhe Bujqësisë, parashikohen funksione si: Kontrolli i analizave laboratorike, kontrolli i sëmundjeve të kafshëve që janë ngjitëse për njeriun, kontrolli i etiketave të shitjes së mallraveò, etj, detyra të cilat sipas ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 ñ*Për ushqimin*ò, i ndryshuar dhe ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 ñ*Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, i përkasin Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe Drejtorive Rajonale të tij, si dhe shërbimit veterinar zyrtar.

- Lidhur me strukturën organizative të Bashkisë Mallakastër, ndërmarrjes dhe institucioneve në varësi, gjatë periudhës 2018-2021 ka pasur disa ndryshime:

Për vitin 2018 është miratuar me VKB nr. 64 datë 25.12.2017 dhe ka në përbërje të saj 434 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara.

Për vitin 2019 është miratuar me VKB nr. 91 datë 20.12.2018 dhe ka në përbërje të saj 434 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara.

Për vitin 2020 është miratuar me Urdhër nr. 104 datë 20.12.2019 dhe ka në përbërje të saj 439 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara.

Për vitin 2021 është miratuar me Urdhër nr. 51 datë 25.11.2020 dhe ka në përbërje të saj 465 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara.

Për periudhën objekt auditimi rezulton se, gjatë periudhës 2019-2021, ka pasur ndryshime të shpeshta të strukturës, në numrin e saj, por edhe në krijimin apo shkrirjen e sektorëve/drejtorive, çka në gjykimin e grupit të auditimit ndikon negativisht në performancën dhe realizimin e objektivave institucional, duke mos pasur qëndrueshmëri në numrin e punonjësve, krijimin e paqartësive si rrjedhojë e ndryshimeve të shpeshta.

Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, por është bërë pjesë e dokumentit e PBA-ve, si dhe nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme.

Për çdo drejtori janë përcaktuar objekti, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Mungon raporti i vlerësimit nga njësia e auditit të brendshëm për përputhjen e rregullores me strukturën organike.

Në lidhje me parimin 4: ñ*Njësia publike demostron angazhimin në realizimin e kompetencave*ò

- Në Bashkinë Mallakastër nuk është hartuar ñ*Harta e proçesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*ò, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve.
- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.
- Për bashkinë, Nëpunësi Autorizues është Kryetari i Bashkisë, si dhe Zëvendëskryetari për dy funksione (autorizuar nga Kryetari i Bashkisë), i cili është menaxheri i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.
- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale.

Në lidhje me parimin 5: ñ*Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale*ò

- Në Rregulloren e Brendshme është parashikuar ñ*Delegimi i kompetencave*ò në zbatim të ligjit 44/2015 ñ*Kodi i Proçedurave Administrative*ò si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokolli i institucionit rezulton se, nga NA për periudhën objekt auditimi ka patur 3 raste të delegimit të detyrave, konkretisht me Urdhër nr. 249, datë 01.08.2019 për

procedurat e prokurimit, Urdhër nr. 01, datë 21.01.2020 për nënshkrimin e disa shkresave ñ*kthim-përgjigje*ò, vërtetime, lëvizje të punonjësve, Urdhër nr. 02, datë 02.03.2020 për nënshkrimin e plan-vendosjeve të hartuara nga sektori i kadastrës.

- *Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS)*.

Në zbatim të nenit nr. 24 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor*ò, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 ñ*Për Menxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 ñ*Për proçedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore*ò, janë ngritur GMS vetëm për hartimin e PBA 2019-2021 dhe 2020-2022 dhe jo për PBA 2021-2023. Lidhur me përbërjen e GMS, në përgjithësi ajo është sipas përcaktimit të bërë në pikën 30 të Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 ñ*Për proçedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore*ò, ku drejtuesi i grupit është Kryetari i Bashkisë, si dhe ka përfaqësues nga të gjitha drejtoritë e bashkisë.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupi të Menaximit Strategjik (GMS) rezultoi se:

- Bashkia Mallakastër nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit përMenaxhimin Strategjikò.
- Nuk administrohen proçesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.
- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.
- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

II. Komponenti "*Menaxhimi i Riskut*":

Në lidhje me parimin 6: ñ*Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre*ò

- Nga Bashkia Mallakastër përcaktohen objektiva sasior (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxheteve vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nga Bashkia Mallakastër nuk ka plane operacionale të punës, si dhe nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar) të Bashkisë Mallakastër, sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të ligjit nr. 68/2017 ñ*Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*ò.
- Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla, kryesisht në planin e buxhetit vjetor me planin e buxhetit të parashikuar në PBA.

Në lidhje me parimin 7: ñ*Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave*ò

- Nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut.
- Në Bashkinë Mallakastër nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut, si dhe nuk ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut.
- Në Bashkinë Mallakastër nuk është krijuar regjistri i riskut.
- Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të proçesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet tû vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò, i ndryshuar ku citohet se: ñ*Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo*

*tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut*ò.

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht nëprogramin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dheprofesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel- it apo ŭ ord-it.
- Në Bashkinë Mallakastër, po ashtu Drejtoria Ekonomike për mbajtjen e Kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave e cila kryhet nga sektori i financës , niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Në bazë të këtij programi me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Ekonomike dhe hartimi i Pasqyrave Financiare, gjithashtu edhe Sektori i Tatim-Taksave operon me programin Excel për monitorimin e të ardhurave. Për cdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe me Agjentët Tatimorë.

Në lidhje me parimin 8: ñ*Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime*ò

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe proçedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë përiodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Në lidhje me parimin 9: ñ*Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm*ò

Bashkia Mallakastër nuk ka një sistem të kontrollit të brendshëm.

III. Komponenti: "*Aktivitetet e Kontrollit*":

Në lidhje me parimin 10: ñ*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli*ò

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për cdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proçeset e punës. Ekzistojnë proçedura të brendshme për proçeset e punës, si proçedurat standarte te zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të proçedurave administrative, etj.
- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, hartimi dhe rregjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.
- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimve/shërbimeve.
- Për çdo vit buxhetor hartohet rregjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhornohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e proçedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga dega e Thesarit dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.
- Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.
- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik*ò i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur rregjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe

pakësimet. Aktivet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit e bazës materiale. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

- Në përgjithësi për proçedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe për asgjesimin e tyre. Ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimit për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, proçesverbale dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe proçesverbalet për asgjesimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet kontabël përkatës.
- Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Mallakastër, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë sipas marrëveshjes së Bashkisë Mallakastër të bërë më këta agjentë. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar.
- Bashkia Mallakastër në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për cdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponilibiteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga bashkia.

Në lidhje me parimin 11: ñ*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë*ò

- Bashkia Mallakastër nuk ka proçedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka proçedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka proçedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.
- Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- Në Bashkinë Mallakastër nuk ka një proçedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.
- Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.
- Në strukturën e Bashkisë Mallakastër është vetëm 1 specialist IT, duke sjellë që i njëjti person të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI-së.

Në lidhje me parimin 12: ñ*Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe proçeduravе*ò

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë të Drejtorëve dhe Përgjegjësve të sektorëve, ku vihen re mbivendosje/mbingarkesë të funksioneve.
- Me vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve merret Drejtoria Ekonomike, duke iâu referuar dispozitave ligjore në fuqi dhe rregullores së brendshme.
- Ekzistojnë proçedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrolle dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditareve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Ekonomike.
- Nuk ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave

financiare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr. 8 datë 09.08.2018 ñ*Për hartimin e PF*ò). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti: "*Informimi dhe Komunikimi*":

Në lidhje me parimin 13: ñ*Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor*ò

Bashkia Mallakastër disponon faqen e saj zyrtare në internet ŭ ŭ ŭ .bashkiamallakastër.gov.al, ku pasqyrohet aktiviteti i saj si Rregullorja e Brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e Këshillit Bashkiak, buxheti vjetor, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për përformancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale.

Përdoret sistemi e-albania për deklarime online për të marrë dokumente të ndryshme informimi. Nëpërmjet sistemit on-line të informimit, Bashkia Mallakastër nuk ka krijuar të gjitha mundësitë për pjesëmarrjen e publikut dhe të gjitha palëve të interesuara në procesin e prioriteteve buxhetore, nuk ka shpallur publikisht kalendarin e dëgjesave publike për cdo drejtori, sipas programeve respektive për periudhen 2018-2021 si:

1. Dëgjesa publike për programin ñ*Paketa Fiskale*ò
2. Dëgjesa publike për programin ñ*Investime në infrastrukturë rrugore dhe transport publik*ò
3. Dëgjesa publike për programin ñ*Strehimi dhe Shërbimi Social*ò
4. Dëgjesa publike për programin ñ*Arsimi parashkollor dhe parauniversitar*ò dhe ñ*Shërbimet publike, investimet në Arsim*ò.

Për vitin 2018-2021 nga Bashkia Mallakastër (për vendimmarrje për dhënien e pasurive të paluajtshme me qira, buxhetin) nuk janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit.

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Në lidhje me parimin 14: "*Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor*ò.

Në lidhje me parimin 15: ñ*Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm*ò.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenet 164 ñ*Marrëdhëniet me publikun*ò.

Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Në Bashkinë Mallakastër punonjësit punojnë me këto sisteme informatike ŭ ord dhe Excel. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale.

Grupi auditues konstaton se, nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të email-it zyrtar të institucionit duke qënë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.

V. Komponenti: "*Monitorimi dhe Raportimi*":

Në lidhje me parimin 16: ñ*Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme*ò

- Proçedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion nuk konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, nuk administrohen plotësisht raportimet e drejtuesve të drejtorive

<u>përkatëse për përmbushjen e objektivave</u>.
- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili duhet të hartohet cdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efiçencës e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.
- Bashkia Mallakastër lidhur me pyetësorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MFE, me përjashtim të raportimit për vitin 2021. Këto mosveprime bien në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar.
- <u>Në Bashkinë Mallakastër mungojnë rregullat të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.</u>
- <u>Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit.</u>
- <u>Në Bashkinë Mallakastër aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë raportet e zbatimit për planet e menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.</u>

Në lidhje me parimin 17: ñ*Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë*ò
- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetsorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm.Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eleminimin e tyre.

<u>Titulli i gjetjes:</u>KLSH ka konstatuar se, në Bashkinë Mallakastër funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ka shfaqur mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht.

<u>Situata:</u>Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, gjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa proçedura në lidhje me 5 komponentët si:

<u>"Mjedisi i kontrollit":</u>
- Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.
- Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.
- Nuk janë përcaktuar objektivat konkret, të matshëm, për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.
- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.
- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të bashkisë në të cilin është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij

<u>"Menaxhimi i Riskut":</u>

- Nuk ka strategji të menaxhimit të riskut, si dhe rregjistër risku, sipas nenit 21 i ligjit nr. 10296 datë 8.07.2010 ñ*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò, i ndryshuar.

Proçesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse në kundrshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 ñ*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò, i ndryshuar, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, si dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 ñ*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut njësitë publike*ò. Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Në Bashkinë Mallakastër, Drejtoria Ekonomike, Sektori i Financës dhe Sektori i Tatim Taksave nuk përdorin program për mbajtjen e kontabilitetit por operojnë me programin Excel ku niveli iriskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

- Nuk ka asnjë proçedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.
- Nuk është hartuar një regjistër kompleks për gjithë bashkinë, ku të identifikoheshin dhe të bëhej vlërësimi i risqeve për të gjitha Drejtoritë e NJA si dhe një plan-menaxhimi të risqeve në nivel bashkie për përcaktimin e veprimeve për të adresuar mangësitë.
- Mungesa e hartimit të regjistrit të riskut dhe i plan-veprimit të menaxhimit të MFK dhe riskut, ka sjellë mosindetifikimin dhe vlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut.
- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe proçedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë përiodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

"Aktivitetet e Kontrollit":

- Bashkia Mallakastër nuk ka proçedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Çdo sistem ka proçedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka proçedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.
- Nuk ka një proçedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqsish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.
- Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi ka vetëm një specialistë që mund të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, testimin, menaxhimin e Serverit qendror, sigurimin, mirmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj.

"Informimi dhe komunikimi":

- Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.
- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për përformancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.
- Në Rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohej me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

"Monitorimi":

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.
- Në Bashkinë Mallakastër mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e

Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Në Bashkinë Mallakastër aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi Z. A,K, ish Kryetari i Bashkisë Mallakastër deri në Gusht të vitit 2019; Z. Q.I, Kryetari në detyrë i Bashkisë Mallakastër; Z. A.R në funksionin e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike; Z. E.I, Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm, për detyrat që ngarkohen ndaj këtij sektori në hartimin e rregjistrit të riskut; Z. N. S, konceptues i rregullores së brendshme; Zj. V. L, Specialiste Juriste, konceptuese e rregullores së brendshme; Zj. R. O., Drejtor i Drejtorisë Juridike, në kuptim të detyrave të përcaktuara në nenin 29 në rregulloren e brendshme miratuar me Vendimin nr.04, datë 11.07.2018, në fuqi deri në miratimin e rregullores së re.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 12-28

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò i ndryshuar.Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Mallakastër.

Ndikimi/Efekti: Mosnjohje e plotë dhe sa duhet e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar nga niveli i lartë drejtues i kritereve të MFK, duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Shkaku: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia:E mesme

Rekomandim 1: Nga Titullari i Bashkisë Mallakastër, me atributet e Kryetarit të GMS dhe të Nëpunësit Autorizues të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin strategjisë së risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Rekomandim 2: Nga Bashkia Mallakastër, të kryhen investime në programe kompjuterike të liçencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryhen procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimesh për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve për realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Të vendoset një sistem komunikimi, i cili të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Rekomandim 3:Të kryhen ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit, për ato funksione të cilat me ligj janë kompetencë e institucioneve të tjera duke rishikuar edhe strukturën e bashkisë me qëllim alokimin eficient të burimeve njerëzore.

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm:

Në zbatim të programit të auditimit sa i përket çështjes mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së kësaj njësie, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njësisë AB të Bashkisë Mallakastër;
2. Planet Strategjike dhe vjetore, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmoizimit të Auditit të Brendshëm;

5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Disa prej dosjeve të auditimit (IMTV, Policia Bashkiake, Sektori i Tatim-Taksave, Drejtoria e Çështjeve Sociale, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Arsimit);
7. Projektraportet dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësive publike;
8. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.

Në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñ*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brëndshëm në Sektorin Publik*ò, është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100, i Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm. Ky sektor gjatë periudhës 2018-2021, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të VKB nr. 64, datë 25.12.2017, nr. 19, datë 20.12.2018, nr.104, datë 20.12.2019 dhe ka pasur numër punonjësish përkatësisht, 3 për vitin 2018 (duke përfshirë edhe drejtuesin e njësisë së auditimit), 3 për vitin 2019, 2 për vitin 2020 si dhe 2 për vitin 2021.

Gjatë periudhës 2018-2021, drejtuesit e Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Mallakastër, janë D. B., përkatësisht drejtues i njësisë deri më datë 13.08.2019, si dhe Edmond Iljazi emëruar me Urdhërin nr. 316, datë 22.06.2020 dhe Urdhërin nr.452, datë 21.09.2020, drejtues i njësisë deri më 31.12.2021.

Struktura e njësisë AB për periudhën 2018-2021, është paraqitur në **Pasqyrën AB1**, në Anekset bashkëlidhur.

2.1.3. Vlerësimi i veprimtarisë t ënjësisë së auditit të brendshëm:

Gjatë periudhës 2018-2021, nga sektori i auditit të brendshëm pranë Bashkisë Mallakastër, janë kryer gjithsej 18 auditime, ndarë si më poshtë vijon:

Viti 2018, plani vjetor i auditimeve i miratuar me shkresën nr. 1619/1 prot., datë 16.10.2017, sipas të cilit janë planifikuar për tâu audituar, e paraqitur në **Pasqyrën AB2**, në Anekset bashkëlidhur.

Viti 2019, plani vjetor i auditimeve i miratuar me shkresën nr. 2025/1 prot., datë 19.10.2018, sipas të cilit janë planifikuar për tâu audituar, e paraqitur në **Pasqyrën AB3**, në Anekset bashkëlidhur.

Viti 2020, plani vjetor i auditimeve i miratuar me shkresën nr. 2235/1 prot., datë 17.10.2019, sipas të cilit janë planifikuar për tâu audituar, e paraqitur në **Pasqyrën AB4**, në Anekset bashkëlidhur.

Viti 2021, plani vjetor i auditimeve i miratuar me shkresën nr.2212/1 prot., datë 20.10.2020, sipas të cilit janë planifikuar për tâu audituar, e paraqitur në **Pasqyrën AB5**, në Anekset bashkëlidhur.

- Plani strategjik 2018-2020 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2018 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 1819/1 prot., datë 18.10.2017. Për aktivitetin e vitit 2018 është raportuar pranë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 52/1 prot., datë 14.02.2019.
- Plani strategjik 2019-2021 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2019 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 2025/2 prot., datë 19.10.2018. Për aktivitetin e vitit 2019 është raportuar pranë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 112/1 prot., datë 14.02.2019.
- Plani strategjik 2020-2022 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2020 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr.

2235/2 prot., datë 17.10.2019. Për aktivitetin e vitit 2020 është raportuar pranë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 126/1 prot., datë 15.02.2021.

- Plani strategjik 2021-2023 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2021 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 2212/2 prot., datë 20.10.2020. Për aktivitetin e vitit 2021 është raportuar pranë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 165/1 prot., datë 14.02.2022.
- Karta e auditimit të brendshëm është miratuar me shkresën nr. 2025/3 prot., datë 14.09.2018.

Nga auditimi i raportimit 2018-2021, rezulton se janë dhënë 226 rekomandime gjithsej, nga të cilat janë pranuar 169 prej tyre ose 74%. Nga rekomandimet e pranuara janë zbatuar 68 prej tyre ose 40%, në proces zbatimi 101 ose 60%, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në **Pasqyrën AB6**, në Anekset bashkëlidhur.

Titulli i Gjetjes: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm Publik.

Situata: Struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, sa i përket numrit të punonjësve dhe certifikimit të tyre në periudha të caktuara nuk ka qenë në përputhje përcaktimet ligjore, të cituara më sipër rast pas rasti.

- Nuk janë kryer auditime të zbatimit të rekomandimeve, të teknologjisë së informacionit dhe prokurimeve.
- Në raste të caktuara nuk janë zbatuar planet e auditimit;
- Për periudhën 2018-2021, rreth 60% e fushave të aktivitetit të Bashkisë Mallakastër, të vlerësuara me risk të lartë nuk janë mbuluar me auditim.

Më hollësisht si vijon:

- Për periudhën nga data 13.08.2019-23.06.2020, pozicioni i drejtuesit të sektorit të auditit të brendshëm ka qenë vakant dhe për këtë nuk janë marrë masa për plotësimin e tij;
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13 të ligjit nr. 114/2015 ñ*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*ò;
- Karta e auditimit të brendshëm nuk është sipas formatit të miratuar në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë ñ*Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm*ò, miratuar me urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016ò;
- Drejtuesi i Sektorit të Auditit të Brendshëm, z. E. I, emëruar me Urdhërat nr. 316, datë 22.06.2020 dhe nr. 452, datë 21.09.2020, nuk ka pasur formimin arsimor të kërkuar dhe nuk ka qenë i certifikuar si auditues i brendshëm;
- Për periudhën Gusht-Dhjetor 2021 numri i punonjësve në sektorin e auditit të brendshëm nuk është sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 3.2.2016 ñ*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*ò, sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës, ndërkohë kanë qenë dy të punësuar;
- Plani strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2019-2021, por nuk është përpiluar në përputhje me standartin e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6, mungon identifikimi i subjekteve, prioritetet;
- Planifikimet vjetore të auditimeve për vitin 2019 - 2021 edhe pse janë përgatitur rregullisht, ata nuk janë përpiluar në përputhje me Formatin Standard 5: Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NJAB përcaktuar në MAB, konkretisht jepet informacion vetëm për fushat që do të auditohen, llojet e auditimit dhe numrin e tyre, pra jo për zhvillimet aktuale të NJAB, objektivi (at) kryesore për vitin, sigurimi i brendshëm i cilësisë;
- Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2018-2021 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së përcaktuar në shkronjën ñçò të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, ñ*Për Auditin e*

*Brendshëm Publik*ò, pasi nuk jepet informacion për shmangiet nga plani, arsyet dhe argumentet përkatëse; veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar;

- Plani strategjik 2020-2022 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2020 nuk është hartuar nga drejtuesi i sektorit të auditimit të brendshëm, por nga specialisti i saj, në kundërshtim me përcaktimin e bërë shkronjën ñcò të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, ñ*Për Auditin e Brendshëm Publik*ò;
- Nuk ka gjetur zbatim Urdhri nr. 4, datë 10.01.2020 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë ñ*Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm*ò, miratuar me urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016ò, lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2021, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.
- Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore, por mbahen në ambientet e brendshme të Sektorit të Auditit të Brendshëm në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 ñ*Për arkivat*ò.
- Dosjet e përhershme për çdo njësi publike të audituar nuk janë çelur elektronikisht dhe manualisht për tëi shërbyer auditimit pasardhës, veprim që bie në kundërshtim me MAB, Kapitulli nr. VI, pika 6.3;
- Në auditimet e kryera për periudhën e vitit 2018-2021**,** konstatohet se Sektori i Auditit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. Kjo ka sjellë që titullari i njësisë të mos informohet mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera, në kundërshtim me neni 6 gërma ñçò e ligjit nr. 114/2015, ñ*Për Auditin e Brendshëm Publik*ò;
- Nuk janë kryer auditime të teknologjisë së informacionit;
- Për vitin 2018 nuk është realizuar auditimi i fondeve të BE-së, në përputhje me planin vjetor të vitit 2018 miratuar me shkresën nr. 1619/1 prot., datë 16.10.2017, si dhe konstatohet që është kryer auditim për sektorin e tatim-taksave, por nuk administrohet relacion për ndryshimin e planit të auditimeve, apo të jetë bërë ndryshimi i planit të auditimeve.

Auditimet e planifikuara dhe të realizuara për vitin 2018 janë përaqitur në **Pasqyrën AB7**, në Anekset bashkëlidhur.

- Për vitin 2019 nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara, konkretisht janë planifikuar për tu kryer 9 auditime dhe janë kryer 6 gjithsej. Gjithashtu konstatohet se, nuk janë kryer auditime për sektorin e prokurimeve, shërbimin zjarrfikës, drejtorinë ekonomike, drejtorinë juridike, por janë kryer auditime të cilat nuk janë planifikuar në planin vjetor 2019, si drejtoria e infrastrukturës, policia bashkiake, qendra kulturore e fëmijëve.

Auditimet e planifikuara dhe të realizuara për vitin 2019 janë përaqitur në **Pasqyrën AB8**, në Anekset bashkëlidhur.

- Për vitin 2020 nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara, konkretisht janë planifikuar për tu kryer 7 auditime dhe janë kryer 2 gjithsej.

Auditimet e planifikuara dhe të realizuara për vitin 2020 janë përaqitur në **Pasqyrën AB9**, në Anekset bashkëlidhur.

- Për vitin 2021 nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara, konkretisht janë planifikuar për tu kryer 6 auditime dhe janë kryer 3 gjithsej.

Auditimet e planifikuara dhe të realizuara për vitin 2020 janë përaqitur në **Pasqyrën AB10**, në Anekset bashkëlidhur.

- Për vitin 2018, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim 9 fusha të aktiviteteve që kryen Bashkia Mallakastër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë.

Fushat e aktiviteteve të pambuluara me auditim gjatë vitit 2018 janë paraqitur në **Pasqyrën AB11**, në Anekset bashkëlidhur.

- Për vitin 2019, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim 9 fusha të aktiviteteve që kryen Bashkia Mallakastër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë.

Fushat e aktiviteteve të pambuluara me auditim gjatë vitit 2019 janë paraqitur në **Pasqyrën AB12**, në Anekset bashkëlidhur.

- Për vitin 2020, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim 9 fusha të aktiviteteve që kryen Bashkia Mallakastër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë.

Fushat e aktiviteteve të pambuluara me auditim gjatë vitit 2020 janë paraqitur në **Pasqyrën AB13**, në Anekset bashkëlidhur.

- Për vitin 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim 9 fusha të aktiviteteve që kryen Bashkia Mallakastër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë.

Fushat e aktiviteteve të pambuluara me auditim gjatë vitit 2021 janë paraqitur në **Pasqyrën AB14**, në Anekset bashkëlidhur.

Në dosjet e përzgjedhura për auditim, u konstatua se:

1.Në dosjen e auditimit të Sektorit të Tatim-Taksave, nuk administrohet vlerësimi i riskut, nuk dokumentohen metodat e përdorura në auditim, nuk janë dhënë rekomandimet në përputhje me llojin dhe natyrën e gjetjes, konkretisht për gjetjet nr.14 dhe 20, në të cilat ka rezultuar se, nuk janë aplikuar tarifat e pastrim, gjelbërim, ndriçim për subjekte që kanë marrë leje ndërtimi për kryerjen e punimeve, si dhe në gjetjen nr.20 ka rezultuar se UK Mallakastër në rolin e agjentit tatimor, nuk ka mbledhur detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për familjarët, nuk administrohet shkresa ñ*Kthim-përgjigje*ò e subjektit të audituar mbi pranimin e rekomandimeve dhe masave që do të merren për zbatimin e tyre, si dhe njoftimi që duhet të kryejë drejtuesi i njësisë së auditimit ndaj titullarit të njësisë publike, në rastet kur subjekti i audituar nuk njofton për planin e masave.

2. Në auditimin e Drejtorisë së Sportit, nuk administrohet njoftimi për fillimin e auditimit, vlerësimi i riskut, nuk dokumentohen metodat e përdorura në auditim.

3. Në dosjen e auditimit të Policisë Bashkiake, nuk është i nënshkruar nga grupi i auditimit programi auditues, nuk administrohet vlerësimi i riskut, nuk dokumentohen metodat e përdorura në auditim.

Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuara si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohen me përgjegjësi Z. A. K., ish Kryetari i Bashkisë Mallakastër deri në Gusht të vitit 2019; Z. Q.I, Kryetari në detyrë i Bashkisë Mallakastër;Z. D. B., ish Pergjegjës Sektori i NJAB deri në 13.08.2019; Z. E.I, Përgjegjës i Sektorit të NJAB deri në 31.12.2021; Zj. A. B, Specialist i Sektorit të NJAB; Zj. V. S, Specialist i Sektorit të NJAB deri në Gusht të vitit 2021.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 12-28

Kriteri: Shkronja ñçò në nenin 6, nenin 13, shkronjat ñcò dhe ñçò në nenin 14, shkronja ñeò në nenin 16 të Ligjit nr. 114/2015 ñ*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*ò; Pikën 3 të VKM nr. 83, datë 3.2.2016 ñ*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*ò; Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë ñ*Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016*ò; Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, Kapitulli II, pika 8, Kreu 2.2.2, shkronjat ñaò dhe ñdò, Kreu 2.4.4, Kapitulli III ñ*Plani i auditimit duhet të përgatitet mbi bazë risku – e thënë ndryshe auditimi i brendshëm fokusohet në ato sisteme/fusha ku gjërat ka të ngjarë të mos bëhen siç duhet ose siç janë parashikuar*ò, Kapitulli III, pika 3.1.6; Kreu 3.1.3 Faza 3 ñ*Strategjia e Auditimit (frekuenca e kryerjes së auditimeve)*ò, Kreu 3.5 ñ*Rishikimi i planeve strategjikë dhe vjetorë të auditimit të brendshëm*ò, Kreu 4.1.2-Hapi 1, Kreu 4.1.8- Hapi 7, Kreu 4.1.12- Hapi 11, Kreu 4.1.13-Ndjekja e rekomandimeve, Kreu 4.1.13.1-Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit ñ*Në qoftë se njësia e audituar nuk përgjigjet me shkrim lidhur me pranimin dhe*

*masat për zbatimin e rekomandimeve, drejtuesi i NjAB-së informon titullarin e njësisë publike, në fushën e përgjegjësisë shtetërore të të cilit bën pjesë njësia e audituar që menaxheri i lartë nuk ka përmbushur përgjegjësitë e tij ligjore*ò, Kreu 6.1, 6.3, Formati Standard 5: Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NJAB.
Ndikimi/Efekti: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institiucioni. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë.
Shkaku: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.
Rëndësia: E mesme
Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut, ku të planifikojë auditime tematike për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, si dhe të kryejë proçesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.
Rekomandimi:Të marrë masa për të arkivuar në arkivin e instuticionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*", ligjet vjetore "*Për buxhetin e shtetit*" të vitit, 2020 si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitet 2020 dhe 2021:

Për periudhën 2020-2021 PBA dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr. 106 datë 20.12.2019 (PBA 2020-2022 dhe buxheti vjetor) dhe VKB nr. 61, datë 23.12.2020 (buxheti vjetor 2021). Gjithashtu janë konfirmuar me shkresat e Prefektit të Qarkut Fier, respektivisht shkresat, nr. 1962/1 prot., datë 30.12.2019 dhe nr. 1314/1 prot., datë 30.12.2020. Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, reabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Mallakastër.
Fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:

a. *Infrastruktura rrugore;*
b. *Furnizimi me ujë të pijshëm;*
c. *Ujitja dhe Kullimi;*
d. *Shërbimi zjarrfikës;*

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 23 datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësive të Qeverisjes Vendore*ò. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion *(kontratat në vazhdim),* angazhimet *(detyrimet e prapambetura sipas llojit)*, tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme *(kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme)*.

Programi i të ardhurave për vitet 2020-2021 është bërë mbi bazën e paketave fiskale të miratuar me VKB nr. 103, datë 20.12.2019 dhe VKB nr. 50, datë 25.11.2020.
Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.
Burimet e financimittëbuxhetittëbashkisëpërperiudhën 2020-2021, vijnëngadyburime:
Nga burimet e vetavendore, kupërfshihëntëardhuratngataksatvendoredhetaksat e ndara, tëardhuratngatarifatvendore, tëardhuratëtjera, donacionedhetëardhuraqëtrashëgohen.
Nga burimetqendrore, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta specifike përfunksionët e reja, që i janë transferuar bashkisë dhe transferta e kushtëzuar.
Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitet 2020-2021, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor, si dhe programet ekonomike që menaxhon Bashkia Mallakastër për periudhën 2020-2021 janë paraqitur në **Pasqyrën B1**, në Anekset bashkëlidhur.
Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe 2021-2023, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezulton se ka diferenca në programe të ndryshme buxhetore, ku veç atyre programeve për të cilat Bashkia Mallakastër nuk mund të bëjë planifikim të saktë të fondeve që do të shpenzohen (investime të reja gjatë vitit buxhetor me fonde të Ministrisë së linjës), ka programe si, aparati, menaxhimi i mbetjeve, shërbime publike, për të cilat Bashkia Mallakastër gjatë vitit buxhetor nuk ka pritshmëri për alokim të fondeve shtesë. Këto diferenca në gjykimin e grupit të auditimit tregojnë pasaktësi në planifikimin e fondeve buxhetore në PBA krahasuar me planin e buxhetit vjetor.
Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore, të pasqyruara në **Pasqyrën B1**, në Anekset bashkëlidhur. Kështu për periudhën 2020-2021 Bashkia Mallakastër ka planifikuar të arkëtojë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në **Pasqyrën B2**, në Anekset bashkëlidhur.

Titulliigjetjes: Zbatimi i Procedurave në përgatitjen e PBA 2020-2022 dhe 2021-2023.
Situata: Nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA 2020-2022 dhe PBA 2021-2023, në veçanti u konstatua se:
- Përvitin 2020, buxheti vjetor nuk është miratuar me vendim të veçantë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 9 të Kreut I në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 ñ*Për rprocedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afat mesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*ò;
- Për PBA 2020-2022 dhe PBA 2021-2023 nukjanëkryerkonsultime me komunitetin dhe grupet e interest të Bashkisë Mallakastër, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën ñçò të nenit 5 në Ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e Vetëqeverisjes Vendore*ò;
- Për PBA 2020-2022 dhe Buxhetin vjetor 2020 nuk ka gjeturzbatimpërcaktimiibërënëpikën 1 tënenit 33 të Ligjit nr. 68/2017 ñ*Për financat e Vetëqeverisjes Vendore*ò, sivijon: ñ*Kryetari i njësisësë vetëqeverisjes vendore* ***përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afat mesëm dhe të buxhetit vjetor****, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedura tstandarde për përgatitjen e kërkesave buxhetor etë programit buxhetor afat mesëm qendror e vendor*ò;
- Nuk administrohet dokumenti përfundimtari PBA përperiudhën 2021-2023, por në dosje administrohet vetëm VKB që kanë miratuar buxhetin vjetor 2020, PBA 2020-2022 dhe buxhetin vjetor 2021. Lidhur me PBA 2021-2023 nga Bashkia Mallakastër na u

vendosnëdispoziciondokumentinëformatin EXCEL përpasqyrat e PBA 2021-2023, në kundërshtim me pikën 6 në Kreun I të Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afat mesëm të njësive të vetë qeverisjes vendore*ò;

- Për PBA 2020-2022 dhe 2021-2023 nukadministrohet VKB përmiratimin e tavaneve përgatitore dhe përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, në kundërshtim me përcaktimin e bërë pikën 6 në nenin 34 dhe pikën 1 në nenin 37 të Ligjit nr. 68/2017 ñ*Për financat e Vetëqeverisjes Vendore*ò;
- Për PBA 2020-2022 dhe 2021-2023 nuk ka gjetur zbatim për caktimi i bërë në pikën 1 tënenit 35 të Ligjit të mësipërm, pasi nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;
- Për PBA 2021-2023 nga Kryetari i Bashkisë nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit Brenda njësisësë vetëqeverisjes vendore, në kundërshtim me përcaktimin e bërënëpikën 29 nëUdhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standard e të përgatitjes së programit buxhetor afat mesëm të njësive të vetë qeverisjes vendore*ò.
- Për PBA 2020-2022 dhe 2021-2023 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e përcaktuaranëshkronjat ña-hò tëpikës 38 nëUdhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afat mesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*ò, përdrejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetoretë Bashkisë Mallakastër, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë proçesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Mallakastër, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;
- Në PBA 2020-2022 dhe 2021-2023, sidhebuxhetetvjetoretëvitit 2020 dhe 2021, nuk janë planifikuar fonde për investime në fondin pyjor, në kundërshtim me përcaktimet e bëranëpikën 5 tënenit 23 nëLigjin nr. 9385, datë 4.5.2005 ñ*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*ò, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri mëdatë 12.06.2020, sidhenëpikën 3 tënenit 13 nëLigjin nr. 57/2020 ñ*Përpyjet*ò, hyrënëfuqimëdatë 13.06.2020.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 28-51

Kriteri: Shkronja ñçò e nenit 5, pika 1 e nenit 33, pika 6 e nenit 34, pika 1 e nenit 35, pika 1 e nenit 37, pika 2 e nenit 39 dhe pika 3 e nenit 41, nëLigjin nr. 68/2017 ñPërfinancat e VetëqeverisjesVendoreò; Pika 5 e nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 ñ*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*ò, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 ñ*Për pyjet*ò, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 29, shkronjat ña-hò të pikës 38 në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*ò.

Ndikimi/Efekti: Planifikim jo i saktë dhe real i kërkesave buxhetore, si dhe moskryerjen e investimeve në fusha të caktuara të aktivitetit të Bashkisë Mallakastër.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia:E mesme

Rekomandim 1: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesë dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Mallakastër.

Rekomandim 2:Për çdo vit buxhetor të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Mallakastër.

2.2.2. a) Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura:

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit parardhës.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të KB.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Mallakastër dhe janë të raportuara periodikisht në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuara sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për periudhën 2020-2021, rezultoi se është realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Mallakastër ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Fier.

U verifikuan situacionet mujore të rakorduara me Degën e Thesarit Mallakastër dhe u gjetën të rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave nga taksat dhe tarifat e Bashkisë dhe nga grantet. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të Bashkisë Mallakastër janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit Mallakastër, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, në Bashkinë Mallakastër rezultoi se:
Për vitin 2020, totali i shpenzimeve të planifikuara përbëhet nga:
Të ardhurat e trashëguara nga viti 2019 në vlerën 70,000,000 lekë;
Transferta e pakushtëzuar 158,882,000 lekë;
Transferta specifike në vlerën 113,695,000 lekë;
Transferta e kushtëzuar 223,142,913 lekë;
Të ardhurat e planifikuara për tû mbledhur gjatë vitit në vlerën 361,157,706 lekë;

Total për tu shpenzuar 926,877,619 lekë.

Gjatë vitit 2020 buxheti i Bashkisë Mallakastër ka pësuar **5 ndryshime**, me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, konkretisht:
Me VKB 18.02.2020, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për transferta në familje, individ, në vlerën 2,000,000 lekë gjithsej.
Me VKB nr. 10 datë 24.02.2020, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për blerje karburant, mjete teknologjike, çakull në vlerën 19,182,888 lekë gjithsej.
Me VKB nr. 16 datë 25.03.2020, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve në blerjen e ushqimeve në vlerën 960,000 lekë gjithsej.
Me VKB nr. 43 datë 23.09.2020, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për rikonstruksion dhe mirëmbajtje, në vlerën 6,620,666 lekë gjithsej.
Me VKB nr. 48 datë 21.10.2020, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për blerjen dezifenktant në vlerën 960,000 lekë gjithsej.
Gjithsej plani vjetor progresiv i buxhetit për vitin 2020 ka qenë 842,077,000 lekë, ose 84,800,619 lekë më pak nga plani fillestar. Realizimi i buxhetit të vitit 2020 ka qenë në vlerën **576,604,000 lekë, ose 265,473,000 lekë më pak.**
Nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, në Bashkinë Mallakastër rezultoi se:
Për vitin 2021, totali i shpenzimeve të planifikuara përbëhet nga:
Të ardhurat e trashëguara nga viti 2020 në vlerën 64,000,000 lekë;
Transferta e pakushtëzuar 159,892,000 lekë;
Transferta specifike në vlerën 122,181,000 lekë;
Transferta e kushtëzuar në vlerën 250,954,450 lekë;
Të ardhurat e planifikuara për tû mbledhur gjatë vitit në vlerën 371,994,000 lekë;

Total për tu shpenzuar 969,021,450 lekë.

Gjatë vitit 2021 buxheti i Bashkisë Mallakastër ka pësuar **5 ndryshime**, me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, konkretisht:
Me VKB nr. 11 datë 15.02.2021, kanë ndodhur shtesa të fondeve për transferta në institucione të tjera dhe familjar në vlerën 8,247,000 lekë gjithsej.
Me VKB nr. 13 datë 26.02.2021, kanë ndodhur shtesa të fondeve për transferta në familjar në vlerën 2,643,000 lekë gjithsej.
Me VKB nr. 25 datë 25.05.2021, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për blerje uniformash dhe kontribut për U.K. Sh.A në vlerën 4,960,000 lekë gjithsej.
Me VKB nr. 34 datë 27.07.2021, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për investime në kapitale të patrupëzuara në vlerën 8,331,000 lekë gjithsej.
Me VKB nr. 38 datë 22.09.2021, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për supervizion dhe kolaudim punimesh në vlerën 580,000 lekë gjithsej.
Gjithsej plani vjetor progresiv i buxhetit për vitin 2021 ka qenë 998,607,000 lekë, ose 29,585,550 lekë më tepër nga plani fillestar. Realizimi i buxhetit të vitit 2021 ka qenë në vlerën **689,558,000 lekë, ose 309,049,000 lekë më pak.**

- Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore të shpeshta gjatë vitit buxhetor, tregon për një performancë mesatare në zbatimin e buxhetit.

Realizimi i buxhetit vjetor në nivel programi ekonomik është paraqitur në **Pasqyrën B3**, në Anekset bashkëlidhur, nga ku rezulton se:
Për vitin 2020 realizimi i buxhetit është në nivelin 68%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimin më të lartë është ñ*Kujdesi Social*ò, ndërsa programi ekonomik me realizimin më të ulët është ñ*Sporti*ò dhe ñ*Rrjeti rrugor rural*ò;
Për vitin 2021 realizimi i buxhetit është në nivelin 69%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimi më të lartë është ñ*Gjendja Civile*ò dhe ñ*Kujdesi Social*ò;
Programi me realizimin më të ulët është ñ*Ndërgjegjësimi Mjedisor*ò, ñ*Strehimi*ò, ñ*Sporti*ò dhe ñ*Rrjeti rrugor rural*ò.

Titulliigjetjes: Angazhime buxhetore pa pasur fonde në dispozicion.
Situata: Nga shqyrtimi i kontratave për investime të Bashkisë Mallakastër, financuar nga Ministria e linjës, konstatohet se:
- Në vitin 2020 Bashkia Mallakastër ka lidhur kontratën nr. 1973/5 prot., datë 10.10.2020 me OE ñSh. 07ò, për rikonstruksionin e rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh, me vlerën 497,726,607 lekë me TVSH, ndërkohë ka pasur në dispozicion fonde buxhetore deri në momentin e lidhjes së kontratës vetëm 100,940,420 lekë (përjashtuar fondet për supervizion), ose 396,786,187 lekë më pak nga vlera e kontraktuar (referuar shkresës nr.6669/1 prot., datë 22.04.2020 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë), me qëllim kryerjen e prokurimit përkatës;
- Në vitin 2020 Bashkia Mallakastër ka lidhur kontratën nr. 1678/7 prot., datë 26.10.2020 me OE K.M.K, për rehabilitimin e rrjetit ujitës Çorush, me vlerën 25,969,200 lekë me TVSH, ndërkohë ka pasur në dispozicion fonde buxhetore deri në momentin e lidhjes së kontratës vetëm 11,000,000 lekë, ose 14,969,200 lekë më pak nga vlera e kontraktuar (referuar shkresës nr. 11990/1 prot., datë 06.07.2020 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë), me qëllim kryerjen e prokurimit përkatës;
- Në vitin 2020 Bashkia Mallakastër ka lidhur kontratën nr. 1936/7 prot., datë 26.10.2020 me OE HE&SK 11, për studim projektim i sistemit të furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit, me vlerën 21,419,681 lekë me TVSH, ndërkohë ka pasur në dispozicion fonde buxhetore deri në momentin e lidhjes së kontratës vetëm 4,928,000 lekë, ose 16,491,681 lekë më pak nga vlera e kontraktuar (referuar shkresës nr. 1889 prot., datë 23.07.2020 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), me qëllim kryerjen e prokurimit përkatës;
- Në vitin 2021 Bashkia Mallakastër ka lidhur kontratën nr. 777/7 prot., datë 07.06.2021 me BOE A. Studio, Ed Konstruksion, K. shpk, për ndërtim linje transmetimi rrjeti i jashtëm i ujësjellësist, me vlerën 568,485,332 lekë me TVSH, ndërkohë ka pasur në dispozicion fonde buxhetore deri në momentin e lidhjes së kontratës vetëm 115,158,267 lekë (përjashtuar fondet për supervizion), ose 453,327,065 lekë më pak nga vlera e kontraktuar (referuar shkresës nr. 504 prot., datë 26.02.2021 nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve), me qëllim kryerjen e prokurimit përkatës;

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 28-51

Kriteri: Pika 1, 9, 10, 14 dhe 38 tënenit 3, nenin 40, nenin 50, nenin 51 nëLigjin nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Përmenaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar; Pika 2 të VKM nr. 807, datë 16.11.2016 ñ*Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore*ò, i ndryshuar; Neni 70 dhe neni 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, i ndryshuar (në fuqi për periudhën kur janë lidhur kontratat e mësipërme); Pikat 81, 142, 155, 165 në Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti:Përballjen e Bashkisë Mallakastër me riskun e moslikuidimit në kohë të detyrimeve kontraktuale, krijimin e detyrimeve të prapambetura, të cilat mund të shoqërohen edhe me penalitete.
Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse.

2.2.2. b) Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID -19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Sa i përket fondeve të shpenzuara nga Bashkia Mallakastër për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, rezulton se, gjatë vitit 2020 janë shpenzuar 1,666,680 lekë gjithsej.
Me VKB nr. 16, datë 25.03.2020, është miratuar përdorimi i fondit të emergjencave civile të Bashkisë Mallakastër në shumën 960,000 lekë për blerjen e ushqimeve. Gjithashtu me VKB nr. 48, datë 21.10.2020 është miratuar përdorimi i fondit prej 960,000 lekë për blerje dezifektant. Fondet e shpenzuara për shkak të situatës Covid-19 janë paraqitur në **Pasqyrën B4,** në Anekset bashkëlidhur.

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimin e raportet e monitorimit:

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Mallakastër, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Mallakastër, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuara me Vendim të KB ose të diktuara nga transferta e deleguar nga pushteti qendror.
Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2020-2021, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:
Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik për viti 2020, është paraqitur në **Pasqyrën B5,** në Anekset bashkëlidhur.
Realizimi i buxhetit në nivel nën artikulli ekonomik për viti 2020, është paraqitur në **Pasqyrën B6,** në Anekset bashkëlidhur.
Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik për viti 2021, është paraqitur në **Pasqyrën B7,** në Anekset bashkëlidhur.
Realizimi i buxhetit në nivel nënartikulli ekonomik për viti 2021, është paraqitur në **Pasqyrën B8,** në Anekset bashkëlidhur.
Referuar **Pasqyrave B5-B8**, rezulton se:
Përperiudhën 2020-2021nëkrahasim me planet vjetore respektive, realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomikpër 12-mujorin është mesatarisht në masën 68.5 %, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 ñ*Transfertat për buxhetet familjare*ò ku përfshihet ndihma ekonomike dhe PAK, ndjekur nga shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe realizimin më të ulët e kanë shpenzimet për mallra e shërbime dhe shpenzime kapitale. Vihet re që gjatë periudhës 2020-2021 investimet (231) paraqiten me realizim mesatarisht 42%, pranë krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët, ose ½ e

fondittëplanifikuarnukshpenzohet, çdokatregon një planifikim jo të saktë të shpenzimeve për investimeve.

- Në mënyrë të detajuar brenda llogarive ekonomike, konkretisht në llogarinë 602 ñ*shpenzime operative*ò përvitin 2020, planifikuar në vlerën 77,822,778 lekë dhe realizuar 40,140,733 lekë, peshën më të lartë e kanë shpenzimet për karburant dhe vaj (15%), shpenzime për elektricitet (14%) dhe shpenzimet për paga këshilltarët, kryetarët e fshatrave (12%); Për vitin 2021 ñ*shpenzime operative*ò, planifikuar në vlerën 76,882,463 lekë dhe realizuar 25,023,453 lekë peshën më të lartë e kanë shpenzimet për elektricitet (28%), shpenzimet për paga këshilltarët, kryetarët e fshatrave (21%) dhe shpenzimet për material dhe shërbime speciale (16%).

Përllogarinëekonomike 231 ñ*investime kapitale*ò përvitin 2020 planifikuar në vlerën 284,547,524 lekë dhe realizuar në vlerën 85,236,362 lekë, peshën më të lartë e kanë shpenzimet për detyrime të prapambetura për investimin në rikonstruksionin e rrugës së Qafë Kashit ï Ka lenjë në vlerën 45,321,400 (53%) dhe shpenzimet për investime për rikonstruksionin e ujësjellësit Mallakastër në vlerën 11,316,524 lekë (13%); Përvitin 2021 ñ*investime kapitale*ò planifikuar në vlerën 431,715,965 lekë dhe realizuar 232,053,837 lekë, peshën më të lartë e kanë shpenzimet për investime në ndërtimin e ujësjellësit nga burimi i Poçemit në vlerën 115,156,640 lekë (50%) dhe shpenzimet për investime në rikonstruksionin e ujësjellësit Ballsh në vlerën 57,500,000 lekë (25%).

- Nëse do të bënim një vlerësim të treguesve të performancës të Bashkisë Mallakastër, sa i përket realizimit të shpenzimeve buxhetore në % kundrejt planit të miratuar, metodologji e miratuar nëpërmjet Urdhërit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 117, datë 01.04.2019 ñ*Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike*ò, sipas të cilës sistemi i pikëzimit është në intervalin 1-4, ku 1 pikë është ñ*negativ*ò dhe 4 pikë është ñ*shumë mirë*ò, do të kishim nga 1 pikë për secilin nga vitet e audituara, sipas **Pasqyrës B9,** në Anekset bashkëlidhur.

➢ **<u>Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit.</u>**

- Referuar **Pasqyrave B5-B8**, rezulton se, fondet e deleguara kanë peshën më të lartë në burimet e financimit, konkretisht për vitin 2020 zënë 53% të fondeve të shpenzuara dhe për vitin 2021 zënë 62%, ndjekur nga granti, ku për vitin 2020 zënë 23% të fondeve dhe vitin 2021 zënë 11% të fondeve, për të vijuar me transfertën specifike dhe të ardhurat, të cilat zënë mesatarisht për vitet 2020 dhe 2021, 10% të fondeve sipas burimit të financimit.

<u>Granti nga niveli i qeverisjes qendrore.</u>

- Buxheti nga granti qendror për vitin 2020 është realizuar në vlerën **130,171 mijë** lekë, ose **10%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2020, ku peshën kryesore, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative, përkatësisht në masën 38% dhe 14% të totalit.
- Për vitin 2021 është realizuar në vlerën **73,729** mijë lekë, ose **11%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative, përkatësisht në masën 68% dhe 13% të totalit. Gjatë këtij viti në krahasim me vitin 2020, rezulton rënie e fondeve të shpenzuara nga granti i qeverisë qendrore, pasi nuk janë alokuar fonde për investime.

<u>Transferta specifike.</u>

- Buxheti nga transferta specifike për vitin 2020 është realizuar në vlerën **98,491 mijë** lekë, ose **17%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2020, ku peshën kryesore brenda transfertës specifike, e zënë fondet e shpenzuara për paga, përkatësisht në masën 80%.
- Për vitin 2021 është realizuar në vlerën **104,554** mijë lekë, ose **15%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda transfertës specifike, e zënë fondet e shpenzuara për paga në masën 71% dhe shpenzimet për investime kapitale në masën 12%. Gjatë vitit 2021 kemi një rritje të fondeve në krahasim me vitin 2020, pasi janë alokuar fonde

për shpenzime në investime kapitale të patrupëzuara dhe të trupëzuara, përkatësisht në vlerat 1,798 mijë lekë dhe 12,128 mijë lekë.

<u>Të ardhurat e veta.</u>

- Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2020 është realizuar në vlerën **42,967 mijë** lekë, ose **7%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2020, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative, përkatësisht në masën 53% dhe 35%.
- Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2021 është realizuar në vlerën **86,211 mijë** lekë, ose **13%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe investime kapitale, përkatësisht në masën 38% dhe 35%. Theksojmë se në krahasim me vitin 2020, kemi një rritje të të ardhurave, por kjo nuk është e ndjeshme në peshën totale të të ardhurave të shpenzuara ndaj fondeve në total të shpenzuara për vititn 2021, pasi në këtë vit, janë akorduar fonde nga Ministria e Bujqësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime) për ndërtimin/rikonstruksionin e ujësjellësave dhe rehabilitim të kanaleve ujitës.
- Fonde nga FZHR nuk ka pasur gjatë periudhës 2020-2021.

➢ **<u>Miratimidhepërdorimiifonditrezervëdhetëkontigjencës.</u>**

Me miratimin e buxheteverespektive 2020-2021 është parashikuar dhe miratuar fondi reserve dhe i kontigjencës, ku për vitin 2020 është planifikuar 12,530 mijë lekë dhe për vitin 2021 është planifikuar 20,954 mijë lekë, pra Brenda nivelit 3% të fondit total të planifikuar, përjashtuar transfertat e kushtëzuara, të cilat nuk janë përdorur.

➢ **<u>Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile.</u>**

Nga Bashkia Mallakastër është krijuar edhe fondi për emergjencat civile, ku për 2020 është planifikuar fillimisht në vlerën 23,601 dhe janë shpenzuar fonde për blerje ushqimesh dhe dezifenktant në vlerën 1,920 mijë lekë.

Për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 28,723 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 1,727 mijë lekë, për transferta korrente të brendshme.

➢ **<u>SubvencionetngaëdhepërBashkinëMallakastër.</u>**

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se, Bashkia Mallakastër gjatë periudhës 2020-2021 nuk ka marrë dhe nuk ka dhënë asnjë subvencion.

<u>Titulli i gjetjes:</u>Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli.

<u>Situata:</u>Grupi i KLSH konstatoi se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele të ulta në vitin 2020, konkretisht në masën 30% dhe në vitin 2021 në masën 54%. Ky mosrealizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Mallakastër në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

<u>Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 28-51</u>

<u>Kriteri:</u>Shkronja ñaò në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò;

Neni 47 në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar.

<u>Ndikimi/Efekti:</u>Mosrealizim i investimeve të planifikuara.

<u>Shkaku:</u> Planifikim i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke i planifikuar ato në raport me planin dhe jo me faktin e të ardhurave të vitit të mëparshëm.

<u>Rëndësia:</u>E lartë

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masa që planifikimi i fondeve për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave në vitin paraardhës dhe jo të planifikimit të tyre.

- **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak.**

Në zbatim të nenit 48 ñ*Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor*ò të ligjit nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 dt.30.07.2018 ñ*Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore*ò, si dhe nenin 44, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, rezultoi se, për vitet 2020 dhe 2021 raportet periodike dhe ai vjetor për monitorimin e zbatimit të buxhetit, janë realizuar dhe përcjellë në Këshillin Bashkiak, si dhe Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra më sipër.

Titulliigjetjes: Angazhime buxhetore përtej afatit ligjor.
Situata: Gjatë periudhës 2020-2021 konstatohet se, Bashkia Mallakastër ka ndërmarrë 5 angazhime të reja buxhetore përtej datës 15 tetor, me vlerë totale **17,693,545 lekë**, duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me operatorë ekonomikë, për investime/mirëmbajtje, konkretisht:

- Për vitin 2020 janë ndërmarrë **3 angazhime** buxhetore në vlerën **9,004,615 lekë**, sipas kontratës datë 27.11.2020 me OE F shpk për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit në vlerën 6,200,000 lekë, kontratës datë 15.12.2020 për blerjen e materialeve elektrike në vlerën 1,577,530 lekë me OE A, si dhe kontratës datë 11.12.2020 për ndërtim ure fshati Kalenjë.
- Për vitin 2021 janë ndërmarrë **2 angazhime** buxhetore në vlerën **8,688,930 lekë**, sipas kontratës datë 27.11.2020 me OE F shpk për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit në vlerën 6,857,700 lekë, si dhe kontratës datë 21.12.2021 me OE K shpk, për kryerjen e punimeve ñ*Rikonstruksion i rrugës Gani Malasi*ò, në vlerën 1,831,230 lekë;

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 28-51
Kriteri: Neni 51 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti: Angazhime buxhetore të cilat nuk raportohen në dokumentet standarde që shoqërojnë hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor.
Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masat e nevojshme përtëeleminuarpraktikat e ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore përtej afatit ligjor.

2.2.4. Vlerësimi I risqeve buxhetore nga niveli I faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve:

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Mallakastër, rezulton se, është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për cdo vit buxhetor, janë raportuar periodikisht në Këshillin Bashkiak dhe MFE.
Me fondet buxhetore 2020 dhe 2021, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me

fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.
Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit gjatë periudhës 01.01.2020-31.12.2021 ka ardhur duke u rritur. Zhvillimi i shumës së detyrimit gjatë periudhës 2019-2021 është pasqyruar në **Pasqyrat B12** dhe **B13,** në Anekset bashkëlidhur.
Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që ka Bashkia Mallakastër ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare 2020 dhe ato të vitit 2021, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyrues (faturë tatimore/vendim gjykate) që krijon detyrimin përkatës.

Titulli i gjetjes: Likuidimi i detyrimeve si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore.
Situata: Nga kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e Bashkisë Mallakastër ndaj palëve të treta, kryesisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore dhe likuidimit të tyre, **konstatohet se:**
- Në fund të vitit 2019, Bashkia Mallakastër ka patur detyrime për likuidimin e vendimeve gjyqësore 1,190,000 lekë gjithsej ndaj personave A.L, Sh.S, L.K dhe tarifë për zyrën përmbarimore. Këto detyrime janë krijuar për Bashkinë Mallakastër gjatë vitit 2018, si dhe përgjatë vitit 2019 janë kryer likuidime pjesore të tyre në vlerën 244,208 lekë, ndërkohë që në fund të vitit 2019 Bashkia Mallakastër ka pasur fonde në dispozicion, në vlerën 70,000,000 lekë, të cilat mund tôi përdorte për likuidimin e plotë të detyrimeve. Kjo situatë konstatohet edhe përgjatë vitit 2020 ku në fund të vitit Bashkia Mallakastër ka patur detyrime për likuidimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 945,792 lekë, dhe përgjatë vitit ka kryer likuidime pjesore në vlerën 594,991 lekë të detyrimit të mbartur nga viti 2019. Në fund të vitit 2020 Bashkia Mallakastër ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 64,000,000 lekë, të cilat mund tôi përdorte për likuidimin e plotë të vendimeve gjyqësore.
- Gjithashtu konstatohet për likuidimet e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por në urdhrin e likuidimit nuk është nxjerrë edhe përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Mallakastër.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 28-51

Kriteri: Pikat 8 dhe 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 1, datë 04.06.2014 ñ*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit*ò.
Ndikimi/Efekti: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat kanë krijuar efekte financiare në vlerën 839,199 (likuidimet për 2019-2020) lekë në buxhetin e Bashkisë Mallakastër.
Shkaku: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës, mungesa e planifikimit në buxhet të likuidimit të detyrimeve të prapambetura.
Rëndësia:E lartë
Rekomandim 1: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.
Rekomandim 2: Titullari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet. Gjithashtu për çdo rast të

likuidimit të detyrimeve të vendimeve gjyqësore, në urdhrin e autorizimit të shpenzimit, të evidentohet dhe të kërkohet nxjerrja e përgjegjësisë administrative, të punonjësit përgjegjës.
Rekomandim 3: Titullari i Bashkisë Mallakastër të marrë masat e nevojshme për analizimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, duke identifikuar personat përgjegjës dhe vendosjen e masave administrative ndaj tyre, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin Juridik të bashkëveprojnë për shmangien e penalizimeve të tilla financiare.

Titulli gjetjes: Fatura të palikuiduara brenda afatit 30 ditor, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura, si dhe mosrespektimi i rradhës në likuidimin e tyre.
Situata: Nga auditimi i pagesave të kryera në përmjet Bankës dhe testimi i tyre nëlidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Mallakastër, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se përperiudhën 2020-2021, ky afat nuk është respektuar në 49 raste për vlerën 183,825,766 lekë, konkretisht, ngallogaria 230-231 ka pasur 43 fatura për vlerën totale167,685,184 lekë dhe nga llogaria 602 ka pasur 6 fatura për vlerën totale 16,140,582 lekë.
Këto fatura analizohen si mëposhtë:
- Në fund tëvitit 2020: - 22 fatura për shpenzime për investime në vlerën 111,651,404 lekë dhe 4 fatura për shpenzime operative nëvlerën 13,860,033 lekë.
- Në fund tëvitit 2021: - 21 fatura përshpenzimepërinvestimenëvlerën 56,033,780 lekëdhe 2 faturapërshpenzime operative nëvlerën 2,280,549 lekë.
- Detyrime për shpronësime në Bashkinë Mallakastër nuk ka patur.
- Sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se, nuk respektohet rradha e likuidimit të tyre, pra fatura e parë të likuidohet më parë. Konkretisht për detyrimin ndaj 36 subjekteve, detyrime të krijuara gjatë periudhës 2010-2015 në vlerën 3,812,237 lekë, gjatë vitit 2020 dhe 2021 nuk është kryer asnjë likuidim i tyre, ndërkohë që gjatë këtyre viteve janë likuiduar subjekte, detyrimet e të cilëve janë krijuar në vitin buxhetor 2019 dhe 2020.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 28-51
Kriteri: Pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti: Moslikuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikuiduara.
Shkaku: Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe moslikuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesës më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i rradhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përjashtuar kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë dhe duke respektuar rradhën e likuidimit sipas parimit ñ*hyrje e parë – dalje e parë*ò.

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR etj, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Ekonomike për periudhën 2020-2021, në lidhje me investimet publike, rezultoi se, nuk ka financim projektesh nga FSHZH/FZHR. Nga Ministritë e Linjës (Infrastrukturës, Bujqësisë) për periudhën 2020-2021, rezulton se janë

financuar 4 projekte investimi me vlerë kontrate 1,113,600,820 lekë, paraqitur në Pasqyrën B si më poshtë vijon:

- Kontratat nuk janë likuiduar sipas afateve të përcaktuara, por në periudha të mëvonshme, kjo si rezultat i mosalokimit të fondeve nga ministritë e linjës.
- Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Mallakastër dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas shkresës përcjellëse nga Ministria e linjës. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

Konkluzion i përgjithshëm:

- Buxhetet e Bashkisë Mallakastër dhe PBA, në përgjithësi janë miratuar në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore të ligjit të buxhetit për periudhën 01.01.2020 ï 30.12.2021;
- Kanë ndodhur ndryshime në buxhetet fillestare (shtesa/pakësimi), të cilat në çdo rast janë miratuar me VKB.
- Për PBA 2020-2022 dhe 2021-2023 nuk kanë gjetur zbatim kriteret lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë proçesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, nuk administrohet dokumentacioni mbi PBA 2020-2022, kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Mallakastër, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;
- Në PBA, si dhe buxhetet vjetore të vitit 2020 dhe 2021, nuk janë planifikuar fonde për investime në fondin pyjor.
- Për periudhën 2020-2021 në krahasim me planet vjetore respektive, realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik për 12-mujorin është mesatarisht në masën 68.5 %, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 ñ*Transfertat për buxhetet familjare*ò ku përfshihet ndihma ekonomike dhe PAK, ndjekur nga shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe realizimin më të ulët e kanë shpenzimet për mallra e shërbime dhe shpenzime kapitale. Vihet re që gjatë periudhës 2020-2021 investimet (231) paraqiten me realizim mesatarisht 42%, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët, ose ½ e fondit të planifikuar nuk shpenzohet, çka tregon një planifikim jo të saktë të shpenzimeve për investimeve.
- Nga shqyrtimi i kontratave për investime të Bashkisë Mallakastër, financuar nga Ministria e linjës, konstatohet se në 4 raste janë lidhur kontrata me vlerën e plotë të projektit ndërkohë që i është deleguar pjesërisht fondi nga ministria e linjës, duke ndërmarrë angazhime buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, si dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit buxhetor.
- Gjatë periudhës 2020-2021 konstatohet se, Bashkia Mallakastër ka ndërmarrë 5 angazhime të reja buxhetore përtej datës 15 tetor, me vlerë totale 17,693,545 lekë, duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me operator ekonomik, për investime/mirëmbajtje.
- Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Mallakastër, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2020-2021, ky afat nuk është respektuar në 49 raste për vlerën 183,825,766 lekë.

Është konstatuar se jo në të gjitha rastet janë ndjekur hapat për realizmin e pagesave sipas afateve, megjithëse dokumentacioni që shoqëron pagesën është i plotë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: z. A.K, ish Kryetar i Bashkisë Mallakastër dhe z. Q. I. Kryetar në detyrë i Bashkisë Mallakastër, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. A. R me funksion Drejtor Ekonomik, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

2.2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

- ***Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore***

Në Bashkinë Mallakastër, për vitin 2018 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 64, datë 25.12.2017, me ndryshime dhe Vendimin e Kryetarit të Bashkisë datë 13.01.2018 ñPër *Zbatimin e Vendimeve të Këshillit të Bashkisë*ò, me ndryshime, ku përfshihet edhe struktura e Sektorit të taksave dhe tarifave vendore. Ky sektor përbëhet nga 6 punonjës, konkretisht 1 përgjegjës dhe 5 specialistë.
Për vitin 2019 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 91, datë 31.12.2018, me ndryshime dhe Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 391, datë 20.12.2018 ñ*Për Zbatimin e Vendimeve të Këshillit të Bashkisë*ò, me ndryshime, ku përfshihet edhe struktura e Sektorit të taksave dhe tarifave vendore. Ky sektor përbëhet nga 6 punonjës, konkretisht 1 përgjegjës dhe 5 specialistë.
Për vitin 2020 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 104, datë 20.12.2019 me ndryshime dhe Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 533, datë 30.12.2019 ñ*Për Zbatimin e Vendimeve të Këshillit të Bashkisë*ò, me ndryshime, ku përfshihet edhe struktura e Sektori i taksave dhe tarifave vendore. Ky sektor përbëhet nga 6 punonjës, konkretisht 1 përgjegjës dhe 5 specialistë.
Për vitin 2021 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 51, datë 25.11.2020, me ndryshime dhe Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 10, datë 14.12.2020 ñ*Për Miratimin e Strukturës Organizative dhe Nivelin e Pagave*ò, me ndryshime, ku përfshihet edhe struktura e Sektorit të taksave dhe tarifave vendore. Ky sektor përbëhet nga 5 punonjës, konkretisht 1 përgjegjës dhe 4 specialistë.
Struktura e Drejtorisë të taksave dhe tarifave vendore për vitet 2018 ï 2021 është paraqitur në **Pasqyrën A1,** në Anekset bashkëlidhur.

Titulli i gjetjes: Performancë e dobët në planifikimin dhe realizimin e disa zërave të të ardhurave për periudhën objekt auditimi.
Situata:Për vitin 2018, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Mallakastër është miratuar me VKB-në nr. 62, datë 25/12/2017.
Referuar planit vjetor të miratuar dhe aktrakordimeve me Degën e Thesarit Mallakastër, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2018 paraqitet i detajuar në **Pasqyrën A2,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga të dhënat e Pasqyrës A2 nëAneksetbashkëlidhur, konstatohet se për vitin 2018,të ardhurat nga 336,716 mijëlekë të planifikuara janë realizuar në masën 322,925mijëlekë ose 95.9%, pra me një mosrealizim në shumën 13,791 mijëlekë.
Mos realizimi përshumën 13,791 mijëlekë ka ndodhur kryesisht si pasojë e mos pagesës nga ana e kompanive naftë nxjerrëse dhe përpunuese.
Për vitin 2019, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Mallakastër është miratuar me VKB-në nr. 91, datë 20.12.2018.
Referuar planit vjetor të miratuar dhe aktrakordimeve me Degën e Thesarit Mallakastër, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2019 paraqitet i detajuar në **Pasqyrën A3,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga të dhënat e Pasqyrës A3 në Anekset bashkëlidhur, konstatohet se për vitin 2019,të ardhurat nga 353,552 mijëlekë të planifikuara janë realizuar në masën 156,564mijëlekë ose 44%, pra me një mos realizim në shumën 198,988 mijëlekë.
Mos realizimi për shumën 198,988 lekë ka ndodhur si pasojë e mos pagesës nga ana e kompanive naftë nxjerrëse dhe përpunuese të cila t zënë peshën më të madhe të të ardhurave në Bashkinë Mallakastër.

Për vitin 2020, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Mallakastër është miratuar me VKB-në nr. 103, datë 20.12.2019.
Referuar planit vjetor të miratuar dhe aktrakordimeve me Degën e Thesarit Mallakastër, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2020 paraqitet i detajuar në **Pasqyrën A4,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga të dhënat e Pasqyrës A4 në Anekset bashkëlidhur, konstatohet se për vitin 2020,të ardhurat nga 341,975 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën 117,205 mijë lekë ose 34.3%, pra me një mos realizim në shumën 224,770 mijë lekë.
Mos realizimi për shumën 224,770 mijë lekë ka ndodhur si pasojë e mos pagesës nga ana e kompanive naftë nxjerrëse dhe përpunuese të cilat zënë peshë nmë të madhe të të ardhurave në Bashkinë Mallakastër.
Për vitin 2021, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Mallakastër është miratuar me VKB-në nr. 50, datë 25.11.2020.
Referuar planit vjetor të miratuar dhe aktrakordimeve me Degën e Thesarit Mallakastër, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2020 paraqitet i detajuar në **Pasqyrën A5,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga të dhënat e Pasqyrës A5 në Anekset bashkëlidhur,konstatohet se për vitin 2021,të ardhurat nga 350,904 mijëlekë të planifikuara janë realizuar në masën 209,997 mijë lekë ose 60%, pra me një mosrealizim në shumën 140,907 mijëlekë.
Mos realizimipërshumën140,907 mijëlekë ka ndodhur si pasojë e mos pagesës nga ana e kompanive naftë nxjerrës edhe për punuese të cilat zënë peshë nmë të madhe të të ardhurave në Bashkinë Mallakastër.
Për vitet 2018-2021, evidencat e rakordimeve me thesarin janë nënshkruar nga: z. A. R, në cilësinë e Drejtorit Ekonomik në Bashkinë Mallakastër dhe z. M. M, në cilësinë e përgjegjësit të degës së thesarit.
Referuar**Pasqyrave A2-A5,** konstatohet se për disa taksa dhe tarifa, realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe te disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet mbi planin, gjë që tregon se planifikimi I te ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve, e cila kryesisht vjen për shkak të mosnjohjes së situates dhe mos kryerjes së rregullt të procedurave, I cili ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.
Në këtë konkekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Mallakastër, që megjithëse të ardhurat nuk janë realizuar asnjëherë dhe vlerat e mosrealizimit janë rritur në vite, në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, duke shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj, në dëm të interesave të publikut.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 28-51
Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar; ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*ò, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, neni 9 pika 1.3 germa ñcò dhe ñçò; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, ñ*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020*ò; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 ñ*Për përgatitjen e Programit*

*Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor*ò, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*ò; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 ñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*ò dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

Ndikimi/Efekti: Mosplanifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave shkakton mangësi dhe probleme në likuidimin e shpenzimeve të kryera nga institucioni, si dhe është shkaku kryesor për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Mosnjohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Mallakastër, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Përsa është trajtuar në Projektraportin e Auditimit, nga sektori i tatim-takasave është paraqitur observacioni i protokolluar në Bashkinë Mallakastër me nr. 2639 prot., datë 12.05.2022, i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022, nëpërmjet të cilit personat e atakuar në thelb nuk i kundërshtojnë konstatimet e shprehura në Projektraport nga grupi i auditimit, por justifikohen për mënyrën e kryerjes së veprimtarisë së përditshme, si dhe shprehin angazhim për punën në vijimësi.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se janë dakord me mënyrën e kryerjes së punës nga personeli i Bashkisë Mallakastër, duke pasur parasysh edhe nivelin e ulët ekonomik të popullatës, etj., por këto fenomene kanë qenë të njohura për grupin e auditimit edhe gjatë kryerjes së auditimit në terren dhe rrjedhimisht nuk e ndryshojnë qëndrimin dhe konstatimet e shprehura në Projëektraport.

Titulli i gjetjes: Krijimi i debitorëve dhe mosndjekja e mjaftueshme e detyrimeve të familjarëve nga struktura tatimore. Probleme me vjeljen e taksës së tokës bujqësore dhe taksës së ndërtesës e tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit nga abonentët familjarë.

Situata:Në rregulloren e brendshme të Bashkisë Mallakastër nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Fier, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Mallakastër dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Mallakastër.

Në lidhje me subjektet, detyrimet tatimore të të cilëve arkëtohen nga agjentët tatimorë, u konstatua se nga Bashkia Mallakastër nuk është krijuar një bazë të dhënash e plotë dhe e saktë, ku përcaktohet numri i subjekteve tatimpagues, lloji i detyrimeve të tyre, periudha e ushtrimit të veprimtarisë, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa subjekte janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, si dhe është bërë rakordim me këta agjentë në lidhje me detyrimet e tyre ndaj Bashkisë Mallakastër, pavarësisht konfirmimit të arkëtimeve nga dega e Thesarit.

Në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, u konstatua se Bashkia Mallakastër nuk ka krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku përcaktohet numri i familjeve

dhe sasia e sipërfaqes së banimit që ka secila familje, kujt viteve i përket banesa, para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, është plotësuar rregullisht njoftimi i detyrimit për çdo familje, si për taksën e ndërtesës edhe për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit.
Për detyrimet e familjarëve, u konstatua se shoqëria UKM Sh.A., është caktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit vetëm për qytetin e Ballshit, pasi për Njësitë Administrative nuk ofrohet furnizimi me ujë nga shoqëria UKM Sh.A.
Në lidhje me tarifat që duhet të mbledhë agjenti tatimor UKM Sh.A., konstatohet se akt-rakordimet nuk janë mbajtur në rregull çdo muaj. Për vlerat e paarkëtuara nga subjektet dhe popullata debitore nuk janë zbatuar përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, neni 117 ñ*Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave*ò, pika b).
Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë gjatë periudhës së audituar janë paraqitur në **Pasqyrën A6,** në Anekset bashkëlidhur.
Detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifat vendore gjatë periudhës së audituar janë paraqitur në **Pasqyrën A7,** në Anekset bashkëlidhur.
Planifikimi dhe realizimi i detyrimeve të familjarëve për taksat dhe tarifat vendoregjatë periudhës së audituar është paraqitur në **Pasqyrën A8,** në Anekset bashkëlidhur.
Numri i familjarëve dhe vlera debitore për taksën e ndërtesës,tarifën e pastrimit dhe tarifën e shërbimit vaditje+kullim është paraqitur në mënyrë të përmbledhur në **Pasqyrën A9,** në Anekset bashkëlidhur.
Për qytetin e Ballshit, detyrimet e familjarëve janë parashikuar mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë me shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Mallakastër.
Bashkia Mallakastër, ka planifikuar tarifë pastrimi dhe shërbimi vetëm për familjet të cilat jetojnë në apartamente, në qytet, ku ofrohet ky shërbim, ndërsa për familjet të cilat banojnë në lagjet periferike të qytetit Ballsh dhe familjet të cilat banojnë në fshatra, tarifa e pastrimit dhe shërbimit nuk vilet, pasi nuk ofrohen këto shërbime nga ana e bashkisë.

- *Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese*

Abonentët familjarë të cilët kanë kontratë furnizimi me agjentin tatimor (Shoqëria UKM), lidhur me detyrimet për taksën familjare njoftohen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm, ku shënohen të gjitha taksat dhe tarifat e abonentëve. Për abonentët e tjerë familjarë të cilët banojnë në fshatra, nuk bëhen njoftime dhe ju vilen detyrimet përkatëse në momentin që paraqiten në bashki për nevoja të ndryshme administrative.
Nga auditimi i detyrimeve të popullatës, rezultoi vlera debitore **30,433,851lekë** (18,491,172 lekë taksa e ndërtesës + 7,216,205 lekë tarifa e pastrimit + 4,726,474 lekë tarifa e shërbimit), e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër, nga mosarkëtimi i taksave dhe tarifave të familjarëve, deri në datën 31.12.2021.
Kjo vlerë detyrimesh të papaguara është e pakontabilizuar sipas personave debitorë.
Taksa e tokës është realizuar përkatësisht 98.3% në vitin 2018, 32.2% në vitin 2019, 45.5% në vitin 2020 dhe 70.2% në vitin 2021.
Sipërfaqja e tokës Bashkinë Mallakastër dhe numri i familjeve të trajtuara me tokë nga ligji 7501, është paraqitur në **Pasqyrën A10,** në Anekset bashkëlidhur.
Parashikimi, realizimi dhe debia e taksës së tokësBashkinë Mallakastër, për vitet 2011-2021, është paraqitur në **Pasqyrën A11,** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e debisë për taksën e tokës bujqësore dhe numri i familjeve deditore në Bashkinë Mallakastër, janë paraqitur të përmbledhura në **Pasqyrën A12,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga auditimi, u konstatua se me ligjin 7501 ñ*Për tokën*ò, janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 7,402 familje, për të cilat është planifikuar pagesa e taksës së tokës por nuk është arkëtuar, nuk është faturuar dhe taksapaguesve nuk u është dërguar njoftim për pagesën e

detyrimit. Nga auditimi i taksës së tokës bujqësore, deri në datën 31.12.2021 rezultoi vlera debitore **68,669,251 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.
Kjo vlerë detyrimesh të papaguara është e pakontabilizuar sipas personave debitorë.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 28-51
Kriteri:ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligji nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligji nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, etj.
Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në nivelin e të ardhurave për vlerën debitore prej 68,669,251 lekë nga mospagesa e taksës së tokës bujqësore dhe 30,433,851 lekë nga mospagesa e taksave dhe tarifave vendore prej familjarëve, në total **99,103,102 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Mallakastër.
Shkaku: Ka munguar përditësimi i të dhënave të regjistrave përkatës, niveli ekonomik i familjeve, mungesa e strategjive për vjeljen e detyrimeve nga administrata, etj.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim 1: Bashkia Mallakastër, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.
Rekomandim 2: Bashkia Mallakastër, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar/vjelë detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës debitore prej **30,433,851 lekë**.
Rekomandim 3: Bashkia Mallakastër, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK dhe Qarku Fier). Për familjet fermere debitore të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë periudhën/vlerën e papaguar, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës debitore prej **68,669,251 lekë.**

Titulli i gjetjes: Të ardhura të munguara nga dhënia me qera e aseteve të bashkisë, si troje, toka bujqësore, pyje e kullota.
Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të disponueshëm në zyrën e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Mallakastër u konstatua se për vitet 2018-2021 janë arkëtuar të ardhura në formën e tarifave të qirasë nga 211 subjekte që shfrytëzojnë toka bujqësore mbi bazë kontratash, akt-marrëveshjesh dhe kërkesash të depozituara pranë Bashkisë Mallakastër, kryesisht të mbartura nga ish komunat përpara reformës territoriale.
Për vitin 2018 ka pasur gjithsej 211 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave publike, për një vlerë totale prej 1,384,087 lekë, nga të cilat janë pa likuiduar 83 subjekte, në vlerën progresive 1,641,750 lekë.
Për vitin 2019 ka pasur gjithsej 210 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave publike, për një vlerë totale prej 1,370,087 lekë, nga të cilat janë pa likuiduar 98 subjekte, në vlerën progresive 1,987,751 lekë.
Për vitin 2020 ka pasur gjithsej 210 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave publike, për një vlerë totale prej 1,370,087 lekë, nga të cilat janë pa likuiduar 88 subjekte, në

vlerën progresive 1,935,270 lekë.
Për vitin 2021 ka pasur gjithsej 211 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave publike, për një vlerë totale prej 1,384,087 lekë, nga të cilat janë pa likuiduar 88 subjekte, në vlerën progresive 2,218,252 lekë.
Nga auditimi i të ardhurave të krijuara nga përdorimi i aseteve, u konstatua se vlera debitore progresive në datën 31.12.2021 është **2,218,252 lekë**, e cila përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.
Listat e plota të debitorëve në datën 31.12.2021 janë paraqitur në **Pasqyrën A13**, në Anekset bashkëlidhur. Për debitorët nga mospagimi i qerave, kamatëvonesat duhet të llogariten sipas nenit 5, pika 1 të ligjit nr. 48/2014, ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 28-51
Kriteri: Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 ñ*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*ò i ndryshuar; Ligji nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò; Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 ñ*Për tokën*ò, i ndryshuar; Ligji nr. 8312, datë 26.03.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, ñ*Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*ò, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për tû lidhur me qeramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñ*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*ò; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò, etj.
Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në buxhetin e Bashkisë Mallakastër në vlerën **2,218,252 lekë** (pa llogaritur kamatëvonesat).
Shkaku: Mosndjekja e procedurave nga strukturat përgjegjëse. Mangësi në përcaktimin specifik të detyrave dhe mungesë e personelit përgjegjës.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Bashkia Mallakastër të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **2,218,252 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave, (*sipas normës së interesit të Bankës së Shqipërisë, plus tetë pikë përqindje*) për të gjitha rastet e detyrimeve të paarkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Titulli i gjetjes: Të ardhura të munguara nga pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara.
Situata: Nga auditimi, u konstatua se **për vitin 2018,** ky zë të ardhurash është realizuar në shumën 9,943,465 lekë nga 13,362,529 lekë të planifikuara ose në masën 74%. Janëdhënë 436 leje legalizimi për 84,581 m^2 ndërtim për të cilat nuk është arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën **3,419,111 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Mallakastër.
Për vitin 2019, ky zë të ardhurash është realizuar në shumën 3,954,974 lekë nga 8,866,197 lekë të planifikuara ose në masën 39%. Janë dhënë 278 leje legalizimi për 56,120 m^2 ndërtim për të cilat nuk është arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën **5,411,223 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Mallakastër.
Për vitin 2020, ky zë të ardhurash është realizuar në shumën 229,469 lekë nga 4,437,420 lekë të planifikuara ose në masën 50%. Janë dhënë 127 leje legalizimi për 28,087 m^2 ndërtim

për të cilat nuk është arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën **2,207,951 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Mallakastër.
Për vitin 2021, ky zë të ardhurash është realizuar në shumën 1,079,809 lekë nga 1,576,609 lekë të planifikuara ose në masën 68%. Janëdhënë 23 leje legalizimi për 9,980 m^2 për të cilat nuk është arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën **496,800 lekë,** e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Mallakastër.
Pagesat dhe subjektet debitore për TNI nga legalizimi i objekteve të ndërtuara pa leje në Bashkinë Mallakastër janë paraqitur të përmbledhura në **Pasqyrën A14,** në Anekset bashkëlidhur.
Lista e hollësishme e debitorëve është paraqitur në **Pasqyrën A15,** në Anekset bashkëlidhur.
Konkluzion:Për periudhën objekt auditimi, janë dhënë 864 leje legalizimi, për sipërfaqen e ndërtimit 178,768 m^2 ndërtim, e cila duhet të paguante TNI në vlerën totale 28,242,660 lekë. Nga kjo vlerë është likuiduar vlera prej 16,707,716 lekë, duke mbetur pa shlyer 381 posedues të lejeve të legalizimit për një sipërfaqeje prej 73,014 m^2 me vlerë 11,534,944 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar.
Nga Drejtoria e administrimit, zhvillimittëterritoritdhekadastrës, Bashkia Mallakastër, nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për Sistemin e Taksave Vendore*ò, i ndryshuar, neni 27, pika 2/1 dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014 ñ*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*ò, pika 5, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Mallakastër në vlerën totale **11,534,944 lekë.**
Drejtoria e administrimit, zhvillimit të territorit dhe kadastrës nuk ka zhvilluar rregullisht korespondecë zyrtare dhe nuk ka patur komunikim me ZVRPP Mallakastër sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës Rajonale Fier (perfshi ish-ALUIZNI dhe ZVRPP), për shkëmbim informacioni mbi hipotekimin e ndërtimeve informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ti propozuar për lidhjen e një aktmarrëveshje ndërmjet Bashkisë Mallakastër dhe ASHK Rajonale Fier, me qëllim që ky institucion të bëhet barrikadë për mosdhënien e lejeve të legalizimeve dhe çertifikatave të pronësisë subjekteve private pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.
Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, ñ*Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*ò i ndryshuar, neni 23, me VKM-në nr. 860, datë 10.12.2014 ñ*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*ò, pika 5, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për Sistemin e Taksave Vendore*ò, i ndryshuar, neni 27 ñ*Taksa e ndikimit në infrastrukturë",* pika 2/1, sidhe me VKB vjetore përkatëse për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Mallakastër.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 28-51
Kriteri: Ligji nr. 9482 datë 03.04.20106, ñ*Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*ò i ndryshuar, neni 23, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 ñ*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*ò, pika 5, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për Sistemin e Taksave vendore*ò, i ndryshuar, neni 27 ñ*Taksa e ndikimit në infrastrukturë*ò, pika 2/1, si dhe VKB vjetore përkatëse për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Mallakastër. etj.
Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, në vlerën **11,534,944 lekë,** nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit nga përfituesite lejes së legalizimit.
Shkaku: Mosbashkëpunimi i fortë me ASHK-në dhe mosmarrja e masave të duhura për parandalimin e dhënies së lejeve të legalizimit, pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë

pranë bashkisë Mallakastër nga subjektet private dhe individët për objektet në proces legalizimi.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Bashkia Mallakastër nëpërmjet bashkëpunimit institucional të kërkojë ASHK-së, Drejtoria Fier, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Mallakastër. Drejtoria e administrimit, zhvillimittëterritoritdhekadastrës, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e vlerës **11,534,944 lekë** nga të gjithë individët e listuar si debitorë në **Pasqyrën A15**, bashkëlidhur Projekt Raportit Auditimit, bazuar në legjislacionin tatimor.

Përsa është trajtuar në Projektraportin e Auditimit, nga Drejtoria e administrimit, zhvillimit të territorit dhe licencave është paraqitur observacioni i protokolluar në Bashkinë Mallakastër me nr. 2516 prot., datë 10.05.2022, i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022, nëpërmjet të cilit personat e atakuar në thelb nuk i kundërshtojnë konstatimet e shprehura në Projektraport nga grupi i auditimit, por informojnë që ka filluar vjelja e detyrimeve dhe po vazhdon puna, justifikohen për mënyrën e kryerjes së veprimtarisë së përditshme, si dhe shprehin angazhim për punën në vijimësi.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se janë dakord me mënyrën e kryerjes së punës nga personeli i Bashkisë Mallakastër, duke pasur parasysh edhe nivelin e ulët ekonomik të popullatës, etj., por këto fenomene kanë qenë të njohura për grupin e auditimit edhe gjatë kryerjes së auditimit në terren dhe rrjedhimisht nuk e ndryshojnë qëndrimin dhe konstatimet e shprehura në Projëektraport.

Për qytetin dhe çdo njësi administrative është krijuar në mënyrë manuale dhe elektronike regjistri për taksat dhe tarifat vendore për subjektet private dhe familjarët, konkretisht regjistri elektronik për bizneset, regjistri elektronik për taksën e tokës dhe regjistri elektronik për popullatën në formatin Excel.
Gjithashtu, regjistrat janë hartuar dhe funksionojnë edhe në formë manuale, konform me formatin përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.
Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Mallakastër janë përmbledhur në **Pasqyrën A16,**në Anekset bashkëlidhur.

Titulli i gjetjes: Mangësi në evidentimin dhe vlerësimin e nivelit të detyrimeve debitore, kontabilizimet dhe procedurat e ndjekjes së borxhit tatimor për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Mallakastër.
Situata: Nga auditimi, rezultoi se në Bashkinë Mallakastër ka 290 subjekte debitore nga biznesi (18 nga biznesi I madh [**Pasqyra A17**], 263 nga biznesi I vogël [**Pasqyra A18**], 2 institucione [**Pasqyra A19**] dhe 7 nga kompanitë e shfrytëzimit dhe përpunimit të naftës [**Pasqyra A20**]). Numri i debitorëve nga biznesi si në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hotelit, truallit, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie dhe kamatëvonesat përkatëse), në fund të vitit 2017 numri i debitorëve ka qenë **327**subjekte në vlerën totale **860,658,401**lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 numri i debitorëve ka qenë **290** subjekte dhe vlera progresive ka qenë **1,137,138,382** lekë, (përfshirë vlerën 57,230,150 lekë, që është në process gjyqësor dhe kamatëvonesat) e cila përfaqëson taksat dhe tarifat vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Nga auditimi, u konstatua se nuk

është llogaritu rdhe kontabilizuar vlera e gjobës (kamatëvonesës) përtatim paguesit, nëmasën 0,06% për çdo ditë vonesë, derinë 365 ditë, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, neni 114 ñ*Mos pagimi në afat I detyrimit tatimor apo i kontributit*ò, pika 1.Kjo vlerë debitore, së bashku me kamatëvonesat, është e pa kontabilizuar.
Vlera e debitorëve e ndarë sipas viteve, numrit dhe sipas biznesit, pa përfshirë detyrimet e familjarëve, plus kamatvonesën e përllogaritur është paraqitur në mënyrë të përmbledhur, në **Pasqyrën A21,** në Anekset bashkëlidhur.
Referuar **Pasqyrave A17-A20** dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga Sektori i tatim-taksave, konstatohet se disponohen të dhëna të plota dhe të sakta të debitorëve që në krijimin e tyre sipas llojit të taksave. Debitorët e krijuar para vitit 2019, duke filluar nga viti 2011 janë mbajtur në programin Excel, në listim subjektesh debitore me shumë progresive të debisë deri në fund të vitit 2018, me analizë detyrimesh sipas llojit të taksave të ngarkuara për çdo subjekt.
Pjesën kryesore të debisë, në vlerën 1,097,007,926 lekë, e zënë kompanitë e shfrytëzimit dhe përpunimit të naftës.
Për subjektet A. sha, IRTC, A.E dhe B.E, të cilët nuk ushtrojnë më aktivitet, nga sektori i tatim taksave në Bashkinë Mallakastër janë marrë masat shtrënguese përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. Subjekti A O & G ka çelur proces gjyqësor për mënyrën e taksimit dhe vlerat e detyrimeve të ngarkuara nga Bashkia Mallakastër.
Nga analiza e të dhënave që disponon sektori i tatim taksave në Drejtorinë ekonomike dhe çështjeve sociale pranë Bashkisë Mallakastër, rezulton se borxhi i akumuluar ndaj Bashkisë Mallakastër është 1,137,138,382 lekë, i cili kryesisht rrjedh si pasojë e moslikuiditetit nga ana e kompanive naftënxjerrëse dhe përpunuese, të cilat zënë peshën më të madhe si në realizimin e të ardhurave, ashtu edhe në akumulimin e debisë me një përqindje prej 96.5% të borxhit. Pjesa prej 4.5% e borxhit është akumuluar nga ana e subjekteve të tjera, fermerëve dhe subjekteve të ndryshme që operojnë në Bashkinë Mallakastër.
Nga auditimi i korrespondencave të Sektorit të tatim taksave, u kostatua se njoftimet për pagesat e detyrimeve janë bërë në mënyrë periodike, ndërkohë që për periudhën e audituar janë bërë 73 akt kontrolle, 70 letër kujtesa dhe 40 bllokime të llogarive bankare.
Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitore, strukturat tatimore të Bashkisë Mallakastër, nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë, duke vepruar në mospërputhje ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore*ò, me ndryshime, Kreut XI, ñ*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*ò, neni 93 dhe 94.
Sa më sipër, nuk gjen zbatim të plotë ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, neni 89 ñ*Njoftimi dhe kërkesa për të paguar*.
Gjithashtu nga strukturat tatimore të Bashkisë Mallakastër, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penal bazuar në nenin 181, ñ*Mos pagimi i taksave dhe tatimeve*ò, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 28-51
Kriteri:Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore*ò, me ndryshime, Kreut XI, ñ*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*ò, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 ñ*Kodi Penal i RSh*ò

me ndryshime neni 181, Ligji nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, i ndryshuar neni 9 ñ*Të drejtat dhe përgjegjësitë*ò pika 1.3., neni 35, ñ*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*ò, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

Ndikimi/Efekti: Krijimi i një numri të madh debitorësh në vlera të konsiderueshme. Efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Mallakastër.

Shkaku: Mosmarrja e masave të plota për ndjekjen e debitorëve nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Mallakastër, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pavjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura ndaj **290 subjekteve** debitore në vlerën prej **1,137,138,382 lekë** *(sipas **Pasqyrave** në Anekset e Projektraportit të Auditimit)*, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. T'u dërgohen bankavetë nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i tatim-taksave të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë Ekonomike e Çështjeve Sociale dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Mallakastër, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Titulli i gjetjes: Parregullsi në procedurat e kryera për menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve/Liçencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, Bashkia Mallakastër.

Situata: Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Mallakastër ushtrojnë aktivitetin 12 subjekte të cilat tregtojnë hidrokarbure, karburante. Subjekte të liçencuar për tregtimin e lëndëve djegëse nuk ka. Aktualisht, detyrimet për pajisjen me autorizim i kanë shlyer sipas përcaktimit në aktet nënligjore subjektet: N.Shpk për dy pika shitjeje, L.Shpk, K. Shpk dhe B.P. Shpk.

Për subjektet B.03 Shpk, Sh. 07 Shpk, B.2003 Shpk, A.2013, O.Shpk dhe E.Shpk, është llogaritur pagesa në masën 200,000 lekë, për një periudhë 1 vjeçare, gjë që është e gabuar, pasi pavarësisht se nga autoriteti vendor përcaktohet kohëzgjatja e licencës së tregtimit, pagesa për licencimin nuk ndryshon.

Nga auditimi i pagesave për pajisjen me licenca për tregtimin e hidrokarbureve, u konstatua se nuk është tarifuar ose është tarifuar gabim vlera totale **6,000,000 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.

Sa më sipër, është në kundërshtim me pikën 9 të VKM-së nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 970, datë 2.12.2015.

Pagesat e kryera deri në momentin e auditimit dhe vlerat debitore për subjektet e pajisura me autorizime për tregtimin e hidrokarbureve janë paraqitur në **Pasqyrën A22,** në Anekset bashkëlidhur.

Vlera prej **6,000,000 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 28-51

Kriteri: Kjo procedurë është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñ*Për*

*përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa ñbò, pikat 9, 15.1 dhe 15.2.
Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, në **vlerën 6,000,000 lekë** nga mospagesa e tarifës së plotë apo të një pjese të tarifës së liçencës/autorizimit nga subjektet që ushtrojnë aktivitetin e shitjes me pakicë të hidrokarbureve, pa rinovuar liçencën e tregtimit.
Shkaku: Mosndjekja e procedurave në bashkëpunim me institucionet përkatëse për mbylljen e aktivitetit të subjekteve që nuk rinovojnë liçencën.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifat e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej **6,000,000 lekë,** sipas Anekseve bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit, **Pasqyra A22**. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.
Për sa më sipër, përgjegjësia është e z. A. K, me funksion ish Kryetar i Bashkisë Mallakastër për periudhën 01.01.2018-01.09.2019, z. Q. I, me funksion Kryetar aktual i Bashkisë Mallakastër, z. A. R, me funksion Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, B. J, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të të Ardhurave, A. Xh, E. G dhe A. M, me detyrë Specialistë në Sektorin e të Ardhurave, Ç.A dhe E. H, me detyrë ish Specialistë në Sektorin e të Ardhurave, të cilët kanë shkëputur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Mallakastër.

2.3. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" si dhe udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*".

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

- **Qasja dhe metodologjia e auditimit.**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për tësë audituar.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2020 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit **7,457,135 lekë** për shpenzimet dhe **10,917,835 lekë** për të ardhurat, sipas **Pasqyrës PF1/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

- **Mbi vlerësimin e riskut.**

Nga grupi i auditimit janë ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të

subjektit.
Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:
- Kontrolli i brendshëm:
Kontrolli i brendshëm në Bashkinë Mallakastër nuk ka funksionuar i plotë, nuk përfshin gjithë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim nuk ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësia ekonomike nuk mund ta dijë ku mund të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.
- Konfirmimet nga të tretët:
Subjekti që auditohet ka të konfirmuara (rakorduara) me të tretët (me dëgën e thesarit) informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.
- Transaksionet:
Janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhën e fundit të vitit ushtrimor.
Nisur nga ky fakt, bazuar në vlerën e materialitetit të përllogaritur (7,457,135 lekë) u filtruan të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës mbi këtë vlerë për muajin nëntor - dhjetor 2020, në vlerën 488,876,695 lekë për muajin nëntor dhe 583,460,772 lekë për muajin dhjetor.
Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik"* për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; Dokumentet autorizues, Dokumentet vërtetues, Dokumentet e kontabilitetit, etj.

- **Teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:**

1. Kontrolli aritmetik:
Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).
2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:
Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*.
3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:
Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
4. Kontrolli i vlerësimit:
Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
5. Konfirmim nga të tretët:
Subjekti që auditohet i ka të konfirmuara (rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.
6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna ñ*jashtë normales*ò, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.*

- **Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare 2020**

Në fund të periudhës ushtrimore 2020, bilanci është janë plotësuar sipas formateve standard të miratuara me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò. Bilanci i vitit 2020 është përgatitur nga z. A. R, me detyrë drejtor i drejtorisë ekonomike dhe Nëpunës Zbatues, është konfirmuar nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër, z. Q. I, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe është depozituar dhe miratuar nga dega e thesarit Mallakastër në datën 26.03.2021, brenda limiteve të përcaktuara me ligj.

Veprimet kontabile janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh, centralizator dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur rregullisht ditarët e arkës, bankës, magazinës dhe veprimeve të ndryshme.

Partitarët analitikë të të gjitha llogarive janë mbajtur dhe azhornuar si dhe i llogarive inventariale të magazinës për të cilat është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Janë përgatitur formatet e mëposhtëm:

- Formati 1: Pasqyra e pozicionit financiar;
- Formati 2: Pasqyra e performancës financiare;
- Formati 3: Pasqyra e flukseve monetare;
- Formati 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 5: Pyetësor me shënimet shpjeguese;

Pasqyrat statistikore:

- Formati 6: Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7, a dhe b: - Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b);
- Formati 8: Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Në pasqyrat shpjeguese nuk ka sqarime për palët e lidhura, ku sipas SKK 2 të përmirësuar, njësitë konsiderohen si të lidhura, nëse njëra palë ose kontrollon palën tjetër, ose ka një ndikim të ndjeshëm mbi palën tjetër. Ndikimi i ndjeshëm ekziston kur ajo lidhet me vendimet financiare dhe ato të shfrytëzimit. Palët janë të lidhura edhe kur ato janë nën kontrollin e përbashkët të një njësie tjetër. Ekzistenca e kontrollit, kontrollit të përbashkët ose ndikimit të ndjeshëm mund të ndikojnë mbi mënyrën se si të dyja palët hyjnë në aktivitete biznesi me njëra-tjetrën.

Në datën 09.01.2020, në organet tatimore është regjistruar si Ent publik Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Mallakastër, e cila zotërohet nga Bashkia Mallakastër. Kjo ndërmarrje është krijuar me VKB Mallakastër nr. 97 datë 27.11.2019, me nr. 2913/1 regj., datë 02.12.2019. Nga auditimi, u konstatua se nuk janë përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara për vitet 2019 dhe 2020, në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për Paraqitjen e Pasqyrave Financiare në NJQP*ò, kreu IV, pika 98 e në vijim.

Përgjegjësi për këtë mosveprim mbajnë z. Q. I, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. A. R, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

- **Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020:**

Mbajtja e kontabilitetit:

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Hartimi i pasqyrave financiare është bazuar në konceptet dhe rregullat e Standardeve

Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 ñ*Paraqitja e Pasqyrave Financiare*ò), të përcaktuara në ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò, si dhe në UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ò; nenit 3 dhe 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për ñ*Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò, i ndryshuar, etj.
Nuk ka patur komunikim me MFE për aspekte të trajtimeve kontabile, apo mbyllje vjetore.
Bilanci kontabël:
Bilanci i hartuar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të Bashkisë Mallakastër në fund të periudhës kontabël, për vitin ushtrimor 2020.
Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë: Aktivet, Detyrimet dhe Kapitali.
Klasifikimi i elementeve të mësipërm në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sinqertë të situatës financiare.
Kjo situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumat për periudhat përkatëse.
Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënnzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit.
Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Mallakastër në 31.12.2020, sipas **formatit F1**, është paraqitur në **Pasqyrën PF2/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2020, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivit dhe të pasivit.
Titulli i gjetjes: Mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2020. Probleme dhe mospërputhje e të dhënave në PF të disponueshme në Bashkinë Mallakastër, me PF të disponueshme në Degën e Thesarit.
Situata:

- **AKTIVET**

I. Aktivet Afat shkurtra
1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre:
Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Mallakastër, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në Bashki, vlera është 2,152,252,453 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 3,924,148,980 lekë, me një diferencë prej 1,771,896,527 lekë më pak në PF në subjekt. Në vijim, në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra, në PF në Bashki, vlera është 264,505,243 lekë, ndërsa në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra në PF në sistemin e Thesarit vlera është 113,285,649 lekë, me një diferencë prej 151,219,594 lekë më pak në PF në sistemin e Thesarit. Llogaria 520 ñ*DisponibilitetenëThesar*ò, në PF në subjekt ka vlerën 138,068,071 lekë, ndërsa në PF në sistemin e Thesarit ka vlerën 0. Për sa më sipër, këto llogari nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë.
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre janë detajuar në **Pasqyrën PF3/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, janë analizuar në **Pasqyrën PF4/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga **Pasqyra PF3/2020**, konstatohet se kjo llogari ka pësuar një rritje me 8,646,752 lekë. Nga verifikimi i zërave të bilancit, u konstatua se kjo llogari kuadraton me shumën e llogarive përkatëse 466 ñ*Kreditorë për mjete në ruajtje*ò, 85 ñ*Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit*ò dhe 12 ñ*Rezultatet e mbartura*ò, në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò, i ndryshuar, Kreu III, pikat 29, 30, 39, 50.

Nga auditimi i ditarit të bankës, u konstatua se në debi të llogarisë 520 janë paraqitur gjithsej 278 transaksione, për vlerën totale **3,612,213,915 lekë**, ndërkohë që planifikimi ka qenë për vlerën totale **9,270,956,144** lekë ose 39%, sipas **Pasqyrës PF5/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

2. Gjendje Inventari qarkullues:

Llogaritë e inventareve paraqiten në vlerën totale 35,850,635 lekë, me një zbritje prej 9,906,901 lekë nga viti ushtrimor parardhës, të cilat janë analizuar në vijim.

Llogaria 31 ñ*Materiale*ò,në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 3,519,012 lekë, me një zbritje prej 4,439,864 lekë nga viti ushtrimor paraardhës, ndërsa llogaria 32 ñ*Inventar i imët*ò, paraqitet në vlerën 32,331,623 lekë, me një zbritje prej 5,467,037 lekë nga viti ushtrimor parardhës. Këto zbritje janë si rezultat i amortizimit dhe nxjerrjes së materialeve jashtë përdorimit. Nga rakordimi i urdhrit të nxjerjes jashtë përdorimit me nr.220 datë 02.09.2021 me kontabilitetin dhe Pasqyrën e Gjendjes dhe Ndryshimit të Aktiveve të Qëndrueshme nuk rezultuan diferenca përsa i përket llogarisë 32 ñ*Inventar i imët*ò dhe llogarisë 31 ñ*Materiale*ò.

Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e dokumentuara në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës, si dhe me vlerat e paraqitura në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

3. Llogaritë e arkëtueshme:

Llogaritë e arkëtueshme paraqiten në vlerën totale 77,435,014 lekë, me një zbritje prej 15,964,535 lekë nga viti ushtrimor parardhës, të cilat janë analizuar në vijim.

Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e paraqitura në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

Llogaria 468 ñ*Debitorë të ndryshëm*ò në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën debitore 60,915,692 lekë. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari është pakësuar për vlerën 927,617 lekë dhe është shtuar për vlerën 1,363,137 lekë, me një rritje neto në vlerën 435,520 lekë, shumë e konstatuar nga debitorët për pagesat e tarifave të kopshtit dhe çerdhes.

Kjo llogari përbëhet nga detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna nga aktet e kontrolleve të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2020. Në mënyrë analitike kjo llogari është paraqitur e detajuar në **Pasqyrën PF6/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

Në këtë nënzë paraqiten edhe tepricat debitore të llogarive të furnitorëve, kërkesat ndaj personelit, individëve, debitorëve të tjerë, kërkesat ndaj pjesëmarrjeve dhe shoqërive të grupit, etj., kur ato klasifikohen si afatshkurtra.

Vihet re se gjatë vitit 2020 janë arkëtuar gjithsej 927,617 lekë nga Bashkia Mallakastër. Për vlerën e paarkëtuar, Bashkia Mallakastër është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërkimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115, të Kodit Civil në R.SH dhe nenit 203 të Kodit Punës në R.SH (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit ñ*Për kundërvajtjet Administrative*ò (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

Në Bashkinë Mallakastër ka mangësi dokumentacioni vërtetues, gjë që e bën të pamundur kërkimin në rrugë zyrtare dhe ligjore të detyrimeve të papaguara në favor të saj.

Detyrimet e klientëve janë kërkesa afatshkurta dhe nëse nuk i mbledh subjekti, atëherë parimi i vijimësisë (qëndrueshmërisë) vihet në pikëpyetje.

Bashkia Mallakastër nuk ka bërë analizë për vlerësimin e llogarive të arkëtueshme dhe për vjetërsinë e tyre dhe nuk ka politika të shkruara rreth procedurave për njohjen e provizioneve. Mungesa e analizave të duhura rreth të arkëtueshmeve dhe politikave të duhura rreth

procedurave për njohjen e provizioneve ndikon në besueshmërinë e vlerës së tyre.
Gjithashtu për vlerat mbi një vit, drejtimi nuk ka bërë zhvlerësimin për këto llogari të arkëtueshme.
Nga auditimi i të ardhurave dhe debitorëve nga taksat dhe tatimet, u konstatua se vlerat debitore të familjarëve, bizneseve, etj, nuk janë kontabilizuar. Këto vlera do të paraqiten në mënyrë progresive në aktin e konstatimit të përgatitur për pasqyrat financiare të vitit 2021. Për sa më sipër, kjo llogari nuk pasqyron vlerën e vërtetë.
Llogaria **4342 "*Operacione me shtetin (të drejta)***ò, në fund të vitit ushtrimor 2020, llogaria 4342 ñ*Operacione me shtetin (të drejta)*ò paraqitet në bilanc në vlerën 16,519,322 lekë, e cila përbëhet nga shuma e llogarive 401-408 ñ*Furnitorë e llogari të lidhura me to*ò në vlerën 2,280,549 lekë, llog. 42 ñ*Detyrimet ndaj personelit*ò në vlerën 10,203,400 lekë, llog. 431 ñ*Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksa*ò në vlerën 596,339 lekë, llog. 435 ñ*Sigurime shoqërore*ò në vlerën 3,023,637 lekë, llog. 436 ñ*Sigurime shëndetësore*ò në vlerën 415,397 lekë dhe llog. 467 ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò, muaji dhjetor në vlerën 10,634,793 lekë. Nga auditimi nuk u konstatuan diferenca midis vlerave të pasqyruara në llogarinë 4342 ñ*Operacione me shtetin, të drejta*ò dhe vlerës të pasqyruar në llogaritë e pasivit. Pra, vlera e kësaj llogarie në bilanc është pasqyruar në mënyrë të drejtë në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

4. Të tjera aktive afatshkurtra

Llogaria 486 ñ*Shpenzime të periudhave të ardhshme*ò, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 10,634,793 lekë. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari është pakësuar për vlerën 45,381,460 lekë. Vlera e kësaj llogarie në bilanc është e barabartë me vlerën e paraqitur në PF të disponueshme në sistemin e thesarit.
Detyrimet e Bashkisë Mallakastër, sipas natyrës janë paraqitur në **Pasqyrën PF7/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Analiza e detajuar e llogarisë 486 ñ*Shpenzime të periudhave të ardhshme*ò, është paraqitur në **Pasqyrën PF8/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Përsa i përket detyrimeve të prapambetura, nga pasqyra e mësipërme vërehet se një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve të prapambetura është e trashëguar nga periudha para reformës territoriale. Fakti që kjo llogari është zvogëluar për vlerën 45,381,460 lekë, tregon se Bashkia Mallakastër është e angazhuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura duke planifikuar dhe likuiduar shuma të konsiderueshme.
Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se vlera debitore e kësaj llogarie, ***është e kuadruar*** me shumën e llogarisë kreditore në pasiv të bilancit, përkatësisht me llogarinë 467 ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò në shumën 10,634,793 lekë, në përputhje të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, Kap. III, pika 42 dhe Aneksi 1, ñ*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*ò.
Vlera e kësaj llogarie është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

<u>II. Aktivet Afatgjata</u>

1. Aktivet afatgjata jomateriale:

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive jo materiale afatgjata sipas UMF nr. 8, datë 9.03.2018 përfshin primet e emisionit dhe rimbursimit të huave, studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca dhe të ngjashme.
Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar.
Përfshirja e tepricave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit:
Aktivet afatgjata jomateriale janë paraqitur në **Pasqyrën PF8/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 ñ*Studime dhe kërkime*ònë Bashkinë Mallakastër në

datën 31.12.2020 përbëhet nga 12 studime dhe kërkime nga të cilat:
Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se 11 studime e projektime në vlerën 21,833,918 lekë, i përkasin investimeve nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër, e cila ka prokuruar dhe lidhur kontratat për 11 projekte.
Kurse 1 projekt ñ*Studim projektim i sistemit të furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit*ò, ka qënë me fonde të deleguara. Kontrata është lidhur me vlerën 21,419,681 lekë, ku për vitin 2020 kanë qënë të planifikuara 12,928,000 lekë.
Nga verifikimi i llogarisë 202 ñ*Studime e kërkime*ò për vitin 2020 rezulton se 4 studime dhe kërkime në vlerën prej 22,492,668 lekë kanë filluar të vihen në zbatim, si më poshtë:
1. Studimprojektimisistemittëfurnizimit me ujëngaburimiiPoçemitpërqytetin e Ballshit;
2. Hartimprojekti: RikonstruksionrrugaBejar-Kutë-Çorrush;
3. Hartimprojekti: Rikualifikimi urban iqëndrëssëqytetitBallsh;
4. Hartimprojekti: Krijimhapësirerekreative zona e liqenit artificial Ballsh;

Për këto asete njësia publike nuk ka përllogaritur norma amortizimi duke i qëndruar Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit (*SKK-05*).
Detajet e llogarisë 202 ñ*Studime e kërkime*ò janë paraqitur në **Pasqyrën PF9/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Studimet dhe kërkimet e pazbatuara në datën 31.12.2020 janë paraqitur në **Pasqyrën PF10/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

2. Aktive afatgjata materiale:

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive materiale afatgjata sipas SKK 5, i përmirësuar.
Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar.
Përfshirja e tepricave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit:
Vlera e kësaj nënrubrike është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.
Shtesat në këtë nënrubrikë përfaqësojnë vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit.
Detajet e nënrubrikës Aktive afatgjata materiale janë paraqitur në **Pasqyrën PF11/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e llogarisë 210 ñ*Toka, Troje, Terrene*ò në datën 31.12.2020, paraqitet në vlerën 309,970 lekë e pandryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Për këtë llogari në Bashkinë Mallakastër nuk disponohet analizë.
Gjendja e llogarisë 211 ñ*Pyje kullota plantacione*ò në datën 31.12.2020, paraqitet në vlerën 8,560,400 lekë e pandryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Për këtë llogari në Bashkinë Mallakastër nuk disponohet analizë.
Për këto zëra të aktivit nuk është mbajtur regjistër aktivesh ku të specifikohen datat e hyrjes së aktivit, vlera e tyre në hyrje, shpenzimet kapitale, personat që i kanë në dorëzim. Gjithashtu identifikohet problematika e mosbërjes së inventarizimit vjetor të tyre, në kundërshtim me pikat 31 dhe 74 të udhëzimit 30 datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò.
Nga verifikimi i regjistrave, u konstatua se për llogaritë 214 ñ*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*ò dhe 215 ñ*Mjete transporti*ò, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga

pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò.

Inventarizimi i aktiveve:

Në Bashkinë Mallakastër inventarizimi është kryer çdo vit në bazë të urdhërave përkatës të titullarit, sipas të cilëve janë ngritur komisionet për inventarizimin fizik të aktiveve, në zbatim të pikave 73, 74 dhe pika 81 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò, si dhe nenit 7 (Inventari i aktiveve dhe detyrimeve) të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò, me ndryshime.

Sipas pasqyrës së aktiveve janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive afatgjata materiale të vlerësuara për dalje jashtë përdorimi dhe asgjësimin e tyre nga komisioni i ngritur me urdhërat përkatës, ñ*Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të aktiveve që propozohen të dalin jashtë përdorimit"*. Për vitin 2020, janë nxjerrë jashtë përdorimit nga llogaria 218 ñ*Inventar ekonomik*ò, materiale në vlerën 7,015,192 lekë.

Nga rakordimi i urdhërit përkatës për nxjerrje jashtë përdorimit, me kontabilitetin dhe Pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve të qëndrueshme nuk rezultuan diferenca.

Gjendja e llogarisë 212 ñ*Ndërtime e konstruksione*ò në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 823,902,195 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 791,244,840 lekë, me një pakësim në vlerën 32,657,354 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 845,817,889 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 54,573,049 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.

Gjendja e llogarisë 212 ñ*Ndërtime e konstruksione*òështë analizuar në **Pasqyrën PF12/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

Gjendja e llogarisë 213 ñ*Rrugë, rrjete vepra ujore*òné datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 1,193,196,744 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,015,556,796 lekë, me një pakësim në vlerën 177,639,948 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit.

Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 1,211,819,108 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 196,262,312 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.

Gjendja e llogarisë 213 ñ*Rrugë, rrjete vepra ujore*ò është analizuar në **Pasqyrën PF13/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

Gjendja e llogarisë 214 ñ*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*ò në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 25,897,323 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 16,422,261 lekë, me një pakësim në vlerën 9,475,062 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë për vlerën e amortizimit dhe dhënie të tjerëve (Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Ballsh). Nxjerrje jashtë përdorimi nuk ka.

Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 20,298,477 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 3,876,216 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.

Gjendja e llogarisë 214 ñ*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*òështë analizuar në **Pasqyrën PF14/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

Gjendja e llogarisë 215 ñ*Mjete transporti*ò në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 35,765,036 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 716,194 lekë, me një pakësim në vlerën 35,048,842 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për mjete transporti, ndërsa pakësimet janë për vlerën e amortizimit dhe

dhënie të tjerëve (Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Ballsh). Nxjerrje jashtë përdorimi nuk ka.
Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 31,545,436 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 30,829,242 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. Gjithashtu, nga auditimi i zërave të veçantë të kësaj llogarie, u konstatua se mjetet e punës, si ekskavatorë, skrepa, autofshirëse, traktor me zinxhirrë, etj., janë pasqyruar në mënyrë të gabuar në këtë llogari, pasi duhet të ishin pasqyruar në llogarinë 214 ñ*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*ò. Për sa më sipër, kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale.
Gjendja e llogarisë 215 ñ*Mjete transporti*ò është analizuar në **Pasqyrën PF15/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e llogarisë 218 ñ*Inventar ekonomik*ò në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 33,683,764 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 20,174,831 lekë, me një pakësim në vlerën 13,508,933 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për materiale inventari si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë për vlerën e amortizimit, dhënie të tjerëve (Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Ballsh) dhe nxjerrje jashtë përdorimit.
Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 708,789 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 19,466,042 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. Për sa më sipër, kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale.
Gjendja e llogarisë 218 ñ*Inventar ekonomik*òështë analizuar në **Pasqyrën PF16/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

- **<u>Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Formati nr. 7/b) Viti 2020.</u>**

Për vitin 2020, amortizimi i AQT-ve (Llogaria 219 ñ*Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara*ò), nuk pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto janë paraqitur në formatin 7/a dhe 7/b (gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ñ*Për tatimin mbi të ardhurat*ò, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 30.01.2006 ñ*Për tatimin mbi të ardhurat*ò, i ndryshuar, pika 3.7 ñ*Amortizimi*ò, si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019 ñ*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ò, i ndryshuar.
Nga auditimi i Bilancit, Formati 7, a dhe b: ñ*Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b)*ò, u konstatua se Amortizimi i Akumuluar në Bashkinë Mallakastër për Aktivet Afatgjata Materiale në fillim të vitit 2020 paraqitet për vlerën 1,081,700,350 lekë dhe në fund të vitit 2020 paraqitet për vlerën 1,352,023,641 lekë.
Nga PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera e llogarisë 219 ñ*Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara*ò, është 1,352,023,641 lekë.
Amortizimi i aktiveve është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhë ushtrimore, shtesën e kostos së blerjes dhe zbritjen e vlerë kontabile neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit për kategoritë përkatëse të aktivit. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.
Normat e amortizimit të përdorura për vitin 2020 janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%

Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

Për aktivet në proces nuk është llogaritur amortizim, në përputhje me përcaktimet ligjore.
Formati 7/a i bilancit, ñ*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*ò është paraqitur në **Pasqyrën PF17/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Formati 7/b i bilancit, ñ*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)*ò është paraqitur në **Pasqyrën PF18/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

3. Aktivet Afatgjata Financiare:

Nga auditimi, u konstatua se Aktivet Afatgjata Financiare, të cilat në fund të vitit 2020 paraqiten në vlerën 0 lekë. E njëjta vlerë konstatohet edhe në PF të disponueshme në sistemin e thesarit.
Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe QKB-së, u konstatua se Bashkia Mallakastër, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2020 paraqitet si:

- Aksionare me 100% të aksioneve të UKM Sh.a., me NUIS J77517803S e cila është shoqëri aksionare me objekt ñ*U k*ò. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën **19,600,000 lekë**. Këto të drejta, Bashkia Mallakastër i ka trashëguar nga reforma territoriale, si përfituese e pasurisë së ish-komunave Aranitas, Hekal, Fratar, Kutë, Qendër Dukas, dhe Bashkisë Ballsh. Kjo vlerë nuk është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2020, konkretisht në llogarinë 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ò. Gjithashtu, u konstatua se që nga viti 2007, nuk është bërë asnjë ndryshim në kapitalin aksionar të kësaj shoqërie.
- Aksionare me 25% të aksioneve të shoqërisë ñBò Sh.a., me NUIS L18407801Q e cila është shoqëri aksionare me objekt ñ*Krijimi i ekipeve zinxhir për sportin e futmollit, si dhe pjesëmarja në garat sportive të organizuara nga FShF. Futja në tregun e lojrave per te blere lojtaë perë të blere lojtar sipas nevojave te ekipit. Aktivitete te tjera ne fushen e futbollit per interesat e shoqerise. Aderimi dhe regjistrimi si klub ne FShF, dhe ne te gjitha llojet e aktiviteteve te futebollit kombetare dhe nderkombetare. Shoqeria, brenda kufijeve te parashikuara nga legjisliacioni në fuqi, do te kryejë çdo operiacion tregtar dhe financiar që të lidhet drejtepërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.*ò. Numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale 20,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 2,000,000 lekë. Partner me 75% të aksioneve është shoqëria ñGjò. Vlera e kapitalit të zotëruar nga Bashkia Mallakastër është **500,000 lekë**, vlerë e cila nuk është pasqyruar në llogarinë 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ò. Këto të drejta, Bashkia Mallakastër i ka trashëguar nga Bashkia Ballsh. Kjo vlerë nuk është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2020, konkretisht në llogarinë 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ò.
- Në datën 09.01.2020 është regjistruar në organet tatimore si ent publik Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Mallakastër, me NUIS M07509871Q, e cila zotërohet nga Bashkia Mallakastër. Kjo ndërmarrje është krijuar me VKB Mallakastër nr. 97 datë 27.11.2019, me nr. 2913/1 regj., datë 02.12.2019. Nga auditimi, u konstatua se nuk janë përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara për vitet 2019 dhe 2020, në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për Paraqitjen e Pasqyrave Financiare në NJQP*ò, kreu IV, pika 98 e në vijim. Nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB-së, u konstatua se kjo shoqëri nuk figuron në regjistrat *online* të QKB-së dhe rrjedhimisht nuk mund të ekstraktohen të dhënat për zotërimin e aksioneve dhe vlerën e kapitalit, por nga Pasqyrat financiare të shoqërisë, konstatohet se vlera e aktiveve është **67,105,362 lekë**, e cila nuk pasqyrohet në Bilancin e Bashkisë Mallakastër, në llogarinë 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ò.

Për sa më sipër, llogaria 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ò nuk paraqet vlerën reale për

shumën 87,205,362 lekë (**19,600,000 lekë** nga shoqëria Ujësjellës Kanalizime Mallakastër Sh.a.; **500,000 lekë nga** shoqëria ñBylisò Sh.a. dhe **67,105,362 lekë**nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Mallakastër), në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 ñ*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*ò, me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñ*Aktivet afatgjata materiale dhe Aktivet afatgjata jo materialë*ò pikat 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 ñ*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*ò.

4. Investimet:

Gjendja e llogarive 230 ñ*Investime për aktive afatgjata jo materiale*ò dhe 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò në datën 31.12.2019 paraqitet në vlerën 0 lekë dhe po aq paraqitet në datën 31.12.2020. Në PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera totale e investimeve është 1,912,481,328 lekë, përkatësisht 35,625,554 lekë në llogarinë 230 ñ*Investime për aktive afatgjata jo materiale*ò dhe 1,876,855,774 lekë në llogarinë 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò. Vlera e prokuruar për investimet në proces gjatë vitit 2020 ka qenë 843,277,815 lekë, nga të cilat 743,844,237 lekë me fonde të deleguara dhe 99,433,578 lekë nga të ardhurat e veta. Vlera e kontraktuar (me Tvsh), për investimet në proces gjatë vitit 2020 ka qenë 813,518,543 lekë, nga të cilat 723,468,827 lekë me fonde të deleguara dhe 90,049,716 lekë nga të ardhurat e veta. Planifikimi total për vitin 2020 ka qenë 119,998,280 lekë, i realizuar plotësisht, nga i cili 80,826,085 lekë me fonde të deleguara dhe 39,172,195 lekë nga të ardhurat e veta.

Si rregull, këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 ñ*Aktive afatgjata materiale*ò. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Sektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, sipas aneksit nr. 9 pika 2. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò, kreu II, pikat 6 dhe 15-18, kreu III, pika 33, 36, Aneksi 1, pika 2, ñ*Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël)*ò, ñ*Aktive afatgjata materiale*ò, etj.

Për sa më sipër, zëri ñ*Investime në proces*ò, i përbërë nga llogaritë 230 ñ*Investime për aktive afatgjata jo materiale*ò dhe 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò, në datën 31.12.2020nuk paraqet vlerën reale, pasi duhet të pasqyronin vlerën 813,518,543 lekë, e cila përbëhet nga shuma e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Mallakastër.

Investimet e vitit 2020 sipaskontratavetëlidhuranëvitin 2020 dhetëlidhuranëvitet e mëparshmejanëparaqitur në **Pasqyrën PF19/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

- **<u>PASIVET</u>**

I. Pasivet Afat shkurtra

1. Llogari të pagueshme:

Në këtë grup llogarish paraqiten të gjitha detyrimet e njësisë ekonomike ndaj të tretëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve me pagesë të mëvonshme.

Në datën 31.12.2020, shuma e llogarive 401-408 ñ*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*ò, 42 ñ*Detyrime ndaj personelit*ò, 431 ñ*Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa*ò, 435 ñ*Sigurime shoqërore*ò, të 436 ñ*Sigurime shoqërore*ò, është e barabartë me gjendjen e llogarisë 4342 ñ*Operacione me shtetin*ò në vlerën 16,519,322 lekë.

Analiza e grupit të llogarive të pagueshme për vitin 2020 është paraqitur në **Pasqyrën PF20/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

Detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2020 për Llogarinë 401-408 ñ*Furnitorë e llogari të*

*lidhura me to*ò, në bilanc paraqiten në vlerën 2,280,549 lekë. Në këtë llogari paraqiten detyrimet e prapambetura për muajin dhjetor të vitit 2020.
Analiza e Llogarisë 401 *"Furnitorë për mallra, produkte e shërbime*ò, është paraqitur në **Pasqyrën PF21/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Llogaria 42 ñ*Personeli e llogari të lidhura me to*ò, analizuar e kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 10,203,400 lekë, përfaqëson detyrimet ndaj punonjësve për pagat e personelit për muajin dhjetor 2020. Në fund të vitit 2019 ka qenë 13,757,686 lekë, me një zbritje në vlerën 3,554,286 lekë.
Llogaria 431 ñ*Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa*ò, analizuar e kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 596,339 lekë përfaqëson detyrimet për tatimin mbi pagat e personelit në muajin dhjetor 2020. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2021.
Llogaria 435 ñ*Sigurime shoqërore*ò, e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 3,023,637 lekë përfaqëson detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore në muajin dhjetor 2020. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2021.
Llogaria 436 ñ*Sigurime shëndetësore*ò, e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 3,023,637 lekë, përfaqëson detyrimet për kontributet e sigurimet shëndetësore në muajin dhjetor 2020. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2021.
Në mbyllje të periudhës raportuese, llogaritë kreditore 42; 431; 435 dhe 436 në vlerën totale 14,238,773 lekë, përfaqësojnë detyrime të njësisë publike Bashkia Mallakastër për pagat e personelit, kontribute për sigurime shoqërore, shëndetësore si dhe tatimin mbi pagë, të përllogaritura për pagesë në muajin dhjetor 2020, të cilat janë likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2021.

2. Detyrime të tjera afatshkurtra:

Në këtë grup të detyrimeve afatshkurtra paraqiten shpenzimet e kryera nga njësia ekonomike, dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur si shpenzime nga njësia ekonomike.
Po kështu, njësia ekonomike përfshin në këtë grup edhe të gjitha detyrimet e llogaritura për të paguar interesat e maturuara ekonomikisht.
Llogaritë për detyrime të tjera afatshkurtra janë paraqitur në **Pasqyrën PF22/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e llogarisë 466 ñ*Kreditorë për mjete në ruajtje*ò në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 41,055,288 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 37,245,475 lekë ose me pakësim në vlerën 3,809,813 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme.
Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Mallakastër, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në llogarinë 466 ñ*Kreditorë për mjete në ruajtje*ò, në sistemin e Thesarit vlera është 74,490,950 lekë, me një diferencë prej 37,245,475 lekë më pak në PF në subjekt, e barabartë me fiks 50% të vlerës së pasqyruar në bilancin e Bashkisë Mallakastër.
Në mënyrë analitike, Llogaria 466 ñ*Kreditorë për mjete në ruajtje*ò në fund të vitit 2020 është paraqitur në **Pasqyrën PF23/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Kontabilizimi i llogarisë 466 ñ*Kreditorë për mjete në ruajtje*ò për vitin 2020 është paraqitur në **Pasqyrën PF24/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, nuk është bërë zhbllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.
Veprimet dhe mosveprimet janë në mosrespektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018

ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 ñ*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*ò i ndryshuar, Kap. II, pika 10.
Gjendja e llogarisë 4341 ñ*Operacione me shtetin (detyrime)*ònë datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 60,480,172 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 60,915,692 lekë ose me rritje në vlerën 435,520 lekë.
Në mënyrë analitike, llogaria 4341 ñ*Operacione me shtetin (detyrime)*ò në fund të vitit 2020 është paraqitur në **Pasqyrën PF25/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e llogarisë 467 ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 56,016,253 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 10,634,793 lekë ose me zbritje në vlerën 45,381,730 lekë.
Vlera e kësaj llogarie është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.
Në mënyrë analitike, Llogaria 467 ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò në fund të vitit 2020 është paraqitur në **Pasqyrën PF26/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

- **KAPITALI**

Sipas përcaktimit të bërë në SKK, kapitali rezulton si diferencë e aktiveve me detyrimet e njësisë ekonomike. Në zbatim të SKK 2 (shtojca 4), njësia ekonomike duhet të pasqyrojë, bazuar në parimin e materialitetit, elementët përbërës të kapitaleve të veta.
Gjendja e llogarisë 101 ñ*Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar*ò(Kapitali i nënshkruar)në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 2,168,770,698 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,926,114,575 lekë ose me zbritje në vlerën 242,656,123 lekë.
Gjendja e llogarisë 85 ñ*Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore*ò (*Humbja/fitimi i ushtrimit*)në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 89,185,031 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 100,822,596 lekë ose me rritje në vlerën 11,637,565 lekë. Në këtë zë paraqitet rezultati i periudhës rrjedhëse ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Llogaritë 105 ñ*Teprica e Granteve kapitale të brendshme*ò dhe 106 ñTeprica e Granteve kapitale të huajaò, si për periudhën ushtrimore paraardhëse, ashtu edhe për periudhën ushtrimore të mbyllur, janë me vlerën 0 (zero).
Grantet kapitale të brendshme mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proçes të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.
Pasqyra e performances financiare në fund të vitit 2020 është paraqitur në **Pasqyrën PF27/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

- **TË ARDHURAT**

1. Të ardhura nga taksat dhe tatimet:
Llogaria 70 ñ*Të ardhurat nga taksat e tatimet*ò, në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 109,649,237 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 75,142,497 lekë ose me ulje në vlerën 34,506,740 lekë.
Të ardhurat nga taksat e tatimet janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën PF28/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Llogaria 71 ñ*Të ardhura jotatimore*ò, në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 28,388,174 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 23,771,846 lekë ose me ulje në vlerën 4,616,328 lekë.
Të ardhurat jotatimore janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën PF29/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

2. Të ardhura të tjera:
Llogaria 72 ñ*Grante korente*ò, në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 545,302,799 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 543,059,664 lekë ose me ulje në vlerën 2,243,135 lekë. Në zërin ñ*Të Ardhura të tjera*ò, në llogarinë 787 ñ*Tërheqje nga seksioni i investimeve*ò, në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 307,724,383 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 22,059,502 lekë ose me ulje në vlerën 285,664,881 lekë. Në llogarinë 73 ñ*Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve*ò, në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 30,012,857 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 9,906,901 lekë ose me ulje në vlerën 20,105,956 lekë.
Së bashku këto llogari kanë pasur një ulje në vlerën 308,013,972 lekë nga viti ushtrimor i mëparshëm.
Grantet korente, të ardhurat e tjera dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën PF30/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

- **SHPENZIMET**

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:
Llogaria 600 ñ*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*ò, në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 200,958,673 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 160,365,438 lekë ose me ulje në vlerën 40,593,235 lekë.
Llogaria 601 ñ*Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndëtësore*ò, në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 33,419,305 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 25,724,344 lekë ose me ulje në vlerën 7,694,961 lekë.
Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Mallakastër me të njëjtën vlerë.
Shpenzimet për pagat dhe kontributet shoqërore e shëndetësore janë paraqitur në **Pasqyrën PF31/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

- **Testimi i llogarisë 600 "*Paga dhe shpërblime*"**

Për vitin 2020, referuar kërkesave të VKM-së nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Mallakastër është miratuar me Urdhër nr. 104 datë 20.12.2019 të Kryetarit të Bashkisë. Numri i miratuar i punonjësve të Bashkisë Mallakastër, funksioneve të transferura dhe gjendjes civile ka qenë 439 punonjës. Sipas listëpagesave janë paguar mesatarisht 284 punonjës për Bashkinë Mallakastër dhe 121 punonjës për Ndërmarrjen e shërbimeve publike, në total 405 punonjës. Sa më sipër, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.
Numri i punonjësve sipas listëpagesave është paraqitur në **Pasqyrën PF32/2020,** në Anekset bashkëlidhur.
Numri i punonjësve sipas Vendimit nr. 104 datë 20.12.2019 është i ndarë si më poshtë:

1.	Administrata e bashkisë	116 punonjës
2.	Njësia Admnistrative Fratar	44 punonjës
3.	Ndërmarrja e Shërbimeve publike	150 punonjës
4.	Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri	14 punonjës
5.	Funksione të transferuara nga arsimi	101 punonjës
6.	Specialist pyjesh (funksion i transferuar)	4 punonjës
7.	Specialist i bujqësisë (funksion i deleguar)	3 punonjës
8.	Gjendja civile	7 punonjës
	Totali:	**439 punonjës**

Sipas listëpagesave të muajve janar 2020, shtator 2020 dhe dhjetor 2020 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.
Listëpagesat dhe përmbledhësja e listëpagesave janë nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, z. A. R dhe nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër.
Janë mbajtur listë prezencat, të cilat janë nënshkruar nga Përgjegjëse e sektorit të Burimeve Njerëzore, znj. J. Ll dhe nga zv/Kryetari Bashkisë znj. A.M.
Auditimi me zgjedhje i disa dosjeve të personelit (me arsim të lartë):

Në auditimin e dosjeve të personelit krahasuar me nivelin e klasave, kategorinë, pagën e grupit, shtesat për vjetërsi, vështirësitë, pozicionin, etj, u konstatua se janë në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore të VKM-së nr. 1619, datë 02.07.2008 ñ*Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore si dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore*ò, i ndryshuar dhe në dosjet personale të nëpunësve administrohet:

- Dokumenti i identifikimit (fotokopje letërnjoftimi); dokumenti mbi gjendjen civile (certifikata e gjendjes familjare); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor në fushën e studimeve (fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave); dokument i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti); raporti mjeko ligjor; librezë pune; fotografi; CV; letër Motivimi; Dëshmi të tjera kualifikimi.

Disa nga dosjet që u audituan janë paraqitur në **Pasqyrën PF33/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

Hartimi i listëpagesave për vitin 2020:

Me përzgjedhje u audituan listëpagesat e muajve janar 2020 dhe dhjetor 2020, nga ku u konstatua se janë plotësuar konform rregullave të përcaktuara. Listëpagesat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkruara nga znj. Jonida Llaka. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, ñ*Kodi i Punës*ò, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 ñ*Për tatimin mbi të ardhurat*ò, me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 ñ*Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH*ò.

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

Llogaria 602 ñ*Blerje mallra dhe shërbime*ò, në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 134,983,547 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 40,140,737 lekë ose me ulje në vlerën 94,842,810 lekë.

Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Mallakastër me të njëjtën vlerë.

Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime janë paraqitur në **Pasqyrën PF34/2020,** në Anekset bashkëlidhur.

- **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës, në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues, të konfirmuara nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dyja palët.

Urdhër-shpenzimet janë përpiluar në bazë të dokumenteve vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit, si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesat, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzime përputhen me vlerat e dokumenteve financiare që mbështesin shpenzimin përkatës.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadron me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas

destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- **Transaksionet financiare nëpërmjet arkës:**

Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se:
Me arkë janë kryer transaksione financiare të ndryshme, si arkëtim të ardhurash për detyrime nga taksa e tokës bujqësore, taksat e tarifat familjare dhe gjoba të Policisë Bashkiake, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuara me të gjitha ekstremitetet, sipas faturës për arkëtim të lëshuar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore. Në vitin 2020, nga arka nuk është kryer asnjë transaksion pagese për kthime të parapagimeve të tarifës për kopshtet dhe çerdhen Ballsh. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkës, i cili është mbyllur për çdo muaj dhe është nënshkruar nga personi përgjegjës për arkën dhe specialiste e financës e ngarkuar për mbajtjen e ditarit të arkës.
Për vitin 2020, janë prerë Mandat Arkëtime në vlerën 25.190.739 lekë dhe libri i arkës është mbyllur me MA nr. 4780 datë 30.12.2020, në vlerën 4,605 lekë.
Nga auditimi i librit të arkës dhe ditarit të arkës konstatohet se të ardhurat nga arkëtimet e kryera për vitin 2020 janë derdhur totalisht në mënyrë periodike në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të çdo viti është 0 (zero) lekë. Gjithashtu, është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël, i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës së të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me VKM-në nr. 783, datë 22.11.2006 ñ*Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël*ò, si dhe të UMF nr.30, datë 27.12.2011 ñ*Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*ò pikat 63, 64. Nga Drejtoria e Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit Mallakastër për të ardhurat.

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Mallakastër nuk ka pasur subvencione.

4. Transferimet korente:

Përfshihen transferimet për nivele të ndryshme të qeverisë për institucione të ndryshme qeveritare. Transferime korente, në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 204,925,647 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 245,524,483 lekë ose me rritje në vlerën 40,598,836 lekë.

5. Shpenzimet financiare:

Përfshihen transferimet për nivele të ndryshme të qeverisë për institucione të ndryshme qeveritare. Shpenzime financiare, në datën 31.12.2019, ka qenë në vlerën 327,592,390 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 91,455,911 lekë ose me ulje në vlerën 236,136,479 lekë.

- **<u>Kontratat e lidhura për vitet 2018-2020:</u>**

<u>Për vitin 2018</u>, janë kryer investime në total për 49 objekte, në vlerën totale të prokuruar 840,994,047 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 797,355,029 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 160,421,515 lekë. Planifikimi për tâu likuiduar gjatë vitit 2018 ka qenë 508,524,538 lekë ndërsa realizimi ka qenë 333,605,062 lekë. Vlera e mbetur për tâu financuar ka qenë 303,328,452 lekë.
Me fonde të deleguara nga Qeveria dhe FZHR kanë qenë gjithsej 10 objekte, në vlerën totale të prokuruar 452,565,568 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 440,472,044 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 79,480,000 lekë. Planifikimi për tâu likuiduar gjatë vitit 2018 ka qenë 237,917,787 lekë ndërsa realizimi ka qenë 192,743,674 lekë. Vlera e mbetur për tâu financuar ka qenë 168,248,370 lekë.
Me fondet e veta kanë qenë gjithsej 37 objekte, në vlerën totale të prokuruar 386,826,539 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 336,538,558 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme

ka qenë për vlerën 80,941,515 lekë. Planifikimi për tâu likuiduar gjatë vitit 2018 ka qenë 250,262,324 lekë ndërsa realizimi ka qenë 120,516,961 lekë. Vlera e mbetur për tâu financuar ka qenë 135,080,082 lekë.
Me financime të huaja kanë qenë gjithsej 2 objekte, në vlerën totale të prokuruar 1,601,940 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 20,344,427 lekë. Likuidim në periudhat e mëparshme nuk ka pasur. Planifikimi për tâu likuiduar gjatë vitit 2018 ka qenë 20,344,427 lekë dhe është shlyer plotësisht.
Për vitin 2019, janë kryer investime në total për 60 objekte, në vlerën totale të prokuruar 783,714,928 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 752,865,238 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 213,235,196 lekë. Planifikimi për tâu likuiduar gjatë vitit 2019 ka qenë 527,091,223 lekë ndërsa realizimi ka qenë 520,861,153 lekë. Vlera e mbetur për tâu financuar ka qenë 18,768,889 lekë.
Me fonde të deleguara nga Qeveria kanë qenë gjithsej 9 objekte, në vlerën totale të prokuruar 315,244,840 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 341,043,343 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 133,978,236 lekë. Planifikimi për tâu likuiduar gjatë vitit 2019 ka qenë 206,957,833 lekë ndërsa realizimi ka qenë 206,334,798 lekë. Vlera e mbetur për tâu financuar ka qenë 730,309 lekë.
Me fondet e veta kanë qenë gjithsej 51 objekte, në vlerën totale të prokuruar 468,470,088 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 411,821,895 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 79,256,960 lekë. Planifikimi për tâu likuiduar gjatë vitit 2019 ka qenë 320,133,390 lekë ndërsa realizimi ka qenë 314,526,355 lekë. Vlera e mbetur për tâu financuar ka qenë 18,038,580 lekë.
Financime të huaja nuk ka pasur.
Për vitin 2020, janë kryer investime në total për 22 objekte, në vlerën totale të prokuruar 843,277,815 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 813,518,543 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 177,759,872 lekë. Planifikimi për tâu likuiduar gjatë vitit 2020 ka qenë 119,998,280 lekë, i realizuar 100%. Vlera e mbetur për tâu financuar ka qenë 515,760,391 lekë.
Me fonde të deleguara nga Qeveria kanë qenë gjithsej 7 objekte, në vlerën totale të prokuruar 743,844,237 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 723,468,827 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 126,882,674 lekë. Planifikimi për tâu likuiduar gjatë vitit 2020 ka qenë 80,826,085 lekë, i realizuar 100%. Vlera e mbetur për tâu financuar ka qenë 515,760,068 lekë.
Me fondet e veta kanë qenë gjithsej 15 objekte, në vlerën totale të prokuruar 99,433,578 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 90,049,716 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 50,877,198 lekë. Planifikimi për tâu likuiduar gjatë vitit 2020 ka qenë 39,172,195 lekë, i realizuar 100%. Vlera e mbetur për tâu financuar ka qenë 323 lekë.
Financime të huaja nuk ka pasur.
Konkluzion: Për vitet 2018-2020 janë lidhur dhe zbatuar 131 kontrata në vlerën totale 2,363,738,810 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i bashkisë, Qeveria, FZHR dhe financime të huaja. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për tâu paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2020 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur

e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet nëllogarinë 476 ñ*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*ò.
Për këto investime nuk janë kryer veprimet kontabël sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike, kështu:
Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, duhej kryer veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 ñ*Disponibilitete në thesar*ò dhe në kredi të llogarisë 476 ñ*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*ò.
Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situcion) duhej bërë veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò dhe në kredi të llogarisë 404 ñ*Furnitorë për investime*ò.
Në momentin e pagesave të faturave, duhej kryer kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 ñ*Furnitorë për investime*ò dhe në kredi të llogarisë 520 ñ*Disponibilitete në thesar*ò.
Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për **investimet e papërfunduara/në proçes,** duhej kryer veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 ñ*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*ò, në kredi të llogarisë 720 ñ*Grant korrent i brendshëm*ò dhe në kredi të llogarisë 4342, ñ*Operacione me shtetin (të drejta)*ò për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.
Me përfundimin e investimit, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës është bërë kapitalizmi aktivit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhej prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 ñ*Aktive afatgjata materiale*ò dhe në kredi të llogarisë 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò.
Me kapitalizmin e aktivit,(për aktivet e marra në dorëzim), duheshin kryer veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 ñ*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*ò e në kredi llogarisë 105 ñ*Grante të brendshme kapitale*ò për fondet buxhetore të përdorura për investime; dhe në kredi të llogarisë 1011 ñ*Shtesa të fondit bazë*ò e në debi të llogarisë105 ñ*Grante të brendshme kapitale*ò për vlerën e aktiveve te blera.
Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò Aneksi 1 ñ*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*ò, Kreu I, pika 8, Kreu II, pika 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, pika 32, Kreu I, ñ*Të përgjithshme*ò, pika 8, Kreu II, ñ*Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, pika 18/a dhe KreuIII, ñ*Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, pika 32.
U kryen procedura testimi analitik me përzgjedhje kampionesh për zona të ndryshme llogarish, duke bërë verifikim të fondeve të planifikuar dhe të përdorura, të përllogaritjeve të vlerave për transaksione financiare të kryera si rezultat i ndodhjes së ngjarjeve ekonomike si dhe verifikimi i përputhshmërisë ligjore i dokumentacionit shoqërues mbështetës nëse ato ishin kryer në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 ñ*Për Vetëqeverisjen Vendore*ò neni 40 ñ*Shpenzimet*ò pika 1.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 51-88
Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 ñ*Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre*ò i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*ò; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 ñ*Për*

*procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 ñ*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*ò; SKK nr. 5 ñ*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomaterialeò* pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 ñ*Investime në Pjesëmarrje*ò pika 35, etj.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Mallakastër.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi 1: Drejtoria Ekonomike dhe e Çështjeve Sociale në Bashkinë Mallakastër, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të llogarive dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike.

Rekomandimi 2: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Rekomandimi 3: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 ñ*Toka, troje terrene*ò; 211 ñ*Pyje, Kullota, Plantacione*ò; 212 ñ*Ndërtime e konstruksione*ò; 213 ñ*Rrugë, rrjete, vepra ujore*ò; 214 ñ*Instalime teknike, makineri e pajisje*ò dhe 215 ñ*Mjete transporti*ò. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivit përkatës.

Rekomandimi 4: Nga Bashkia Mallakastër, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe çregjistrimin e shoqërisë ñ*Ujësjellës kanalizime*ò, e themeluar në datën 28.02.1997, aktualisht me status ñ*Aktiv*ò, me NIPT/NUIS **J77517803S,** kapitali i së cilës rezulton të jetë transferuar i gjithi në shoqërinë ñ*UKK Sha*ò, me NIPT/NUIS **K47605804N,** si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të kësaj shoqërie në masën 100%, me vlerë **totale 621,858,000 lekë**, në debi të llogarisë 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*ò dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Rekomandimi 5: Nga Bashkia Mallakastër, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 ñ*Debitorë të ndryshëm*ò duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH. Gjithashtu, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 ñ*Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit*ò, për vitin në vazhdim.

Rekomandimi 6: Nga Nëpunësi Zbatues, të merren masa për të llogaritur amortizimin në mënyrë progresive dhe për të mbajtur në mënyrë kumulative në regjistrin e aktiveve së bashku me të gjitha detajet e tjera të regjistrit, të listuara në rekomandimin 3 më sipër.

- **Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare 2021:**

Në fund të periudhës ushtrimore, bilanci është janë plotësuar sipas formateve standard të miratuara me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò. Bilanci i

vitit 2021 është përgatitur nga z. A.R, me detyrë drejtor i drejtorisë ekonomike dhe Nëpunës Zbatues, është konfirmuar nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër, z. Q.I, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe është depozituar dhe miratuar nga dega e thesarit Mallakastër në datën 16.03.2021, brenda limiteve të përcaktuara me ligj.
Veprimet kontabile janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh, centralizator dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur rregullisht ditarët e arkës, bankës, magazinës dhe veprimeve të ndryshme.
Partitarët analitikë të të gjitha llogarive janë mbajtur dhe azhornuar si dhe i llogarive inventariale të magazinës për të cilat është bërë rakordimi llogari-magazinë.
Janë përgatitur formatet e mëposhtëm:
- Formati 1: Pasqyra e pozicionit financiar;
- Formati 2: Pasqyra e performancës financiare;
- Formati 3: Pasqyra e flukseve monetare;
- Formati 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 5: Pyetësor me shënimet shpjeguese;

Pasqyrat statistikore:
- Formati 6: Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7, a dhe b: - Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b);
- Formati 8: Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Krahas formateve të mësipërme, pas rekomandimit dhe konsultimeve me grupin e auditimit të KLSH-së, për vitin 2021 janë përpiluar edhe pasqyrat financiare të konsoliduara, ku jepen sqarime për palët e lidhura, konkretisht për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Mallakastër, e cila zotërohet nga Bashkia Mallakastër. Kjo ndërmarrje është krijuar me VKB Mallakastër nr. 97 datë 27.11.2019, me nr. 2913/1 regj., datë 02.12.2019. PF të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për Paraqitjen e Pasqyrave Financiare në NJQP*ò, kreu IV, pika 98 e në vijim.

- **Qasja dhe metodologjia e auditimit.**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për tû audituar.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2021 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit **12,211,132 lekë** për shpenzimet dhe **12,039,336 lekë** për të ardhurat, sipas **Pasqyrës PF1/2021,** në Anekset bashkëlidhur.

- **Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021:**

Mbajtja e kontabilitetit:
Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.
Hartimi i pasqyrave financiare është bazuar në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 ñ*Paraqitja e Pasqyrave Financiare*ò), të përcaktuara në ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò, si dhe në UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ò; nenit 3 dhe 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për ñ*Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò, i ndryshuar, etj.
Nuk ka patur komunikim me MFE për aspekte të trajtimeve kontabile, apo mbyllje vjetore.

Bilanci kontabël:
Bilanci i hartuar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të Bashkisë Mallakastër në fund të periudhës kontabël, për vitin ushtrimor 2021.
Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë: Aktivet, Detyrimet dhe Kapitali.
Klasifikimi i elementeve të mësipërm në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sinqertë të situatës financiare.
Kjo situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumat për periudhat përkatëse.
Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënnzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit.
Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Mallakastër në 31.12.2021, sipas **formatit F1**, është paraqitur në **Pasqyrën PF2/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivit dhe të pasivit.

Titulli i gjetjes: Mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2021. Probleme dhe mospërputhje e të dhënave në PF të disponueshëm në Bashkinë Mallakastër, me PF të disponueshëm në Degën e Thesarit.
Situata:

- **AKTIVET**

I. Aktivet Afat shkurtra
1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre:
Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Mallakastër, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në bashki, vlera është 2,215,499,987 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 1,989,157,450 lekë, me një diferencë prej 226,342,537 lekë më shumë në PF në subjekt. Në vijim, në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra, në PF në bashki, vlera është 348,120,020 lekë, ndërsa në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra në PF në sistemin e Thesarit vlera është 111,203,912 lekë, me një diferencë prej 236,916,108 lekë më pak në PF në sistemin e Thesarit. Llogaria 520 ñ*DisponibilitetenëThesar*ò, në PF në subjekt ka vlerën 223,825,807 lekë, ndërsa në PF në sistemin e Thesarit ka vlerën 0. Për sa më sipër, këto llogari nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë.
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre janë detajuar në **Pasqyrën PF3/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, janë analizuar në **Pasqyrën PF4/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga Pasqyra PF3, konstatohet se kjo llogari ka pësuar një rritje me 85,757,736 lekë. Nga verifikimi i zërave të bilancit, u konstatua se kjo llogari kuadraton me shumën e llogarive përkatëse 466 ñ*Kreditorë për mjete në ruajtje*ò, 85 ñ*Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit*ò dhe 12 ñ*Rezultatet e mbartura*ò, në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò, i ndryshuar, Kreu III, pikat 29, 30, 39, 50.
Nga auditimi i ditarit të bankës, u konstatua se në debi të llogarisë 520 janë paraqitur gjithsej 291 transaksione, për vlerën totale **3,656,953,839 lekë**, ndërkohë që planifikimi ka qenë për vlerën totale **9,967,589,662** lekë sipas **Pasqyrës PF5/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
2. Gjendje Inventari qarkullues:
Llogaritë e inventareve paraqiten në vlerën totale 34,621,123 lekë, me një zbritje prej 1,229,512 lekë nga viti ushtrimor parardhës, të cilat janë analizuar në vijim.
Llogaria 31 ñ*Materiale*ò,në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën

3,633,613 lekë, me një zbritje prej 114,601 lekë nga viti ushtrimor paraardhës, ndërsa llogaria 32 ñ*Inventar i imët*ò, paraqitet në vlerën 30,987,510 lekë, me një zbritje prej 1,344,113 lekë nga viti ushtrimor parardhës. Këto zbritje janë si rezultat i amortizimit dhe nxjerrjes së materialeve jashtë përdorimit. Nga rakordimi i urdhërit përkatës për nxjerrjen jashtë përdorimit, me kontabilitetin dhe Pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të Aktiveve të Qëndrueshme, nuk rezultuan diferenca përsa i përket llogarisë 32 ñ*Inventar i imët*ò dhe llogarisë 31 ñ*Materiale*ò.

Nga analiza e kryer për llogarinë 32 ñ*Inventar i imët*ò, Bashkia Mallakastër dhe Njësitë Administrative përkatëse gjatë vitit 2021 kemi zbritje prej 1,229,512 lekë dhe materiale të nxjerra jashtë përdorimit në vlerën 4,127,830 lekë. Diferencat me pasqyrimin në bilanc i përkasin shtesave gjatë periudhës.

Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e dokumentuara në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës, si dhe me vlerat e paraqitura në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

3. Llogaritë e arkëtueshme:

Llogaritë e arkëtueshme paraqiten në vlerën totale 76,582,789 lekë, me një zbritje prej 852,225 lekë nga viti ushtrimor parardhës, të cilat janë analizuar në vijim.

Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e paraqitura në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

Llogaria 468 ñ*Debitorë të ndryshëm*ò në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën debitore 60,528,690 lekë. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari është pakësuar për vlerën 927,617 lekë dhe është shtuar për vlerën 98,599 lekë, me një rritje neto në vlerën 387,002 lekë, shumë e konstatuar nga debitorët për pagesat e tarifave të kopshtit dhe çerdhes.

Kjo llogari përbëhet nga detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna nga aktet e kontrolleve të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2021. Në mënyrë analitike kjo llogari është paraqitur e detajuar në **Pasqyrën PF6/2021,** në Anekset bashkëlidhur.

Në këtë nënzë paraqiten edhe tepricat debitore të llogarive të furnitorëve, kërkesat ndaj personelit, individëve, debitorëve të tjerë, kërkesat ndaj pjesëmarrjeve dhe shoqërive të grupit, etj., kur ato klasifikohen si afatshkurtra.

Vihet re se gjatë vitit 2021 janë arkëtuar gjithsej 300,000 lekë nga Bashkia Mallakastër. Për vlerën e paarkëtuar, Bashkia Mallakastër është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërkimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115, të Kodit Civil në R.SH dhe nenit 203 të Kodit Punës në R.SH (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit ñ*Për kundërvajtjet Administrative*ò (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

Në Bashkinë Mallakastër ka mangësi dokumentacioni vërtetues, gjë që e bën të pamundur kërkimin në rrugë zyrtare dhe ligjore të detyrimeve të papaguara në favor të saj.

Detyrimet e klientëve janë kërkesa afatshkurta dhe nëse nuk i mbledh subjekti, atëherë parimi i vijimësisë (qëndrueshmërisë) vihet në pikëpyetje.

Bashkia Mallakastër nuk ka bërë analizë për vlerësimin e llogarive të arkëtueshme dhe për vjetërsinë e tyre dhe nuk ka politika të shkruara rreth procedurave për njohjen e provizioneve.

Mungesa e analizave të duhura rreth të arkëtueshmeve dhe politikave të duhura rreth procedurave për njohjen e provizioneve ndikon në besueshmërinë e vlerës së tyre.

Gjithashtu për vlerat mbi një vit, drejtimi nuk ka bërë zhvlerësimin për këto llogari të arkëtueshme.

Nga auditimi i të ardhurave dhe debitorëve nga taksat dhe tatimet, u konstatua se vlerat

debitore të familjarëve, bizneseve, etj, nuk janë kontabilizuar. Këto vlera do të paraqiten në mënyrë progresive në aktin e konstatimit të përgatitur për pasqyrat financiare të vitit 2021. Për sa më sipër, kjo llogari nuk pasqyron vlerën e vërtetë.

Llogaria **4342 "*Operacione me shtetin (të drejta)***ò: Në fund të vitit ushtrimor 2021, llogaria 4342 ñ*Operacione me shtetin (të drejta)*ò paraqitet në bilanc në vlerën 16,054,099 lekë, e cila përbëhet nga shuma e llogarive 401-408 ñ*Furnitorë e llogari të lidhura me to*ò në vlerën 403,000 lekë, llog. 42 ñ*Detyrimet ndaj personelit*ò në vlerën 11,247,905 lekë, llog. 431 ñ*Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksa*ò në vlerën 678,080 lekë, llog. 435 ñ*Sigurime shoqërore*ò në vlerën 3,275,378 lekë, llog. 436 ñ*Sigurime shëndetësore*ò në vlerën 3,275,378 lekë dhe llog. 467 ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò, muaji dhjetor në vlerën 10,573,571 lekë. Nga auditimi nuk u konstatuan diferenca midis vlerave të pasqyruara në llogarinë 4342 ñ*Operacione me shtetin, të drejta*ò dhe vlerës të pasqyruar në llogaritë e pasivit. Pra, vlera e kësaj llogarie në bilanc është pasqyruar në mënyrë të drejtë në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

4. Të tjera aktive afatshkurtra

Llogaria 486 ñ*Shpenzime të periudhave të ardhshme*ò, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 10,573,571 lekë. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari është pakësuar për vlerën 61,222 lekë. Vlera e kësaj llogarie në bilanc është e barabartë me vlerën e paraqitur në PF të disponueshme në sistemin e thesarit.

Detyrimet e Bashkisë Mallakastër, sipas natyrës janë paraqitur në **Pasqyrën PF7/2021,** në Anekset bashkëlidhur.

Analiza e detajuar e llogarisë 486 ñ*Shpenzime të periudhave të ardhshme*ò, është paraqitur në **Pasqyrën PF8/2021,** në Anekset bashkëlidhur.

Përsa i përket detyrimeve të prapambetura, nga Pasqyra PF8/2021vërehet se një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve të prapambetura është e trashëguar nga periudha para reformës territoriale.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se vlera debitore e kësaj llogarie, ***është e kuadruar*** me shumën e llogarisë kreditore në pasiv të bilancit, përkatësisht me llogarinë 467 ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò në shumën 10,573,571 lekë, në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, i ndryshuar, Kap. III, pika 42 dhe Aneksi 1, ñ*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*ò.

Vlera e kësaj llogarie është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

<u>II. Aktivet Afatgjata</u>

1. Aktivet afatgjata jomateriale:

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive jo materiale afatgjata sipas UMF nr. 8, datë 9.03.2018 përfshin primet e emisionit dhe rimbursimit të huave, studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca dhe të ngjashme.

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar. Përfshirja e tepricave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit:

Aktivet afatgjata jomateriale janë paraqitur në **Pasqyrën PF9/2021,** në Anekset bashkëlidhur.

Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 ñ*Studime dhe kërkime*ònë Bashkinë Mallakastër në datën 31.12.2021 përbëhet nga 12 studime dhe kërkime nga të cilat:

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se 11 studime e projektime në vlerën 21,833,918 lekë, i përkasin investimeve nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër, e cila ka prokuruar dhe lidhur kontratat për 11 projekte.

Kurse 1 projekt ñ*Studim projektim i sistemit të furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit*ò, ka qënë me fonde të deleguara. Kontrata është lidhur me vlerën

21,419,681 lekë, ku për vitin 2021 kanë qënë të planifikuara 12,928,000 lekë.
Nga verifikimi i llogarisë 202 ñ*Studime e kërkime*ò për vitin 2021 rezulton se 4 studime dhe kërkime në vlerën prej 22,492,668 lekë kanë filluar të vihen në zbatim, si më poshtë:

1. Studimprojektimisistemittëfurnizimit me ujëngaburimiiPoçemitpërqytetin e Ballshit;
2. Hartimprojekti: RikonstruksionrrugaBejar-Kutë-Çorrush;
3. Hartimprojekti: Rikualifikimi urban iqëndrëssëqytetitBallsh;
4. Hartimprojekti: Krijimhapësirerekreative zona e liqenit artificial Ballsh;

Për këto asete njësia publike nuk ka përllogaritur norma amortizimi duke i qëndruar Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit (*SKK-05*). Në këto aktive nuk mund të amortizohen shpenzimet e projektimit. Për aq kohë sa objekti nuk ka filluar të ndërtohet, përfshirja në shpenzime në këtë periudhë nëpërmjet amortizimit është e gabuar.
Detajet e llogarisë 202 ñ*Studime e kërkime*ò janë paraqitur në **Pasqyrën PF10/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Studimet dhe kërkimet e pazbatuara në datën 31.12.2021 janë paraqitur në **Pasqyrën PF11/2021,** në Anekset bashkëlidhur.

2. Aktive afatgjata materiale:

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive materiale afatgjata sipas SKK 5, i përmirësuar.
Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar. Përfshirja e tepricave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit:
Vlera e kësaj nënrubrike është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.
Shtesat në këtë nënrubrikë përfaqësojnë vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit.
Detajet e nënrubrikës Aktive afatgjata materiale janë paraqitur në **Pasqyrën PF12/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e llogarisë 210 ñ*Toka, Troje, Terrene*ò në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 309,970 lekë e pandryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Për këtë llogari në Bashkinë Mallakastër nuk disponohet analizë.
Gjendja e llogarisë 211 ñ*Pyje kullota plantacione*ò në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 8,560,400 lekë e pandryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Për këtë llogari në Bashkinë Mallakastër nuk disponohet analizë.
Për këto zëra të aktivit nuk është mbajtur regjistër aktivesh ku të specifikohen datat e hyrjes së aktivit, vlera e tyre në hyrje, shpenzimet kapitale, personat që i kanë në dorëzim. Gjithashtu identifikohet problematika e mosbërjes së inventarizimit vjetor të tyre, në kundërshtim me pikat 31 dhe 74 të udhëzimit 30 datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò.
Nga verifikimi i regjistrave, u konstatua se për llogaritë 214 ñ*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*ò dhe 215 ñ*Mjete transporti*ò, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò.

Inventarizimi i aktiveve:

Në Bashkinë Mallakastër inventarizimi është kryer çdo vit në bazë të urdhërave përkatës të titullarit, sipas të cilëve janë ngritur komisionet për inventarizimin fizik të aktiveve, në zbatim të pikave 73, 74 dhe pika 81 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò, si dhe nenit 7 (Inventari i aktiveve dhe detyrimeve) të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò, me ndryshime.
Sipas pasqyrës së aktiveve janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive afatgjata materiale të vlerësuara për dalje jashtë përdorimi dhe asgjësimin e tyre nga komisioni i ngritur me urdhërat përkatës, ñ*Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të aktiveve që propozohen të dalin jashtë përdorimit"*. Për vitin 2021, janë nxjerrë jashtë përdorimit nga llogaria 218 ñ*Inventar ekonomik*ò, materiale në vlerën 4,127,380 lekë.
Nga rakordimi i urdhërit përkatës për nxjerrje jashtë përdorimit, me kontabilitetin dhe Pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve të qëndrueshme nuk rezultuan diferenca.
Gjendja e llogarisë 212 ñ*Ndërtime e konstruksione*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 791,244,840 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 752,534,178 lekë, me një pakësim në vlerën 38,710,662 lekë.
Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është **774,449,870** lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 21,915,692 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.
Gjendja e llogarisë 212 ñ*Ndërtime e konstruksione*òështë paraqitur në **Pasqyrën PF13/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e llogarisë 213 ñ*Rrugë, rrjete vepra ujore*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 1,015,556,796 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 850,018,562 lekë, me një pakësim në vlerën 165,538,234 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit.
Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 834,188,729 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 15,829,833 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.
Gjendja e llogarisë 213 ñ*Rrugë, rrjete vepra ujore*òështë paraqitur në **Pasqyrën PF14/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e llogarisë 214 ñ*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 16,422,261 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 13,137,809 lekë, me një pakësim në vlerën 3,284,452 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë për vlerën e amortizimit dhe dhënie të tjerëve (Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Ballsh). Nxjerrje jashtë përdorimi nuk ka.
Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 5,038,963 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 8,098,846 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.
Gjendja e llogarisë 214 ñ*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*òështë paraqitur në **Pasqyrën PF15/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e llogarisë 215 ñ*Mjete transporti*òë datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 716,194 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 572,955 lekë, me një pakësim në vlerën 143,239 lekë. Pakësimet në këtë llogari janë për vlerën e amortizimit. Nxjerrje jashtë përdorimi nuk ka.
Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 337,110 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 235,845 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. Gjithashtu, nga auditimi i zërave të veçantë të kësaj llogarie, u konstatua se automjeti zjarrfikës është pasqyruar në mënyrë të gabuar në këtë llogari, pasi duhet të ishte pasqyruar

në llogarinë 214 ñ*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*ò. Për sa më sipër, kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale.
Gjendja e llogarisë 215 ñ*Mjete transporti*ò është paraqitur në **Pasqyrën PF16/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e llogarisë 218 ñ*Inventar ekonomik*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 20,174,831 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 20,646,231 lekë, me një pakësim në vlerën 471,400 lekë. Pakësimet në këtë llogari janë për vlerën e amortizimit.
Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 20,639,700 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 6,531 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.
Gjendja e llogarisë 218 ñ*Inventar ekonomik*ò është paraqitur në **Pasqyrën PF17/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Formati 7/a i bilancit, ñ*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*ò është paraqitur në **Pasqyrën PF18/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Formati 7/b i bilancit, ñ*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)*ò është paraqitur në **Pasqyrën PF19/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 51-88
Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 ñ*Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre*ò i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*ò; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 ñ*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*ò; SKK nr. 5 ñ*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale*ò pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 ñ*Investime në Pjesëmarrje*ò pika 35, etj.
Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Mallakastër.
Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi 1: Drejtoria Ekonomike dhe e Çështjeve Sociale në Bashkinë Mallakastër, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të llogarive dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike.
Rekomandimi 2: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
Rekomandimi 3: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 ñ*Toka, troje terrene*ò; 211 ñ*Pyje, Kullota, Plantacione*ò; 212 ñ*Ndërtime e konstruksione*ò; 213 ñ*Rrugë, rrjete, vepra ujore*ò; 214 ñ*Instalime teknike, makineri e pajisje*ò dhe 215 ñ*Mjete transporti*ò. Në llogaritjen e vlerës

së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivit përkatës.

Rekomandimi 4: Nga Bashkia Mallakastër, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 ñ*Debitorë të ndryshëm*ò duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 ñ*Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit*ò.

- **Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Formati nr. 7/b) Viti 2021.**

Për vitin 2021, amortizimi i AQT-ve (Llogaria 219 ñ*Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara*ò), nuk pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto janë paraqitur në formatin 7/a dhe 7/b (gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ñ*Për tatimin mbi të ardhurat*ò, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 30.01.2006 ñ*Për tatimin mbi të ardhurat*ò, i ndryshuar, pika 3.7 ñ*Amortizimi*ò, si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019 ñ*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ò, i ndryshuar.

Nga auditimi i Bilancit, Formati 7, a dhe b: ñ*Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b)*ò, u konstatua se Amortizimi i Akumuluar në Bashkinë Mallakastër për Aktivet Afatgjata Materiale në fillim të vitit 2021 paraqitet për vlerën 1,610,597,111 lekë dhe në fund të vitit 2021 paraqitet për vlerën 1,081,700,350 lekë.

Nga PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera e llogarisë 219 ñ*Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara*ò, është 1,610,597,111 lekë.

Amortizimi i aktiveve është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhë ushtrimore, shtesën e kostos së blerjes dhe zbritjen e vlerë kontabile neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit për kategoritë përkatëse të aktivit. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Normat e amortizimit të përdorura për vitin 2021 janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

Për aktivet në proces nuk është llogaritur amortizim, në përputhje me përcaktimet ligjore.

3. Aktivet Afatgjata Financiare:

Nga auditimi, u konstatua se Aktivet Afatgjata Financiare, të cilat në fund të vitit 2021 paraqiten në vlerën 0 lekë. E njëjta vlerë konstatohet edhe në PF të disponueshme në sistemin e thesarit.

Titulli i gjetjes: Mangësi në kontabilizimin e aktiveve afatgjata financiare në Pasqyrën e

Pozicionit Financiar për periudhën e audituar.
Situata: Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe QKB-së, u konstatua se Bashkia Mallakastër, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2021 paraqitet si:

- Aksionare me 100% të aksioneve të UKM Sh.a., me NUIS **J77517803S** e cila është shoqëri aksionare me objekt ñ*U k*ò, e themeluar në datën 28.02.1997, aktualisht me status ñ*Aktiv*ò. Numri i aksioneve është 19,600 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën **19,600,000 lekë**. Këto të drejta, Bashkia Mallakastër i ka trashëguar nga reforma territoriale, si përfituese e pasurisë së ish-komunave Aranitas në masën 11.7% ose 2,293.2 aksione, Hekal në masën 12.5% ose 2,450.2 aksione, Fratar në masën 12.9% ose 2,528.4 aksione, Kutë në masën 9% ose 1,764 aksione, Qendër Dukas në masën 23.1% ose 4,527.6 aksione dhe Bashkisë Ballsh në masën 30.8% ose 6,036.8 aksione. Kjo vlerë nuk është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2021, konkretisht në llogarinë 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ò. Gjithashtu, u konstatua se që nga viti 2007, nuk është bërë asnjë ndryshim në kapitalin aksionar të kësaj shoqërie.
- Aksionare me 100% të aksioneve të UKM Sh.a., me NUIS **K47605804N** e cila është shoqëri aksionare me objekt ñ*Objekti i shoqerise brenda territorit te bashkise se krijuar sipas ligjit nr. 115/2014, "Per ndarjen administrative-territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Republikene Shqiperise", eshte: a) Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij; b) Mirembajtja e sistemit/sistemeve te furnizimit me uje te pijshem; c)Prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve; ç) Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura; d) Mirembajtja e sistemeve te ujerave te ndotura, si dhe te impianteve te pastrimit te tyre. 2. Shoqeria duhet te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregtar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi. 3. Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me lejet. autorizimet, licencat sipas legjislacionit ne fuqi.*ò, e themeluar në datën 15.04.2004, me Vendimin nr. 31633 të Gjykatës Tiranë, aktualisht me status ñ*Aktiv*ò. Në aktin e themelimit të kësaj shoqërie anonime, përcaktohet se kapitali themeltar ka qenë 19,600,000 lekë, e ndarë në 19,600 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë secili. Numri i aksioneve është 621,858 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën **621,858,000 lekë**, e gjitha në pronësi të Bashkisë Mallakastër. Kjo vlerë nuk është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2021, konkretisht në llogarinë 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ò. Nga sa më sipër, është e qartë se kjo shoqëri rrjedh nga shoqëria që ka ekzistuar para reformës territoriale, por nga ana e Bashkisë Mallakastër nuk janë marrë masat për mbylljen dhe fshirjen e shoqërisë fillestare në regjistrin e bizneseve.
- Aksionare me 25% të aksioneve të shoqërisë ñBò Sh.a., me NUIS L18407801Q e cila është shoqëri aksionare me objekt ñ*Krijimi i ekipeve zinxhir për sportin e futmollit, si dhe pjesëmarja në garat sportive të organizuara nga FShF. Futja në tregun e lojrave per te blere lojtaë perë të blere lojtar sipas nevojave te ekipit. Aktivitete te tjera ne fushen e futbollit per interesat e shoqerise. Aderimi dhe regjistrimi si klub ne FShF, dhe ne te gjitha llojet e aktiviteteve te futebollit kombetare dhe nderkombetare. Shoqeria, brenda kufijeve te parashikuara nga legjisliacioni në fuqi, do te kryejë çdo operiacion tregtar dhe financiar që të lidhet drejtepërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.*ò. Numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale 20,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 2,000,000 lekë. Partner me 75% të aksioneve është shoqëria ñGjanicaò. Vlera e kapitalit të zotëruar nga Bashkia Mallakastër është **500,000 lekë**, vlerë e cila nuk është pasqyruar në llogarinë 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ò. Këto të drejta, Bashkia Mallakastër i ka trashëguar nga Bashkia Ballsh. Kjo vlerë nuk është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2020, konkretisht në llogarinë 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ò.

- Në datën 09.01.2020 është regjistruar në organet tatimore si ent publik Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Mallakastër, me NUIS M07509871Q, e cila zotërohet nga Bashkia Mallakastër. Kjo ndërmarrje është krijuar me VKB Mallakastër nr. 97 datë 27.11.2019, me nr. 2913/1 regj., datë 02.12.2019. Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2021, pas diskutimit dhe konsultimeve me grupin e auditimit të KLSH-së janë përgatitur PF të konsoliduara, ku përfshihen të dhënat shpjeguese për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Mallakastër, në përputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për Paraqitjen e Pasqyrave Financiare në NJQP*ò, kreu IV, pika 98 e në vijim. Nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB-së, u konstatua se kjo shoqëri nuk figuron në regjistrat *online* të QKB-së dhe rrjedhimisht nuk mund të ekstraktohen të dhënat për zotërimin e aksioneve dhe vlerën e kapitalit, por nga Pasqyrat financiare të shoqërisë, konstatohet se vlera e aktiveve është **67,105,362 lekë**, e cila nuk pasqyrohet në Bilancin e Bashkisë Mallakastër, në llogarinë 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ò.

Për sa më sipër, llogaria 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ò nuk paraqet vlerën reale për shumën **689,463,362 lekë** (**621,858,000** lekë nga shoqëria Ujësjellës Kanalizime Mallakastër Sh.a.; 500,000 lekë nga shoqëria ñBylisò Sh.a. dhe 67,105,362 lekënga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Mallakastër), në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 ñ*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*ò, me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñ*Aktivet afatgjata materiale dhe Aktivet afatgjata jo materiale*ò pikat 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 ñ*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*ò.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 51-88

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 ñ*Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre*ò i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*ò; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 ñ*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*ò; SKK nr. 5 ñ*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale*ò pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 ñ*Investime në Pjesëmarrje*ò pika 35, etj.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve financiare të Bashkisë Mallakastër.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e aktiveve financiare.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi 1: Nga Bashkia Mallakastër, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive: **1.** ñ*UKM Sh.a.*ò, me NUIS K47605804N, për 100% të aksioneve, në vlerën 621,858,000 lekë; **2.** ñ*B*ò Sh.a., me NUIS L18407801Q, për 25% të aksioneve në vlerën 500,000 lekë; **3.** ñ*NSHP, Mallakastër*ò, me NUIS M07509871Q, për 100% të aksioneve, në vlerën 67,105,362 lekë, si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive prej **689,463,362 lekë**në debi të llogarisë 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*ò dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Rekomandimi 2: Nga Bashkia Mallakastër, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë çregjistrimin e shoqërisë ñ*Uk*ò, e themeluar në datën 28.02.1997, aktualisht me status ñ*Aktiv*ò, me NIPT/NUIS J77517803S, kapitali i së cilës rezulton të jetë transferuar i gjithi në shoqërinë ñ*U Sha*ò, me NIPT/NUIS K47605804N.

Titulli i gjetjes: Mangësi në kontabilizimin e aktiveve afatgjata financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për periudhën e audituar.

Situata:4. Investimet:

Gjendja e llogarive 230 ñ*Investime për aktive afatgjata jo materiale*ò dhe 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò në datën 31.12.2021 paraqitet përkatësisht 5,236,027 lekë për llog. 230 dhe 181,601,917 lekë për llog. 231, në total 186,837,944 lekë. Vlerat e pasyruara në PF të disponueshme në Bashkinë Mallakastër, janë të barabarta me vlerat e pasqyruara në PF në sistemin e thesarit.

Vlera e prokuruar për investimet në proces gjatë vitit 2021 ka qenë 1,259,818,211 lekë, nga të cilat 1,125,017,874 lekë me fonde të deleguara dhe 134,800,337 lekë nga të ardhurat e veta. Vlera e kontraktuar (me Tvsh), për investimet në proces gjatë vitit 2021 ka qenë 1,177,981,840 lekë, nga të cilat 1,101,002,753 lekë me fonde të deleguara dhe 76,979,087 lekë nga të ardhurat e veta. Planifikimi total për vitin 2021 ka qenë 278,451,257 lekë, nga i cili 198,785,588 lekë me fonde të deleguara, me realizim në vlerën 189,552,711 lekë dhe 79,665,669 lekë nga të ardhurat e veta, me realizim në vlerën 42,501,126 lekë.

Si rregull, këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 ñ*Aktive afatgjata materiale*ò. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Sektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021, sipas aneksit nr. 9 pika 2. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò, kreu II, pikat 6 dhe 15-18, kreu III, pika 33, 36, Aneksi 1, pika 2, ñ*Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël)*ò, ñ*Aktive afatgjata materiale*ò, etj.

Për sa më sipër, zëri ñ*Investime në proces*ò, i përbërë nga llogaritë 230 ñ*Investime për aktive afatgjata jo materiale*ò dhe 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò, në datën 31.12.2020nuk paraqet vlerën reale, janë nënvlerësuar për 991,143,896 lekë, pasi duhet të pasqyronin vlerën 1,177,981,840 lekë, e cila përbëhet nga shuma e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Mallakastër.

Investimet e vitit 2021 sipaskontratavetëlidhuranëvitin 2021 dhetëlidhuranëvitet e mëparshmejanëparaqitur në **Pasqyrën PF20/2021** në Anekset bashkëlidhur.

Në periudhën raportuese 2021, vlera faktike e investimeve të realizuara sipas listës së mësipërme ka qenë 232,053,837 lekë. Për sa më sipër, llogaritë 230 ñ*Investime për aktive afatgjata jo materiale*ò dhe 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò, në datën 31.12.2021nuk paraqesin vlerën reale, pasi janë nëvlerësuar për shumën totale 45,215,893 lekë.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 51-88

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 ñ*Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre*ò i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*ò; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 ñ*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*ò; SKK nr. 5 ñ*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale*ò pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 ñ*Investime në Pjesëmarrje*ò pika 35, etj.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve financiare të Bashkisë Mallakastër.
Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e aktiveve financiare.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Çështjeve Sociale në Bashkinë Mallakastër të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 ñ*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*ò deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, të kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

- **PASIVET**

I. Pasivet Afat shkurtra
1. Llogari të pagueshme:
Në këtë grup llogarish paraqiten të gjitha detyrimet e njësisë ekonomike ndaj të tretëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve me pagesë të mëvonshme.
Në datën 31.12.2021, shuma e llogarive 401-408 ñ*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*ò, 42 ñ*Detyrime ndaj personelit*ò, 431 ñ*Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa*ò, 435 ñ*Sigurime shoqërore*ò, të 436 ñ*Sigurime shoqërore*ò, është e barabartë me gjendjen e llogarisë 4342 ñ*Operacione me shtetin*ò në vlerën 16,054,099 lekë.
Analiza e grupit të llogarive të pagueshme për vitin 2021 është paraqitur në **Pasqyrën PF21/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2021 për Llogarinë 401-408 ñ*Furnitorë e llogari të lidhura me to*ò, në bilanc paraqiten në vlerën 403,000 lekë. Në këtë llogari paraqiten detyrimet e prapambetura për muajin dhjetor të vitit 2020.
Analiza e Llogarisë 401 *"Furnitorë për mallra, produkte e shërbime*ò, është paraqitur në **Pasqyrën PF22/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Llogaria 42 ñ*Personeli e llogari të lidhura me to*ò, analizuar e kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 11,247,905 lekë, përfaqëson detyrimet ndaj punonjësve për pagat e personelit për muajin dhjetor 2020. Në fund të vitit 2020 ka qenë 10,203,400 lekë, me një zbritje në vlerën 1,044,505 lekë.
Llogaria 431 ñ*Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa*ò, analizuar e kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 678,080 lekë përfaqëson detyrimet për tatimin mbi pagat e personelit në muajin dhjetor 2021. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2022.
Llogaria 435 ñ*Sigurime shoqërore*ò, e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 3,275,378 lekë përfaqëson detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore në muajin dhjetor 2021. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2022.
Llogaria 436 ñ*Sigurime shëndetësore*ò, e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 449,736 lekë, përfaqëson detyrimet për kontributet e sigurimet shëndetësore në muajin dhjetor 2021. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2022.
Në mbyllje të periudhës raportuese, llogaritë kreditore 42; 431; 435 dhe 436 në vlerën totale 15,651,099 lekë, përfaqësojnë detyrime të njësisë publike Bashkia Mallakastër për pagat e personelit, kontribute për sigurime shoqërore, shëndetësore si dhe tatimin mbi pagë, të përllogaritura për pagesë në muajin dhjetor 2021, të cilat janë likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2022.
Detyrime të tjera afatshkurtra:
Në këtë grup të detyrimeve afatshkurtra paraqiten shpenzimet e kryera nga njësia ekonomike, dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur si shpenzime nga njësia ekonomike.

Po kështu, njësia ekonomike përfshin në këtë grup edhe të gjitha detyrimet e llogaritura për të paguar interesat e maturuara ekonomikisht.
Llogaritë për detyrime të tjera afatshkurtra janë paraqitur në **Pasqyrën PF23/2021,** në Anekset bashkëlidhur.

Titulli i gjetjes: Mosmarrja në dorëzim e kontratave të investimeve të mbyllura, mbajtja e garancisë përtej limiteve kohore.
Situata: Gjendja e llogarisë 466 ñ*Kreditorë për mjete në ruajtje*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 37,245,475 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 48,822,037 lekë ose me rritje në vlerën 11,576,562 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme.
Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Mallakastër, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se shifra është e njëjtë me vlerën e pasqyruar në bilancin e Bashkisë Mallakastër.
Në mënyrë analitike, Llogaria 466 ñ*Kreditorë për mjete në ruajtje*ò në fund të vitit 2021 është paraqitur në **Pasqyrën PF24/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, nuk është bërë zhbllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 51-88
Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 ñ*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*ò i ndryshuar, Kap II ñ*Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit*ò, të VKM nr. 3, datë 15.2.2001 ñ*Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit*ò i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2001 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike*ò i ndryshuar pikat 42 ï 50 të tij, UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 ñ*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*ò i ndryshuar, Kap. II, pika 10.
Ndikimi/Efekti: Mosmarrja në dorëzim e objekteve janë verime të cilat nuk garantojnë nëse objekti është zbatuar sipas kushteve teknike të projekt/preventivave, si është realizuar dhe nëse është realizuar brenda kushteve teknike. Gjithashtu, moskryerja e këtij veprimi bën që nga Bashkia Mallakastër të mos bëhet vlerësimi i subjekteve mbi cilësinë e punimeve dhe nëse këto subjekte janë shoqëri të besueshme për kryerjen e punimeve me cilësi dhe në afatet të caktuar, si dhe vënia në vështirësi ekonomike e OE, të cilëve iu nevojiten fondet e ngurtësuara për të vazhduar veprimtarinë e tyre ekonomike.
Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor nga personat përgjegjës.
Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuara.

Gjendja e llogarisë 4341 ñ*Operacione me shtetin (detyrime)*ònë datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 60,915,692 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 60,528,690 lekë ose me rritje në vlerën 387,002 lekë.

Në mënyrë analitike, llogaria 4341 ñ*Operacione me shtetin (detyrime)*ò në fund të vitit 2020 është paraqitur në **Pasqyrën PF25/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e llogarisë 467 ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 10,634,793 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 10,573,571 lekë ose me zbritje në vlerën 61,222 lekë.
Vlera e kësaj llogarie është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.
Në mënyrë analitike, Llogaria 467 ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò në fund të vitit 2021 është paraqitur në **Pasqyrën PF26/2021,** në Anekset bashkëlidhur.

- **KAPITALI**

Sipas përcaktimit të bërë në SKK, kapitali rezulton si diferencë e aktiveve me detyrimet e njësisë ekonomike. Në zbatim të SKK 2 (shtojca 4), njësia ekonomike duhet të pasqyrojë, bazuar në parimin e materialitetit, elementët përbërës të kapitaleve të veta.
Gjendja e llogarisë 101 ñ*Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar*ò(Kapitali i nënshkruar)në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 1,926,114,575 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,904,517,820 lekë ose me zbritje në vlerën 21,596,755 lekë.
Gjendja e llogarisë 85 ñ*Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore*ò (*Humbja/fitimi i ushtrimit*)në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 100,822,596 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 175,003,770 lekë ose me rritje në vlerën 74,181,174 lekë. Në këtë zë paraqitet rezultati i periudhës rrjedhëse ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Llogaritë 105 ñ*Teprica e Granteve kapitale të brendshme*ò dhe 106 ñTeprica e Granteve kapitale të huajaò, si për periudhën ushtrimore paraardhëse, ashtu edhe për periudhën ushtrimore të mbyllur, janë me vlerën 0 (zero).
Grantet kapitale të brendshme mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proçes të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.
Pasqyra e performances financiare në fund të vitit 2020 është paraqitur në **Pasqyrën PF27/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Sipas SKK nr. 2, në pasqyrën e performancës duhet të përfshihen të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në një periudhë kontabël.
Ky standard siguron trajtim të ndryshëm për rrethanat në vijim:
a. Efektet e korrigjimeve të gabimeve dhe ndryshimet në politikat kontabël paraqiten si rregullime retrospektive të periudhave të mëparshme dhe jo si pjesë e fitimit ose humbjes në periudhën në të cilën ato lindin (*SKK 1 - Parimet e Përgjithshme për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare*);
b. Si pjesë e të ardhurave gjithëpërfshirëse, jashtë fitimit/ humbjes së vitit, njihen katër lloje të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse;

i. fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga përkthimi i pasqyrave financiare të një veprimtarie të huaj (*SKK 12 - Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit*);
ii. fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale në vlerë të drejtë sipas trajtimit alternativ të lejuar (*SKK 5 - Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale);*
iii. fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje (*SKK 3 "Instrumentet Financiare";*
iv. Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet

Emërtimet e zërave duhet të respektohen, megjithëse mund të shtohen zëra të tjerë ose nënkategori të zërave, nëse ato ndikojnë në përmirësimin e qartësisë dhe lexueshmërisë së pasqyrës së performancës.
Pasqyra e përformancës tregon, minimalisht, zërat që paraqesin shumat të cilat përbëjnë fitimin ose humbjen. Fitimi ose humbja është rreshti i fundit i kësaj pasqyre.

- **TË ARDHURAT**

1. Të ardhura nga taksat dhe tatimet:
Llogaria 70 ñ*Të ardhurat nga taksat e tatimet*ò, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 109,649,237 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 75,142,497 lekë ose me ulje në vlerën 34,506,740 lekë.
Të ardhurat nga taksat e tatimet janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën PF28/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Llogaria 71 ñ*Të ardhura jotatimore*ò, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 23,771,846 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 41,021,227 lekë ose me rritje në vlerën 17,249,381 lekë.
Të ardhurat jotatimore janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën PF29/2021,** në Anekset bashkëlidhur.
Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

2. Të ardhura të tjera:
Llogaria 72 ñ*Grante korente*ò, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 543,061,807 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 491,337,127 lekë ose me ulje në vlerën 51,724,680 lekë. Në zërin ñ*Të Ardhura të tjera*ò, në llogarinë 787 ñ*Tërheqje nga seksioni i investimeve*ò, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 22,057,359 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 64,000,000 lekë ose me rritje në vlerën 41,942,641 lekë. Në llogarinë 73 ñ*Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve*ò, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 9,906,901 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,229,512 lekë ose me ulje në vlerën 8,677,389 lekë.
Grantet korente, të ardhurat e tjera dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën PF30/2021,** në Anekset bashkëlidhur.

- **SHPENZIMET**

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:
Llogaria 600 ñ*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*ò, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 160,365,438 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 164,137,167 lekë ose me rritje në vlerën 3,771,729 lekë.
Llogaria 601 ñ*Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*ò, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 25,724,344 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 26,619,992 lekë ose me rritje në vlerën 895,648 lekë.
Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Mallakastër me të njëjtën vlerë.
Shpenzimet për pagat dhe kontributet shoqërore e shëndetësore janë paraqiturtë detajuara në **Pasqyrën PF31/2021,** në Anekset bashkëlidhur.

- **Testimi i llogarisë 600 "*Paga dhe shpërblime*"**

Për vitin 2021 numri i punonjësve është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 51 datë 25.11.2020. Numri i miratuar i punonjësve të Bashkisë Mallakastër, funksioneve të transferura dhe gjendjes civile ka qenë 465 punonjës. Sipas listëpagesave janë paguar mesatarisht 276 punonjës për Bashkinë Mallakastër dhe 161 punonjës për Ndërmarrjen e shërbimeve publike, në total 406 punonjës. Sa më sipër, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.
Numri i punonjësve sipas listëpagesave është paraqitur në **Pasqyrën PF32/2021,** në Anekset bashkëlidhur.

Numri i punonjësve sipas Vendimit nr. 51 datë 25.11.2020 është i ndarë si më poshtë:

1.	Administrata e Bashkisë	120 punonjës.
2.	Njësia Admnistrative Fratar	48 punonjës
3.	Nërmarrja e Sherbimeve publike	168 punonjës
4.	Shërbimi mbrojtjes nga zjarri	14 punonjës
5.	Funksione te transferuara nga arsimi	101 punonjës
6.	Specialist pyjesh (funksion i transferuar)	4 punonjës
7.	Specialist i bujqësisë (funksion i deleguar)	3 punonjës
8.	Gjendja civile	7 punonjës
	Totali:	**465 punonjës**

Sipas listë pagesave të muajve janar, shtator dhe dhjetor 2021 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listëpagesat dhe përmbledhësja e listëpagesave janë nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, z. A.R dhe nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër.

Janë mbajtur listë prezencat, të cilat janë nënshkruar nga Përgjegjëse e sektorit të Burimeve Njerëzore, znj. J.Ll dhe nga zv/Kryetari Bashkisë znj. A. M.

Auditimi me zgjedhje i disa dosjeve të personelit (me arsim të lartë).

Në auditimin e dosjeve të personelit krahasuar me nivelin e klasave, kategorinë, pagën e grupit, shtesat për vjetërsi, vështirësitë, pozicionin, etj, u konstatua se janë në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore të VKM-së nr. 1619, datë 02.07.2008 ñ*Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore si dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore*ò, i ndryshuar dhe në dosjet personale të nëpunësve administrohet:

- Dokumenti i identifikimit (fotokopje letërnjoftimi); dokumenti mbi gjendjen civile (certifikata e gjendjes familjare); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor në fushën e studimeve (fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave); dokument i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti); raporti mjeko ligjor; librezë pune; fotografi; CV; letër Motivimi; Dëshmi të tjera kualifikimi.

Hartimi i listëpagesave për vitin 2021

Me përzgjedhje u testuan listëpagesat e muajve janar, shtator dhe dhjetor 2021, nga ku u konstatua se janë plotësuar konform rregullave të përcaktuara. Listëpagesat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkruara nga znj. J.Ll. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, ñ*Kodi i Punës*ò, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 ñ*Për tatimin mbi të ardhurat*ò, me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 ñ*Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH*ò.

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

Llogaria 602 ñ*Blerje mallra dhe shërbime*ò, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 40,140,737 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 24,713,562 lekë ose me ulje në vlerën 15,427,175 lekë.

Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Mallakastër me të njëjtën vlerë.

Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime janë paraqitur në **Pasqyrën PF34/2021,** në Anekset bashkëlidhur.

- **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës, në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues, të konfirmuara nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dyja palët.
Urdhër-shpenzimet janë përpiluar në bazë të dokumenteve vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit, si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesat, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzime përputhen me vlerat e dokumenteve financiare që mbështesin shpenzimin përkatës.
Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.
Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadron me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- **Transaksionet financiare nëpërmjet arkës.**

Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se:
Me arkë janë kryer transaksione financiare, si arkëtim të ardhurash për detyrime nga taksa e tokës bujqësore, taksat e tarifat familjare, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuara me të gjitha ekstremitetet, sipas faturës për arkëtim e lëshuar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, arkëtim gjoba të Policisë Bashkiake. Nga arka nuk është kryer asnjë transaksion pagese. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkës, i cili është mbyllur për çdo muaj dhe është nënshkruar nga personi përgjegjës për arkën dhe specialiste e financës e ngarkuar për mbajtjen e ditarit të arkës.
Për vitin 2021, janë prerë Mandat Arkëtime në vlerën 30,049,422 lekë dhe libri i arkës është mbyllur me MA nr. 5451 datë 30.12.2021, në vlerën 4,544 lekë.
Janë derdhur në bankë 29,909,422 lekë dhe janë likuiduar nga arka paradhëniet për tarifat e kopshteve dhe çerdhes Ballsh në shumën 140,000 lekë.
Nga auditimi i librit të arkës dhe ditarit të arkës konstatohet se të ardhurat nga arkëtimet e kryera për vitin 2021 janë derdhur totalisht në mënyrë periodike në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të çdo viti është 0 (zero) lekë. Gjithashtu, është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël, i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës së të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me VKM-në nr. 783, datë 22.11.2006 ñ*Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël*ò, si dhe të UMF nr.30, datë 27.12.2011 ñ*Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*ò pikat 63, 64. Nga Drejtoria e Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit Mallakastër për të ardhurat.

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Mallakastër nuk ka pasur subvencione.

4. Transferimet korente:

Përfshihen transferimet për nivele të ndryshme të qeverisë për institucione të ndryshme qeveritare. Transferime korente, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 245,524,483 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 351,464,904 lekë ose me rritje në vlerën 105,940,421 lekë.

5. Shpenzimet financiare:

Përfshihen transferimet për nivele të ndryshme të qeverisë për institucione të ndryshme qeveritare. Shpenzime financiare, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 91,455,911 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 0 (zero) lekë.

Titulli i gjetjes: Probleme në lidhje me kryerjen e veprimeve kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për tâu paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivit.

Situata:

- **Kontratat e lidhura për vitin 2021:**

Për vitin 2021, janë kryer investime në total për 17 objekte, në vlerën totale të prokuruar 1,259,818,211 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 1,177,981,840 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 21,577,602 lekë. Planifikimi për tâu likuiduar gjatë vitit 2021 ka qenë 278,451,257 lekë, është realizuar në vlerën 232,053,837 lekë. Vlera e mbetur për tâu financuar ka qenë 924,350,401 lekë.

Me fonde të deleguara nga Qeveria kanë qenë gjithsej 5 objekte, në vlerën totale të prokuruar 1,125,017,874 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 1,101,002,753 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 21,300,402 lekë. Planifikimi për tâu likuiduar gjatë vitit 2021 ka qenë 198,785,588 lekë, është realizuar në vlerën 189,552,711 lekë. Vlera e mbetur për tâu financuar ka qenë 890,149,640 lekë.

Me fondet e veta kanë qenë gjithsej 12 objekte, në vlerën totale të prokuruar 134,800,337 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 76,979,087 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 277,200 lekë. Planifikimi për tâu likuiduar gjatë vitit 2021 ka qenë 79,665,669 lekë, është realizuar në vlerën 42,501,126 lekë. Vlera e mbetur për tâu financuar ka qenë 34,200,761 lekë.

Konkluzion:Për vitin 2021 kanë qenë në zbatim 17 kontrata, të lidhura gjatë vitit dhe në vitet ushtrimore të mëparshme, në vlerën totale 1,177,981,840 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i bashkisë, Qeveria, FZHR dhe financime të huaja. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për tâu paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2021 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet nëllogarinë 476 ñ*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*ò.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò Aneksi 1 ñ*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*ò, Kreu I, ñ*Të përgjithshme*ò, pika 8, Kreu II, ñ*Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, "*Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, pika 32.

U kryen procedura testimi analitik me përzgjedhje kampionesh për zona të ndryshme llogarish, duke bërë verifikim të fondeve të planifikuar dhe të përdorura, të përllogaritjeve të vlerave për transaksione financiare të kryera si rezultat i ndodhjes së ngjarjeve ekonomike si dhe verifikimi i përputhshmërisë ligjore i dokumentacionit shoqërues mbështetës nëse ato

ishin kryer në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 ñ*Për Vetëqeverisjen Vendore*ò neni 40 ñ*Shpenzimet*ò pika 1.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 51-88

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 ñ*Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre*ò i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*ò; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 ñ*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*ò; SKK nr. 5 ñ*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale*ò pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 ñ*Investime në Pjesëmarrje*ò pika 35, etj.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Mallakastër.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës sëdërguarnga MFE përalokimin e fonditpjesortëvititushtrimortëdetajuarsipasprojektevetëinvestimeve, tëkryhetveprimikontabëlpërshumatpërkatësenëdebitëllogarisë 520 ñ*Disponibilitetenëthesar*ò dhenëkreditëllogarisë 476 ñ*Tëardhuratëcaktuarapërt'upërdorur*ò.

Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situcion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò dhe në kredi të llogarisë 404 ñ*Furnitorë për investime*ò.

Në momentin e pagesave të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 ñ*Furnitorë për investime*ò dhe në kredi të llogarisë 520 ñ*Disponibilitete në thesar*ò.

Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për **investimet e papërfunduara/në proçes,** të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 ñ*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*ò, në kredi të llogarisë 720 ñ*Grant korrent i brendshëm*ò dhe në kredi të llogarisë 4342, ñ*Operacione me shtetin (të drejta)*ò për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

Me përfundimin e investimit, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 ñ*Aktive afatgjata materiale*ò dhe në kredi të llogarisë 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò.

Me kapitalizmin e aktivit,(për aktivet e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 ñ*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*ò, në kredi llogarisë 105 ñ*Grante të brendshme kapitale*ò për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 ñ*Shtesa të fondit bazë*ò dhe në debi të llogarisë 105 ñ*Grante të brendshme kapitale*ò për vlerën e aktiveve të blera.

Për sa më sipër, përgjegjësia është e z. Q. Ij, me funksion Kryetar aktual i Bashkisë Mallakastër, z. A. R, me funksion Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, z. Q. S, me funksion Përgjegjës i Sektorit të Financës, dhe z. R. Lj, me funksion Specialist i Financës.

2.4. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*", VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", i ndryshuar me VKM nr. 420, datë 13.05.2015, me VKM nr. 823, datë 23.11.2016 me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 dhe me VKM nr. 80, datë 14.02.2018, Manualeve përkatëse të punimeve, udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik etj, për periudhën 01.01.2018-31.12.2021.

(Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve; Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara; Auditimi mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit);

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve:

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitet ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara:

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Mallakastër *(regjistrat e parashikimit dhe realizmit)*, për periudhën 01.01.2019 ï 31.12.2020, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Procedura 01.01.2018-31.12.2021	Nr.	Vl. Fond Limit	Vl. Kontrate
Gjithsej	**79**	**1,843,388,628**	**1,705,157,694**
- Të hapura	29	1,679,872,736	1,556,333,970
- Hapura me lote	11	20,732,277	18,194,933
- Kërkesë me propozim	39	142,783,615	130,628,791
Sipas objekteve	**79**	**1,843,388,628**	**1,705,157,694**
- Objekte në fushën e investimeve	22	1,428,767,094	1,321,598,283
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	57	414,621,534	383,559,411

Burimi: *Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Mallakastër*

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2018 ï 31.12.2021, janë realizuar gjithsej **79** procedura me fond limit 1,843,388 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 1,705,694 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 138,230 mijë lekë ose 7.5%, *nga e cila:* për ***vitin 2018*** janë realizuar gjithsej **20** procedura me fond limit 338,486 mijë lekë dhe vlerë kontrate 320,122 mijë lekë, për ***vitin 2019*** janë realizuar gjithsej **30** procedura me fond limit 236,362 mijë lekë dhe vlerë kontrate 210,070 mijë lekë, në ***vitin 2020*** janë realizuar gjithsej **14** procedura me fond limit 595,193 mijë lekë dhe vlerë kontrate 550,605 mijë lekë dhe për ***vitin 2021*** janë realizuar **15** procedura me fond limit 673,346 mijë lekë dhe vlerë kontrate 624,360 mijë lekë.

Kanë marrë pjesë në procedura **364** OE/BOE dhe janë sõkualifikuar **164** OE/BOE ose 45%.
Sipas llojit të aktivitet, konstatohet se në fushën e ndërtimit (investime), janë **22** procedura me vlerë kontrate 1,321,598 mijë lekë ose 77.5% e kontratave të lidhura dhe në të tjera janë **57** procedura me vlerë kontrate 383,559 mijë lekë.
Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **11** procedura ose 14% e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 41 procedura, ose 52% e tyre, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuara nga AK Bashkia Mallakastër janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të operatorëve të kualifikuar.
Mbi bazën e materialitetit dhe riskut të bërë nga Grupi i KLSH, nga **79** procedura me vlerë kontrate 1,705,157 mijë lekë janë vlerësuar për auditim **39** procedura me vlerë kontrate 1,615,821 mijë lekë ose 94.7% e kontratave të lidhura, ku shkeljet sipas procedurave dhe problematikave paraqitet si më poshtë vijon:

Titulli i gjetjes: KLSH-ja, konstatoi se në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2020, janë konstatuar kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST, të miratuar nga AK-ja**.**
Situata: Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2018 ï 31.12.2021, janë realizuar gjithsej **79** procedura me fond limit 1,843,388 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 1,742,304 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 138,230 mijë lekë ose 7.5%, *nga e cila:* për ***vitin 2018*** janë realizuar gjithsej **20** procedura me fond limit 338,486 mijë lekë dhe vlerë kontrate 320,122 mijë lekë, për ***vitin 2019*** janë realizuar gjithsej **30** procedura me fond limit 236,362 mijë lekë dhe vlerë kontrate 210,070 mijë lekë, në ***vitin 2020*** janë realizuar gjithsej **14** procedura me fond limit 595,193 mijë lekë dhe vlerë kontrate 550,605 mijë lekë dhe për ***vitin 2021*** janë realizuar **15** procedura me fond limit 673,346 mijë lekë dhe vlerë kontrate 624,360 mijë lekë.
Grupi i KLSH-^{së}, referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut nga **79** procedura me vlerë kontrate 1,742,304 mije lekë janë vlerësuar për auditim **39** procedura me vlerë kontrate 1,615,821 mijë lekë ose 94.7% e vlerës së kontratave të lidhura, *nga e cila:* për *vitin 2018* nga **20** procedura me vlerë kontrate 307,193 mijë lekë janë audituar **10**procedura me vlerë kontrate 209,808 mijë lekë, për *vitin 2019* nga **30** procedura me vlerë kontrate 210,070 mijë lekë janë audituar **11**procedura me vlerë kontrate 172,554 mijë lekë ose 82% e vlerës së kontratave, për *vitin 2020* nga **14** procedura me vlerë kontrate 550,605 mijë lekë janë audituar **9**procedura me vlerë kontrate 541,255 mijë lekë ose 98% e vlerës së kontratave, dhe për *vitin 2021* nga **15** procedura me vlerë kontrate 624,360 mijë lekë janë audituar **7** procedura me vlerë kontrate 604,888 mijë lekë ose 97% e kontratave.
Nga auditimi i **39** procedurave me vlerë kontrate **1,615,821**mijë lekë, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **18** procedura, *nga të cilat*: në **15** procedura kriteret nuk janë në përputhje me llojin e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në mospjesëmarrjen e OE në procedura, në **7** procedura OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK, në vlerën **197,346 mijë lekë** pa TVSH, veprime në kundërshtim me ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, ñ*Për prokurimin publik*ò, i ndryshuar nenet 2, 20, 23, 24, 46, 47, 53, 55, 58, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, i ndryshuar, nenet 26, 27, 28, 61*konkretisht sipas periudhave:*

a. ***Për aktivitetin e vitit 2018***, nga auditimi i **10** procedurave me vlerë kontratë 209,808 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, gjithsej **7** procedura me të audituara, ku në **6** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **2**raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mallakastër, pasi ka mangësi në plotësimin

e tyre, në vlerën **61,761 mijë lekë pa TVSH**.

b. ***Për aktivitetin e vitit 2019***, nga auditimi i **11** procedurave me vlerë kontratë 172,554 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, gjithsej **6** procedura me të audituara, ku në **5** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **2**raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mallakastër, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, vlerën **44,599 mijë lekë pa TVSH**.

c. ***Për aktivitetin e vitit 2020***, nga auditimi i **9** procedurave me vlerë kontratë 541,255 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, gjithsej **3** procedura me të audituara, ku në **2** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **1**raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mallakastër, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, në vlerën **21,641 mijë lekë pa TVSH**.

d. ***Për aktivitetin e vitit 2021***, nga auditimi i **7** procedurave me vlerë kontratë 604,888 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, gjithsej **3** procedura me të audituara, ku në **2**raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **2**raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mallakastër, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, veprime në paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **69,345 mijë lekë pa TVSH**.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, ñ*Për prokurimin publik*ò, i ndryshuar: Neni 2, *"Parimet e përzgjedhjeje";* Neni 20, *"Mosdiskriminim",* Neni 23, *"Specifikimet teknike",* Neni 24, *"Anulimi i një procedure",* Neni 46, *"Kualifikimi i ofertuesve"*, pika 1, Neni 53, *"Shqyrtimi i ofertave",* pika 3: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, i ndryshuar, Neni 26, pika 5, ñ*Kontratat për punë publike*ò, Neni 27, pika 3, ñ*Kontratat e mallrave*ò, Neni 28, pika 2, ñ*Kontratat e shërbimeve,*Neni 61, pika 2, *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"* Neni 74, pika 3, *"Bashkimi i operatorëve ekonomikë"*

Shkaku: Mos vlerësimi i drejtë i kritereve dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe aplikimi i kritereve të rënduara të cilat çojnë direkt ose indirekt në mospjesëmarrjen e OE.

Ndikimi/Efekti: Aplikimi i kritereve jo në mënyrë të argumentuar dhe në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kritereve të DST për vlerën **276,084 mijë lekë**, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: anëtarët e NJHDT dhe KVO, sipas procedurave ku ato janë pjesëmarrës, ku rast pas rasti do trajtohen më poshtë.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e NJHDT dhe KVO, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës dhe të trajnuar, të cilët në hartimin e kritereve të aplikohen kritere të cilat i përshtaten procedurës së zhvilluar, ndërsa në shpalljen fitues të OE të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke mos lejuar veprime me dy standarde në klasifikimin e tyre dhe të udhëhiqen nga kriteri kryesor ñ*Çmimi më i leverdishëm",* midis OE pjesëmarrës, kjo për të bërë të mundur përdorimin më me efektivitet të fondeve të prokuruara për vlerën **197,346 mijë lekë**.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për

marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

- **Procedurat e vitit 2018:**

Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve buxhetore.

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, Bashkia Mallakastër, referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **20** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 338,486 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 320,122 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 18,363 mijë lekë pa TVSH ose 5.5%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2018-31.12.2018	Nr.	Vl. Fond Limit	Vl. Kontrate
Gjithsej	**20**	**338,486,059**	**320,122,090**
Të hapura	8	289,564,988	274,327,775
Kërkesë me propozim	12	48,921,071	45,794,315
Sipas objekteve	**20**	**338,486,059**	**320,122,090**
Objekte në fushën e investimeve	8	243,691,744	229,385,591
Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	12	94,794,315	90,736,499

Burimi: *Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Mallakastër*

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **61** OE/BOE, nga të cilat janë skualifikuar **33** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **3** procedura ose 15% e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 16 ose 80% e tyre, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuara nga AK Bashkia Mallakastër janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të operatorëve të kualifikuar.

Nga auditimi i **10** procedurave me vlerë kontratë 209,808 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, gjithsej **7** procedura të audituara, ku në **6** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **3**raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mallakastër, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, në vlerën **101,677** mijë lekë, *si më poshtë vijon:*

1. Tenderi me objekt: "Karburant (Diezel)" Viti 2018, me këto të dhëna:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Karburant (Diezel)"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.289 regj, datë 29.01.2018 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.289 regj, datë 29.01.2018 1. .B. F ï (Jurist-PPP) 2. A. S -(Ing.Mek-Spec. i fushës) 3. P. L ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 42, datë 29.01.2018 1. H. S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. A. X (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 12,208,300 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñNERIò Shpkò me marzh 8.6 %, me lidhje kontrate datë 15.03.2018, me afat 12 muaj	7.Diferenca me fondin limit: X lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 27.02.2018	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e fondit limit.

Situata: Komisioni i ngritur sipas urdhrit nr. 19, datë 16.01.2018 për përllogaritjen e sasisë vlerës limit dhe afatit të lëvrimit për blerjen e karburantit që do prokurohet për vitin 2018, nuk ka dokumentuar metodikën e ndjekur për përllogaritjen e fondit limit, duke mos ju përmbajtur kritereve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë

29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Trajtuar tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos angazhimi në komisione i personave të kualifikuar.
Ndikimi/Efekti: Risku i përllogaritjeve të gabuara të sasive dhe vlerës së shpenzuar për karburant.
Rëndësia:E mesme
Rekomandimi: Titullari i AK, të krijojë komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, duke angazhuar personel të kualifikuar, dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.
Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit E. Ç, A.M, P. G, A.S dhe Z. H.

2. Tenderi me objekt: "Blerje materiale për mirëmbajtje trotuare dhe sheshe" Viti 2018, me këto të dhëna:

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje materiale për mirëmbajtje trotuare dhe sheshe"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.1452 regj, datë 19.06.2018 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñKërkesë për propozimò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.1452 regj, datë 19.06.2018 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. M. V ï (Ing.Nd.-Spec. i fushës) 3. P.L ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.187, Datë 19.06.2018 1. H. S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. A. X (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 5,833,333 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñSò Shpkò me ofertë 5,052,030 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 27.07.2018, me afat 30 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 781,303 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 02.07.2018	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 6 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 5 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nu ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e fondit limit.
Situata: Hartimi i fondit limit: Mungon urdhri për ngritjen e komisionit për hartimin specifikimeve teknike dhe fondit limit. Dokumenti nr.472/2 prot., datë 31.05.2018 i administruar në dosje, ka përcaktuar sasisë dhe vlerën e fondit limit, por nuk dokumentuar metodikën e ndjekur për përllogaritjen e fondit limit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 56, dhe pikën 2 të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Trajtuar tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos angazhimi në komisione i personave të kualifikuar.
Ndikimi/Efekti: Kryerja e procedurës në mos përmbushje të akteve nënligjore.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Titullari i AK, të krijojë komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, duke angazhuar personel të kualifikuar, dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.
Në çdo rast, komisionet e përfshira në procedurat e prokurimit publik, të ngrihen me urdhër titullarit.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e hartimit të preventivit F.B, A.M dhe E. Ç.

3. Tenderi me objekt: "Shtresë tapeti i rrugëve të lagjes "Bylis", të bulevardit qendror deri te shkolla "Odisea", si dhe ndërtim trotuare e bordura në rrugët e lagjes "Bylis" Viti 2018, me këto të dhëna:

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Shtresë tapeti i rrugëve të lagjes "Bylis", të bulevardit qendror deri te shkolla "Odisea", si dhe ndërtim trotuare e bordura në rrugët e lagjes "Bylis"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 1533 regj, datë 28.06.2018 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 1533 regj, datë 28.06.2018 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A. N ï (Ark.-Spec. i fushës) 3. P. L ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.204, Datë 28.06.2018 1. H.S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. A. X (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 55,360,000 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE ñBò Shpk & ñAò Shpk, me ofertë 52,805,688 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 23.08.2018, me afat 1 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 2,554,312 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 07.08.2018	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b)Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, - Ankesë nga OE ñB-93ò Shpk, protokolluar në bashki me nr. 1569 regj, datë 05.07.2018	12. Përgjigje ankesës nga AK, - Shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga OE ñBò Shpk, nr.1569/1 regj, datë 09.07.2018	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata:Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3/i e DST** e cila kërkon minimalisht 15 punonjës të pajisur me dëshmi për sigurimin teknik, nga të cilat të paktën njëri të jetë inxhinier ndërtimi dhe një teknik ndërtimi, është kërkesë e paargumentuar nga AK. Kjo kërkesë, me përjashtim të specifikimit per 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 teknik ndërtimi, nuk përcakton konkretisht profilet e punonjësve për të cilët kërkohet dëshmia e sigurimit teknik. Kërkesa është e paplotë, dhe nuk i shërben AK.

2.Kërkesa e pikës **2.3/h e DST**, e cila kërkon nga OE 1 mjek, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 ñ*Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*ò, pika 1 ku përcaktohet se:

ñ*Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon: "6.Punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C" dhe "D", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë."*ò

3.Kërkesa e pikës **2.3/j e DST**, kërkon nga OE disponimin në pronësi, qira ose kontratë furnizimi për 1 impiant prodhim betoni, 1 për prodhim inertesh dhe 1 për prodhim asfalti.

-Për impiantin e prodhimit të asfaltit, kërkohet QKL, Leje Mjedisi Tipi B, Kodi III.1.B si dhe të jetë e pajisur me ISO 9001:2015 dhe ISO 140001:2015, si dhe raport monitorimin brenda 6 muajve të fundit. Gjithashtu, kërkohet distanca **jo më e madhe se 30 km** nga vendndodhja e objektit të prokurimit.

-Për impiantin e prodhimit të betonit, kërkohet Leje mjedisi tipi B, Kodi III.1.B ñ*Për impiant betoni*ò, si dhe raport monitorimi të paktën 6 muajt e fundit.

-Për impiantin e inerteve, kërkohet QKL ï Leje Mjedisi Kodi III.1.B ñ*Për impiant inertesh*ò.

-Për impiantin e prodhimit të Inerteve dhe Impiantin e prodhimit të Betonit, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin e pronësisë, ose në rastet e marrjes me

qira kontratë noteriale e marrjes me qira, apo kontratë noteriale furnizimi, të shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë, si dhe duhet të paraqesë raport testimet për materialet si më poshtë:

- Raport Testim të Materialeve Inerte Granil, Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012. Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012- Raport Testimi të materialeve Inerte Rërë e Larë. Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012. Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012

- Raport Testimi nga Impianti i Prodhimit, metoda e e testimit S SH EN 12390 -1: 3 2009, SSH-EN 12390 1: 3 – 2009 për mostrën e betonit.

- Raport Testimi nga Impianti i Prodhimit i Ujit për Beton, metoda e testimit S SH EN 1008 : 2002

- Testimet e mësipërme duhet të jenë nga Laborator i akredituar konform S SH ISO/EN 17025;2006

- Raporti i testimeve duhet të jetë sipas standardeve në fuqi bazuar në ligjin Nr.9290 datë 07/10/2004 "Për Produktet e Ndërtimit". Raport testimet duhet të jenë të paktën brenda 1 viti nga data e prokurimit për këtë objekt.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatë Cilësie nga prodhuesi për materialet ndërtimore: Inerte, Çimento.

-Në lidhje me sa është kërkuar më sipër, sqarohet se kërkesat për certifikatat ISO si dhe kërkesat për paraqitjen e kërkesave për testimet, janë kërkesa të tejkaluara të LPP. Sqarojmë se përmbushja e specifikimeve teknike plotësohet me paraqitjen e deklaratës përkatëse nga OE, pasi këto dokumente janë për të tretë që nuk marrin pjesë direkt në procedurën e prokurimit. Gjithashtu, sqarohet se kërkesa për raport testimet e kryera të paktën brenda 1 viti nga data e prokurimit, nuk është kërkesë që i shërben AK, pasi janë raporte për produkte të cilat nuk janë produktet me të cilat do kryhet punimet në objektin e prokurimit.

-Në lidhje me kërkesën që fabrika ose impiantet të jenë jo më shumë se 30 km, përbën gjithashtu kufizim për OE, pasi distanca është shumë e afërt, ndërkohë që cilësia e produkteve të betonit ose asfaltit, mund të garantohet përtej kësaj distance.

Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 64, pika 5, dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar. Miratimi i raportit përmbledhës është bërë me vendimin nr. 1884/1, datë 22.08.2018.

1.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/i të DST,** e cila kërkon minimalisht 3 manovratorë, për të cilën kërkon të paraqesë krahas kontratës së punës, edhe policat e sigurimit të aksidenteve personale. Rezulton se për asnjërin prej manovratorëve, nuk është paraqitur polica e sigurimit të aksidenteve në punë.

2.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/j të DST** për mjetet kamionë (4 copë), kamionçina (3 copë), Fadroma (3 copë), Autobetoniere (3 copë), Autopompë betoni (1 copë), miniekskavator (2 copë). Për mjetet e mësipërme, rezulton mangësia si më poshtë:

a.Nga 4 kamionë të kërkuar, vetëm mjeti me targa AA601NP plotëson kriteret e vendosura. Mjetet tjera, konkretisht mjeti i deklaruar nga B shpk me targa AA674LM, i blerë me kontratë nga subjekti B, rezulton se të gjitha dokumentet e paraqitura janë në emër të subjektit B (leje qarkullimi, siguracion, certifikata e kontrollit), ndërkohë që këto dokumente duhet të jenë në emër të OE që ka blerë mjetin. Kamioni me targa AA189IU, i marrë me kontratë qiraje nga subjekti B, rezulton se ka certifikatën e transportit për vete, dhe jo për të tretë dhe me qira, sipas përcaktimeve ligjore. Mjeti me targa AA647DB+AER 400, i marrë me qira nga subjekti Vëllezërit D, rezulton se ka certifikatën e transportit për vete, dhe jo për të tretë dhe me qira. Kamionët e deklaruar edhe sipas shtojcës 10 nga OE A me targa TR9262P dhe AA522NF, të marrë me kontratë qiraje nga subjekti R. Group shpk, rezulton se nuk kanë certifikatën e transportit sipas kërkesës së DST.

b.Nga 3 fadroma të kërkuara, BOE ka paraqitur 3 fadroma me goma të marra me kontrata

qiraje, për të cilat mungon certifikata e transportit, pasi kërkesës së DST.
c.Nga 3 autobetoniere dhe 1 autopompë betoni të kërkuara, rezulton se të gjitha mjetet e deklaruara, të cilat janë marrë me kontrata qiraje, konkretisht autobetonieret me targa TR6295K, TR6294T, TR5537N dhe autopompa me targa TR5537N të marra me kontatë qiraje nga subjekti Eurobeton 2005, si dhe autobetoniere me targa AA386SC e marrë me kontratë qiraje ndërmjet OE B dhe Vëllezërit D, nuk kanë certifikatën e transportit për të tretë dhe me qira, por vetëm për vete.
Mangësitë e mësipërme, janë në kundërshtim me nenin 41 të ligjit me nr. 8308, datë 18.03.1998 ñ*Për transportet rrugore*ò i ndryshuar, i cili përcakton se:

Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

3.BOE nuk përmbush kriterin për 2 miniekskavator, pasi për mjetin e marrë me qira nga subjekti I. K, nuk ka paraqitur fotot sipas kërkesës në DST.
4.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/j të DST** për impiant prodhim betoni, inertesh dhe asfalti në lidhje me raport testimet, ISO-t si dhe QKL e kërkuara.
-Së pari, Raport Testimet e paraqitura nuk kanë asnjë informacion se kujt i drejtohen, por jepen vetëm disa të dhëna teknike laboratorike. Nuk jepet asnjë përshkrim në këto raporte testime, se kush është kërkuesi apo përfituesi i këtyre të dhënave.
-Së dyti, në DST kërkohet që për fabrikën e asfaltit, të paraqiten certifikatat ISO 9001:2015 dhe 14001:2015. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se nuk disponohet nga furnizuesi i këtij materiali, certifikata ISO 14001:2015, konkretisht nga furnitori ñSh. 07ò.
-Së treti, në DST kërkohet që për Nyjen e Inerteve, të disponohet QKL Kodi III.1.B. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se subjekti më të cilët kanë lidhur marrëveshje, konkretisht Sh. 07, disponon Licencën Kodi III.1.A, dhe atë të kërkuar në DST.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:****Personi përgjegjës për hartimin e kritereve të veçanta znj. A.N,* si dhe *anëtarët e KVO z. H.S, z. A. R dhe z. A. X.*
Ndikimi/Efekti: Prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E-të) në vlerën **52,805 mijë lekë** pa TVSH**.**
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga specialisti përgjegjës për hartimin e kritereve, znj. A. N, është paraqitur observacionit i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:
Pretendimet e subjektit:
1.Kërkesa e pikës 2.3/i e DST për 15 punonjës me dëshmi të sigurimit teknik.
Si dhe Ju kemi sqaruar ne Observacion Ju sqaroj shkurtimisht se kjo kerkese eshte vendosur duke marre parasysh, faktin e shtrirjes së madhe që ka kantieri ne zone te banuar, si dhe realizimit të kontratës brenda një afati kohor te shkurter prej 1 muaji. Arsyetimi i kerkeses ka qene se do teishte e nevojshme per te pakten 15 punonjes te trajnuar me masat e sigurimit teknik, ku rol kryesor ka qene vendodhja e punimeve (ne zone e banuar), ku pervec vetes, kolegeve, punonjesit e kompanise zbatuese duhet te kujdesen edhe per sigurine e banoreve dhe qytetareve.
2. Kërkesa mbi distancen. Sqaroj se eshte vendosur kjo kerkese pasi per materialet që do të përdoren në vepër, elementi kohe prodhimi-kohe vendosje eshte shume i rendesishem.
Argumentim teknik: Referuar VKM Nr.629 dt.15/07/2015 "Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre, si dhe VKM Nr.628, datë 15.07.2015 ñPër miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëveé é specifikimetò, midis të tjerave parashikon se:
Përzierja e prodhuar duhet zakonisht të transportohet menjëherë në kantierin e ndërtimit.

E gjithë procedura e prodhimit, transportit, vendosjes dhe ngjeshjes së përzierjes nuk lejohet të jetë më shumë se 2 (dy) orë.
Temperatura e lejuar e shtrimit 130-150 °C
Për 70 min temperatura ulet me rreth 30 °C
Duke patur parasysh se një kamion që transporton, sipas rregullave të qarkullimit rrugor, lëviz me shpejtësi mesatare 45-50 km/orë dhe duke patur parasysh plotësimin e kushtit prej 2 orësh për përmbylljen e procesit të shtrimit, nga përllogaritjet rezulton:

Prodhimi i asfaltit	40 minuta
Mbushja e kamionit referuar fabrikave 100 ton/orë	10.4 minuta
Procesi i shkarkimit, vendosjes dhe ngjeshjes së materialit	50 minuta
Koha e mbetur për transport materiali	19.6 minuta

Pra referuar të dhënave për këtë proces, distanca maksimale e përllogaritur për vendndodhjen e fabrikës së asfaltit, rezulton të jetë 16.3 km. Kjo distancë del nga përllogaritja sipas formulës së treshit, nga ku është marrë për bazë lëvizja e kamionit me ngarkesë me shpejtësi 50 km/orë (60 min) dhe koha e mbetur për transportin e materialit prej 19.6 minuta.
Duke qenë se në distancën maksimale të përllogaritur nuk sigurohet numri dhe konkurenca minimale për një impiant të tillë për përmbushjen e kërkesave të cilësisë së materialit që do të përdoret në vepër, gjykohet se distanca e përcaktuar prej jo më shumë se 30 km siguron konkurencën minimale, duke qenë se në këtë distancë rezultojnë të ketë disa impiante të prodhimit të asfaltit. Distanca e vendosur në një largësi prej jo më shumë se 30 km, është brenda kufirit të lejuar për sjelljen e materialit në kohe dhe për një realizim të mirë të punës në objekt.
Pra sa më sipër, për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të kontratës, kërkohet domosdoshmërisht plotësimi i kushteve dhe elementëve të mësipërm për mjetet e makineritë, të përcaktuara në shkronjën ñjò.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 9 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
Oferta e paraqitur nga ky OE është oferta me vlerën më të ulët të paraqitur në këtë procedurë.
Duke e krahasuar ofertën fituese, rezulton se diferenca e ofertës fituese nga fondi limit është **2.554.312** lekë pa TVSH.
Grupi i Auditimit të KLSH ka konsideruar se BOE ñB shpk & A shpkò,i shpallur fitues nuk plotëson kriteret sipas pikave 2.3/i,dhe 2.3/j të DST.
Për këtë arsye, paraqesim këtë Observacion, duke sqaruar si më poshtë:
Për sa i përket mangësive të konstatuara ne pikën 2.3/i dhe 2.3/j të DST nga KVO është konsideruar si e plotësuar për shkak se totali i mjeteve të deklaruara nga ana e BOE ñB& Aò e plotëson dhe e tejkalon kapacitetin dhe volumet e kërkuara nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër,nga KVO është vlerësuar se pavarësisht se në çertifikatat e mjeteve të paraqitura nuk janë dhe për me qera,paraqitja e aktit noterial për marrje me qera të mjeteve nga oprator të tjerë ekonomik e bënë të pranueshme dhe të plotësuar kriterin e vendosur nga AK.
Pra, oferta e paraqitur nga OE fitues është vlerësuar nga ana jonë për shkak të çmimit më të ulët të ofruar, duke patur në fokus parimin e ekonomicitetit dhe parashikimet e bëra në ligjin e prokurimit publik.
Gjatë vlerësimit të ofertave, KVO ka mbajtur në konsideratë anën ekonomike, sipas kriterit të vlerësimit "çmimi më i ulët", të përcaktuar në dokumentet e tenderit të kësaj procedure, duke i konsideruar si devijime të vogla mangësitë në dokumentacionin e paraqitur nga operatorët

ekonomikë të kualifikuar.
Në arritjen e këtij konkluzioni, KVO është referuar në pikën 4, të nenit 53, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...*".

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 9 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

4. Tenderi me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Besëlidhja", qyteti Ballsh" Viti 2018, me këto të dhëna:

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Besëlidhja", qyteti Ballsh"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.1732 regj, datë 26.07.2018 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.1732 regj, datë 26.07.2018 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A.N ï (Ark.-Spec. i fushës) 3. M. V ï (Ing.Nd.-Spec. i fushës)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.236, Datë 26.07.2018 1. H S (Kryetar) 2. A R (Anëtar) 3. A X (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 62,952,642 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE ñBò Shpk & ñPò Shpk, me ofertë 60,416,378 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 18.09.2018, me afat 5 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 2,536,264 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 27.08.2018	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b)Skualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP

5. Tenderi me objekt: "Rikonstruksion i shkollës Hekal" Viti 2018, me këto të dhëna:

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i shkollës Hekal"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 2622 regj, datë 19.11.2018 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 2622 regj, datë 19.11.2018 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A. N ï (Ark.-Spec. i fushës) 3. P. L ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.356, Datë 19.11.2018 1. H. S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. E. Ç (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 28,141,381 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE ñF. Kò Shpk & ñE. Kò Shpk, me ofertë 26,899,654 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 31.12.2018, me afat 5 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 1,241,727 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 20.12.2018	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit dhe Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b)Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Procedurat e mësipërme, janë audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Programit të auditimit me nr. 624/1 prot., datë 04.09.2019, dhe Vendimit të Kryetarit të KLSH me nr. 159, datë 24.12.2019.

6. Tenderi me objekt: "Blerje çakull, stabilizant, steril bituminoz për mirëmbajtje rruge në fshatra" Viti 2018, me këto të dhëna:

6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje çakull, stabilizant, steril bituminoz për mirëmbajtje rruge në fshatra"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 1925 regj, datë 30.08.2018	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 1925 regj, datë 30.08.2018 1. B.F ï (Jurist-PPP) 2. M. V ï (Ing.Nd.-Spec. i fushës) 3. P. L ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.262, Datë 30.08.2018 1. H.Sj (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. E.Ç (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 41,666,667 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñFò shpkòme ofertë 39,916,097 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 19.10.2018, me afat 2 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 1,750,570 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 04.10.2018	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve.
Situata:Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3/c e DST** e cila kërkon nga OE një punësim mesatar prej 25 punonjës për periudhën Janar 2017 ï Korrik 2018, është kërkesë e ekzagjeruar si për numrin 25 punonjës në listëpagesa, numër i cili është relativisht i lartë në raport me natyrën e kontratës objekt prokurimi, dhe gjithashtu shtrirja kohore prej 19 muajsh në listëpagesa, është gjithashtu kriter kufizues i cili nuk i shërben AK, por bëhet pengesë për OE.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:****Personi përgjegjës specialist i fushës për hartimin e kritereve të veçanta z. M V.*
Ndikimi/Efekti: Ndikon në numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
OE ñ**F** shpk**"** ka paraqitur ofertën **39.916.097lekë pa TVSH.**
Oferta e paraqitur nga ky OE është oferta me vlerën më të ulët të paraqitur në këtë procedurë.
Duke e krahasuar ofertën fituese, rezulton se diferenca e ofertës fituese nga fondi limit është **1,750,570** lekë pa TVSH
Grupi i Auditimit të KLSH ka konsideruar se OE ñFò shpk, i shpallur fitues nuk plotëson kriteret sipas pikave 2.3/a,2 dhe 2.3/d të DST.
Për këtë arsye, paraqesim këtë Observacion, duke sqaruar si më poshtë:
1.Nga dokumentacioni i dorëzuar nga opertaori ekonomik "F" shpk rezulton se nga verifikimi i kontratave te dorezuara së bashku me situacionet përkatëse nga operatori ekonomik "F"shpk janë kryer punë të ngjashme më sumë se sa vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor.Nga KVO është vlerësuar dhe marrë në kosideratë dhe realizimi i punëve në të cilat janë përfshirë zera të materialeve te cilat janë objket i prokurimit nga bashkia Mallakastër, kryesisht zërat çakull, stabilizant.
2.Për sa i përket pikë 2.3/d të DST nga KVO është konsideruar si e plotësuar për shkak se totali

i mjeteve të deklaruara nga ana e subjektit "F" shpk e plotëson dhe e tejkalon kapacitetin dhe volumet e kërkuara nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër. Në plotësimin e kësaj kërkese, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se thelbi dhe synimi i saj është disponimi nga ana e operatorit ekonomik i mjeteve dhe makinerive të kërkuara, për realizimin e punimeve objekt kontrate, dhe konkretisht për kapacitetin e tyre, ku në rastin konkret kapaciteti plotësohet në referim dhe të volumeve të preventivit, dhe është konsideruar si nje devijim i vogël ndyshimi në ndonje mjet të veçante i kapacitetit në nivele të vogla, pasi në vlerësim të qëllimit që duhet të përmbushe OE e ka plotësuar dhe tejkaluar kapacitetin teknik të kërkuar dhe të nevojitur për realizmin e kontratës. Sa më sipër refuzimi i një oferte fituese në kushte të tilla do ishte kunder interesit të AK për realizimin e investimit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Pranohet observacioni juaj lidhur me kontratën e ngjashme. Në kushtet kur OE rezulton se në punët publike, në të gjitha rastet është shoqëruar edhe me furnizim të materialeve të ngjashme ose të njëjta të cilat janë të nevojshme për realizimin e kontratave, do konsiderohet e argumentuar dhe i përmbushur si kriter. Gjithashtu, lidhur me kapacitetin e mjeteve, do konsiderohet kriter i përpmbushur, pasi OE provon se disponon një numër më të madh mjetesh se sa ai i kërkuar, të cilët jo në çdo rast kanë kapacitetin sipas kërkesës në DST, mgjth kapaciteti në total i mjeteve e tejkalon dhe do konsiderohet kriter i përmbushur, por në rastet në vijim, AK duhet të bëjë evidentimin e këtyre situatave dhe ti paraqesë ato në Raportin Përmbledhës.

7. Tenderi me objekt:, "Rikonstruksion godina MNZ" me këto të dhëna:

7. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion godina MNZ"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.regj 2392, datë 22.10.2018 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Kërkesë për Propozim	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1.B. F 2.P. L 3.A. N	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 318, datë 22.10.2018 1.H. S (Kryetar) 2.A. R (Anëtar) 3.E. Ç (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 4,166,667 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñFò shpk - 3,929,994 lekë me lidhje kontrate 26.11.2018 me afat 2 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 236,673 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 05.11.2.018	9.Burimi Financimit:Nga buxheti i bashkise 2018, transferte e pakushtezuar + te ardhurat	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b)Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve.
Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3/f e DST** e cila nga kërkon OE, të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, është kërkesë e paargumentuar. Kërkesa që Drejtuesi Teknik i punimeve të jetë me kohë të plotë në objekt dhe i paangazhuar me kontrata të tjera, është në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. ñ*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*ò, i cili përcakton se:

*Për vlera me vlerë të plotë të preventuar mbi **30,000,000 lekë**, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.*

2.Kërkesa e pikës **2.3/g e DST**, e cila kërkon të jetë pjesë e stafit një mjek i punësuar, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 ñ*Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*ò, pika 1

ku përcaktohet se:

ñ*Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:*
*"6.Punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C" dhe "D", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë."*ò

3.Kërkesa e pikës **2.3/h e DST**, e cila kërkon 20 punonjës, nga 28 në total të kërkuar për zbatimin e kësaj kontrate, të cilët duhet të kenë dëshmi sigurimi teknik, është kërkesë e fryrë, dhe jo në përputhje me vlerën dhe volumin e punimeve.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:****Personin përgjegjës specialist i fushës për hartimin e kritereve të veçanta znj. Aurora Naka.*

Ndikimi/Efekti: Ndikon në numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga specialisti i fushës, anëtarët i NJHDT është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1.Kërkesa e pikës 2.3/f e DST ,sqaroj se:

Kjo kërkesë është vendosur për të garantuar autoritetin kontraktor se punimet objekt kontrate do të ndiqen dhe zbatohen gjatë kohës së implementimit të tyre nga drejtuesi teknik i përcaktuar nga ana e shoqërisë, i cili nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Mos-angazhimi në kontrata të tjera garanton AK-në për angazhimin maksimal gjatë zbatimit të punimeve objekt kontrate.Kjo kërkesë nuk është kufizuese, pasi nuk është kërkuar sipas UKM nr.2, dt.13.05.2005 që drejtuesit teknik të jenë rezident. Fakti i mos angazhimit në kontrata të tjera nuk nënkupton të qenit rezident në kantierin e punimeve, por thjesht garanton AK për disponibilitetin e drejtuesit teknik ne realizmin e punimeve në mënyrë korrekte ne përputhje me KTZ dhe brenda afatit të përcaktuar.

2.Kërkesa e pikës 2.3/h e DST ,sqaroj se:

Observacioni për stafin me dëshmi sigurimi teknik, është i njëjtë me observacionin e paraqitur dhe trajtuar tek procedura e mësipërme.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 9 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

8. Tenderi me objekt: "Blerje pemë dhe lule dekorative për gjelbërimin e ambienteve të qytetit" Viti 2018, me këto të dhëna:

8. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje pemë dhe lule dekorative për gjelbërimin e ambienteve të qytetit"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 2144 regj, datë 27.09.2018	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 2144 regj, datë 27.09.2018 1. B. F ï (Jurista-PPP) 2. E. A ï (Ing.Pyjesh.-Spec. i fushës) 3. P. L ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.282, Datë 27.09.2018 1. H. S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. E. Ç (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñKërkesë për propozimò		
5.Fondi Limit (pa Tvsh)	6.Oferta fituese:	7.Diferenca me fondin limit:

5,033,324 lekë pa tvsh	OE ñFò Shpkò me ofertë 4,858,225 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 22.10.2018, me afat 10 ditë	175,099 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 08.10.2018	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar - OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e fondit limit.
Situata: Hartimi i fondit limit: Komisioni i ngritur sipas urdhrit nr. 272, datë 17.09.2018 për hartimin e specifikimeve teknike, preventivit dhe lëvrimit të mallit..., nuk ka dokumentuar metodikën e ndjekur për përllogaritjen e fondit limit, duke mos ju përmbajtur kritereve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Trajtuar tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos angazhimi në komisione i personave të kualifikuar.
Ndikimi/Efekti: Kryerja e procedurës në mos përmbushje të akteve nënligjore.
Rëndësia:E mesme
Rekomandimi: Titullari i AK, të krijojë komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, duke angazhuar personel të kualifikuar, dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.

9. Tenderi me objekt: "Blerje materiale për ndriçim qyteti" Viti 2018, me këto të dhëna:

9. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje materiale për ndriçim qyteti"		
1.Urdhër Prokurimi: Nr. 2535 regj, datë 07.11.2018 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 2535 regj, datë 07.11.2018 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. P. G ï (Ing.Elektrik-Spec.i fushës) 3. P. L ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.343, Datë 07.11.2018 1. H.S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. E. Ç (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 9,166,667 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñEò Shpk, me ofertë 8,895,145 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 01.02.2019, me afat 10 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 271,522 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 17.12.2018	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar - OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Ka/Nuk ka (nëse ka nr. date ankese dhe ankimues) - Ankesë nga OE ñAò Shpk, protokolluar në bashki me nr. 2604 regj, datë 15.11.2018	12. Përgjigje ankesës nga AK, Ka/Nuk ka (nëse ka nr. date ankese dhe ankimues) - Shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga OE ñAò Shpk, nr.2604/1 regj, datë 16.11.2018	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka/Nuk ka (nëse ka nr. date) - Vendimi K.P.P. Nr.04/2019, Datë 08.01.2019, protokolluar në bashki me nr.39 regj, datë 10.01.2019.

Titulli i gjetjes: Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në kundërshtim me kriteret.
Situata: Lidhur me specifikimet teknike të vendosura për këtë procedurë, AK Mallakastër ka kontraktuar një specialist të jashtëm, z. P. G, për vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimin e kritereve. Pranë AK, është paraqitur një ankesë nga OE subjekti ñA.B.Eò shpk, e protokolluar me nr. 2604, datë 15.11.2018, i cili ankohet për specifikimet teknike të vendosura. Titullari i AK, me urdhrin nr. 352, datë 15.11.2018, ka urdhëruar pezullimin e procedurës, dhe ngritjen e KSHA, e cila përbëhet nga specialisti i kontraktuar P. G. Pikërisht,

vendosja e tij për shqyrtimin e ankesës, është në kundërshtim me pikën 6, germa (a), paragrafi i dytë i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar, i cili përcakton se:

Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Trajtuar tek situata e gjetjes.
Shkaku: Neglizhencë e strukturave të përfshira në procesin e procedurave të prokurimit.
Ndikimi/Efekti: Vlerësim i ankesave në kushtet e konfliktit të interesit
Rëndësia:E mesme
Rekomandimi: Titullari i AK, në çdo rast shqyrtimi të ankesave, të vendosë persona të cilët nuk janë të përfshirë në proceset për të cilat këto ankesa janë paraqitur.

10. Tenderi me objekt: "Sistemi i ngrohjes dhe infrastruktura e Bashkisë" Viti 2018, me këto të dhëna:

10. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Sistemi i ngrohjes dhe infrastruktura e Bashkisë"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 2345 regj, datë 18.10.2018	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 2345 regj, datë 18.10.2018 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A. N ï (Ark.-Spec. i fushës) 3. P. L ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.314, Datë 18.10.2018 1. H. S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. E. Ç (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñKërkesë për propozimò		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 9,514,648 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñSHò Shpk,me ofertë 8,956,765 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 19.11.2018, me afat 30 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 557,883 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 29.10.2018	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave.
Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3/c e DST** e cila kërkon mesatarisht 43 punonjës për zbatimin e kësaj kontrate, është kërkesë që nuk argumentohet nga AK. Ky numër është relativisht i lartë, bazuar në vlerën e preventivit dhe volumin e punimeve.
2.Kërkesa e pikës **2.3/h e DST**, e cila kërkon nga ofertuesi që të ketë inxhinierët e kërkuar me dëshmi trajnimi si ñSpecialist për sigurimin dhe shëndetin në punëò, është kërkesë e ekzagjeruar dhe jo e argumentuar nga AK. Kjo kërkesë duhej të minimizohej në të paktën njërin prej inxhinierëve, ose specialist të kualifikuar për ñSigurinë dhe shëndetin në punëò, ndërkohë që kërkesa që të 4-rt inxhinierët të kenë kualifikimin e mësipërm, përbën kufizim për OE.
3.Kërkesa e pikës **2.3/e e DST**, e cila kërkon 1 mjek, është në kundërshtim me VKM-së nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 ñ*Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*ò, pika 1 ku përcaktohet se:

ñ*Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:*
"6. Punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi,

*për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C" dhe "D", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë."*ò

Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 64, pika 5, dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar. Raporti përmbledhës është miratuar me vendimin nr. 2565/1 regj., datë 12.11.2011 të titullarit.

-Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, u konstatua se nuk plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/1 të DST** për mjetin minifadromë. OE nuk provon se disponon këtë mjet sipas kërkesës në DST.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/1 të DST** për mjetin kamion me kosh me krahë të gjatë 15 ml. Për të përmbushur këtë kriter, është paraqitur mjeti me targa AA886SG i marrë me kontratë qiraje nga subjekti U shpk. Për këtë mjet nuk disponohet asnjë skedë teknike për të përcaktuar se ka krahët me gjatësi 15 ml.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *Personi përgjegjës specialist i fushës për hartimin e kritereve të veçanta znj. A. N, si dhe anëtarët e KVO z. H.S, z. A.R dhe z. E.Ç.*

Ndikimi/Efekti: Prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E^{të}) në vlerën **8,956 mijë lekë** pa TVSH**.**

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga specialisti i fushës për hartimin e kritereve të veçanta znj. A. N, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1.Kërkesa e pikës 2.3/c e DST,sqarojmë se:

NJHDT ka arsyetuar se Kërkesa që ofertuesit të kenë minimalisht 43 punonjës është vendosur për të garantuar autoritetin kontraktor për realizimin e punimeve objekt kontrate, gjë për të cilën shoqëria ofertuese duhet të dëshmojë se ka një staf minimalisht të qëndrueshëm prej jo më pak se numri mesatar prej 43 punonjësish, të shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar. Kjo kërkesë shihet në harmoni edhe me grafikun e punimeve objekt kontrate, i cili është parashikuar të jetë **30 ditë.** Pra sipas llogaritjeve të volumeve të përcaktuara në preventiv dhe afatit të zbatimit të punimeve, rezulton se kjo kërkesë është në përputhje me to dhe nuk është kufizuese. Gjithashtu është marre parasysh edhe vendndodhja e kantierit ï realizimi i punimeve eshte ne godinen e institucionit te bashkisë Mallakastër.

Sqarojmë se, NJHDT ï AK Bashkia Mallakastër ka vepruar mbështetur ne nenin 46 te Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò *(me ndryshime),cit.*:

1.Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, <u>që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme,</u> për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

2.b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë <u>se zotërojnë kualifikimet</u> e nevojshme ..., si dhe <u>personelin e nevojshëm</u>, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

NJHDT, ka kryer përllogaritjet përkatëse ne baze te fuqisë punëtore te nevojitur ne përputhje me volumet, zërat e punimeve si dhe duke marre parasysh mjete/makineritë dhe afatin e shkurtër te realizimit te objektit te prokurimit, duke marre ne konsiderate edhe veprimtarinë e institucionit dhe kryerjen e shërbimeve ndaj qytetareve dhe funksioneve te veta pa u penguar nga zhvillimi i punimeve,

si pasoje e mungesës se stafit te duhur ne objekt.
2.Kërkesa e pikës 2.3/h e DST,sqarojmë se:
Kjo kërkesë është një standard i domosdoshëm që duhet të plotësojë operatori ekonomik, pasi inxhinierët drejtues teknik që do të jenë të pranishëm në kantier gjatë proceseve specifike të punës duhet të jenë të kualifikuar dhe me dëshmi trajnimi si ñSpecialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punëò sipas standardit OHSAS 18001:2007, e cila është një garanci për mbarëvajtjen e proceseve të punës dhe minimizimin e incidenteve të ndryshme. Pra kjo kërkesë nuk është kufizuese por është një kërkesë që jep garanci lidhur me zbatimin e punimeve në përputhje me KTZ, ne zbatim te Ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", si dhe Vendimi i KM Nr.312, datë 5.5.2010 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR SIGURINË NË KANTIER.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 9 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raport Auditimi, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
OE fitues BOE ñ**SH** shpkò ka paraqitur ofertën **8,956,765lekë pa TVSH.**
Oferta e paraqitur nga ky OE është oferta me vlerën më të ulët të paraqitur në këtë procedurë.
Duke e krahasuar ofertën fituese, rezulton se diferenca e ofertës fituese nga fondi limit është **557,883** lekë pa TVSH.
Pra, oferta e paraqitur nga OE fitues është vlerësuar nga ana jonë për shkak të çmimit më të ulët të ofruar, duke patur në fokus parimin e ekonomicitetit dhe parashikimet e bëra në ligjin e prokurimit publik.
OE ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas pikave 2.1 të DST si më poshtë:
1. Për mjetin tip fadrom operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin për mjetin TIP Hitachi EX30-2 me nr. Seriali :4760 1AE-04760,si dhe mjetin me targa FR3810D.*(dokumentat bashkalidhur);*
2. Për kamionin me vinç të cilin e ka marë me kontratë qera nga subjekti ñUò shpk operatori ekonomik fitues ñSHò shpk, ka paraqitur dokumentacionin perkatës për mjetin me targa AA886SG ,ku dhe nga verifikimi vizual dhe fizik i mjetit rezulton se plotëson parametrat e kërkuara nga autoriteti kontraktor.*(dokumentat bashkalidhur).*

Gjatë vlerësimit të ofertave, KVO ka mbajtur në konsideratë anën ekonomike, sipas kriterit të vlerësimit "çmimi më i ulët", të përcaktuar në dokumentet e tenderit të kësaj procedure, duke i konsideruar si devijime të vogla mangësitë në dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë të kualifikuar.
Në arritjen e këtij konkluzioni, KVO është referuar në pikën 4, të nenit 53, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...*".

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Lidhur me kërkesën për miniekskavator, pretendimi nuk qëndron. Dokumentacioni i paraqitur për mjetin TIP Hitachi EX30-2 me nr. seriali 4760 1 AE-04760, rezulton një dokument i ngjashëm me faturë tatimore, e lëshuar në Athinë (Greqi), e cila figuron e papërkthyer, në kundërshtim me DST. Në lidhje me mjetin me targa FR3810D, rezulton mjet fadromë dhe jo minifadromë sipas kërkesës në

DST, fakt i pasqyruar edhe nga fotot e paraqitura në këtë observacion. 2.Lidhur me pikën 2 të observacionit, pretendimi nuk qëndron. Mungojnë specifikimet teknike të mjetit për të përcaktuar gjatësinë e krahut, e cila është kërkuar 15 m/l.

11. Tenderi me objekt: "Rikonstruksion i rrugëve në fshatra" Viti 2018, me këto të dhëna:

11. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i rrugëve në fshatra"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 2614 regj, datë 16.11.2018 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 2614 regj, datë 16.11.2018 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A. N ï (Ark.-Spec. i fushës) 3. P. L ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.353, Datë 16.11.2018 1. H. S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. E. Ç (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 52,985,965 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE ñGò Shpk & ñFò Shpk , me ofertë 47,457,410 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 10.01.2019, me afat 6 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 5,528,555 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 19.12.2018	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

<u>Titulli i gjetjes</u>: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve.
<u>Situata:</u> Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3/g e DST** e cila kërkon të paktën 5 punonjës me dëshmi kualifikimi sigurimi teknike sipas SSH EN ISO/IEC 17024:2012, dhe Ligjit Nr.8734, date 01.02.2001, është e paargumentuar dhe jo në përputhje me dispozitën ligjore të cituar. Vlen të theksohet se ligji i mësipërm është ñ*Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike*ò. Sa më sipër kërkesa nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.
2.Kërkesa e pikës **2.3/j e DST**, kërkon nga OE disponimin në pronësi, qira ose kontratë furnizimi për 1 impiant prodhim betoni, 1 për prodhim inertesh dhe 1 për prodhim asfalti.
-Për impiantin e prodhimit të asfaltit, kërkohet QKL, Leje Mjedisi Tipi B, Kodi III.1.B si dhe të jetë e pajisur me ISO 9001:2015 dhe ISO 140001:2015, si dhe raport monitorimin brenda 6 muajve të fundit. Gjithashtu, kërkohet distanca **jo më e madhe se 40 km** nga vendndodhja e objektit të prokurimit.
-Për impiantin e prodhimit të betonit, kërkohet Leje mjedisi tipi B, Kodi III.1.B ñPër impiant betoniò, si dhe raport monitorimi të paktën 6 muajt e fundit.
-Për Për impantin e inerteve, kërkohet QKL ï Leje Mjedisi Kodi III.1.B ñPër impiant inerteshò.
-Për impiantin e prodhimit të Inerteve dhe Impiantin e prodhimit të Betonit, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin e pronësisë, ose në rastet e marrjes me qera kontratë noteriale e marrjes me qira, apo kontratë noteriale furnizimi, të shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë, si dhe duhet të paraqesë raport testimet për materialet si më poshtë:
- Raport Testim të Materialeve Inerte Granil, Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012. Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012
- Raport Testimi të materialeve Inerte Rërë e Larë. Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012. Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012
- Raport Testimi nga Impianti i Prodhimit, metoda e testimit S SH EN 12390 -1: 3 2009, SSH-EN 12390 1: 3 – 2009 për mostrën e betonit.
- Raport Testimi nga Impianti i Prodhimit i Ujit për Beton, metoda e testimit S SH EN 1008 : 2002

- Testimet e mësipërme duhet të jenë nga Laborator i akredituar konform S SH ISO/EN 17025;2006
- Raporti i testimeve duhet të jetë sipas standardeve në fuqi bazuar në ligjin Nr.9290 datë 07/10/2004 "Për Produktet e Ndërtimit". Raport testimet duhet të jenë të paktën brenda 1 viti nga data e prokurimit për këtë objekt.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatë Cilësie nga prodhuesi për materialet ndërtimore: Inerte, Çimento.
-Në lidhje me sa është kërkuar më sipër, sqarohet se kërkesat për certifikatat ISO si dhe kërkesat për paraqitjen e kërkesave për testimet, janë kërkesa të tejkaluara të LPP. Sqarojmë se përmbushja e specifikimeve teknike plotësohet me paraqitjen e deklaratës përkatëse nga OE, pasi këto dokumente janë për të tretë që nuk marrin pjesë direkt në procedurën e prokurimit.
-Në lidhje me kërkesën që fabrika ose impiantet të jenë jo më shumë se 40 km, përbën gjithashtu kufizim për OE, pasi distanca është shumë e afërt, ndërkohë që cilësia e produkteve të betonit ose asfaltit, mund të garantohet përtej kësaj distance.
Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 64, pika 5, dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar. Raporti përmbledhës është miratuar me vendimin nr. 05/1, datë 03.01.2019.
-Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, u konstatua se nuk plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:
1.OE ñGò shpk, i cili ka marrë përsipër sipas akt marrëveshjes 80% të punimeve, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/b të DST,** lidhur me kategoritë e licencës, pasi nuk disponon kategoritë NP-12 dhe NS-18.
2.OE ñGò shpk, i cili ka marrë përsipër sipas akt marrëveshjes 80% të punimeve, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/f të DST,** e cila kërkon nga OE të kenë staf drejtues që të **figurojnë në licencën e shoqërisë**, 1 inxhinier ndërtimi, 1 hidroteknik, 1 topograf dhe 1 inxhinier mjedisi. Sipas licencës së shoqërisë, rezulton drejtues teknik vetëm inxhinieri hidroteknik K. P, ndërkohë që inxhinieri i ndërtimit O. A, nuk figuron si i tillë në licencë. Në lidhje me inxhinierët topograf dhe të mjedisit, ky OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion se ka në përbërje të shoqërisë tregtare këtë inxhinierë.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:****Personi përgjegjës specialist i fushës për hartimin e kritereve të veçanta znj. A. N.*
Ndikimi/Efekti: Ndikon në numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, specialisti i fushës për hartimin e kritereve të veçanta znj. A.N është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 54/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:
Pretendimet e subjektit:
1.Kërkesa e pikës 2.3/g DST,sqarojmë se:
Kërkesa që ofertuesit të kenë 5 punonjës të pajisur me dëshmi për sigurimin teknik është një kërkesë jokufizuese, por në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit.
Kjo kërkesë është vendosur për arsye se punonjësit që do të merren me ekzekutimin e drejtpërdrejtë të punimeve duhet të tregojnë përgjegjshmëri dhe siguri për veten e tyre dhe personat e tretë, gjë për të cilën është e nevojshme që ata të jenë të trajnuar sa i përket sigurimit teknik. Ne referim te V.K.M. Nr.312, datë 5.5.2010 ñPër miratimin e rregullores "për sigurinë në kantierò -15.9 Detyrimet e

punëmarrësve. Punëmarrësit u nënshtrohen programeve të formimit ose të praktikës, të organizuara nga punëdhënësi. Punëmarrësit përdorin pajisjet e punës të vëna në dispozicion në përputhje me informacionin, formimin dhe praktikën e bërë.
Për këtë arsye është kërkuar minimalisht numri prej 5 punonjësish të pajisur me dëshmi të sigurimit teknik, ne zbatim te Ligjit Nr.152/2015 date 21.12.2015 ñPër shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtiminò; Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin e disiplinimin e punimeve në ndërtim", Ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë".
Mendojmë se ky kriter është vendosur prej NJHDT, ne përputhje dhe ne zbatim te nenit 46 te Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò (me ndryshime), neni 61, të VKM nr.914, datë 29.12.2014.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 9 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
Oferta e paraqitur nga ky OE është oferta me vlerën më të ulët të paraqitur në këtë procedurë.
Duke e krahasuar ofertën fituese, rezulton se diferenca e ofertës fituese nga fondi limit është **5.528.555** lekë pa TVSH.
Grupi i Auditimit të KLSH ka konsideruar se OE ñFò shpk, i shpallur fitues nuk plotëson kriteret sipas pikave 2.3/b, 2.3/f dhe 2.3/j të DST.
Për këtë arsye, paraqesim këtë Observacion, duke sqaruar si më poshtë:
- Nga KVO është vlerësuar se BOE në dokumentacionin e dorëzuar plotësojnë kriteret sepse pikat e liçensave dhe drejtuesve teknik janë të plota dhe të rregullta nga njëri prej operatorëve. Kapaciteti teknik dhe i burimeve njërëzore i BOE garanton realizimin e objektit të prokurimit.

Oferta e paraqitur nga OE fitues është vlerësuar nga ana jonë për shkak të çmimit më të ulët të ofruar, duke patur në fokus parimin e ekonomicitetit dhe parashikimet e bëra në ligjin e prokurimit publik.
Refuzimi i ofertave më të ulta thjesht për devijime të vogla nuk kufizon konkurrencën, dhe nuk dëmton ekonominë si dhe efikasitetin e mirëpërdorimit të fondeve publike. Në rastin Konkret nuk mund të procedohet në skualifikim të ofertës fituese për elemente dytësor që nuk ndikojnë drejtpërdrejtë në aftësinë e OE në realizimin e kontratës. Sa më sipër refuzimi i një oferte fituese në kushte të tilla do ishte kundër interesit të AK për realizimin e investimit.
Në plotësimin e kësaj kërkese, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se thelbi dhe synimi i saj është disponimi nga ana e operatorit ekonomik i mjeteve dhe makinerive të kërkuara, për realizimin e punimeve objekt kontrate, dhe konkretisht për kapacitetin e tyre, ku në rastin konkret kapaciteti plotësohet në referim dhe të volumeve të preventivit, dhe është konsideruar si nje devijim i vogël ndryshimi në ndonjë mjet të veçante i kapacitetit në nivele të vogla, pasi në vlerësim të qëllimit që duhet të përmbushe OE e ka plotësuar dhe tejkaluar kapacitetin teknik të kërkuar dhe të nevojitur për realizmin e kontratës.
Gjatë vlerësimit të ofertave, KVO ka mbajtur në konsideratë anën ekonomike, sipas kriterit të vlerësimit "çmimi më i ulët", të përcaktuar në dokumentet e tenderit të kësaj procedure, duke i konsideruar si devijime të vogla mangësitë në dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë të kualifikuar.
Në arritjen e këtij konkluzioni, KVO është referuar në pikën 4, të nenit 53, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: *"4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në*

***dokumentet e tenderit...*”.**

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 9 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

12. Tenderi me objekt: “Rikualifikim i bllokut të pallateve të Tecit, lagjia 5 Shkurti” Viti 2018, me këto të dhëna:

12. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikualifikim i bllokut të pallateve të Tecit, lagjia 5 Shkurti”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 2899 regj, datë 27.12.2018 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 2899 regj, datë 27.12.2018 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A N ï (Ark.-Spec. i fushës) 3. P. L ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.390, Datë 27.12.2018 1. H. S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. E.Ç (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 27,083,333 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñAò Shpk me ofertë 25,729,070 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 15.02.2019, me afat 4 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 1,354,263 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 28.01.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b)Skualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave.
Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3/c e DST** e cila nga kërkon OE, të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, është kërkesë e paargumentuar. Kërkesa që Drejtuesi Teknik i punimeve të jetë me kohë të plotë në objekt dhe i paangazhuar me kontrata të tjera, është në kundërshtim me UKM nr. 2 , datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. ñ*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*ò, i cili përcakton se *Për vlera me vlerë të plotë të preventuar mbi **30,000,000 lekë**, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.*
2.Kërkesa e pikës **2.3/g e DST**, e cila kërkon ndër të tjera edhe 1 inxhinier mekatronik, është kërkesë jo në përputhje me natyrën e punës. Mekatronika si shkencë inxhinierike ka qasje të natyrës robotike, dhe kërkesa të tilla në procedura për punë publike, nuk përbëjnë gjë tjetër veçse kufizim për OE.
3.Kërkesa e pikës **2.3/g e DST,** e cila kërkon 1 mjek ndërmarrjeje, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 ñ*Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*ò, pika 1 ku përcaktohet se:

ñ*Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:*
“6. Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë

*shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë."*ò

4.Kërkesa e pikës **2.3/h e DST**, e cila kërkon për fabrikën e asfaltit të jetë jo më larg se 50 km nga objekti i prokurimit, është kërkesë e paargumentuar teknikisht e cila përbën kufizim për OE, pasi cilësia e asfaltit sigurohet brenda parametrave teknik edhe përtej kësaj distance. Në këto kushte, kërkesa të tilla pengojnë OE për paraqitje oferte.

Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5, dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar. Raporti përmbledhës është miratuar nga titullari me nr. 415/1 regj., datë 12.02.2019.

-Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, u konstatua se nuk plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/g të DST,** për mjekun M. A, pasi kontrata e saj e punës është në kundërshtim me VKM nr.399, datë 3.5.2017 ñ*Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi*ò, pasi paga është 10.000 lekë ndërkohë që përshkruhet si i punësuar me kohë të plotë. KVO ka mbajtur të njëjtin qëndrim në procedurën me objekt ñRikonstruksion i shkollës Hekal...ò, ku e ka konsideruar arsye sôkualifikimi pikërisht pagën e deklaruar 10,000 lekë për mjekun e OE A shpk, si dhe mjekun e BOE ñA.Kò dhe E.

2.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/h të DST** për mjetet 1 rrul hekur ï hekur mbi 9 Ton si dhe 1 rrul me kompresor minimumi 10 Ton, si dhe për 1 ekskavator me goma. Konkretisht:

a.Për rrulin hekur ï hekur mbi 10 Ton, është paraqitur një deklaratë doganore e qiradhënësit ñSh. 07ò shpk, e cila nuk përcakton nëse ky mjet është hekur ï hekur. Gjithashtu nuk janë paraqitur foto e mjetit.

b.Rruli i deklaruar në pronësi të A.shpk , për të cilin ka paraqitur një faturë tatimore me nr. Serial 0762292, datë 21.09.2002, ka vetëm një përshkrim sipas të cilit ky mjet është 12 Ton, dhe skedë teknike apo dokument tjetër për të provuar peshën e këtij mjeti. Mungojnë gjithashtu fotot e mjetit.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/h të DST,** për mjetin autobitumatriçe. Ky OE ka deklaruar mjetin me targa AA617DA të marrë me kontratë qiraje nga subjekti ñShò shpk, mjet i cili rezulton njëkohësisht i deklaruar në procedurën ñRikonstruksion i rrugëve në fshatraò, procedurë e cila është në zbatim dhe e vlerësuar nga i njëjti AK.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:****Personi përgjegjës specialist i fushës për hartimin e kritereve të veçanta znj. A.N, si dhe anëtarët e KVO z. H. S, z. A. R dhe z. E.Ç.*

Ndikimi/Efekti: Ndikon në numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, si dhe nuk jep garanci për kryerjen e punimeve sipas projektit.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga specialisti i fushës për hartimin e kritereve të veçanta znj A. N është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:

1.Kerkesa e pikës **2.3/c DST,sqarojme se:**

NJHDT ï AK Bashkia Mallakastër ka vepruar mbështetur ne nenin 46 te Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò *(me ndryshime),* Kjo kërkesë është vendosur për të garantuar autoritetin kontraktor se punimet objekt kontrate do të ndiqen dhe zbatohen gjatë kohës së implementimit të tyre nga drejtuesi teknik i përcaktuar nga ana e shoqërisë, i cili nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Mos-angazhimi në kontrata të tjera garanton AK-në për angazhimin maksimal gjatë zbatimit të punimeve objekt kontrate.Kjo kërkesë nuk është kufizuese, pasi nuk është kërkuar sipas UKM nr.2, dt.13.05.2005 që drejtuesi teknik të jetë rezident. Fakti i mosangazhimit në

kontrata të tjera nuk nënkupton të qenit rezident në kantierin e punimeve, por thjesht garanton AK për disponibiitetin e drejtuesit teknik ne realizmin e punimeve në mënyrë korrekte ne përputhje me KTZ dhe brenda afatit të përcaktuar.

2.Kërkesa e pikës **2.3/g DST,<u>sqarojme se:</u>**

Ky kriter është vendosur prej NJHDT ne zbatim te nenit 46 te Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò (me ndryshime) dhe Neni 26, VKM nr.914, datë 29.12.2014,per prezantimin e aftësisë teknike dhe konfirmimin se ofertuesi zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, si dhe personelin e nevojshëm, mbi përdorimin, instalimin e pajisjeve elektromekanike gjate zbatimit te kontratës. Kërkesa që ofertuesi të ketë në stafin e shoqërisë të 1 inxhinieri makatronik, është vendosur për gatishmërinë e makinerive/pajisjeve elektromekanike që do të angazhohen për ekzekutimin e punimeve objekt kontrate. Kjo kërkesë nuk është kufizuese por garanton vijueshmërinë normale të aktivitetit të punimeve në kantier sa i përket gatishmërisë së makinerive/pajisjeve elektromekanike që do të angazhohen për ekzekutimin e punimeve.

3.Kërkesa e pikës **2.3/h DST,<u>sqarojme se:</u>**

Observacioni dhe argumentet e paraqitura për pikën 4 të gjetjes lidhur me distancën e fabrikës së asfaltit, janë të njëjta me ato të trajtuara në procedurën me objekt "Shtresë tapeti i rrugëve të lagjes "Bylis", të bulevardit qendror deri te shkolla "Odisea".

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 11 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Oferta e paraqitur nga ky OE është oferta me vlerën më të ulët të paraqitur në këtë procedurë.

Duke e krahasuar ofertën fituese, rezulton se diferenca e ofertës fituese nga fondi limit është **1.354.263** lekë pa TVSH.

Grupi i Auditimit të KLSH ka konsideruar se BOE ñ**A."** shpkò, i shpallur fitues nuk plotëson kriteret sipas pikave 2.3/g,2.3/h të DST.

Për këtë arsye, paraqesim këtë Observacion, duke sqaruar si më poshtë:

-Nga ana e KVO është vlerësuar se niveli i pagës së punonjësve të deklaruar nga operatori ekonomik nuk ndikon në realizimin e objektit të prokurimit spse ajo është në varësi të ditëve të punura gjatë atij muaji.Ndaj nga KVO është vlerësuar si kriter i plotësuar nga operatori ekonomik.

-Për mjetet të cilat operatori ekonomik i ka të provuara që i posedon me dokumentacion ligjor si kontrata qeraje, fatura tatimore, akt shit-blerje e të tjera nga KVO janë marë të mirëqena qe operatori ekonomik i posedon këto mjete dhe e quan të plotësuar kërkesën e AK.Operatoret ekonomik kanë depozituar dokumentacionin ku provojnë tonazhin e kërkuar nga AK.

-Për mjetet të cilat do të levizin në kantierin ku kryhen punimet nuk është e parë e nevojshme çertifikata e transportit pasi këto mjete deri në kantier transportohen nga mjete të tjera si rimorkiator, karroatrec etj.

-Për mjetet e mara me qera dhe deklarohen për objektin e prokuruar dhe që kontratat janë të rregullta operatori apo eperatoret ekonomik planifikojne sipas grafikut të punimeve apo shërbimeve për përdorimin e mjeteve dhe makinerive.

Refuzimi i ofertave më të ulta thjesht për devijime të vogla nuk kufizon konkurrencën, dhe nuk dëmton ekonominë si dhe efikasitetin e mirëpërdorimit të fondeve publike. Në rastin Konkret nuk mund të procedohet në skualifikim të ofertës fituese për elemente dytësor që nuk ndikojnë drejtpërdrejtë në aftësinë e OE në realizimin e kontratës. Sa më sipër refuzimi i një oferte fituese në

kushte të tilla do ishte kunder interesit të AK për realizimin e investimit.
Në plotësimin e kësaj kërkese, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se thelbi dhe synimi i saj është disponimi nga ana e operatorit ekonomik i mjeteve dhe makinerive të kërkuara, për realizimin e punimeve objekt kontrate, dhe konkretisht për kapacitetin e tyre, ku në rastin konkret kapaciteti plotësohet në referim dhe të volumeve të preventivit, dhe është konsideruar si nje devijim i vogël ndryshimi në ndonjë mjet të veçante i kapacitetit në nivele të vogla, pasi në vlerësim të qëllimit që duhet të përmbushe OE e ka plotësuar dhe tejkaluar kapacitetin teknik të kërkuar dhe të nevojitur për realizmin e kontratës.
Gjatë vlerësimit të ofertave, KVO ka mbajtur në konsideratë anën ekonomike, sipas kriterit të vlerësimit "çmimi më i ulët", të përcaktuar në dokumentet e tenderit të kësaj procedure, duke i konsideruar si devijime të vogla mangësitë në dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë të kualifikuar.
Në arritjen e këtij konkluzioni, KVO është referuar në pikën 4, të nenit 53, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...*".

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Obesrvacioni juaj nuk pranohet pasi nuk është i argumentuar. Lidhur me pagën e mjekes, e njëjta KVO ka mbajtur qëndrim të ndryshëm duke e sokualifikuar OE pikërisht për këtë fakt. Së dyti, mangësitë që lidhen me kapacitetin e rrulit, janë të rëndësishme për mbarëvajtjen e punimeve, pasi në DST është kërkuar të kenë një kapacitet të nevojshëm për kryerjen e punimeve, ndërkohë që OE nuk disponon dokumentacionin e nevojshëm i cili të përcaktojë tonazhin e rrulave, dhe llojin e tyre.

Procedurat e vitit 2019

Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve buxhetore.

Për periudhën 01/01/2019 ï 31/12/2019, nga Bashkia Mallakastër referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **30** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 236,362 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 210,070 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 26,292 mijë lekë pa TVSH ose 11%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2019-31.12.2019	Nr.	Vl. Fond Limit	Vl. Kontrate
Gjithsej	**30**	**236,362,707**	**210,070,044**
- Të hapura	7	169,405,006	148,170,825
- Të hapura me lote	11	20,732,277	18,194,933
- Kërkesë me propozim	12	46,225,424	43,704,286
Sipas objekteve	**30**	**236,362,707**	**210,070,044**
- Objekte në fushën e investimeve	4	105,613,072	89,013,334
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	26	130,749,635	121,056,710

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **141** OE/BOE, nga të cilat janë sokualifikuar **66** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **6** procedura ose 20 % e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 11 ose 36.6% e tyre, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuara nga AK Bashkia Mallakastër janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të operatorëve të kualifikuar.
- Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit nga **30** procedura prokurimi të zhvilluara me vlerë kontrate 210,070 mijë lekë, vlerësoj për auditimin e **11** procedurave me vlerë kontrate 172,554 mijë lekë ose 82% e vlerës së kontratave të lidhura.
-Në të gjitha procedurat e audituara, konstatohet se nga KVO janë mbajtur procesverbalet për hapat e zhvillimit të procedurës, veprime në përputhje me nenin 64 pika 5 dhe nenit 68 të

VKM nr. 914, datë 27.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, i ndryshuar.
- Nga auditimi i **11** procedurave me vlerë kontratë 272,070 mijë lekë, u konstatua se janë në shkelje të akteve ligjore/ nënligjorë të LPP, gjithsej **6** procedura të audituara, ku në **5** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **2**raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mallakastër, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, në vlerën **44,599 mijë lekë pa TVSH**, *si më poshtë vijon:*

13. Tenderi me objekt: "Karburant (Diezel)" Viti 2019, me këto të dhëna:

13. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Karburant (Diezel)"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.87 regj, datë 14.01.2019 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.87 regj, datë 14.01.2019 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A. S-(Ing.Mek-Spec. i fushës) 3. P. L ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 13, datë 14.01.2019 1. H. S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. E. Ç (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 15,833,300 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñNò Shpkò me marzh 7.6 %, me lidhje kontrate datë 26.02.2019, me afat 12 muaj	7.Diferenca me fondin limit: X lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 13.02.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar - OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e fondit limit.
Situata: 1.Komisioni i ngritur sipas urdhrit nr. 15, datë 07.01.2019 për përllogaritjen e sasisë vlerës limit dhe afatit të lëvrimit për blerjen e karburantit që do prokurohet për vitin 2018, nuk ka dokumentuar metodikën e ndjekur për përllogaritjen e fondit limit, duke mos ju përmbajtur kritereve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Trajtuar tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos angazhimi në komisione i personave të kualifikuar.
Ndikimi/Efekti: Risku i përllogaritjeve të gabuara të sasive dhe vlerës së shpenzuar për karburantin.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Titullari i AK, të krijojë komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, duke angazhuar personel të kualifikuar, dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e komisionit E. Ç, A. M, P., A. S dhe Z. H.

14. Tenderi me objekt: "Rikonstruksion i pjesshëm dhe mobilim i sallës së kinemasë dhe zyrave të sektorit të kulturës" Viti 2019, me këto të dhëna:

14. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i pjesshëm dhe mobilim i sallës së kinemasë dhe zyrave të sektorit të kulturës"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.407 regj, datë 11.02.2019 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.407 regj, datë 11.02.2019 1. B.F ï (Jurist-PPP) 2. A. N ï (Ark.-Spec. i fushës)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.43, Datë 11.02.2019 1. H. S (Kryetar) 2. A R (Anëtar)

	3. P. L ï (Ekonomist-Anëtar)	3. E. Ç (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 25,000,000 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñFò Shpkò me ofertë 23,749,870 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 25.04.2019, me afat 4 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 1,250,130 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 27.03.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b)Skualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve.
Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3/e DST** e cila nga OE ofertues, që të deklarojë drejtuesin teknik të punimeve në objekt, i cili nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata tjera, është në kundërshtim me UKM nr. 2 , datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. ñ*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*ò, i cili përcakton se *Për vlera me vlerë të plotë të preventuar mbi **30,000,000 lekë**, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.*
2.Kërkesa e pikës **2.3/f e DST** e cila kërkon një punësim mesatar prej 40 punonjës për periudhën Janar 2018 ï Janar 2019, është kërkesë e paargumentuar nga AK. Ky numër është relativisht i lartë në raport me vlerën, volumin dhe grafikun e punimeve për periudhën 4 mujore të përcaktuar për përfundimin e tyre.
3.Kërkesa e pikës **2.3/h e DST** e cila ndër të tjera 1 Arkitekt, 20 punonjës me dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik si dhe 2 manovrator, janë kërkesa të paargumentuara nga AK. Në lidhje me arkitektin, sqarohet se kjo kërkesë nuk është e nevojshme, përsa kohë që kemi një projekt të miratuar për zbatim, dhe janë 3 inxhinierë të tjerë të kërkuar të cilën kanë ekspertizën e nevojshme për të vënë në zbatim projektin. Në lidhje me kërkesën për 20 punonjës me dëshmi sigurimi teknik, është një numër relativisht i lartë, në raport me vlerën dhe volumin e punimeve. Gjithashtu, kërkesa është e paplotë, pasi AK duhej të përcaktonte konkretisht se çfarë stafi të kualifikuar duhet të disponojë OE. Është kërkesë e paplotë që nuk i shërben AK. Gjithashtu, kërkesa për 2 manovratorë, në kushtet që janë kërkuar 2 minifadroma, është kërkesë e tepërt dhe jo në përputhje me volumet. Objekti është rikonstruksion ndërtese. Kërkesa për manovratorët që të jenë me polica sigurimi, është e pambështetur në asnjë akt teknik dhe ligjor.
4.Kërkesa e pikës **2.3/h e DST** e cila kërkon 1 mjek, është në kundërshtim me VKM-së nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 ñ*Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*ò, pika 1 ku përcaktohet se:

ñ*Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:*
*"6. Punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C" dhe "D", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë."*ò

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:****Personin përgjegjës specialist i fushës për hartimin e kritereve të veçanta, znj. Aurora Naka.*
Ndikimi/Efekti: Ndikon në numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditmit, specialisti i fushës për hartimin e kritereve të veçanta znj. A.N është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1.Kërkesa e pikës **2.3/e DST,<u>sqarojmë se:</u>**

Mendojmë se ky kriter është vendosur prej NJHDT, ne përputhje dhe ne zbatim te nenit 46 te Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPer Prokurimin Publikò (me ndryshime), neni 61, të VKM nr.914, datë 29.12.2014. Kjo kërkesë është vendosur për të garantuar autoritetin kontraktor se punimet objekt kontrate do të ndiqen dhe zbatohen gjatë kohës së implementimit të tyre nga drejtuesi teknik i përcaktuar nga ana e shoqërisë, i cili nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Mos-angazhimi në kontrata të tjera garanton AK-në për angazhimin maksimal gjatë zbatimit të punimeve objekt kontrate.Kjo kërkesë nuk është kufizuese, pasi nuk është kërkuar sipas UKM nr.2, dt.13.05.2005 që drejtuesit teknik të jenë rezident. Fakti i mosangazhimit në kontrata të tjera nuk nënkupton të qenit rezident në kantierin e punimeve, por thjesht garanton AK për disponibiitetin e drejtuesit teknik ne realizmin e punimeve në mënyrë korrekte ne përputhje me KTZ dhe brenda afatit të përcaktuar.

2.Kërkesa e pikës **2.3/f DST,<u>sqarojmë se:</u>**

Kërkesa e pikës **2.3/f DST** është vendosur prej NJHDT, ne përputhje dhe ne zbatim te nenit 46 te Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPer Prokurimin Publikò (me ndryshime), neni 61, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, për të garantuar autoritetin kontraktor për realizimin e punimeve objekt kontrate, gjë për të cilën shoqëria ofertuese duhet të dëshmojë se ka një staf minimalisht të qëndrueshëm prej jo më pak se numri mesatar prej 40 punonjësish për periudhën e percaktuar, të shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar.

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, <u>si dhe personelin e nevojshëm</u>, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Neni 26, VKM nr.914, datë 29.12.2014:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

Kjo kërkesë shihet në harmoni proceset e punës, volumet, specialitetet e punës, karakteristikat e objektit, preventivit edhe me grafikun e punimeve objekt kontrate.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

15. Tenderi me objekt: "Sistem survejimi për ambientet e jashtme të shkollave, sheshet publike, kryqëzimeve kryesore, kinemasë dhe stadiumit" Viti 2019, me këto të dhëna:

15. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Sistem survejimi për ambjentet e jashtme të shkollave, sheshet publike, kryqëzimeve kryesore, kinemasë dhe stadiumit"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.958 regj, datë 25.04.2019	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.958 regj, datë 25.04.2019 1. B. Fï (Jurist-PPP) 2. R. T ï (IT- Spec. i fushës) 3. P. L ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.97, Datë 25.04.2019 1. H. S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. E. Ç (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñKërkesë për propozimò		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 6,666,667 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñPò Shpkò me ofertë 6,653,200 lekë	7.Diferenca me fondin limit: 13,467 lekë pa tvsh

	pa tvsh, me lidhje kontrate datë 24.05.2019, me afat 30 ditë	
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 07.05.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar - OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e fondit limit.
Situata: Hartimi i fondit limit: Mungon urdhri për ngritjen e komisionit për hartimin specifikimeve teknike dhe fondit limit. Hartuesit e preventivit kanë përcaktuar sasisë dhe vlerën e fondit limit, por nuk kanë dokumentuar metodikën e ndjekur për përllogaritjen e fondit limit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 56, dhe pikën 2 të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Trajtuar tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos angazhimi në komisione i personave të kualifikuar.
Ndikimi/Efekti: Kryerja e procedurës në mos përmbushje të akteve nënligjore.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Titullari i AK, të krijojë komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, duke angazhuar personel të kualifikuar, dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.
Në çdo rast, komisionet e përfshira në procedurat e prokurimit publik, të ngrihen me urdhër titullarit.
Veprimet e mësipërme, janë përgjegjësi e hartuesve të preventivit, R. T dhe A. M.

16. Tenderi me objekt: "Blerje mobilje dhe paisje zyre" Viti 2019, me këto të dhëna:

16. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje mobilje dhe paisje zyre"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 1142 regj, datë 21.05.2019 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñKërkesë për propozimò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 1142 regj, datë 21.05.2019 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A. N ï (Ark.-Spec. i fushës) 3. P. L ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.128, Datë 21.05.2019 1. H. S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. E. Ç (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 6,666,667 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñEò Shpkò me ofertë 6,624,332 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 24.06.2019, me afat 20 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 42,335 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 10.06.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar - OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, - Ankesë nga OE ñTò Shpk, protokolluar në bashki me nr. 1209 regj, datë 28.05.2019	12. Përgjigje ankesës nga AK, - Shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga OE ñTò Shpk, nr.1209/1 regj, datë 30.05.2019	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në kundërshtim me kriteret.
Situata: Lidhur me kriteret e vendosura për këtë procedurë, është paraqitur një ankesë nga subjekti ñTò shpk, e protokolluar me nr. 1209, datë 28.05.2019, i cili ankohet për kriterin për certifikatën EN ISO 3834-2:2006. Titullari i AK, me urdhrin nr. 147, datë 28.05.2019, ka urdhëruar pezullimin e procedurës, dhe ngritjen e KSHA, e cila përbëhet nga punonjësja A.N,

e cila rezulton njëkohësisht anëtare e NJP e cila ka hartuar kriteret e veçanta për kualifikim. Vendosja e saj për shqyrtimin e ankesës, është në kundërshtim me pikën 6, germa (a), paragrafi i dytë i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar, i cili përcakton se:

Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Trajtuar tek situata e gjetjes.
Shkaku: Neglizhencë e strukturave të përfshira në procesin e procedurave të prokurimit.
Ndikimi/Efekti: Vlerësim i ankesave në kushtet e konfliktit të interesit
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Titullari i AK, në çdo rast shqyrtimi të ankesave, të vendosë persona të cilët nuk janë të përfshirë në proceset për të cilat këto ankesa janë paraqitur.

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve.
Situata: **Hartimi i kritereve:** 1.Kërkesa e pikës **2.3/b e DST** e cila kërkon nga OE një punësim mesatar prej jo më pak se 26 punonjës për periudhën Prill 2018 ï Prill 2019, është kërkesa e ekzagjeruar dhe kufizuese për OE. AK nuk ka argumentuar numrin e lartë të stafit të kërkuar në raport me llojin e kontratës, dhe aq më pak kërkesën që ky numër prej 25 punonjësish mesatarisht të jetë për një periudhë 13 mujore.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:****Specialisti i fushës për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit znj. A. N*.
Ndikimi/Efekti: Ndikon në numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, specialisti i fushës për hartimin e kritereve të veçanta znj. Aurora Naka është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1.Kërkesa e pikës **2.3/b DST,sqarojme se:**

Kërkesa e pikës **2.3/b DST** janë vendosur prej NJHDT, ne përputhje dhe ne zbatim te nenit 46 te Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò (me ndryshime), neni 61, të VKM nr.914, datë 29.12.2014.

Kërkesa e përcaktuar sipas shkronjës **2.3/b DST**lidhur me punësimin mesatar të jo më pak se 26 (njëzet e gjashtë) punonjësish për periudhën prill 2018 ï prill 2019, është vendosur për të garantuar autoritetin kontraktor se kontraktuesi do të realizojë me cilësi dhe në kohë lëvrimin e mallrave objekt kontrate. Gjithashtu prania në stafin e operatorit ekonomik e të paktën 1 (një) punonjësi të punësuar me profesion Inxhinier Druri, garanton autoritetin kontraktor se kontraktuesi ka logjistikën e nevojshme lidhur me mallrat objekt prokurimi dhe se percepton natyrën e materialeve dhe modeleve të kërkuara. OE duhet vërtetojnë se zotërojnë *kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative*, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, *reputacionin dhe besueshmërinë*, përvojën e duhur, *si dhe personelin e nevojshëm*, për të zbatuar kontratën.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

17. Tenderi me objekt: "Blerje Kamionë vetëshkarkues 2 copë, Minieskavator 1 copë dhe Skrep me goma 1 copë" Viti 2019, me këto të dhëna:

17. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje Kamiona vetshkarkues 2 copë, Minieskavator 1 copë dhe Skrep me goma 1 copë"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.823 regj, datë 10.04.2019 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.823 regj, datë 10.04.2019 1. B.F ï (Jurist-PPP) 2. A.S-(Ing.Mek-Spec. i fushës) 3. P. L ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.88, Datë 10.04.2019 1. H. S (Kryetar) 2. A.R (Anëtar) 3. E. Ç (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 19,166,667 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñG ò Shpkò me ofertë 18,300,000 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 14.06.2019, me afat 30 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 866,667 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 23.05.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar - OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Ka/Nuk ka (nëse ka nr. date ankese dhe ankimues) - Ankesë nga OE ñKò Shpk, protokolluar në bashki me nr. 1043 regj, datë 09.05.2019.	12. Përgjigje ankesës nga AK, Ka/Nuk ka (nëse ka nr. date ankese dhe ankimues) - Shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga OE ñKò Shpk nr.1043/1 regj, datë 10.05.2019.	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka/Nuk ka (nëse ka nr. date)

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vendosjen e specifikimeve teknike, argumentimin e fondit limit si dhe ngritjen e komisionit për shqyrtimin e ankesave.

Situata: Me urdhër të titullarit me nr. 70, datë 25.03.2019, është ngritur komisioni për *"Hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e vlerës limit për blerje kamion vetëshkarkues 2 copë, miniekskavator 1 copë dhe skrep me goma 1 copë".* Komisioni përbëhet nga E. Çï kryetar, dhe anëtarët A. M, A. S, A. B dhe Z. H. Ky komision, ka mbajtur dokumentim ñAkt Teknikò me nr. 692/1, datë 08.04.2019 dhe të miratuar nga titullari, ku ka përcaktuar specifikimet teknike për mjetet e kërkuara, si dhe fondin e përllogaritur për këto mjete.

A.Lidhur me specifikimet e vendosura, pranë AK është paraqitur ankesë nga subjekti ñK-R-Coò shpk me nr. 1043 prot., datë 09.05.2019. Lidhur me mjetet e kërkuara, ku subjekt sqaron se specifikimet teknike të ndryshuara nuk mund të përcaktohet me milimetra ndryshimi nga njëri mjet në tjetrin. Kërkesa nga ana juaj duhet të jetë më shenjën jo më e madhe ose jo më e vogël sepse parametrat e përcaktuar me 1mm ose me 1 fuqi motorike nuk bën diferencë nga mjeti në mjet por paracakton llojin e mjetit fitues dhe bën të pamundur konkurrimin.

-Me urdhrin nr. 114, datë 10.05.2019 të titullarit, është pezulluar për procedura dhe ngarkon komisionin e ngritur për përcaktimin e specifikimeve teknike për shqyrtimin e saj. Në shqyrtim të kësaj ankese, komisioni ka vendosur mos pranimin e saj me arsyetimin se specifikimet teknike nuk i janë referuar asnjë marke specifike.

Lidhur me komisionin e ngritur për shqyrtimin e kësaj ankese, rezulton se është vepruar në kundërshtim me pikën 6, germa (a), paragrafi i dytë i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar, i cili përcakton se:

Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.

Specifikimet teknike: B. Në lidhje me specifikimet teknike të vendosura, u konstatuan mangësi si vijon:

1.Për 2 mjetet kamion vetëshkarkues, është përcaktuar gjatësia maksimale e mjetit 7885mm ï 7890 mm. Përcaktimi i kësaj gjatësie me kufi shumë të ngushtë me vetëm 5mm, është specifikim i cili mund të vendosë OE në kushte jo të barabarta.

2.Specifikimi teknik për 2 kamionët, të cilët nuk duhet të kenë qenë të targuar, në funksion pune ose shërbimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për vitin 2019, është tjetër specifikim i cili ndikon drejtpërdrejtë në paraqitjen e ofertave nga OE. Praktikisht, AK ka përcaktuar që vetëm kamionët e targuar 5 muajt e fundit, janë të kualifikueshëm në këtë procedurë. Specifikime të tilla teknike, përbëjnë kufizim për OE për të paraqitur ofertat e tyre.

Specifikimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 23, pika 1 dhe 2 të LPP të cilët përcaktojnë se:

1.Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2.Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

C.Gjithashtu, komisioni i ngritur për specifikimet teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, në preventivin e hartuar, nuk ka përcaktuar asnjë nga metodat e ndjekura për përllogaritjen e fondit limit të kësaj kontrate, veprim ky në kundërshtim me nenin 59 pika 2 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Vendosja e personave të pa kualifikuar për hartimin e specifikimeve teknike.

Ndikimi/Efekti: Shmang konkurrencën.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi 1: Titullari i AK, të marrë masa për vendosjen nëpër komisionet e ngritura për procedurat e prokurimit publik, të persona me kualifikimin e duhur. Të merren masa për vendosjen e specifikimeve teknike, për krijimin e kushteve për konkurrim të paanshëm ndërmjet kandidatëve ofertues.

Rekomandimi 2: Titullari i AK, në çdo rast shqyrtimi të ankesave, të vendosë persona të cilët nuk janë të përfshirë në proceset për të cilat këto ankesa janë paraqitur.

18. Tenderi me objekt: "Shpenzime për sinjalistikën rrugore (tabela+vizime)" Viti 2019, me këto të dhëna:

18. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Shpenzime për sinjalistikën rrugore (tabela+vizime)"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 821 regj, datë 10.04.2019	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 821 regj, datë 10.04.2019	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.87, Datë 10.04.2019
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A. S-(Ing.Mek-Spec. i fushës) 3. P. Lï (Ekonomist-Anëtar)	1. H. S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. E .Ç (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 8,375,300 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñSò shpk me ofertë 7,225,300 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 29.05.2019, me	7.Diferenca me fondin limit: 1,150,000 lekë pa tvsh

	afat 30 ditë	
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 06.05.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e fondit limit.
Situata:1.Komisioni i ngritur sipas urdhrit nr. 73, datë 26.03.2019 *Për hartimin e specifikimeve teknike, përcaktimin e sasisë së mallrave dhe përllogaritjen e vlerës limit për objektin që do prokurohet*, nuk ka dokumentuar metodikën e ndjekur për përllogaritjen e fondit limit, duke mos ju përmbajtur kritereve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Trajtuar tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos angazhimi në komisione i personave të kualifikuar.
Ndikimi/Efekti: Risku i përllogaritjeve të gabuara të sasive dhe vlerës së shpenzuar për blerjet e mallrave.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Titullari i AK, të krijojë komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, duke angazhuar personel të kualifikuar, dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e komisionit E. Ç, A.M dhe A.S.

19. Tenderi me objekt: "Blerje pajisje për arredimin e sallës së kinemasë dhe bibliotekës" Viti 2019, me këto të dhëna:

19. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje paisje për arredimin e sallës së kinemasë dhe bibliotekës"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 1165 regj, datë 23.05.2019 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñKërkesë për propozimò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 1165 regj, datë 23.05.2019 1. B.Fï (Jurist-PPP) 2. A.N ï (Ark.-Spec. i fushës) 3. P. L ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.138, Datë 23.05.2019 1. H. S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. E.Ç (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 6,250,000 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñEò Shpk me ofertë 6,137,000 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 24.06.2019, me afat 20 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 113,000 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 10.06.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar - OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Ka/Nuk ka (nëse ka nr. date ankese dhe ankimues) - Ankesë nga OE ñTò, protokolluar në bashki me nr.1208 regj, datë 28.05.2019.	12. Përgjigje ankesës nga AK, Ka/Nuk ka (nëse ka nr. date ankese dhe ankimues) - Shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga OE ñTò nr.1208/1 regj, datë 30.05.2019.	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në kundërshtim me kriteret.
Situata: Lidhur me kriteret e vendosura për këtë procedurë, është paraqitur një ankesë nga subjekti ñT T Coò shpk, e protokolluar me nr. 1208, datë 28.05.2019, i cili ankohet për kriterin për certifikatën EN ISO 3834-2:2006. Titullari i AK, me urdhrin nr. 146, datë 28.05.2019, ka urdhëruar pezullimin e procedurës, dhe ngritjen e KSHA, e cila përbëhet nga punonjësja A. N, e cila rezulton njëkohësisht anëtare e NJP e cila ka hartuar kriteret e veçanta

për kualifikim. Vendosja e saj për shqyrtimin e ankesës, është në kundërshtim me pikën 6, germa (a), paragrafi i dytë i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar, i cili përcakton se:

Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Trajtuar tek situata e gjetjes.
Shkaku: Neglizhencë e strukturave të përfshira në procesin e procedurave të prokurimit.
Ndikimi/Efekti: Vlerësim i ankesave në kushtet e konfliktit të interesit
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Titullari i AK, në çdo rast shqyrtimi të ankesave, të vendosë persona të cilët nuk janë të përfshirë në proceset për të cilat këto ankesa janë paraqitur.

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve.
Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3/b e DST** e cila kërkon nga OE një punësim mesatar prej jo më pak se 25 punonjës për periudhën Prill 2018 ï Prill 2019, është kërkesa e ekzagjeruar dhe kufizuese për OE. AK nuk ka argumentuar numrin e lartë të stafit të kërkuar në raport me llojin e kontratës, dhe aq më pak kërkesën që ky numër prej 25 punonjësish mesatarisht të jetë për një periudhë 13 mujore.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:****Specialisti i fushës për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit znj. A. N*.
Ndikimi/Efekti: Ndikon në numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, specialisti i fushës për hartimin e kritereve të veçanta znj. A. N është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1.Kërkesa e pikës **2.3/b DST,sqarojme se:**

Kërkesa e pikës **2.3/b DST** janë vendosur prej NJHDT, ne përputhje dhe ne zbatim te nenit 46 te Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò (me ndryshime), neni 61, të VKM nr.914, datë 29.12.2014.

Kërkesa e përcaktuar sipas shkronjës **2.3/b DST**lidhur me punësimin mesatar të jo më pak se 25 (njëzet e pesë) punonjësish për periudhën prill 2018 ï prill 2019, është vendosur për të garantuar autoritetin kontraktor se kontraktuesi do të realizojë me cilësi dhe në kohë lëvrimin e mallrave objekt kontrate. Gjithashtu prania në stafin e operatorit ekonomik e të paktën 1 (një) punonjësi të punësuar me profesion Inxhinier Druri, garanton autoritetin kontraktor se kontraktuesi ka logjistikën e nevojshme lidhur me mallrat objekt prokurimi dhe se percepton natyrën e materialeve dhe modeleve të kërkuara. OE duhet vërtetojnë se zotërojnë *kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative*, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, *reputacionin dhe besueshmërinë*, përvojën e duhur, *si dhe personelin e nevojshëm*, për të zbatuar kontratën.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur

argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

20. Tenderi me objekt: "Ndërtim shëtitore nga shkolla "Odisea" deri te varrezat e qytetit" Viti 2019, me këto të dhëna:

20. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim shëtitore nga shkolla "Odisea" deri te varrezat e qytetit"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 1199 regj, datë 27.05.2019 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 1199 regj, datë 27.05.2019 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A. N ï (Ark.-Spec. i fushës) 3. M. V ï (Ing.Nd.-Spec. i fushës)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.139, Datë 27.05.2019 1. H. S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. E. Ç (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 26,665,416 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE ñSHò Shpk & ñAò Shpk me ofertë 22,609,755 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 24.06.2019, me afat 15 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 4,055,661 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 27.06.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar - OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

<u>Titulli i gjetjes:</u>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

<u>Situata:</u> Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.2/d e DST** e cila nga OE ofertuesit një vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitet 2017, 2018 dhe 2019, është kërkesë e ekzagjeruar. Në kushtet kur OE ka likuiduar detyrimet e vitit të fundit, i ka paguar edhe vitet e mëparshme.

2.Kërkesa e pikës **2.3/g e DST** e cila nga OE që të jenë të pajisur me licencë kodi II.4 nga QKL për prodhim, tregtim fara dhe fidanë, është kërkesë kufizuese për OE. AK duhet të merrte në konsideratë mundësinë e disponimit të kësaj licence edhe me kontratë shërbimi.

3.Kërkesa e pikës **2.3/f e DST,** e cila kërkon 1 mjek ndërmarrjeje, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 ñ*Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*ò, pika 1 ku përcaktohet se:

ñ*Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:* *"6. Punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C" dhe "D", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë."*ò

4.Kërkesa e pikës **2.3/h e DST** e cila kërkon për fabrikën e asfaltit që të jetë jo më larg se 30 km nga vendndodhja e objektit të prokurimit, është kërkesë e paargumentuar, diskriminuese e cila nuk i shërben AK por përbën pengesë për OE. AK duhet të marrë në konsideratë faktin që cilësia e asfaltit sigurohet edhe përtej kësaj distance brenda parametrave teknik, ndërkohë që kufizimi brenda 30 km, cenon mundësinë për të paraqitur ofertë.

Vlerësimi i ofertave: 1.OE ñAò shpk, nuk përmbush kriterin e pikës **2.2/b të DST,** për paraqitjen e bilanceve për vitit 2016, 2017 dhe 2018. Janë paraqitur bilancet e viteve 2017-2018, por mungon ai i vitit 2016. Rezulton se është hedhur në SPE bilanci i një subjekti tjetër, Ll. shpk, i cili nuk është ofertues në këtë procedurë.

2.OE ñAò shpk, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/b të DST,** lidhur me licencën profesionale

të shoqërisë. Rezulton se ky OE nuk ka paraqitur licencën përkatëse në SPE, për të provuar se disponon kategoritë e kërkuara.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:****specialistët e fushës për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, znj. A. N, z. M. V,* si dhe *anëtarët e KVO z. H. S, z. A. R dhe z. E. Ç.*

Ndikimi/Efekti: Prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E-të) në vlerën **22,609 lekë lekë** pa TVSH**.**

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga specialistët e fushës për hartimin e kritereve të veçanta znj. A.N dhe z. M.V është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1.Kërkesa e pikës **2.2/d DST,sqarojme se:**

Kërkesa e pikës **2.2/d DST** mbi taksat vendore per 3 vitet e fundit nuk është e ekzagjeruar, pasi është një kërkesë minimale, vërtet mund te ishte vetëm per vitin e fundit por është ndjekur rregulli i përdorur gjerësisht mbi detyrimet e 3 vjetarit te fundit. Për OE është një kërkese e thjeshte, pa kosto, dhe lehtësisht e plotësueshme, nëse i ka shlyer detyrimet e lartpërmendura.

NJHDT, ka vepruar ne përputhje dhe ne zbatim te nenit 46 te Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPer Prokurimin Publikò (me ndryshime), neni 61, të VKM nr.914, datë 29.12.2014.

2.Kërkesa e pikës **2.3/g DST, sqarojmë se:**

Kërkesa sipas pikës **2.3/g DST**është vendosur për të garantuar cilësinë dhe profesionalizmin e operatorit ekonomik ofertues, lidhur me fidanët që janë parashikuar për tu mbjellë, për faktin se shëtitorja që do të ndërtohet është në hyrje të qytetit dhe këta fidanë që janë pjesë e këtij projekti duhet të kenë një cilësi maksimale për një prezantim sa më dinjitoz të hyrjes së qytetit dhe kjo gjë garantohet mjaft mirë nëpërmjet licencimit të OE në këtë fushë.

3.Observacioni për fabrikën e asfaltit jo më larg se 30 km, është i njëjtë me observacionet tjera të paraqitura më sipër.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

OE fitues BOE ñ**SH"** shpk ka paraqitur ofertën **22.609.755 lekë pa TVSH.**

Oferta e paraqitur nga ky OE është oferta me vlerën më të ulët të paraqitur në këtë procedurë.

Duke e krahasuar ofertën fituese, rezulton se diferenca e ofertës fituese nga fondi limit është **4.055.661** lekë pa TVSH.

Pra, oferta e paraqitur nga OE fitues është vlerësuar nga ana jonë për shkak të çmimit më të ulët të ofruar, duke patur në fokus parimin e ekonomicitetit dhe parashikimet e bëra në ligjin e prokurimit publik.

Grupi i Auditimit të KLSH ka konsideruar se OE ñSHò shpk, i shpallur fitues nuk plotëson kriteret sipas pikave 2.2/b dhe 2.3/b, të DST.

Refuzimi i ofertave më të ulta thjesht për devijime të vogla nuk kufizon konkurrencën, dhe nuk

dëmton ekonominë si dhe efikasitetin e mirëpërdorimit të fondeve publike. Në rastin Konkret nuk mund të procedohet në skualifikim të ofertes fituese për elemente dytësor që nuk ndikojnë drejtpërdrejtë në aftësinë e OE në realizimin e kontratës. Sa më sipër refuzimi i një oferte fituese në kushte të tilla do ishte kundër interesit të AK për realizimin e investimit.
Gjatë vlerësimit të ofertave, KVO ka mbajtur në konsideratë anën ekonomike, sipas kriterit të vlerësimit "çmimi më i ulët", të përcaktuar në dokumentat e tenderit të kësaj procedure, duke i konsideruar si devijime të vogla mangësitë në dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë të kualifikuar.
Në arritjen e këtij konkluzioni, KVO është referuar në pikën 4, të nenit 53, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...*".

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Lidhur me observacionet e paraqitura, pretendimi nuk qëndron. OE ñAò nuk ka paraqitur licencën e shoqërisë, dokument i rëndësishëm për të provuar se ky OE ka kategoritë e duhura të punimeve. Observacioni i paraqitur ndërkohë është i njëjtë me atë të paraqitur për Akt Konstatimin nr. 10, duke mos paraqitur prova apo argumente tjera për të mbështetur pretendimin tuaj.

21. Tenderi me objekt: "Rikonstruksion i rrugëve në fshatra" Viti 2019, me këto të dhëna:

21. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i rrugëve në fshatra"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 1201 regj, datë 27.05.2019 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 1201 regj, datë 27.05.2019 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A. N ï (Ark.-Spec. i fushës) 3. M.V ï (Ing.Nd.-Spec. i fushës)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.140, Datë 27.05.2019 1. H. S (Kryetar) 2. A. R (Anëtar) 3. E. Çj (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 49,364,323 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñFò Shpk me ofertë 38,462,100 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 17.07.2019, me afat 8 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 10,902,223 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 28.06.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar - OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve të vendosura.
Situata: **Hartimi i kritereve:** 1.Kërkesa e pikës **2.3/d e DST** e cila kërkon nga OE ofertuesit një vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitet 2017, 2018 dhe 2019, është kërkesë e ekzagjeruar. Në kushtet kur OE ka likuiduar detyrimet e vitit të fundit, i ka paguar edhe vitet e mëparshme.
2.Kërkesa e pikës **2.3/4 e DST,** e cila kërkon 1 mjek të pajisur me licencë, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 ñ*Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*ò, pika 1 ku përcaktohet se:

ñ*Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:*
"6. Punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të

*punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C" dhe "D", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë."*ò

3.Kërkesa e pikës **2.3/h e DST** e cila nga OE të kenë minimalisht 25 punonjës me dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik, nga të cilët një të jetë inxhinier ndërtimi dhe 1 inxhinier mekanik, është kërkesë e paargumentuar nga AK. Së pari, kërkesa që të jenë 25 punonjës me dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik, është kërkesë evazive, dhe cilësisht jo në shërbim të AK, i cili duhet të përcaktonte llojin e specialistëve të kërkuar. Nga mënyra e përcaktuar në DST, mund të konsiderohet çdo punonjës që disponon dëshmi sigurimi teknik, pavarësisht nëse është e nevojshme në raport me punimet ekspertiza e tij. Gjithashtu, kërkesa që njëri ndër punonjësit të jetë inxhinieri mekanik, është kërkesë tjetër jo në përputhje me preventivin e punimeve.

4.Kërkesa e pikës **2.3/j e DST** e cila kërkon për fabrikën e asfaltit që të jetë jo më larg se 40 km nga vendndodhja e objektit të prokurimit, është kërkesë e paargumentuar, diskriminuese e cila nuk i shërben AK por përbën pengesë për OE. AK duhet të marrë në konsideratë faktin që cilësia e asfaltit sigurohet edhe përtej kësaj distance brenda parametrave teknik, ndërkohë që kufizimi brenda 40 km, cenon mundësinë për të paraqitur ofertë.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:****specialistët e fushës për hartimin e kritereve të veçanta, znj. A.N dhe z. M. V.*

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri në aplikimin e kritereve të vendosura.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga specialistët e fushës për hartimin e kritereve të veçanta është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

1.Kërkesa e pikës **2.3/d DST,sqarojmë se:**

Kërkesa e pikës **2.2/d DST** mbi taksat vendore per 3 vitet e fundit nuk është e ekzagjeruar, pasi është nje kërkesë minimale, vërtet mund te ishte vetëm per vitin e fundit por është ndjekur rregulli i përdorur gjerësisht mbi detyrimet e 3 vjecarit te fundit. Per OE eshte nje kërkesë e thjeshte, pa kosto, dhe lehtësisht e plotesueshme, nëse i ka shlyer detyrimet e lartpërmendura.

2.Kërkesa e pikës **2.3/i DST,sqarojme se:**

Kërkesat per ñKontejner stacioner (zyrë në objekt)ò eshte vendosur prej NJHDT ne referim te ANEKSIT 4 I VKM Nr.312, datë 5.5.2010, Udhëzimit Nr.2, datë 13.5.2005, te nenit 67, 70, 71 ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 me ndryshime.

Qëndrimi i Grupit të auditimit

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Obesrvacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

22. Tenderi me objekt: "Materiale të ndryshme, çakull, stabilizant për mirëmbajtje rruge në fshatra" Viti 2019, me këto të dhëna:

22. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Materiale të ndryshme, çakull, stabilizant për mirëmbajtje rruge në fshatra"		
1.Urdhër Prokurimi :	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:	3.Komisioni Vlerësimit

Nr. 1247 regj, datë 30.05.2019 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	Nr. 1247 regj, datë 30.05.2019 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. M.V ï (Ing.Nd.-Spec. i fushës) 3. P.Lï (Ekonomist-Anëtar)	Ofertave: Nr.155, Datë 30.05.2019 1. H. S (Kryetar) 2. A.R (Anëtar) 3. E. Ç (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 25,000,000 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñBò Shpk me ofertë 21,990,500 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 18.07.2019, me afat 2 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 3,009,500 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 24.06.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar - OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për vlerësimin e ofertave.
Situata:Vlerësimi i ofertave: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 64, pika 5, dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar. Raporti përfundimtar është miratuar me vendimin nr. 1538/1, datë 10.07.2019.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se OE i shpallur fitues nuk përmbush kriteret për tu kualifikuar dhe konkretisht:
1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/a të DST** për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës. Për të përmbushur këtë kriter, OE ka paraqitur një kontratë të lidhur me Bashkinë Selenicë për kryerje punimesh me objekt ñSistemim asfaltim i rrugës Treblovë ï Peshkepi, Loti I, L=2000mlò. Siç konstatohet, kontrata e paraqitur nga OE nuk është kontratë furnizimi, por kontratë për punë publike, e cila nuk është në përputhje me kërkesën në DST. OE nuk disponon kontrata të ngjashme.
2.Oe nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/b të DST** lidhur me kërkesën për fletë analizën apo raport testimin të lëshuar nga organe kompetente shtetërore të akredituara, jo më parë se 3 muaj nga data e zhvillimit të tenderit për mallrat objekt prokurimi çakëll dhe stabilizant. OE nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kërkesës së mësipërm.
3.OE nuk përmbush kriteret e pikës **2.3/e të DST** për impiantin e inerteve, për të cilët ka kërkuar të paraqesë edhe raport testimet si më poshtë:
- Raport Testim të Materialeve çakëll, stabilizant, Metoda e Testimit S SH EN 933-1:2012. Metoda e Testimit S SH EN 933-1:2012
- Testimet e mësipërme duhet të jenë nga Laborator i akredituar konform SSH ISO/EN 17025:2006
-Janë paraqitur 2 kontrata furnizimi me materialet çakëll, konkretisht me subjektin ñM.ò shpk, për të cilën ka paraqitur disa raport testime të vitit 2017 që nuk përcaktohet asnjëra nga metodat e kërkuara, ndërkohë që edhe periudha e raport testimeve është e dy viteve përpara, dhe kontratën e lidhur me subjektin ñAò shpk, për të cilën nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar dhe raport testimet e materialeve.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:****anëtarët e KVO z. H. S, z. A. R dhe z. E. Ç.*
Ndikimi/Efekti: Prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E-[të]) në vlerën **21,990 mijë lekë** pa TVSH**.**
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Akt Konstatimin Nr. 10, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/4 prot., datë 04.04.2022 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

OE fitues OE ñ**B"** shpk ka paraqitur ofertën **21.990.500lekë pa TVSH.**

Oferta e paraqitur nga ky OE është oferta me vlerën më të ulët të paraqitur në këtë procedurë.

Duke e krahasuar ofertën fituese, rezulton se diferenca e ofertës fituese nga fondi limit është **3.009.500** lekë pa TVSH.

Grupi i Auditimit të KLSH ka konsideruar se BOE ñ**B**ò shpk, i shpallur fitues nuk plotëson kriteret sipas pikave 2.3/a,2.3/b, 2.3/d dhe 2.3/e të DST

Për këtë arsye, paraqesim këtë Observacion, duke sqaruar si më poshtë:

-Për pikën 2.3/a të DST,ga ana e operatorit ekonomik ñBò shpk janë depozituar punë të ngjashme ku pavarsisht një pjesë e tyre nuk kanë qënë furnizime,por në zerat e punimeve të kontratave të realizuara operatori ekonomik ka kryer furnizime dhe vendosje të materjaleve të cilat janë objekt i prokurimit nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër.Pra ky operator ka kryer blerje të këtyre materjaleve dhe ka realizuar objekte ku zërat e punimeve përbëhen nga materjalet të cilat kërkohen nga autoriteti kontraktor.

-Për sa i përket pikë 2.3/d të DST nga KVO është konsideruar si e plotësuar për shkak se totali i mjeteve të deklaruara nga ana e subjektit ñBò shpk e plotëson dhe e tejkalon kapacitetin dhe volumet e kërkuara nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër,nga KVO është vlerësuar se pavarësisht se në çertifikatat e mjeteve të paraqitura nuk janë dhe për me qera,paraqitja e aktit noterial për marrje me qera të mjeteve nga oprator të tjerë ekonomik e bënë të pranueshme dhe të plotësuar kriterin e vendosur nga AK.

Refuzimi i ofertave më të ulta thjesht për devijime të vogla nuk kufizon konkurrencën, dhe nuk dëmton ekonominë si dhe efikasitetin e mirëpërdorimit të fondeve publike. Në rastin Konkret nuk mund të procedohet në skualifikim të ofertes fituese për elemente dytësor që nuk ndikojnë drejtpërdrejtë në aftësinë e OE në realizimin e kontratës. Sa më sipër refuzimi i një oferte fituese në kushte të tilla do ishte kundër interesit të AK për realizimin e investimit.

Në plotësimin e kësaj kërkese, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se thelbi dhe synimi i saj është disponimi nga ana e operatorit ekonomik i mjeteve dhe makinerive të kërkuara, për realizimin e punimeve objekt kontrate, dhe konkretisht për kapacitetin e tyre, ku në rastin konkret kapaciteti plotësohet në referim dhe të volumeve të preventivit, dhe është konsideruar si nje devijim i vogël ndryshimi në ndonjë mjet të veçante i kapacitetit në nivele të vogla, pasi në vlerësim të qëllimit që duhet të përmbushe OE e ka plotësuar dhe tejkaluar kapacitetin teknik të kërkuar dhe të nevojitur për realizmin e kontratës.

Gjatë vlerësimit të ofertave, KVO ka mbajtur në konsideratë anën ekonomike, sipas kriterit të vlerësimit "çmimi më i ulët", të përcaktuar në dokumentet e tenderit të kësaj procedure, duke i konsideruar si devijime të vogla mangësitë në dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë të kualifikuar.

Në arritjen e këtij konkluzioni, KVO është referuar në pikën 4, të nenit 53, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...*".

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

23. Tenderi me objekt: "Pjesë këmbimi për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit viti 2019" Viti 2019, me këto të dhëna:

23. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Pjesë këmbimi për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit viti 2019"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 2376 regj, datë 09.10.2019 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñKërkesë për propozimò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 2376 regj, datë 09.10.2019 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A. S-(Ing.Mek-Spec. i fushës) 3. Q. S ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.379, Datë 09.10.2019 1. Z. M. (Kryetar) 2. A.R (Anëtar) 3. E. Ç (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 5,000,000 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñMò Shpk me ofertë 4,968,700 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 14.11.2019, me afat 12 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 31,300 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 28.10.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e fondit limit.
Situata:1.Komisioni i ngritur sipas urdhrit nr. 341, datë 18.09.2019 *"evidentimin e nevojave për shërbime dhe pjesë këmbimi, llogaritjen e sasisë, vlerës limit dhe afatin e realizimit/lëvrimit për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit për vitin 2019"*, nuk ka dokumentuar metodikën e ndjekur për përllogaritjen e fondit limit, duke mos ju përmbajtur kritereve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Trajtuar tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos angazhimi në komisione i personave të kualifikuar.
Ndikimi/Efekti: Risku i përllogaritjeve të gabuara të sasive dhe vlerës së shpenzuar për blerjet e mallrave.
Rëndësia:E mesme
Rekomandimi: Titullari i AK, të krijojë komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, duke angazhuar personel të kualifikuar, dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e komisionit E. Ç, F.B, A. S, N. O dhe F. S.

Procedurat e vitit 2020

Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve buxhetore.
Për periudhën 01/01/2020 ï 31/12/2020, nga Bashkia Mallakastër referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **14** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 595,193 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 550,605 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 44,588 mijë lekë pa TVSH ose 7.5 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2020-31.12.2020	**Nr.**	**Vl. Fond Limit**	**Vl. Kontrate**
Gjithsej	**14**	**595,193,582**	**550,605,427**
- Të hapura	8	578,059,021	535,805,041
- Kërkesë me propozim	6	17,134,561	14,800,386

Sipas objekteve	**14**	**595,193,582**	**550,605,427**
- Objekte në fushën e investimeve	5	498,238,540	462,233,789
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	9	96,955,042	88,371,638

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **90** OE/BOE, nga të cilat janë sëkualifikuar **33** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE është gjithsej **1** procedura ose 7 % e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 7 ose 50% e tyre, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuara nga AK Bashkia Mallakastër janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të operatorëve të kualifikuar.
- Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditmit nga **14** procedura prokurimi të zhvilluara me vlerë kontrate 550,605 mijë lekë, vlerësoj për auditimin e **9** procedurave me vlerë kontrate 541,255 mijë lekë ose 98% e vlerës së kontratave të lidhura.
-Në të gjitha procedurat e audituara, konstatohet se nga KVO janë mbajtur procesverbalet për hapat e zhvillimit të procedurës, veprime në përputhje me nenin 64 pika 5 dhe nenit 68 të VKM nr. 914, datë 27.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, i ndryshuar.
- Nga auditimi i **9** procedurave me vlerë kontratë 541.255 mijë lekë, u konstatua se janë në shkelje të akteve ligjore/ nënligjorë të LPP, gjithsej **3** procedura të audituara, ku në **2** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **1**rast OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mallakastër, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, në vlerën **21,641 mijë lekë** pa TVSH, *si më poshtë vijon*:

24. Tenderi me objekt: "Blerje karburant (Diezel+Benzinë) viti 2020ò (ndarë në 2 Lote) Viti 2020, me këto të dhëna:

24. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje karburant (Diezel+Benzinë) viti 2020" (ndarë në 2 Lote)		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.687 regj, datë 04.03.2020 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.687 regj, datë 04.03.2020 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A.S-(Ing.Mek-Spec. i fushës) 3. Q. S ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.167, Datë 05.03.2020 1. A. R (Kryetar) 2. A.X. (Anëtar) 3. M. M (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 14,916,602.5 lekë pa tvsh - Loti 1- ñBlerje karburant (Diezel) viti 2020ò Fondi Limit (pa Tvsh) 14,166,625 lekë pa TVSH Nga të cilat: *1,529,962.5 – Bashkia* *12,636,662.5 – NSHP*	6.Oferta fituese: Loti 1 OE ñNò Shpk, me marzh 3.69 %, me lidhje kontrate (Bashkia + NSHP) datë 23.04.2020, me afat 12 muaj	7.Diferenca me fondin limit: X lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 01.04.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë dhe Buxheti i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Procedura është në përputhje me rregullat e LPP

25. Tenderi me objekt: "Materiale të ndryshme, çakull, stabilizant, rërë bituminoze per mirembajtje rruge ne fshatra" (për nevoja të NSHP) Viti 2020, me këto të dhëna:

25. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Materiale të ndryshme, çakull, stabilizant, rërë bituminoze per mirembajtje rruge ne fshatra" (për nevoja të NSHP)		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.1093 regj, datë 27.05.2020 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.1093 regj, datë 27.05.2020 1. B. Fï (Jurist-PPP) 2. M. M ï (Ing.Nd.-Spec. i fushës) 3. A.S-(Ing.Mek-Spec. i fushës)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.283, Datë 27.05.2020 1. Z. M (Kryetar) 2. A. X (Anëtar) 3. Q. S (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 33,333,333 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñSHò Shpk,me ofertë 29,832,000 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 28.07.2020, me afat 3 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 3,501,333 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 29.06.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

OE fitues ñSHò shpk ka paraqitur ofertën **29,832,000lekë pa TVSH.**

Oferta e paraqitur nga ky OE është oferta me vlerën më të ulët të paraqitur në këtë procedurë.

OE fitues ñSHò shpk për përmbushjen e kërkesës sipas pikës 2.3.1 të DST lidhur me kontratat e ngjashme, përveç disa kontratave furnizimi, ka paraqitur edhe kontrata për punë publike, të cilat përmbushin këtë kërkesë pasi referuar situacioneve shoqëruese të këtyre kontratave janë të njëjtat zëra (mallra) me zërat e mallrave që kërkohen.

Shuma e këtyre zërave përmbush vlerën e kontratave të ngjashme prej 40% të fondit limit, çka përmbush kërkesën e përcaktuar në DST.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Pranohet observacioni juaj lidhur me kontratën e ngjashme. Në kushtet kur OE rezulton se në punët publike, në të gjitha rastet është shoqëruar edhe me furnizim të materialeve të ngjashme ose të njëjta të cilat janë të nevojshme për realizimin e kontratave, do konsiderohet e argumentuar dhe e përmbushur pika 2.3.1 e DST, por në rastet në vijim, AK duhet të bëjë evidentimin e këtyre situatave dhe ti paraqesë ato në Raportin Përmbledhës.

26. Tenderi me objekt: "Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh" Viti 2020, me këto të dhëna:

26. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.1014 regj, datë 12.05.2020 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.1014 regj, datë 12.05.2020 1. B.F ï (Jurist-PPP) 2. B. V ï (Ing.Hidro.-Spec i fushës) 3. A. X ï (Ing.Nd.-Spec. i fushës)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.267, Datë 12.05.2020 1. Z. M (Kryetar) 2. M. M (Anëtar) 3. Q. Sj (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 421,842,119 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE ñEò Shpk & ñ2 Tò Shpk & ñShò Shpk & ñBò Shpk, me ofertë 416,094,749 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 19.10.2020, me afat 24 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 5,747,370 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 15.06.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK,	12. Përgjigje ankesës nga AK,	13.Përgjigje Ankesës nga APP

- Ankesë nga OE ñIò Shpk, protokolluar në bashki me nr.1014/3 regj, datë 21.05.2020. - Ankesë nga BOE ñPò Shpk & ñLò Shpk & ñBò Shpk, protokolluar në bashki me nr.1493 regj, datë 07.07.2020.	- Shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga OE ñIò Shpk nr.1014/5 regj, datë 22.05.2020 - Shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga BOE ñPò Shpk & ñLò Shpk & ñBò Shpk nr.1493/1 regj, datë 10.07.2020.	apo KPP, - Vendimi K.P.P. Nr.343/2020, Datë 28.08.2020, protokolluar në bashki me nr.1973 regj, datë 02.09.2020.

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve të vendosura.

Situata: **Hartimi i kritereve:** 1.Kërkesa e pikës **2.3.2 e DST**, e cila kërkon të punësuar staf me kohë të plotë prej 220 punonjës për periudhën Nëntor 2019-Prill 2020, është kërkesë e paargumentuar nga AK. Nuk është bërë asnjë analizë dhe përllogaritje për të nxjerrë përfundimin se duhet kërkuar ky numër punonjësish, që është relativisht i lartë. AK duhet ti referohet në çdo rast VKM-së me nr. 629, datë 15.07.2015 ñ*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*ò, ku të përcaktojë me saktësi inxhinierike, volumet metrike me krahë dhe me makineri, VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008 ñ*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimit*ò Kreut III, ku parashikohet shprehimisht se: AK në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në DT të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve për periudhën 22 mars ï 23 tetor me 2 turne, për ndërtimin e objekteve në lartësi, dhe me 3 turne për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtimeve të tjera.

Nga AK, është e rëndësishme të provohet disponimi i numrit të nevojshëm të punonjësve nga ana e OE, por përcaktimi i numrit duhet të vijë pas një analize gjithëpërfshirëse të gjithë elementëve, përfshirë edhe nenin 78, pika 1 dhe 4 të Kodit të Punës, që përcakton kohëzgjatjen normale të ditës së punës 8 orë, nenin 83 që përcakton 40 orët e punës në javë, etj., por në respekt të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM-së nr. 914..., kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

2.Kërkesa e pikës **2.3.2/2 e DST**, e cila kërkon nga OE ofertues të kenë pjesë të stafit 10 punonjës të pajisur me certifikatë për dhënien e ndihmës së parë, është kërkesë e ekzagjeruar dhe e paargumentuar nga OE. AK nuk ka kryer një analizë për të përcaktuar numrin e mësipërm, dhe proceset konkrete të cilat paraqesin risk për të cilën kërkohet nevoja për punonjësit e mësipërm. Është kërkesë kufizuese për OE.

3.Kërkesa e pikës **2.3.2/3 e DST** e cila kërkon 1 mjek, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 ñ*Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*ò, pika 1 ku përcaktohet se:

> ñ*Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:*
> *"6. Punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C" dhe "D", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë."*ò

4.Kërkesa e pikës **2.3.2/6 e DST** e cila kërkon nga OE të kenë pjesë të stafit së paku muajin e fundit 1 punonjës ñ*Përgjegjës për dëmet në mjedis*ò me eksperiencë jo më pak se 3 vjet, është kërkesë jo e përshtatshme dhe kufizuese për OE. Është kushtëzuese kërkesa për 1 punonjës me këtë ekspertizë, ndërkohë që kjo mund të ofrohej edhe nga inxhinierë mjedisi dhe persona që janë të certifikuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ndërkohë që nuk është kërkuar në DST as kategoria NP-12 e licencës që përkon pikërisht me punimet në mjedis. Gjithashtu

përcaktimi e eksperiencës jo më pak se 3 vjet, përbën gjithashtu kusht kufizues dhe të paargumentuar nga AK.
5.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon fabrikë asfalti me distancë jo më shumë se 30 km, është kërkesë e cila mund të përbëjë kufizim për OE, pasi cilësia e asfaltit mund të sigurohet brenda parametrave edhe përtej kësaj distance.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:****specialistët e fushës për hartimin e kritereve të veçanta, znj. B. V. dhe z. A. X.*
Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri në aplikimin e kritereve të vendosura
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga specialistët e fushës për hartimin e kritereve të veçanta znj. B.V dhe z. A. X është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:
Sa i përket kërkesës së përcaktuar në pikën **2.3.2** të DST, sqarojmë se:
Projekt-zbatimi i këtij objekti, është hartuar nga shoqëria projektuese "E" shpk, e cila ka përcaktuar grafikun e punimeve të zbatimit në një afat prej 24 muajsh, si dhe ka përcaktuar numrin e fuqisë punëtore prej 220 (dyqind e njëzetë) punonjësish të nevojshëm, për realizimin e punimeve sipas këtij afati.
Ky përcaktim, është marrë i mirëqenë nga ana jonë, pasi është përcaktuar nga vetë autori i projektit dhe ne nuk mund të ndërhyjmë dhe të përcaktojmë të tjera kushte dhe afate për realizimin e një projekti të tillë e me rëndësi të veçantë.
Nga ana jonë është përcaktuar vetëm periudha nëntor – prill 2020, periudhe e cila garanton autoritetin kontraktor, se shoqëria ofertuese ka qëndrueshmëri sa i përket kapaciteteve të burimeve njerëzore të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate.
Sa i përket kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3.2/2** dhe **2.3.3/3** të DST, sqarojmë se:
Duke patur në konsideratë numrin total të punonjësve të parashikuar nga projektuesi, është parë e arsyeshme të kërkohet që OE të ketë në stafin e tij 10 (dhjetë) punonjës të pajisur me certifikatë për dhënien e ndihmës së parë, parë kjo jo vetëm në raport me përmasat që ka kantieri, por edhe në lidhje me proceset komplekse të punimeve që do të kryhen, të cilat paraqesin risqe të ndryshme. Pra, në objekt do të jenë të angazhuar kategori punonjësish të ekspozuar ndaj rriskut, siç janë drejtuesit e mjeteve, manovratorët, saldatorët, por edhe kalimtarë të ndryshëm etj. Sa i përket mjekut, kjo kërkesë është vendosur me qëllim për ti ardhur në ndihmë personelit që do të ekzekutojë punimet objekt kontrate, në rastet e dëmtimeve të shëndetit si pasojë e incidenteve të ndryshme apo si pasojë e sëmundjeve profesionale. Gjykojmë se këto kërkesa nuk janë kufizuese dhe synimi i vendosjes së tyre është realizimi me profesionalizëm i dhënies së ndihmës së parë, në rast se në kantier do të ketë incidente apo aksidente të ndryshme të punonjësve të ekspozuar ndaj rriskut.
Sipas VKM nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier" në aneksin 4 "Kërkesa minimale me karakter të përgjithshëm për vendet e punës në kantier" në pikën 13 përcaktohet se: "I takon punëdhënësit të garantojë që në çdo moment të mund të kryejë një ndihmë të shpejtë me personel që të ketë formimin e përshtatshëm. Duhet të merren masa për të siguruar largimin për kura mjekësorë të punëmarrësve, viktima të aksidenteve ose të një sëmundje të papritur".
Gjithashtu në aneksin 5 "Zbatimi i masave për promovimin dhe përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve në punë", pika 10.1 e në vazhdim përcakton se: "10.1. Punëdhënësi, duke marrë në konsideratë natyrën e aktivitetit dhe madhësinë e ndërmarrjes dhe të njësive të prodhimit, pasi ka marrë mendimin e mjekut kompetent, aty ku është e parashikuar, merr masat e duhura në fushën e ndihmës së shpejtë e të asistencës mjekësore e të emergjencës, duke pasur parasysh praninë e personave të tjerë në vendin e punës e duke vendosur raportet e nevojshme me shërbimet e jashtme,

dhe për transportin e punëmarrësve të aksidentuar." "10.2. Punëdhënësi, kur nuk i përcakton vetë, emëron një ose më shumë punëmarrës për zbatimin e masave në pikën 10.1.". "10.3. Karakteristikat minimale të mjeteve të ndihmës së shpejtë, kërkesat e personelit dhe formimi i tyre përcaktohen në lidhje me natyrën e aktivitetit, numrin e punëmarrësve dhe faktorëve të rrezikut."

Gjithashtu në pikën 11 e vazhdim të aneksit 5 të kësaj VKM-je përcaktohet se: "Kontrolli shëndetësor kryhet nga mjeku kompetent dhe përfshin: a) kontrollin paraprak për të konstatuar nëse ka kushte të përshtatshme në punë ndaj të cilave rrezikohen punëmarrësit dhe nëse punëmarrësit janë të përshtatshëm nga ana shëndetësore për të kryer atë detyrë; b) kontrolle periodike për shëndetin e punëmarrësve dhe shprehjen e mendimit mbi përshtatshmërinë e punës." Mjeku kompetent: a) bashkëpunon me punëdhënësin dhe zyrën për parandalimin dhe mbrojtjen, sipas organizimit të ndërmarrjes, njësive të prodhimit dhe situatave të rrezikut, të përgatitjes për zbatimin e masave për mbrojtjen e shëndetit dhe integritetit psikofizik të punëmarrësve; b) kryen kontrolle mjekësore; c) shpreh mendimin për përshtatshmërinë e punëmarrësve për një detyrë specifike në punë; 2. Mjeku kompetent, mbi bazën e motiveve të argumentuara, mund të bashkëpunojë me mjekun specialist të zgjedhur nga punëdhënësi, i cili mbulon shpenzimet e mjekut specialist.".

Sa i përket kërkesës së përcaktuar në pikën **2.3.2/6** të DST, sqarojmë se:

Kërkesa që shoqëria ofertuese të ketë të siguruar, së paku muajin e fundit në stafin e saj, 1 punonjës si "Përgjegjës për dëmet në mjedis" gjatë kryerjes së veprimtarisë, me eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet, është vendosur për të garantuar autoritetin kontraktor se shoqëria ofertuese njeh dhe zbaton politikat mjedisore duke minimizuar impaktin negativ që shkakton aktiviteti i punimeve. Kjo kërkesë është në harmoni edhe me frymën që parashikojnë dispozitat e ligjit Nr.10431, datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

Kjo është një kërkesë minimale dhe e kundërta do të ishte nëse nga ana jonë do të kërkohej një drejtues teknik si psh. ing.mjedisi, i cili për të fituar të drejtën për të qenë i tillë do të duhej të kishte minimalisht 5 vite eksperiencë pune.

Përgjegjësi për dëmet në mjedis nuk është specifikuar të ketë domosdoshmërisht licencë profesionale e cila kërkon një kohë më të gjatë për sigurimin e saj, por mund të jetë një punonjës i cili është trajnuar dhe ka një formim të caktuar për parandalimin e dëmeve në mjedis që mund të shkaktohen si pasojë e punimeve.

Dispozitat e ligjit Nr.10431, datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" përcaktojnë se operatorët që kryejnë veprimtari me impakt në mjedis duhet të marrin masat e nevojshme për parandalimin dhe minimizimin e tyre.

Sa i përket kërkesës së përcaktuar në pikën **2.3.7** të DST, lidhur me fabrikën e asfaltit, sqarojmë se:

Mbështetur në kërkesat e STASH:660-87 dhe STASH:561-87, duke ditur se përgatitja e asfaltit realizohet në temperaturën 155 ^{o}C deri në 170 ^{o}C, Fabrika/Impianti i prodhimit të Asfaltit duhet të jetë në një distancë jo më të largët se 30 km nga vendndodhja e objektit të prokurimit. Kjo për arsye që të sigurohet se temperatura e domosdoshme për ngjeshjen e asfaltit jo më pak se 130°C, kusht teknik për ngjeshje. Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin 9290 datë 07.10.2004 "Për produktet e Ndërtimit" (I ndryshuar), dhe në VKM 679 datë 22.10.2004 "Për miratimin e rregullave teknike për betonet strukturore" (I ndryshuar) dhe VKM 279 datë 18.04.2007 "Për miratimin e listës së produkteve të ndërtimit për të cilat kërkohet vlerësimi i detyruar i konformitetit".

Argumentim teknik: Referuar VKM Nr.629 dt.15/07/2015 "Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre, si dhe VKM Nr.628, datë 15.07.2015 "Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve……specifikimet", midis të tjerave parashikon se:

Përzierja e prodhuar duhet zakonisht të transportohet menjëherë në kantierin e ndërtimit.

E gjithë procedura e prodhimit, transportit, vendosjes dhe ngjeshjes së përzierjes nuk lejohet të jetë më shumë se 2 (dy) orë.

Temperatura e lejuar e shtrimit 130-150 °C

Për 70 min temperatura ulet me rreth 30°C

Duke patur parasysh se një kamion që transporton, sipas rregullave të qarkullimit rrugor, lëviz me shpejtësi mesatare 45-50 km/orë dhe duke patur parasysh plotësimin e kushtit prej 2 orësh për përmbylljen e procesit të shtrimit, nga përllogaritjet rezulton :

Prodhimi i asfaltit..... 40 minuta

Mbushja e kamionit referuar fabrikave min 100 ton/orë..... 10.4 minuta

Procesi i shkarkimit, vendosjes dhe ngjeshjes së materialit..... 50 minuta
Koha e mbetur për transport materiali..... 19.6 minuta
Pra referuar të dhënave për këtë proces, distanca maksimale e përllogaritur për vendndodhjen e fabrikës së asfaltit, rezulton të jetë 16.3 km. Kjo distancë del nga përllogaritja, nga ku është marrë për bazë lëvizja e kamionit me ngarkesë me shpejtësi 50 km/orë (60 min) dhe koha e mbetur për transportin e materialit prej 19.6 minuta.
Duke qenë se në distancën maksimale të përllogaritur nuk sigurohet numri dhe konkurenca minimale për një impiant të tillë për përmbushjen e kërkesave të cilësisë së materialit që do të përdoret në vepër, gjykohet se distanca e përcaktuar prej jo më shumë se 30 km siguron konkurencën minimale, duke qenë se në këtë distancë rezultojnë të ketë disa impiante të prodhimit të asfaltit. Distanca e vendosur në një largësi prej jo më shumë se 30 km, është brenda kufirit të lejuar për sjelljen e materialit në kohe dhe për një realizim të mirë të punës në objekt. Pra sa më sipër, për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të kontratës, kërkohet domosdoshmërisht plotësimi i kërkesës për fabrikën e asfaltit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 11 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

27. Tenderi me objekt: "Rehabilitimi i rrjetit ujitës Çorrush" Viti 2020, me këto të dhëna:

27. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitimi i rrjetit ujitës Çorrush"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.1678 regj, datë 27.07.2020 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.1678 regj, datë 27.07.2020 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. B. Vï (Ing.Hidro.-Spec. i fushës) 3. M. M ï (Ing.Nd.-Spec. i fushës)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.362, Datë 27.07.2020 1. A. M (Kryetar) 2. A. X (Anëtar) 3. Q.S (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 28,320,000 pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE ñKò Shpk & ñ2 Nò Shpk, me ofertë 21,641,000 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 26.10.2020, me afat 2 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 6,679,000 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 08.09.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 4 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

<u>Titulli i gjetjes:</u>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve të vendosura dhe vlerësimin e ofertave.
<u>Situata:</u> Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **1.2.4 e DST** e cila kërkon nga ofertuesit të paraqesin deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për vitet 2018, 2019 dhe kështet e maturuara për vitin 2020, dhe njëkohësisht kërkon edhe vërtetime të lëshuara nga këto njësi vendore ku ka ushtruar aktivitetin, është kërkesë e dubluar e cila nuk i shërben AK, e cila duhej të mjaftohej me njërën nga format e mësipërme. Gjithashtu, shtrirja në një periudhë mbi 2 vjet e kësaj kërkese nuk argumentohet, por shton kostot administrative të OE.
2.Kërkesa e pikës **2.3.3 e DST** e cila kërkon nga OE të jenë të licencuar nga QKL me licencën Kodi III.2.B ñ*Grumbullim, transportim mbetjeve urbane*ò, është kërkesë kufizuese për OE, pasi duhej të mundësonte disponimin e kësaj licence edhe nëpërmjet një kontrate

shërbimi.
3.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon nga OE një punësim mesatar prej 60 punonjës për periudhën Shkurt 2020 ï Korrik 2020, është kërkesë e paargumentuar nga AK. Nuk është bërë asnjë analizë dhe përllogaritje për të nxjerrë përfundimin se duhet kërkuar ky numër punonjësish, që është relativisht i lartë. AK duhet ti referohet në çdo rast VKM-së me nr. 629, datë 15.07.2015 ñ*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*ò, ku të përcaktojë me saktësi inxhinierike, volumet metrike me krahë dhe me makineri, VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008 ñ*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimit*ò Kreut III, ku parashikohet shprehimisht se: AK në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në DT të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve për periudhën 22 mars ï 23 tetor me 2 turne, për ndërtimin e objekteve në lartësi, dhe me 3 turne për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtimeve të tjera.
Nga AK, është e rëndësishme të provohet disponimi i numrit të nevojshëm të punonjësve nga ana e OE, por përcaktimi i numrit duhet të vijë pas një analize gjithëpërfshirëse të gjithë elementëve, përfshirë edhe nenin 78, pika 1 dhe 4 të Kodit të Punës, që përcakton kohëzgjatjen normale të ditës së punës 8 orë, nenin 83 që përcakton 40 orët e punës në javë, etj., por në respekt të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM-së nr. 914..., kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.
4.Kërkesa e pikës **2.3.6 e DST** e cila kërkon nga OE 1 mjek, 1 inxhinier topograf dhe 1 inxhinier ndërtimi, janë kërkesa të tepërta dhe të paargumentuara. Së pari kërkesa për 1 mjek, është në kundërshtim me VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 ñ*Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*ò, pika 1 ku përcaktohet se:

ñ*Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:*
*"6. Punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C" dhe "D", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë."*ò

-Kërkesa për 1 inxhinier topograf dhe 1 inxhinier ndërtimi, është kërkesë e tepërt, duke marrë parasysh faktin që janë kërkuar këta inxhinierë edhe si drejtues teknik në licencën e shoqërisë. Kjo kërkesë nuk vjen në përputhuje në raport me vlerën e investimit. Nuk argumentohet numri i lartë i inxhinierëve të kërkuar.
5.Kërkesa e pikës **2.3.8 e DST** e cila kërkon nga OE që të përcaktojë me anë të një deklarate të administratorit të shoqërisë se Drejtuesit Teknik të paktën 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier hidroteknik, 1 (një) inxhinier gjeodet/topograf, nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera, të cilët duhet të pajisur me diplomë, kontratë noteriale pune dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Shkurt 2020 ï Korrik 2020, është kërkesë e paargumentuar. AK, së pari duhet mbajtur në konsideratë UKM-në nr. 2, datë 13.05.2005, e cila në pikën 2 të Kreut e cila përcakton se kërkesat për inxhinerë të paangazhuar në kontrata tjera janë për investimet mbi 30 milion lekë. Ndërkohë që kërkesa e mësipërme, e cila përcakton jo 1 por 3 inxhinierë të paangazhuar në kontrata tjera, është e ekzagjeruar dhe kufizuese për OE. Nuk ka mbështjetje ligjore, dhe nuk është në përputhje me vlerën e investimit.
Vlerësimi i ofertave: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 64, pika 5, dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar. Raporti

përmbledhës është miratuar me vendimin nr. 1678/4, datë 01.10.2020.
1.BOE nuk përmbush kriterit e pikës **2.3.7 të DST** lidhur me kërkesën për 2 mekanikë, 2 hekurkthyes, 4 karpentierë dhe 1 specialist për punime pranë ujit. Për të përmbushur këtë kriter, në DST është kërkuar që stafi të jetë i kualifikuar me dëshmi të sigurimit teknik si dhe **dëshmi të kualifikimit profesional diploma/certifikata trajnimi.**
Nga punonjësit e mësipërm, rezultojnë me mangësi 1 mekanik nga 2 të kërkuar, pasi për punonjësin Xh.A nuk është paraqitur dëshmia e kualifikimit profesional; për hekurkthyes, rezulton se punonjësit e deklaruar P.S, S. Btë OE ñ2ò dhe B. M, E.O të OE ñKò nuk kanë dëshmi kualifikimi profesional; për karpentier, rezulton se punonjësit e deklaruar P.N nga OE ñ2Nò dhe B. V, F. D, M. H të OE ñKò nuk kanë dëshmi kualifikime profesional; për 1 specialist për punime pranë ujit, nuk kanë paraqitur dokumentacion për asnjë punonjës të tillë.
2.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.11 të DST** për mjetet që duhet të disponojë OE për punimet objekt kontrate me konkretisht:
a.Nuk përmbushet kriteri për 2 kamionë me kapacitet mbajtës mbi 15 Ton. Mjeti me targa AA149ZO, i marrë me kontratë qiraje nga subjekti Sh. A, ka Lejen e Qarkullimit të palexueshme, çka bën të pamundur leximin e kapacitetit mbajtës të këtij mjeti. Gjithashtu Certifikata e transportit nuk figuron me targa e këtij mjeti, por me targa BR4864B. Mjeti me targa AA173PO plotëson kriteret.
b.Për mjetin minifadromë, është paraqitur kontratë blerje ndërmjet OE ñ2ò shpk dhe shtetasit N. Sh, por mungon dokumentacioni mbi fadromën si deklarata zhdoganimi dhe fatura tatimore.
f.Për mjetin Ekskavator me krahë të gjatë mbi 18 metër, është paraqitur kontratë qiraje ndërmjet OE ñKò shpk dhe subjektit ñCò shpk për mjetin ekskavator, por nga shqyrtimi i dokumentacionit, nuk rezulton asnjë skedë teknike për të përcaktuar gjatësinë mbi 18 metër të krahut.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:****Specialistët e fushës për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, znj. B. V dhe z. M. M* si dhe *anëtarët e KVO znj. A. M, z. A.X dhe z. Q. S.*
Ndikimi/Efekti: Prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E-të) në vlerën**21,641 mijë lekë** pa TVSH**.**
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga specialistët e fushës për hartimin e kritereve të veçanta znj. B. V. dhe z. M. M është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
1.Sa i përket kërkesës së përcaktuar në pikën **2.3.3** të DST, sqarojmë se:
Kërkesa që OE të kenë Licencë kodi III.2.B "Grumbullim, transportim të mbetjeve urbane", nuk është kufizuese, por është një kërkesë e cila bazohet në legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me politikat mjedisore. Kjo kërkesë garanton AK që OE e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje dhe në harmoni me kërkesat e parashikuara nga legjislacioni mjedisor.
Kjo licencë ka të bëjë me veprimtaritë e tjera me ndikim në mjedis, siç është grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane, dhe është vendosur duke marrë në konsideratë mbrojtjen e mjedisit dhe kujdesin që duhet treguar për të, si dhe duke patur parasysh trajtimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta që do të dalin gjatë punimeve. Kjo kërkesë është në harmoni me politikat mjedisore dhe në përputhje me dispozitat që parashikon ligji nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe ligji nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Qëllimi i vendosjes së

këtij kriteri nuk është kufizimi i OE, por garantimi i mbrojtjes së mjedisit që mund të dëmtohet nga aktiviteti dhe jo domosdoshmërisht që të jetë i pajisur vetë OE, por duhet ta disponojë një të tillë, disponim që mundësohet nga pajisja e vetë OE ose me kontratë shërbimi nga një palë e tretë e licencuar për këtë veprimtari. Pra disponimi nuk nënkupton që vetë OE të jetë i pajisur apo licencuar, por mund ta disponojë këtë licencë edhe me mënyra të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, siç është kontraktimi i subjekteve të licencuara.

2.Sa i përket kërkesës së përcaktuar në pikën **2.3.4** të DST, sqarojmë se:

Kërkesa që OE të kenë një punësim mesatar prej 60 punonjës për periudhën shkurt 2020 – korrik 2020, është në përputhje me volumet dhe përmasat që ka kantieri i punimeve. Theksojmë, se kjo kërkesë është rishikuar nga ana jonë pasi fillimisht ishte parashikuar një numër më i lartë punonjësish (80), gjë e cila është korrigjuar nga ana jonë dhe është parashikuar një punësim mesatar prej 60 punonjës. Kjo kërkesë është e lidhur ngushtë edhe me afatin e punimeve, afat i cili është 2 muaj dhe garanton AK për zbatimin e kontratës brenda afatit të parashikuar në grafikun e punimeve.

3.Sa i përket kërkesës së përcaktuar në pikën **2.3.6** të DST, sqarojmë se:

Kërkesa për të pasur një mjek në staf është është vendosur me qëllim për ti ardhur në ndihmë personelit që do të ekzekutojë punimet objekt kontrate, në rastet e dëmtimeve të shëndetit si pasojë e incidenteve të ndryshme apo si pasojë e sëmundjeve profesionale. Sipas VKM nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier" në aneksin 5 "Zbatimi i masave për promovimin dhe përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve në punë", pika 10.1 e në vazhdim përcakton se: "10.1. Punëdhënësi, duke marrë në konsideratë natyrën e aktivitetit dhe madhësinë e ndërmarrjes dhe të njësive të prodhimit, pasi ka marrë mendimin e mjekut kompetent, aty ku është e parashikuar, merr masat e duhura në fushën e ndihmës së shpejtë e të asistencës mjekësore e të emergjencës, duke pasur parasysh praninë e personave të tjerë në vendin e punës e duke vendosur raportet e nevojshme me shërbimet e jashtme, dhe për transportin e punëmarrësve të aksidentuar." "10.2. Punëdhënësi, kur nuk i përcakton vetë, emëron një ose më shumë punëmarrës për zbatimin e masave në pikën 10.1.". "10.3. Karakteristikat minimale të mjeteve të ndihmës së shpejtë, kërkesat e personelit dhe formimi i tyre përcaktohen në lidhje me natyrën e aktivitetit, numrin e punëmarrësve dhe faktorëve të rrezikut.".

Gjithashtu në pikën 11 e vazhdim të ankesit 5 të kësaj VKM-je përcaktohet se: "Kontrolli shëndetësor kryhet nga mjeku kompetent dhe përfshin: a) kontrollin paraprak për të konstatuar nëse ka kushte të përshtatshme në punë ndaj të cilave rrezikohen punëmarrësit dhe nëse punëmarrësit janë të përshtatshëm nga ana shëndetësore për të kryer atë detyrë; b) kontrolle periodike për shëndetin e punëmarrësve dhe shprehjen e mendimit mbi përshtatshmërinë e punës." Mjeku kompetent: a) bashkëpunon me punëdhënësin dhe zyrën për parandalimin dhe mbrojtjen, sipas organizimit të ndërmarrjes, njësive të prodhimit dhe situatave të rrezikut, të përgatitjes për zbatimin e masave për mbrojtjen e shëndetit dhe integritetit psikofizik të punëmarrësve; b) kryen kontrolle mjekësore; c) shpreh mendimin për përshtatshmërinë e punëmarrësve për një detyrë specifike në punë; 2. Mjeku kompetent, mbi bazën e motiveve të argumentuara, mund të bashkëpunojë me mjekun specialist të zgjedhur nga punëdhënësi, i cili mbulon shpenzimet e mjekut specialist.".

Kërkesa për të pasur një inxhinier topograf në staf, lidhet me volumet dhe përmasat e kontratës që prokurohet, përmasat e kantierit të ndërtimit, si dhe për kujdesin e veçantë që duhet treguar për piketimin e punimeve, kuotimin dhe gjurmën e tyre. Kjo pasi natyra e objektit (rrjet ujitës) dhe terreni ku ai shtrihet, kërkon përcaktimin me saktësi të gjurmës dhe pjerrësisë optimale sa i përket funksionalitetit të tij. Kërkesa për të pasur një inxhinier ndërtimi në staf, lidhet me të gjitha aktivitetet dhe proceset e ndryshme ndërtimore në kantierin e punimeve, në funksion të zbatimit korrekt të tyre.

Pra kërkesat e përcaktuara lidhur me stafin nuk janë kufizuese, por janë të lidhura me natyrën e punimeve.

4.Sa i përket kërkesës së përcaktuar në pikën **2.3.8** të DST, sqarojmë se:

Kërkesa që OE të përcaktojë me një deklaratë se drejtuesit teknik 1 inxhinier ndërtimi, 1 inxhinier hidroteknik dhe 1 inxhinier gjeodet/topograf vendosur për të garantuar autoritetin kontraktor se punimet objekt kontrate do të ndiqen dhe zbatohen gjatë gjithë kohës së implementimit të tyre nga drejtuesit teknik të përcaktuar nga ana e shoqërisë, të cilës nuk duhet të jenë të angazhuar në kontrata të tjera, Mos angazhimi në kontrata të tjera garanton autoritetin kontraktor për angazhimin maksimal gjatë zbatimit të punimeve objekt kontrate duke patur parasysh rëndësinë që ka vepra për komunitetin dhe grafikun relativisht të shkurtër në kohë. Kjo kërkesë nuk është kufizuese, pasi nuk është kërkuar

sipas UKM nr.2, dt.13.05.2005 që drejtuesit teknik të jenë rezident. Fakti i mosangazhimit në kontrata të tjera nuk nënkupton të qenit rezident në kantierin e punimeve, por thjesht garanton AK për realizmin e punimeve në mënyrë korrekte dhe brenda afatit të përcaktuar.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 11 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
Grupi i Auditimit të KLSH ka konsideruar se BOE fitues ñKò shpk & ñ2ò shpk, nuk plotëson kriteret sipas pikave 2.3.7 dhe 2.3.11 të DST.
Për këtë arsye, paraqesim këtë Observacion, duke sqaruar si më poshtë:
BOE fitues ñKò shpk & ñ2ò shpk ka paraqitur ofertën **21,641,000 lekë pa TVSH.**
Oferta e paraqitur nga BOE është oferta me vlerën më të ulët të paraqitur në këtë procedurë.
Duke e krahasuar ofertën fituese me fondin limit prej 28,320,000 lekë pa TVSH, rezulton se diferenca e ofertës fituese nga fondi limit është 6,679,000 lekë pa TVSH.
Pra, oferta e paraqitur nga BOE është vlerësuar nga ana jonë për shkak të çmimit më të ulët të ofruar, duke mbajtur në konsideratë parimin e ekonomicitetit dhe parashikimet e bëra në ligjin e prokurimit publik.
Gjatë vlerësimit të ofertave, KVO ka mbajtur në konsideratë anën ekonomike, sipas kriterit të vlerësimit "çmimi më i ulët", të përcaktuar në dokumentet e tenderit të kësaj procedure, duke i konsideruar si devijime të vogla mangësitë në dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë të kualifikuar.
Në arritjen e këtij konkluzioni, KVO është referuar në pikën 4, të nenit 53, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...*".
Ky fakt është pasqyruar nga KVO edhe në procesverbalin e vlerësimit të ofertave të datës 22.09.2020, si dhe në raportin përmbledhës të procedurës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 11 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

28. Tenderi me objekt: "Blerje mjetesh: Makinë teknologjike, Rul, Transportues, Fuoristradë" Viti 2020, me këto të dhëna:

28. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje mjetesh, Makinë teknologjike, Rrul, Transportues, Fuoristradë"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.1719 regj, datë 30.07.2020	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.1719 regj, datë 30.07.2020	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.369, Datë 30.07.2020
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	1. B.Fjï (Jurist-PPP) 2. M. M ï (Ing.Nd.-Anëtar) 3. A.S-(Ing.Mek-Spec. i fushës)	1. A. M (Kryetar) 2. Q.S (Anëtar) 3. G. J (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh)	6.Oferta fituese:	7.Diferenca me fondin limit:

12,500,000 lekë pa tvsh	OE ñBò Shpk, me ofertë 12,200,000 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 02.10.2020, me afat 30 ditë	300,000 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 31.08.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b)Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, - Ankesë nga OE ñLò Shpk, protokolluar në bashki me nr.2063 regj, datë 14.09.2020.	12. Përgjigje ankesës nga AK, - Shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga OE ñL Bò Shpk nr.2063/2 regj, datë 16.09.2020.	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vendosjen e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit.
Situata: Mungon urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit.
Në dosjet gjendej një akt teknik, i miratuar nga drejtori i NSHP z. B. V, ku një komision prej 5 personash, i përbërë nga A. S, F. B, E. B, Q. L dhe A. B, kanë hartuar specifikimet teknike dhe përllogaritur fondin limit. Lidhur me fondit limit, ky komision nuk ka përcaktuar asnjë nga metodat e ndjekura për përllogatjen e fondit limit të kësaj kontrate, veprim ky në kundërshtim me nenin 59 pika 2 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar.
Specifikimet teknike: Në lidhje me specifikimet teknike të vendosura, u konstatuan mangësi si vijon:
1.Për mjetin makinë teknologjike, është përcaktuar masa maksimale e mjetit 11990 ï 12000 kg. Përcaktimi i kësaj mase maksimale të peshës me kufi shumë të ngushtë me vetëm 10 kg, është specifikim teknik me diferencë shumë të vogël i cili mund të vendosë OE në kushte jo të barabarta dhe kufizuese.
2.Specifikimi teknik për makinën teknologjike dhe mjetin tip fuoristradë, të cilët nuk duhet të kenë qenë të targuara, në funksion pune ose shërbimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për vitin 2019, është tjetër specifikim i cili ndikon drejtpërdrejtë në paraqitjen e ofertave nga OE. Praktikisht, AK ka përcaktuar që vetëm kamionët e targuar 7 muajt e fundit, janë të kualifikueshëm në këtë procedurë. Specifikime të tilla teknike, përbëjnë kufizim për OE për të paraqitur ofertat e tyre.
Specifikimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 23, pika 1 dhe 2 të LPP të cilët përcaktojnë se:

1.Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.
2.Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit për *"Hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e vlerës limit të kontratës.*
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Vendosja e personave të pa kualifikuar për hartimin e specifikimeve teknike.
Ndikimi/Efekti: Shmang konkurrencën.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi 1: Titullari i AK, të marrë masa për vendosjen nëpër komisionet e ngritura për procedurat e prokurimit publik, të persona me kualifikimin e duhur. Të merren masa për

vendosjen e specifikimeve teknike, për krijimin e kushteve për konkurrim të paanshëm ndërmjet kandidatëve ofertues.

29. Tenderi me objekt: "Studim projektim i sistemit të furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit" Viti 2020, me këto të dhëna:

29. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Studim projektim i sistemit të furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.1936 regj, datë 28.08.2020 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.1936 regj, datë 28.08.2020 1. B.F ï (Jurist-PPP) 2. M. M ï (Ing.Nd.-Spec. i fushës) 3. A. R ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.408, Datë 28.08.2020 1. Z. M (Kryetar) 2. A.X (Anëtar) 3. Q. S (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 20,483,876 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñHò Shpk, me ofertë 17,849,734 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 26.10.2020, me afat 3 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 2,634,142 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 05.10.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, - Ankesë nga OE ñS.S. K-SAò Shpk, protokolluar në bashki me nr.2044 regj, datë 10.09.2020.	12. Përgjigje ankesës nga AK, - Shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga OE ñSò Shpk nr.2044/2 regj, datë 11.09.2020.	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,

Procedura është në përputhje me rregullat e LPP

30. Tenderi me objekt: "Mirëmbajtje e mjeteve të transportit viti 2020" Viti 2020, me këto të dhëna:

30. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Mirëmbajtje e mjeteve të transportit viti 2020"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.2188/1 regj, datë 06.10.2020 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñKërkesë për propozimò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.2188/1 regj, datë 06.10.2020 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A. S-(Ing.Mek-Spec. i fushës) 3. A. R ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.471, Datë 06.10.2020 1. Z. M.(Kryetar) 2. A. X (Anëtar) 3. Q.S (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 6,309,272 lekë pa tvsh *nga të cilat:* *916,660 – Bashkia* *5,392,612 – NSHP*	6.Oferta fituese: OE ñFò Shpk, me ofertë 6,200,000 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 27.11.2020, me afat 12 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 109,272 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 19.10.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë dhe Buxheti i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar - OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në argumentimin e përllogaritjes së fondit limit.
Situata: Mungon urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit.
Në dosjet gjendet dokumenti me nr. 254/9, datë 28.09.2020, ku një komision prej 5

personash, i përbërë nga A.S, F. A, A. H, Q. L dhe F. E, kanë hartuar specifikimet teknike dhe përllogaritur fondin limit. Lidhur me fondit limit, ky komision nuk ka përcaktuar asnjë nga metodat e ndjekura për përllogatjen e fondit limit të kësaj kontrate, veprim ky në kundërshtim me nenin 59 pika 2 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Trajtuar tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos angazhimi në komisione i personave të kualifikuar.

Ndikimi/Efekti: Kryerja e procedurës në mos përmbushje të akteve nënligjore.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: Titullari i AK, të krijojë komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, duke angazhuar personel të kualifikuar, dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.

Në çdo rast, komisionet e përfshira në procedurat e prokurimit publik, të ngrihen me urdhër titullarit.

31. Tenderi me objekt: "Rikonstruksion i rrugës autostradë - Rromës" Viti 2020, me këto të dhëna:

31. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i rrugës autostradë - Rromës"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.2596/3 regj, datë 16.11.2020 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.2596/3 regj, datë 16.11.2020 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. M. M ï (Ing.Nd.-Spec. i fushës) 3. A. R ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.518, Datë 16.11.2020 1. Z. Mi (Kryetar) 2. A. X (Anëtar) 3. Q. Sj (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 16,666,666 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñShò Shpk, me ofertë 9,190,900 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 17.02.2021, me afat 2 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 7,475,766 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 23.12.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 12 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 11 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Procedura është në përputhje me rregullat e LPP

32. Tenderi me objekt: "Rikonstruksion i rrugës nga Autostrada Levan Tepelenë - Ninësh" Viti 2020, me këto të dhëna:

32. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i rrugës nga Autostrada Levan Tepelenë - Ninësh"		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.2639/2 regj, datë 17.11.2020 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.2639/2 regj, datë 17.11.2020 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. M. M ï (Ing.Nd.-Spec. i fushës) 3. A. R ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.523, Datë 17.11.2020 1. Z. M (Kryetar) 2. A. X (Anëtar) 3. Q. S (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 29,996,424 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE ñEò Shpk & ñJò Shpk, me ofertë 14,080,055 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 19.02.2021, me afat 3 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 15,916,369 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 28.12.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 13 OE

		b)Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 10 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Procedura është në përputhje me rregullat e LPP

Procedurat e vitit 2021

Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.
Për periudhën 01/01/2021 ï 31/12/2021, nga Bashkia Mallakastër referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **15** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 673,346 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 624,360 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 48,986 mijë lekë pa TVSH ose 7.3 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2021-31.12.2021	Nr.	Vl. Fond Limit	Vl. Kontrate
Gjithsej	**15**	**673,346,280**	**624,360,133**
- Të hapura	6	642,843,721	598,030,329
- Kërkesë me propozim/E hapur e thjeshtuar	9	30,502,559	26,329,804
Sipas objekteve	**15**	**673,346,280**	**624,360,133**
- Objekte në fushën e investimeve	5	581,223,738	540,965,569
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	10	92,122,542	83,394,564

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **72** OE/BOE, nga të cilat janë sôkualifikuar **32** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE është gjithsej **1** procedura ose 13 % e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 7 ose 53% e tyre, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuara nga AK Bashkia Mallakastër janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të operatorëve të kualifikuar.
- Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit nga **15** procedura prokurimi të zhvilluara me vlerë kontrate 624,360 mijë lekë, vlerësoj për auditimin e **7** procedurave me vlerë kontrate 604,888 mijë lekë ose 97.5% e vlerës së kontratave të lidhura.
-Në të gjitha procedurat e audituara, konstatohet se nga KVO janë mbajtur procesverbalet për hapat e zhvillimit të procedurës, veprime në përputhje me nenin 64 pika 5 dhe nenit 68 të VKM nr. 914, datë 27.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, i ndryshuar.
- Nga auditimi i **7** procedurave me vlerë kontratë 624,360 mijë lekë, u konstatua se janë në shkelje të akteve ligjore/ nënligjorë të LPP, gjithsej **3** procedura të audituara, ku në **2** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **2**rast OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mallakastër, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, në vlerën **69,345 mijë lekë** pa TVSH, veprime në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, të ndryshuar, **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT dhe KVO sipas procedurave,** *si më poshtë vijon*:

33. Tenderi me objekt: "Blerje materiale të ndryshme, çakull, stabilizant, rërë bituminoze për mirëmbajtje rruge në fshatra, për nevoja të NSHP" Viti 2021, me këto të dhëna:

33. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje materiale të ndryshme, çakull, stabilizant, rërë bituminoze për mirëmbajtje rruge në fshatra, për nevoja të NSHP"

1.Urdhër Prokurimi : Nr.565 regj, datë 02.03.2021 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.565 regj, datë 02.03.2021 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. M. M ï (Ing.Nd.-Spec. i fushës) 3. A. R ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.62, Datë 02.03.2021 1. E. B (Kryetar) 2. A. X (Anëtar) 3. Q.S (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 40,833,333.33 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñSHò Shpk,me ofertë 34,359,033 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 21.05.2021, me afat 3 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 6,474,300.33 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 29.03.2021	9.Burimi Financimit: Buxheti i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b)Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, vlerësimin e ofertave.
Vlerësimi i ofertave: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 64, pika 5, dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar. Miratimi i raportit përmbledhës është bërë me vendimin nr. 565/4, datë 06.05.2021.
1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** lidhur me kërkesën për të paktën 1 karrierë çakulli. Në rast disponimi me kontratë furnizimi, kërkohet ndër të tjera të përcaktohet në kontratë *emërtimi i objektit që prokurohet, sasitë, afati i lëvrimit dhe deklarata e garancisë së prodhuesit i cili të jetë i pajisur me leje mjedisi Kodi III.1.B të lëshuar nga QKL.* Për të përmbushur këtë kriter, OE ka paraqitur kontratën e furnizimit lidhur me subjektin ñV. Llò SHPK me datë 16.03.2016, e cila nuk vjen sipas kërkesës së vendosur në DST. Nuk është përcaktuar objekti e prokurimit, sasitë dhe afatin e lëvrimit, si dhe nuk është paraqitur deklarata e garancisë së prodhuesit. Është paraqitur gjithashtu kontratë e lidhur me subjektin ñBò shpk që mban datën 26 nëntor 2013 për materialet çakull, të cilës i mungojnë përcaktimet sipas kërkesës në DST lidhur me objektin e kontratës, sasitë, afatin e lëvrimit, deklaratën e garancisë si dhe lejen e mjedisit Kodi III.1.B e cila nuk disponohet.
2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST** lidhur me kërkesën për të paktën 1 pikë/impiant për nxjerrje dhe përpunim të rërës bitumiznoze. Në rast disponimi me kontratë qiraje ose kontratë furnizimi, kërkohet ndër të tjera të përcaktohet në kontratë *emërtimi i objektit që prokurohet, sasitë dhe afati i lëvrimit...* Për të përmbushur këtë kriter, OE ka paraqitur kontratën e furnizimit lidhur me subjektin ñAò SHPK të datës 30.08.2018, e cila nuk vjen sipas kërkesës së vendosur në DST, qoftë me objektin e prokurimit, sasitë dhe afatin e lëvrimit. Mungon deklarata e garancisë së prodhuesit si dhe leja e mjedisit Kodi III.1.B. Gjithashtu është paraqitur edhe kontrata me subjektin ñCò e datës 29.08.2020 e cila nuk vjen sipas kërkesës së vendosur në DST, qoftë me objektin e prokurimit, sasitë dhe afatin e lëvrimit. Mungon edhe deklarata e garancisë së prodhuesit.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe në vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *anëtarët e KVO z. E. B, z. A. X dhe z. Q. S.*
Ndikimi/Efekti: Prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E-[të]) në vlerën **34,359 mijë lekë** pa TVSH**.**
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Akt Konstatimin Nr. 12, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i

administruar në KLSH me nr. 57/4 prot., datë 04.04.2022 si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
1.Lidhur me pikën 1, sqarojmë se **O.E** sh.p.k ka paraqitur kontratën e furnizimit të lidhur me subjektin ñLlò shpk, e cila ka si aktivitet përpunim guri si dhe prodhim i të gjitha llojeve të inerteve dhe materialeve të ndërtimit dhe Tregtim me shumicë e pakicë é .Në Kontratën e lidhur midis palëve me datë 16.03.2016 para Noterit shkruhet qartë ***se Shoqëria V. LL SHPK do të furnizojnë me materiale inerte të të gjitha kategorive që ajo prodhon dhe tregton, sipas kërkesave dhe nevojave që do të ketë shoqëria "SH" Shpk. Afati i kontratës është 10 (DHJET) vjeçar, që përfundon në datën 14.03.2026***. Bashkëlidhur kësaj kontrate ndodhet dhe leja e mjedisit Kodi III.1.B. Nisur nga kontratat e lidhur midis palëve, si dhe kushtet e vendosura ne këtë kontrate KVO vlerëson se OE fitues e ka përmbushur kriterin e mësipërm gjithashtu vlerësojmë se përderisa OE fitues e kishte një kontratë furnizimi e cila është brenda afatit të realizimit të furnizimit të materialeve të objektit që prokurohet , kjo kontratë është e mjaftueshme.
2.Lidhur me pikën 2, sqarohet se **O.E SH** sh.p.k ka paraqitur kontratën e furnizimit të lidhur me subjektin ñCò shpk , e cila ka si aktivitet nxjerrjen ,përpunim dhe Tregtim me shumicë e pakicë të rërave bituminoze në zonën e Kasnicës é .Në Kontratën e lidhur midis palëve me datë 29.08.2020 para Noterit , shkruhet qartë se Shoqëria ñCò shpk do të furnizojë me rërë bituminoze, sipas kërkesave dhe nevojave që do të ketë shoqëria "SH" Shpk. Afati i kontratës është 5 (pesë) vjeçar, që përfundon në datën 28.08.2025 . Bashkëlidhur kësaj kontratë ndodhet dhe leja e mjedisit Kodi III.1.B . Pra objekti në këtë kontratë është furnizim me rërë bituminoze e cila korrespondon e njëjtë me objektin e prokurimit. *(bashkëlidhur Kontrata).* Nisur nga kontrata e lidhur midis palëve, si dhe kushtet e vendosura në këtë kontratë KVO vlerëson se OE fitues e ka përmbushur kriterin e mësipërm, gjithashtu vlerësojmë se përderisa OE fitues e kishte një kontratë furnizimi e cila është brenda afatit të realizimit të furnizimit të materialeve të objektit që prokurohet kjo kontratë është e mjaftueshme.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

34. Tenderi me objekt: "Blerje mjetesh: Dy kamionë me 3 akse 3 diferenciale dhe dy kamionçina 4x4, për nevoja të NSHP" Viti 2021, me këto të dhëna:

34. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje mjetesh: Dy kamionë me 3 akse 3 diferenciale dhe dy kamionçina 4x4, për nevoja të NSHP"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.752 regj, datë 23.03.2021 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.752 regj, datë 23.03.2021 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A.H-(Ing.M-Sp. fushës) 3. A.R ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.78, Datë 23.03.2021 1. E. B. (Kryetar) 2. A. X (Anëtar) 3. Q.S (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 10,833,333 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñS ò Shpk, me ofertë 10,688,000 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 28.05.2021, me afat 30 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 145,333 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 19.04.2021	9.Burimi Financimit: Buxheti i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar - OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Procedura e ndjekur është në përputhje me rregullat e LPP.

35. Tenderi me objekt: "Ndërtimi i linjës së transmetimit të rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Rajonal (nga Burimi i Poçemit)" Viti 2021, me këto të dhëna:

35. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtimi i linjës së transmetimit të rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Rajonal (nga Burimi i Poçemit)"		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.4, datë 25.03.2021 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.777 regj, datë 25.03.2021 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. M.Mï (Ing.Nd.-Spec. i fushës) 3. A. R ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.81, Datë 25.03.2021 1. E. B (Kryetar) 2. A. X (Anëtar) 3. Q. Sj (Anëtar)s
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 486,002,541 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE ñAò Shpk & ñEò Shpk & ñKò Shpk, me ofertë 479,375,637.27 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 06.07.2021, me afat 11 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 6,626,904 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 29.04.2021	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, ć Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

<u>Titulli i gjetjes:</u>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave.

<u>Situata:</u> Vlerësimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST**, e cila kërkon të punësuar staf prej 220 punonjës për periudhën Nëntor 2019-Prill 2020, është kërkesë e paargumentuar nga AK. Nuk është bërë asnjë analizë dhe përllogaritje për të nxjerrë përfundimin se duhet kërkuar ky numër punonjësish, që është relativisht i lartë. AK duhet ti referohet në çdo rast VKM-së me nr. 629, datë 15.07.2015 ñ*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*ò, ku të përcaktojë me saktësi inxhinierike, volumet metrike me krahë dhe me makineri, VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008 ñ*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimit*ò Kreut III, ku parashikohet shprehimisht se: AK në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në DT të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve për periudhën 22 mars ï 23 tetor me 2 turne, për ndërtimin e objekteve në lartësi, dhe me 3 turne për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtimeve të tjera.

Nga AK, është e rëndësishme të provohet disponimi i numrit të nevojshëm të punonjësve nga ana e OE, por përcaktimi i numrit duhet të vijë pas një analize gjithëpërfshirëse të gjithë elementëve, përfshirë edhe nenin 78, pika 1 dhe 4 të Kodit të Punës, që përcakton kohëzgjatjen normale të ditës së punës 8 orë, nenin 83 që përcakton 40 orët e punës në javë, etj., por në respekt të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM-së nr. 914..., kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

2.Kërkesa e pikës **2.3.6 e DST** e cila kërkon 2 inxhinierë ndërtimi, 2 inxhinier hidroteknik, 2 inxhinierë gjeodët/gjeomatik/topograf/markshajder si drejtues teknik në licencën e shoqërisë, dhe 1 inxhinier telekomunikacioni/elektronik, janë kërkesa fryra dhe të paargumentuara. Së pari, kërkesa për nga 2 inxhierë drejtues teknik për profil, është e tepërt dhe kufizuese, pasi shoqëri në fushën e ndërtimit mund të disponojnë profilet e mësipërme si staf mbështetës në listëpagesat e tyre, por jo domosdoshmërisht drejtues teknik. Kërkesa e mësipërme, duhej të minimizohej me nga 1 drejtues teknik, dhe pjesa tjetër të mbulohej me staf mbështetës në fushën inxhnierike të kërkuar. Së dyti, kërkesa për 1 inxhinier telekomunikacioni/elektronik

është jo në përputhje me natyrën e punës dhe nuk ka zëra konkret për të kërkuar ekspertizën e tyre, dhe aq me pak për ta kërkuar edhe si drejtues teknik në licencën e shoqërisë. Përbën kriter kufizues.

3.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon 2 ekspertë me kontratë të rregullt pune të pajisur me licencë zbatimi për veprimtari arkeologjike, është kërkesë e tepërt dhe kufizuese për OE. Së pari, vlerësimi mbi ekspertizën arkeologjike përcaktohet që në hartimin e projektit, ku është kërkuar ekspertiza e nevojshme e ekspertit për arkeologjinë, dhe në këto kushte është e tepërt kërkesa për ekspert arkeologjie, dhe aq më pak 2 të tillë. Së dyti, kërkesa që OE, të disponojnë 2 ekspertë me licenca të tilla, përbën njëkohësisht kufizim për OE, pasi AK nuk ka përkufizuar saktë mënyrën e disponimit të tyre, duke përcaktuar vetëm me kontratë të rregullt pune. AK do duhej të përcaktonte mundësinë e një kontratë shërbimi për OE për ekspertizën e mësipërme.

5.Kërkesa e pikës **2.3.10 e DST** e cila kërkon nga OE të kenë pjesë të stafit drejtues teknik të pajisur me certifikatë ISO 9001: 2015 dhe të figurojë në listëpagesa 6 muajt e fundit, është kërkesë e paargumentuar nga AK, dhe konsiderohet kufizuese për OE. Së pari, është kërkuar nga NJP disponimi i certifikatës ISO 9001:2015 për shoqërinë ofertuese, dhe kërkesa të disponohet edhe nga 1 inxhinier drejtues teknik, është e kërkesë e dublikuar, e fryrë e cila nuk i shërben AK. Fakti që disponohet nga shoqëria, konsiderohet se përmbush kushtet sipas objektit të kësaj certifikate. Gjithashtu, kërkesa që të jetë edhe drejtues teknik, dhe në listëpagesa të paktën 6 muajt e fundit, janë njëkohësisht kërkesa kufizuese për OE.

6.Kërkesa e pikës **2.3.13 e DST** e cila kërkon 1 mjek, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 ñ*Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*ò, pika 1 ku përcaktohet se:

ñ*Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:*
*"6. Punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C" dhe "D", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë."*ò

7.Kërkesa e pikës **2.3.16 e DST** e cila kërkon nga OE mjetet dhe pajisjet teknike për realizimin e punimeve, ka kërkuar ndër të tjera 7 kamionë me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton, 6 kamionë mbi 12 Ton dhe maksimumi 20 Ton, 4 kamionë 3.5 deri 5 Ton, 2 kamionçina 1.5 deri 2 Ton; Ka kërkuar 3 autovinxh 7 deri 10 Ton; 6 ekskavatorë me zinxhirë 1 ekskavator me çekiç pneumatik dhe 2 ekskavatorë me goma, 4 miniekskavatorë dhe 2 minifadroma; 2 fadroma me kova para dhe mbrapa si dhe 5 autobetoniere.

Sa më sipër, AK nuk ka argumentuar numrin e lartë të këtyre mjeteve, duke përcaktuar nevojat konkrete në raport me volumin e punimeve, grafikun dhe afatin e tyre. Gjithashtu numri i lartë i mjeteve të gërmimit, 17 copë, është relativisht i lartë, ndërkohë është detyrë e NJHDT të kryente një analizë për të përcaktuar numrin e tyre.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe në vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *Specialistët e fushës për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, z. M. M.*

Ndikimi/Efekti: Ndikon në numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga specialisti i fushës, anëtarë i NJHDT është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:
1.Lidhur me mungesën stafin e punësimit prej 220 punonjës, sqarohet se është në përputhje me volumet dhe përmasat që ka kantieri i ndërtimit. Kjo kërkesë është e lidhur ngushtë edhe me afatin prej 11 muajsh që garanton AK për zbatimin e kontratës brenda afatit të parashikuar. Kjo kërkesë është bazuar në në objekte të ngjashme zhvilluar një vit më parë, ku janë kërkuar 220 punonjës për punime që shtihen për 24 muaj. Është i justifikueshëm ku numër në raport me grafikun 11 mujor.
2.Lidhur me kërkesën për stafin drejtues ku janë kërkuar nga 2 drejtues teknik për disa kategori inxhinierësh, dhe 1 inxhinier telekomunikacioni, sqarohet se kjo është kërkuar në raport me përmasat që ka kantieri i ndërtimit. Proceset e punës e diktojnë kërkesa të tilla. Për inxhinierin e telekomunikacionit, është kërkuar për zbatimin e punimeve të kësaj natyre të parashikuara në preventiv.
3.Lidhur me kërkesën për 2 ekspertë që disponojnë licencë zbatimi për veprimtari arkeologjie, është vendosur duke mbajtur në konsideratë zonën në të cilën do realizohet ky projekt, ku respektivisht ndodhen sitet arkeologjike si Parku i Bylisit dhe qytei antik Nikaia.
4.Lidhur me kërkesën për drejtuesin teknik të pajisur me certifikatë ISO 9001:2015, është vendosur për të garantuar AK se OE disponon staf të përgatitur dhe me kualifikimet e duhura sa i përket kontrollit dhe cilësisë së punimeve gjatë implementimit të projektit.
5. Lidhur me kërkesën për mjek, sqarohet se kjo është kërkesë në përputhje me VKM-në nr. 312, datë 5.5.2010 ñPër miratimin e rregullores për sigurinë në kantier, përcaktohet në aneksin 5 marrja e mendimit të mjekut kompetent. Në vijim të këtij aneksi, sqarohet se kontrolli shëndetësor kryhet nga mjeku kompetent.
6.Lidhur me kërkesën për numrin e lartë të mjeteve, sqarohet se janë kërkuar pasi janë të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate, janë vendosur duke ju referuar zërave dhe natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv. Nevoja për këto mjete është edhe për shkak të periudhës 11 mujore për përfundimin e punimeve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 12 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

36. Tenderi me objekt: "Rikonstruksion i rrugës Bejar – diga e rezervuarit" Viti 2021, me këto të dhëna:

36. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i rrugës Bejar – diga e rezervuarit"		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.6 regj, datë 29.03.2021 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.815 regj, datë 29.03.2021 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. M. M ï (Ing.Nd.-Spec. i fushës) 3. A. Rï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.86, Datë 29.03.2021 1. E. B (Kryetar) 2. A. X (Anëtar) 3. Q.S (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 59,394,361.54 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE ñKò Shpk & ñCò Shpk, me ofertë 34,986,000 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 19.08.2021, me afat 6 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 24,408,361.54 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 30.04.2021	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 7 OE b)Skualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11.Ankimime AK, Ka/Nuk ka (nëse ka nr. date ankese dhe ankimues) - Ankesë nga OE ñò shpk, protokolluar në bashki me	12. Përgjigje ankesës nga AK, Ka/Nuk ka (nëse ka nr. date ankese dhe ankimues) - Shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga OE ñShò Shpk nr.1293/2 regj, datë 26.05.2021.	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka/Nuk ka (nëse ka nr. date) - Vendimi K.P.P. Nr.360/2021, Datë

nr.1293 regj, datë 24.05.2021.		13.07.2021, protokolluar në bashki me nr.1424/2 regj, datë 22.07.2021.

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave.

Situata: Vlerësimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.3 e DST**, e cila kërkon të punësuar staf prej 80 punonjës për periudhën Shtator 2020 ï Shkurt 2021, është kërkesë e paargumentuar nga AK. Nuk është bërë asnjë analizë dhe përllogaritje për të nxjerrë përfundimin se duhet kërkuar ky numër punonjësish, që është relativisht i lartë. AK duhet ti referohet në çdo rast VKM-së me nr. 629, datë 15.07.2015 ñ*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*ò, ku të përcaktojë me saktësi inxhinierike, volumet metrike me krahë dhe me makineri, VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008 ñ*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimit*ò Kreut III, ku parashikohet shprehimisht se: AK në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në DT të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve për periudhën 22 mars ï 23 tetor me 2 turne, për ndërtimin e objekteve në lartësi, dhe me 3 turne për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtimeve të tjera.

Nga AK, është e rëndësishme të provohet disponimi i numrit të nevojshëm të punonjësve nga ana e OE, por përcaktimi i numrit duhet të vijë pas një analize gjithëpërfshirëse të gjithë elementëve, përfshirë edhe nenin 78, pika 1 dhe 4 të Kodit të Punës, që përcakton kohëzgjatjen normale të ditës së punës 8 orë, nenin 83 që përcakton 40 orët e punës në javë, etj., por në respekt të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM-së nr. 914..., kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

2.Kërkesa e pikës **2.3.6 e DST** e cila kërkon 12 shoferë...të siguruar të paktën 3 muajt e fundit, është kërkesë kufizuese për OE. Në DST është kërkuar që mjetet e nevojshme të mundësohen edhe me qira, dhe në këto kushte, mund të mundësohej edhe disponimi i shoferit, pasi kërkesa që ata të jenë në listëpagesa 3 muajt e fundit, pamundëson kontraktimin e tyre për të kryer këtë shërbim.

3.Kërkesa e pikës **2.3.6 e DST** e cila kërkon 1 inxhinier pjesë të stafit drejtues i pajisur me kualifikim si ñ*Koordinator për sigurinë në kantier*ò dhe të jetë i pajisur me certifikatë për kontrollin e cilësisë sipas standardit ISO 9001:2015..., është kërkesë e tepërt dhe e dubluar, pasi njëkohësisht është kërkuar nga OE të disponojnë si shoqëri certifikatën e mësipërme.

4.Kërkesa e pikës **2.3.6 e DST** e cila kërkon 1 inxhinier ndërtimit dhe 20 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është kërkesë e paargumentuar nga AK, pasi nuk ka specifikuar specialitetin e këtyre punonjësve, duke e lënë evazive dhe në këto kushte e bën një kërkesë e cila nuk i shërben AK.

5.Kërkesa e pikës **2.3.6 e DST** e cila kërkon një ekspert zjarrfikës, është kërkesë e paargumentuar nga AK, pasi nga tipologjia e punimeve, nuk rezultojnë zëra apo procese për të cilat të jetë e nevojshme ekspertiza për ekspert zjarrfikës.

6.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon 1 mjek, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 ñ*Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*ò, pika 1 ku përcaktohet se:

ñ*Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:*
"6. Punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të

*punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C" dhe "D", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë."*ò

Vlerësimi i ofertave: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 64, pika 5, dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar. Miratimi i raportit përmbledhës është bërë me vendimin nr. 1424/5, datë 28.07.2021.

1.OE ñCò shpk, i cili ka marrë përsipër kryerjen e 36.28 nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.2 të DST** lidhur me kategorinë e punimeve NS-18, të cilën nuk e disponon në licencën e shoqërisë.

2.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST** e cila kërkon nga OE 12 drejtues mjetesh (shoferë)... të cilët të jenë figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 muajt e fundit. Kriterin e mësipërm e përmbush vetëm njëri nga shoferët e deklaruar, konkretisht B.S, ndërkohë gjithë shoferët tjerë kanë mangësi pasi shoferët A.B, O. Ç, B. A, Sh. A, B. T, N. C, A. P, I. C, A. Q dhe R. H, nuk figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit. Konkretisht në listëpagesat e fundit të paraqitura ato të muajve Dhjetor 2020, Janar ï Shkurt 2021, nuk figurojnë, ndërkohë edhe kontratat e lidhura me ta, janë të datës 29.04.2021, vetëm 1 ditë përpara hapjes së ofertave nga KVO. Gjithashtu, disa prej tyre si Bashkim Ahmati dhe B. T kanë lejet e drejtimit jashtë afateve të vlefshmërisë, ndërkohë që për A.Q është paraqitur vetëm dëshmia për automakinist dhe jo për shofer.

3.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.11 të DST** e cila kërkon nga OE ofertues që të jenë të pajisur me licencë nga QKL, Kodi III.2.B ñTransportimi i mbetjeve jo të rrezikshme nga ndërtimet dhe prishjetò. Asnjëri nga BOE nuk e disponon licencën e mësipërme, sipas kërkesës së DST.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe në vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *Specialisti përgjegjës për hartimin e kritereve të veçanta z. M.M dhe,* si dhe *anëtarët e KVO z. E. B, z. A.X dhe z. Q. S.*

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **34,986 mijë lekë** pa TVSH**.**

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga Specialisti përgjegjës për hartimin e kritereve të veçanta është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1.Lidhur me fuqinë punëtore të kërkuar prej 80 punonjës, sqarohet se është vendosur për të garantuar autoritetin për realizimin e punimeve objekt kontrate. Kjo kërkesë vlerësohet si garanci për AK e cila konsiston në qëndrueshmërinë e fuqisë punëtore e të kapaciteteve të burimeve njerëzore të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate. Kjo kërkesë përputhet dhe është në harmoni me volumet dhe me grafikun e punimeve të zbatimin të parashikuar për 6 muaj.

3.Lidhur me kërkesën për 12 shoferë, sqaron se ky numër ka të bëjë me numrin e lartë të mjeteve të kërkuara për realizimin e punimeve. Është gjykuar se shoqëria ofertuese të ketë minimalisht 12 shoferë të siguruar për 3 muajt e fundit, gjë e cila jep garancinë e nevojshme se OE ka një staf të qëndrueshëm në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

4.Lidhur me koordinatorin për sigurinë në kantier me kualifikim për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë me ISO 9001:2015, sqarohet se është vendosur për të garantuar AK se OE disponon staf të përgatitur dhe me kualifikimet e duhura sa i përket sigurisë në kantier si dhe kontrollit dhe cilësisë së punimeve.

5.Lidhur me kërkesën për 1 inxhinier dhe 20 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit

teknik dhe 1 ekspert zjarrfikës, lidhet me punimet që do kryejë në kantier stafi që do të angazhohet me zbatimin e tyre, të cilët duhet të kenë dëshmitë dhe kualifikimet e nevojshme. Duke qenë se ndër materialet që përdoret janë me bazë hidrokarbure, në temperatura të larta ekziston rreziku i ndezjes dhe për këtë qëllim është kërkuar nga OE të kenë një punonjës me dëshmi apo kualifikim si ekspert zjarrfikës.
6.Lidhur me kërkesën për mjek, sqarohet se kjo është kërkesë në përputhje me VKM-në nr. 312, datë 5.5.2010 ñPër miratimin e rregullores për sigurinë në kantier, përcaktohet në aneksin 5 marrja e mendimit të mjekut kompetent. Në vijim të këtij aneksi, sqarohet se kontrolli shëndetësor kryhet nga mjeku kompetent.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 12 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
1.Lidhur me kategorinë e punimeve N.S ï 18 , të cilën nuk e disponojnë në licencën e shoqërisë. **Sqarojmë se:** BOE ñ Kò shpk & ñ Cò shpk , sipas dokumentacionit të paraqitur ne ditën e tenderit , BOE ka licencë zbatimi me kategorinë e punimeve N.S ï 18 . Konkretisht shoqëria ñ K.ò shpk si pjesë BOE, është e pajisur me Licencë zbatimi me NR. 000195 , NZ.7591/7 , pa afat kohor , dhe kjo licencë përmban kategorinë e punimeve N.S ï 18 C . *(ndodhet bashkëlidhur).*
2. Nga shqyrtimi i ofertës fituese Komisioni i KLSH i cili ka audituar, konstaton se **BOE "K" shpk & " C" shpk** nuk i përmbush kriteret si më poshtë:
Nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.11 të DST e cila kërkon nga OE ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), Kodi III.2.B ñTransportimi i mbetjeve jo të rrezikshme nga ndërtimet dhe prishjetò.
Sqarojmë se Për përmbushjen e kësaj kërkese nga BOE, është paraqitur Akt-Marrëveshje noteriale e lidhur me një palë të tretë të kontraktuar, ku ndër të tjera ka për objekt edhe ofrimin e shërbimit lidhur me transportin e mbetjeve për të cilat kërkohet licencë specifike nga QKL, konkretisht me kod III.2.B, e cila zotërohet nga pala e kontraktuar.
Në plotësimin e kësaj kërkese, KVO vlerëson se thelbi dhe synimi i saj është garantimi i Autoritetit Kontraktor për minimizimin e impaktit negativ mjedisor, i cili lidhet me shërbimin e heqjes dhe transportimit të mbetjeve që dalin nga procesi i ndërtimit, me destinacion depozitimin e tyre në vende të autorizuara. Fakti që ky shërbim disponohet nga ofertuesi me kontraktim, ia jep garancinë e nevojshme Autoritetit Kontraktor për minimizimin e impaktit negativ mjedisor, dhe pikërisht për këtë arsye, KVO e konsideron si një devijim të vogël e të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, bazuar në pikën 4, të nenit 53, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Sa më sipër, BOE "K." shpk & "C" shpk, me dokumentacionin e paraqitur, vërteton se është në përputhje me kërkesat për kualifikim dhe besojmë se Oferta e tij është në përzgjedhjen e një oferte më të mirë ekonomike-teknike. (dok bashkelidhur)
3. Lidhur kriterin e pikës 2.3.6 të DST e cila kërkon që Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 12 (dymbëdhjetë) drejtues automjetesh (shoferë), shoqëruar me lejen/dëshminë përkatëse, kontratë pune të vlefshme, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.
A.B , me profesion Drejtues mjetesh dhe me kontratë të lidhur në datë 29.04.2021, dhe me afat 6 muaj , O. C , me profesion Drejtues mjetesh dhe me kontratë të lidhur në datë 29.04.2021 , dhe me afat 6 muaj , B.A, me profesion Drejtues mjetesh dhe me kontartë të lidhur në datë 29.04.2021 , dhe me afat 6 muaj, Sh. A, me profesion Drejtues mjetesh dhe me kontratë të lidhur në datë 29.04.2021 , dhe me

afat 6 muaj ,B. T, me profesion Drejtues mjetesh dhe me kontakte të lidhur në datë 29.04.2021 , dhe me afat 6 muaj, N. C, me profesion Drejtues mjetesh dhe me kontratë të lidhur në datë 29.04.2021 , dhe me afat 6 muaj, A. P, me profesion Drejtues mjetesh dhe me kontratë të lidhur në datë 29.04.2021 , dhe me afat 6 muaj, I. C , me profesion Drejtues mjetesh dhe me kontratë të lidhur në datë 29.04.2021 , dhe me afat 6 muaj, A. Q , me profesion Drejtues mjetesh dhe me kontratë të lidhur në datë 29.04.2021 , dhe me afat 6 muaj, R. H , me profesion Drejtues mjetesh dhe me kontratë të lidhur në datë 29.04.2021, dhe me afat 6 muaj, B. S , me profesion Drejtues mjetesh dhe me kontratë të lidhur në datë 05.01.2021 , dhe me afat deri në 02.01.2024. Theksojmë se 10 nga punonjësit e mësipërm kanë kontratë të lidhur në datë 29.04.2021 , dhe me afat 6 muaj dhe sipas kësaj kontrate këta Drejtues mjetesh do të punojnë ne zbatimin e punimeve në objektin e mësipërm , KVO vlerëson se OE kanë të drejtë të lidhin kontratë me punonjës edhe me objekt të veçantë, duke mos qenë nevoja e të qenit në listëpagesën e tre muajve të fundit. Gjithashtu BOE ka paraqitur në dokumentet e tenderit 10 kamionë të marra me qira dhe sipas kontratës së qirasë ai mund të mundësoj edhe disponimin e shoferave.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 12 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

37. Tenderi me objekt: "Blerje karburant (Diezel) viti 2021ò Viti 2021, me këto të dhëna:

37. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje karburant (Diezel) viti 2021"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.1127/3 regj, datë 11.05.2021 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.1127/3 regj, datë 11.05.2021 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A. H-(Ing.M-Sp. fushës) 3. A. R ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.122, Datë 11.05.2021 1. E. B (Kryetar) 2. A. X (Anëtar) 3. Q. S (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 16,851,666.7 lekë pa tvsh *nga të cilat:* *1,666,666.7 – Bashkia* *15,185,000 – NSHP*	6.Oferta fituese: OE ñNò Shpk, me marzh 9.3 %, me lidhje kontrate (Bashkia + NSHP) datë 24.06.2021, me afat 12 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 0 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 04.06.2021	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë dhe Buxheti i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

<u>Titulli i gjetjes:</u>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e fondit limit.
Situata: 1.Komisioni i ngritur sipas urdhrit nr. 117, datë 06.05.2021 për përllogaritjen e sasisë vlerës limit dhe afatit të lëvrimit për blerjen e karburantit që do prokurohet për vitin 2018, nuk ka dokumentuar metodikën e ndjekur për përllogaritjen e fondit limit, duke mos ju përmbajtur kritereve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar.
<u>Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179</u>
<u>Kriteri:</u> Trajtuar tek situata e gjetjes.
<u>Shkaku:</u> Mos angazhimi në komisione i personave të kualifikuar.
<u>Ndikimi/Efekti:</u>Risku i përllogaritjeve të gabuara të sasive dhe vlerës së shpenzuar për karburanti.

Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Titullari i AK, të krijojë komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, duke angazhuar personel të kualifikuar, dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e komisionit A. H, F.E, A. B.

38. Tenderi me objekt: "Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara" Viti 2021, me këto të dhëna:

38. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.2431 regj, datë 13.09.2021 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapurò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.2431 regj, datë 13.09.2021 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. M. M ï (Ing.Nd.-Spec. i fushës) 3. A. R ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.230, Datë 14.09.2021 1. E. B (Kryetar) 2. A.X (Anëtar) 3. G. J (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 28,928,485 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE ñGò Shpk, me ofertë 21,769,992 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 24.12.2021, me afat 12 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 7,158,493 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 07.12.2021	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit + Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 14 OE b)Skualifikuar 6 OE, c) Kualifikuar 8 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Procedura është në përputhje me rregullat e LPP.

39. Tenderi me objekt: "Mirëmbajtje e mjeteve të transportit viti 2021" Viti 2021, me këto të dhëna:

39. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Mirëmbajtje e mjeteve të transportit viti 2021"		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.13 regj, datë 25.10.2021 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñE hapur e thjeshtuarò	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.3169 regj, datë 25.10.2021 1. B. F ï (Jurist-PPP) 2. A. H-(Ing.M-Sp. fushës) 3. A. R ï (Ekonomist-Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.281, Datë 25.10.2021 1. E. B (Kryetar) 2. A. X (Anëtar) 3. G.J (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 6,990,880 lekë pa tvsh *nga të cilat:* *1,074,600 – Bashkia* *5,916,280 – NSHP*	6.Oferta fituese: OE ñFò Shpk, me ofertë 6,857,700 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate datë 28.12.2021, me afat 12 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 133,180 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 01.12.2021	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë dhe Buxheti i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Procedura është në përputhje me rregullat e LPP.

2.4.4. Auditim mbi hartimin e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomike fitues.

2.4.5. Auditim mbi zbatimin e kushteve në realizimin e punimeve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera në kontratat e lidhura me operatorët ekonomike fitues

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit në Bashkinë Mallakastër, nga audituesit e KLSH-së z. A. Z dhe z. J. P u krye auditimi i zbatimit të punimeve në objektet:

1. "*Ndërtim shëtitore nga shkolla "Odisea"deri tek varrezat e qytetit*"", Bashkia Mallakastër.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1604 prot datë 17.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër, të përfaqësuar nga Titullari z. Q.I dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë ñShò SHPK, me administrator z. Y.B, me licencë profesionale respektivisht NZ 3580/17 & ñAò SHPK, me administrator z. A.B,me licencë profesionale respektivisht NZ 3785/10. Vlera e kontratës është 27,131,706 lekë me TVSH, me financim nga Bashkia Mallakastër. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 210 ditë, nga data e fillimit të punimeve.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 55/1 prot, datë 05.07.2019, është lidhur kontrata me BOE ñIò SHPK me përfaqësues L. L, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2406/1 & ñLòSHPK, me përfaqësues N. P, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0985/6 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 512,675 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1751 prot., datë 08.08.2019, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi OE ñSò SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3244, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 69,533 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, me Urdhërin nr. 546 datë 21.12.2020 të kryetarit të Bashkisë Mallakastër, nga grupi i punës me përbërje ing. M. M, ing. A.X dhe ing. B.V, të cilët kanë hartuar certifikatën e marrjes së përkohshme në dorëzim të objektit në datën 22.12.2020.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje infrastrukturore, me nr. 1424/2 prot, datë 16.07.2019.
- Projekti i zbatimit është hartuar nga OE ñEò SHPK në vitin 2019.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 18.07.2019 dhe kanë përfunduar me datë 13.02.2020, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Me shkresën pa nr. prot, datë 22.07.2019, sipërmarrësi i punimeve ka relatuar për domosdoshmërinë e ndryshimeve në projektpreventivin fillestar. Pas shqyrtimit të këtij relacioni, Mbikëqyrësi i punimeve i ka dërguar investitorit Bashkia Mallakastër kërkesën për miratimin e preventivit të ndryshuar (tabelës së balancimit të punimeve). Pas kësaj kërkese, është hartuar dhe miratuar ñProcesverbali mbi ndryshimet në objektò, i nënshkruar edhe nga ish Kryetari i Bashkisë Mallakastër, z. A. K. Sipas këtij procesverbali punimet që shtohen/pakësohen, janë në vlerë 9,895,790 lekë pa TVSH (përfshirë fondin rezervë 1,076,655 lekë pa TVSH).
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Ndërtim shëtitore nga shkolla "Odisea" deri tek varrezat e qytetit", Bashkia Mallakastër				
14.Lidhja e kontratës Nr. 1604 prot, datë 17.07.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 27,131,706 lekë BOE fitues ñShò SHPK, & ñAò SHPK		16.Likuiduar deri dt	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 27,131,706 lekë -Vlera pa tvsh 22,609,755 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 210 ditë, Zbatuar 207 ditë. Fillimi punimeve: 18.07.2019 Perfundimi punimeve : 13.02.2020		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE ñIò SHPK & ñLò SHPK	Licenca Nr: MK 2406/1 MK. 0985/6	Kontrata me nr. 55/1 prot, datë 05.07.2019	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve OE ñSò SHPK	Licenca Nr: MK 3244	Kontrata nr. 1751 prot., datë 08.08.2019	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 18.03.2020	23.Akt i marrjes në dorëzim dt 22.12.2020		24. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **621,602 lekë pa tvsh**.

Titulli i gjetjes: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin ñ*Ndërtim shëtitore nga shkolla "Odisea"deri tek varrezat e qytetit*ò, Bashkia Mallakastër, nga zbatuesi i punimeve BOE ñShò Shpk, & ñAò Shpk, për zërat e punimeve I.3.8, I.4.4, III.6 dhe IV.2.3.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

- Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës ñFV bordura betoni parafabrikat 20x35, çmimiò, ñMur betoni C 16/20ò, ñFV puseta betoni me kapak gize në trotuar, çmimiò dhe ñFV Pemë bliri d=18 cm, h>5 m, çdo 8 mò, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñ*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*ò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñ*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*ò e konkretisht Kreu II, Pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1604 prot datë 17.07.2019; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 55/1 prot, datë 05.07.2019; Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1751 prot., datë 08.08.2019.

Shkaku: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Mallakastër.

Ndikimi/Efekti: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 621,602 lekë pa tvsh nga BOE ñShò SHPK, & ñAò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1604 prot datë 17.07.2019 me objekt ñNdërtim shëtitore nga shkolla ñOdiseaòderi tek varrezat e qytetitò, *Bashkia Mallakastër,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Znj. L.L me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. L. B me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Gjithashtu, nga verifikimi në terren, rezultoi se pemët e mbjella, të cilat në projektpreventiv janë përcaktuar ñFV pemë bliri me d=18 cm h>5 mò dhe në ofertë dhe situavion me vlerën **1,440,000 lekë pa TVSH**, rezultojnë të jenë me diametër rreth 10 cm dhe mesatarisht me h ≠ m. *Përsa sipër, kjo vlerë është shpenzim i fondeve pa efektivitet dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin, kolaudatorin dhe grupin e marrjes në dorëzim.*

Për këtë pikë të Projektraportit, është bërë observacioni me datë 04.06.2022, protokolluar në KLSH me nr. 57/7, datë 09.05.2022 nga mbikëqyrësi i punimeve, si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
1. Zëri me Nr. 3.618 Bordurë betoni C 16/20 20 x 35 cm. Gjatë evidentimit në terren gjatë zbatimit të punimeve, në gjatësitë e evidentuara dhe të vendosura në pozicionin vertical, bordurat e vendosura kanë qenë në object me përmasa 20 x 35 cm. Dhe konkretisht të realizuara gjatë inspektimitme të paktën me gjatësi 800 ml dhe si rezultat 800 ml linear janë realizuar me permasën 20 x 35 cm dhe me çmimin 1100 lekë/ml. Ndërsa pjesa e gjatesisë tjetër qëndron si evidentim nga grupi auditimit, e cila është më pak, me vlerë: 410 ml x 110 lekë/ml = 45,100 lekë pa TVSH, si kosto më tepër. Këto gjatësi me vendosje bordure 20x30, evidentohen konkretisht në intersektimet e vendkalimeve të rrugëve dytësore, të cilat janë të pozicionuara të shtrira në gjatësinë e trotuarit. Si rezultat kërkojmë rishikimin e këtij zëri pune, duke rivlerësuar vlerën nga 133,100 lekë pa TVSH e llogaritur nga audituesit, në 45,100 lekë pa TVSH, si kosto e rivlerësuar dhe që duhet të qëndrojë si ulje përfundimtare.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit
Përsa pretendohet më sipër, grupi i auditimit sqaron se ka dalë në këtë konkluzion pas verifikimit në terren të këtij zëri pune, në prani të mbikëqyrësit të punimeve. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:
2. Zëri me Nr. 3.243/1 - Mur betoni C 16/20. Nga matjet në objekt gjatë shqyrtimit të akt konstatimit, është konstatuar një lapsus te hartuesit e librezës mbi hedhjen me mangësi të seksioneve tërthore në librezën e masave, por që janë paraqitur qartë në projektin e azhornuar.
Ne kundershtojme këtë pikë për gjatesinë e murit në fakt, pasi është i matshëm në çdo moment. Gjatësia faktike rezulton 103.7 ml dhe jo 96.7, pra është më shumë me 7 ml Nga llogaritjet e bere nga grupi auditimit per volumet qe zbriten eshte bere lapsus gjeresia e murit:
38 ml x 0.2 (gjeresi) x 1 ml (h-lartesi) = 7.6 m3 dhe
58.7 ml x 0.2 (gjeresi) x 0.5 (h-lartesi) = 5.87 m3
Totali = 13.47 m3
Pra nga matjet e evidentuara nga ana e audituesve është bërë lapsus ne llogaritje në zbritje e cila nuk është 54 m^3 por 13.47 m^3. Pra kemi vetem 13.47 m^3 më pak volum ku për rrjedhojë del vlera: 13.47 x 11000 = 148,170 lekë.
Dhe nëse do të zbresim sipas llogarisë së audituesve edhe lartësinë e kontrabordurës ku është llogaritur 0.2 gjer. dhe h-0.3 x 96.7 = 58.8 m^3, minus qe zbritet ngelet 0.2x0.2x96.7 = 3.87 m3. Pra, për kontrabordurën sipas audituesve duhet të zbritet vetem volume 3.87 m3 .
Dhe ne total eshte 3.87+13.47 = 17.34 m^3 minus me pak, kjo llogaritje rezulton me vlere me pak 190,740 leke pa TVSH ï është vlera e saktë, e cila është evidentimi që është bërë nga audituesit dhe jo 594,000 leke pa TVSH..
Gjatë realizimit të mureve përgjatë aksit të shëtitores, në prog.0+362 deri 0+370.8 është realizuar brenda objektit, ndërtimi i një ure, pa të cilën, objekti nuk do te merrte formë dhe funksionim, nëse nuk do të realizohej nga sipërmarrësi. Në këto kushte, jo vetëm që nuk ka sasi më pak, por janë kryer më tepër punime për te cilat jane paraqitur ne projektin e azhornuar, por per lapsus eshte harruar te evidentohet ne librezen e masave, e cila nuk eshte vjele si vlere ne leke.

Ura ka permasat me gjatesi L=8.72 ml dhe gjeresi 3.45 m.
Volumi I betonit te hedhur per realizimin e soletes, ku mbi kete siperfaqe eshte ndertuar vazhdimi I trotuarit dhe eshte si me poshte:
Volumi 1 - 8.72m x 3.45m x 0.5m (h e betonit) = 15.042 m3 .
Volumi 2 ï Kembet e ures ï per sasi 2 cope
Gjatesi e 1 kembe ure 3.45 + 1 = 4.45 ml
Trashesia e kembes = 0.7 m
H e kembes se ures = 2.8 m
Nga llogaritja del 2 x 4.45m x0.7mx2.8m = 17.44 m3 I njejti beton eshte edhe per muret .
Ne keto kushte sasia del nga 17.34 m3 (sasi e dale si me pak nga muret)
Sasia e betonit te ures = 17.44 m3 beton (sasi e dale me shume nga ura).
Ne keto kushte volume nuk eshte me pak por me shume 0.1 m^3.
Kjo eshte e evidentueshme pasi ura eshte ne vend dhe e faktuar me fotot si me poshte.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit
Përsa pretendohet më sipër, grupi I auditimit sqaron se llogaritja e diferencave në këtë zë pune është bërë pas verifikimit në terren së bashku me mbikëqyrësin e punimeve dhe të dhënat e paraqitura në aktkonstatim kanë dalë nga matjet e bëra. Llogaritjet e bëra nga observuesi në pjesën e parë nuk janë të sakta. Përsa i përket kryerjes së punimeve të bëra mbi urë dhe të shoqëruara me foto, janë marrë në konsideratë në Projektraportin e auditimit. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:
3. Zeri Anal. F.V. Puseta betoni me kapak gize ne trotuar 40x40x40cm – ky zë pune nga konstatimi i audituesve është i saktë dhe qendron.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit
Konstatimi I Grupit të auditimit do të qëndrojë edhe në Raportin Përfudnimtartë auditimit.

Pretendimi i subjektit:
4. Zeri Anal.F.V, pemë Bliri d = 18 cm h > 5,0 m çdo 8 m.
Në lidhje me zërin e lartëpermendur, e kundershtojmë plotësisht pasi nëse do te ishin 75 copë peme, aq do të ishin pasqyruar dhe jo 80 cope pemë.
Objekti ka gati 2 vjet qe ka perfunduar, dhe ruajtja nga demtimet e jashtme nuk eshte realizuar korrektesisht, si rezultat sot ne terren ne objekt jane faktikisht 78 cope peme dhe 2 prej tyre jane asgjesuar dhe ka ngelur vetem vendi bosh. Pra ne këtë pozicion ku ndodheshin keto 2 peme kryhet nje aktivitet biznesi makinash dhe qytetari mund te kete hequr pemet nga vendndodhja e tyre.
Ju bejme me dije se pemet jane matur kur kane ardhe ne objekt dhe kane qene mbi 5 m lartesi dhe trashesi mesatare rreth 18cm ne pjesen fundit. Pemet qe duken jane te inkastruara ne toke 80-100cm.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit
Përsa pretendohet më sipër, grupi i auditimit sqaron se llogaritja e diferencave në këtë zë pune është bërë pas verifikimit në terren në prani të mbikëqyrësit të punimeve. Përsa i përket vendosjes së dy pemëve para subjekt privat, të cilat janë hequr (të shoqëruara me foto), janë marrë në konsideratë në Projektraportin e auditimit. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2. "*Rikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja "5 Shkurti"*", Bashkia Mallakastër.

Kontratat
Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 462 prot datë 15.02.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër, të përfaqësuar nga Titullari z. A. K dhe Operatorit Ekonomik ñAò SHPK, me administrator z. A.A, me licencë profesionale NZ 1916/33. Vlera e kontratës është 30,874,884 lekë me TVSH, me financim nga Bashkia Mallakastër. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 120 ditë, nga data e fillimit të punimeve.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 403/1 prot., datë 11.02.2019,

është lidhur kontrata me OE ñMò SHPK, me përfaqësues P. M, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3119/1 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 477,155 lekë me tvsh.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 50/1 prot., datë 26.06.2019, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi OE ñDò SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1676/8, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 81,614 lekë me TVSH.
Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, është mbajtur akti i datës 10.07.2019, i nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, si dhe nga titullari i Bashkisë Mallakastër z. A. K.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje infrastrukturore, me nr. 2908/2 prot, datë 16.01.2019, ndryshuar me Lejen Infrastrukturore me nr. 742/2 prot., datë 01.04.2019.
- Projekti i zbatimit është hartuar nga grupi i projektimit i Bashkisë Mallakastër, i përbërë nga ing. B. V, Ark. A. N dhe ing. Top. B.M, në vitin Dhjetor 2018 dhe është miratuar nga Bashkia Mallakastër (vetëm vula e njomë).

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 15.02.2019 dhe kanë përfunduar me datë 14.06.2019, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.
- Me shkresën pa nr. prot, datë 10.05.2019, sipërmarrësi i punimeve ka relatuar për domosdoshmërinë e ndryshimeve në projektpreventivin fillestar. Pas shqyrtimit të këtij relacioni, Mbikëqyrësi i punimeve i ka dërguar investitorit Bashkia Mallakastër kërkesën për miratimin e preventivit të ndryshuar (tabelës së balancimit të punimeve). Pas kësaj kërkese, është hartuar dhe miratuar ñProcesverbali mbi ndryshimet në objektò, i nënshkruar edhe nga ish Kryetari i Bashkisë Mallakastër, z.A.K. Sipas këtij procesverbali punimet që shtohen/pakësohen, janë në vlerë 6,849,154 lekë pa TVSH.
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja "5 Shkurti", Bashkia Mallakastër				
14.Lidhja e kontratës Nr. 462 prot datë 15.02.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 30,874,884 lekë OE fitues ñAò SHPK		16.Likuiduar deri dt	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 30,874,884 lekë -Vlera pa tvsh 25,729,070 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 120 ditë, Zbatuar 120 ditë. Fillimi punimeve: 15.02.2019 Perfundimi punimeve : 14.06.2020		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE ñMò SHPK	Licenca Nr: MK 3119/1	Kontrata me nr. 403/1 prot., datë 11.02.2019	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve OE ñDò SHPK	Licenca Nr: MK 1676/8	Kontrata nr. 50/1 prot., datë 26.06.2019	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 04.07.2019	23.Akt i marrjes në dorëzim dt 10.07.2019		24. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën

225,914 lekë pa tvsh.

Titulli i gjetjes: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin ñRikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja ñ5 Shkurtiò, Bashkia Mallakastër, nga zbatuesi i punimeve OE ñAò SHPK, për zërat e punimeve I.1+I.2, III.2, III.6, III.8, V.2 dhe V.6.
Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës ñFV bordura betoni parafabrikat 15x25, çmimiò,òShtresë betoni për nivelim bordurashò, FV shtylla dekorative njëdegëshe për ndriçim, H=8mò, ëtj., për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179
Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñ*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*ò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñ*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*ò e konkretisht Kreu II, Pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 462 prot datë 15.02.2019; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 403/1 prot., datë 11.02.2019; Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 50/1 prot., datë 26.06.2019.
Shkaku: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Mallakastër.
Ndikimi/Efekti: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 225,914 lekë pa tvsh nga OE ñAò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 462 prot datë 15.02.2019 me objekt ñRikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja ñ5 Shkurtiò, *Bashkia Mallakastër,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi :
1. Z. P.M me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. V.T me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

3. "*Rikonstruksioni i rrugës nga Autostrada Levan Tepelenë-Ninësh*", Bashkia Mallakastër.
Kontratat
Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 159/8 prot datë 19.02.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër, të përfaqësuar nga Titullari z. Q. I dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë ñEò SHPK, me administrator z. E.Q, me licencë profesionale respektivisht NZ 6083/9 & ñJò SHPK, me administrator z. I. B. Vlera e kontratës është 16,896,066 lekë me TVSH, me financim nga Bashkia Mallakastër për vitin 2018 në vlerën 5,920,462 lekë me TVSH dhe për vitin 2019 në vlerën 31,748,431 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 95 ditë, nga data e nënshkrimit të kontratës. Në dosje administrohet Amendament kontrate nr. 465 prot, datë 27.01.2020 për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, sipas të cilit është miratuar shtyrja për një periudhë kohore prej 120 ditë, ose deri në datën 11.06.2020.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2936 prot, datë 31.12.2020, është lidhur kontrata me OE ñGò SHPK me përfaqësues G.S, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2928/8 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 486,085 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2938 prot., datë 31.12.2020, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi ing. M. K, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1200/4, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 58,330 lekë me TVSH.
Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, me Urdhërin nr. 195 datë 04.08.2021 të kryetarit të Bashkisë Mallakastër, nga grupi i punës me përbërje ing. M. M, Q. S dheing. B. V, të cilët kanë hartuar certifikatën e marrjesë së përkohshme në dorëzim të objektit në datën 06.08.2021.
Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të kryera në përputhje me projektin e azhurnuar dhe sipas volumeve të situacionuara.

2.4.6. Në lidhje me rregullshmërinë dhe përputhshmërinë ligjore të kryerjes së pagesave nëpërmjet bankës dhe dokumentacionit mbështetës shoqërues, si dhe të procedurave të prokurimit me vlera të vogla.

-Për vitet 2018-2021, institucioni i Bashkisë Mallakastër, fondet e akorduara në artikullin 602 ñ*Shpenzime operative*ò i ka parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimit me procedurë ñ*Blerje me vlera të vogla*ò. Regjistri i parashikimit të prokurimeve dhe regjistrat e realizimeve janë hartuar në zbatim të Neni 4, të VKM nr.914, datë 29.12.2004 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, i ndryshuar, sipas formatit ñTipò bashkëlidhur Udhëzimit të APP nr.2 datë 27.01.2015 ñ*Për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimit publik dhe regjistri i realizimit të prokurimit publik*ò dhe me udhëzimin nr.01, datë 05.01.2018 ñ*Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik*ò Kreu U, pika 3.
-Sipas regjistrave të realizimit të dërguar në APP, për vitin 2018 janë zhvilluar 96 procedura prokurimi me vlerë të vogël me fond limit pa tvsh për vlerën prej 19,455,771lekë, dhe vlerën e kontratës prej 17,850,090 lekë (91.7% e fondit limit), me një diferencë nga fondi limit prej 1,618,431 lekë, nga ku 39 prej këtyre procedurave me fond limit 16,938,830 lekë janë mbi 100,000 lekë deri në 800,000 lekë, dhe 57 procedura me fond limit 2,516,941 lekë, janë nën 100,000 lekë.
-Për vitin 2019, sipas regjistrit të realizimit, janë zhvilluar 79 procedura prokurimi me vlerë të vogël, me fond limit 15,867,515 lekë, dhe vlerën e kontratës 12,881,487 lekë (81% e fondit limit), me një diferencë nga fondi limit prej 2,551,880 lekë, nga ku 32 prej këtyre procedurave me fond limit 13,891,784 lekë janë mbi 100,000 lekë deri në 800,000 lekë, dhe 47 procedura me fond limit 1,975,731 lekë, janë nën 100,000 lekë.
-Për vitin 2020, sipas regjistrit të realizimit, janë zhvilluar 27 procedura prokurimi me vlerë të vogël, me fond limit 10,806,592 lekë, dhe vlerën e kontratës 9,294,896 lekë (86% e fondit limit), me një diferencë nga fondi limit prej 1,511,696 lekë, nga ku 23 prej këtyre procedurave me fond limit 10,616,549 lekë janë mbi 100,000 lekë deri në 800,000 lekë, dhe 4 procedura me fond limit 190,043 lekë, janë nën 100,000 lekë.
-Për vitin 2021, sipas regjistrit të realizimit, janë zhvilluar 25 procedura prokurimi me vlerë të vogël, me fond limit 11,223,107 lekë, dhe vlerën e kontratës 8,307,654 lekë (74% e fondit limit), me një diferencë nga fondi limit prej 2,551,880 lekë, nga ku 24 prej këtyre procedurave me fond limit 11,173,107 lekë janë mbi 100,000 lekë deri në 800,000 ï 1,000,000 lekë, dhe 47 procedura me fond limit 1,975,731 lekë, janë nën 100,000 lekë.

- Për vitin 2018, është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë z. A. K me nr. 25, datë 17.01.2018 me përbërje si vijon:
  1. Z. A. R ï Kryetar
  2. Z. N.K ï Anëtar

3. Znj. B. J ï Anëtar

- Për vitin 2019, është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë z. A.K me nr. 03, datë 04.01.2019 me përbërje si vijon:
  1. Z. A. R ï Kryetar
  2. Z. N. K ï Anëtar
  3. Znj. B. J ï Anëtar
- Për vitin 2020, është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë z. Q. I me nr. 03, datë 13.01.2020 me përbërje si vijon:
  1 Z. A. R ï Kryetar
  2 Z. A.A ï Anëtar
  3 Znj. B. J ï Anëtar
- Për vitin 2021, është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë z. Q.I me nr. 05, datë 06.01.2021 me përbërje si vijon:
  1 Z. A. R ï Kryetar
  2 Z. A. A ï Anëtar
  3 Znj. B.J ï Anëtar

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për procedurat e prokurimit blerje të vogla.

Situata:1.Nga testimi i 25 procedurave blerje të vogla për periudhën 01.01.2018 ï 31.12.2021, rezulton se Komisioni i Blerjeve të Vogla, në të gjitha rastet nuk ka argumentuar përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar.

2.Në 2 raste, konkretisht procedurat me objekt *"Blerje kamion vetëshkarkues me vinxh"*, dhe *"Blerje korrëse bari"*, specifikimet teknike janë vënë në mënyrë jo konkurruese, të cilat janë ndikuese në trajtimin e ofertuesve, veprim në kundërshtim me pikën 2 të nenit 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò i ndryshuar.

3.Në 2 procedura, me objekt blerje produkte ushqimore, nuk është bërë përshkrimi i plotë i mallrave që prokurohen, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 23 të cituar më sipër.

4.Në procedurën me objekt ñ*Blerje tonera për printera dhe fotokopje*ò, OE i shpallur fitues me të cilin është lidhur kontrata, N. M, rezulton 2 muaj debitor, duke mos përmbushur pikën III/1.d të Ftesës për Ofertë.

5.Në procedurën me objekt ñ*Shërbim interneti dhe telefonie*ò, në kriteret apo specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, rezulton se AK ka kërkuar nga OE ofertues të disponojë si pjesë të stafit teknik, minimalisht 5 punonjës inxhinierë telekomunikacioni/elektronik ose informatikë. Ky kriter është i ekzagjeruar dhe i paargumentuar nga KBV. Është një numër relativisht i lartë duke marrë parasysh llojin dhe vlerën e kontratës prej 500,000 lekë pa tvsh.

6.Në 11 procedura blerje të vogla, rezulton se likuidimet për faturat tatimore të shitjes janë kryer tej tej afatit 30 ditor, veprim në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2009 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò i cili përcakton se:

ñ*Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.*ò

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 88-179

Kriteri: Trajtuar tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos angazhimi në komisione i personave të kualifikuar.

Ndikimi/Efekti: Risku i përllogaritjeve të gabuara të sasive dhe vlerës së shpenzuar për

mallrat apo shërbimet objekt prokurimi. Specifikimet teknike ndikojnë në trajtimin e barabartë ndërmjet operatorëve dhe në rritjen e konkurrencës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1: Titullari i AK, të angazhojë persona të kualifikuar në komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.

Rekomandimi 2:Të merren masa në procedurat e ardhshme, që hartimi i specifikimeve teknike të mundësojë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe të rrisë konkurrencën ndërmjet tyre, dhe njëkohësisht të bëhet përshkrim sa më i saktë dhe në mënyrë të plotë objektet që prokurohen.

Rekomandimi 3: Komisioni për blerjet e vogla, të hartojë kriteret në përputhje me objektin e kontratës, duke shmangur kriteret të cilat ulin konkurrencën dhe përbëjnë kufizim për operatorët ekonomikë.

Rekomandimi 4: Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Mallakastër, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve te faturave brenda afateve ligjore.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e komisionit të blerjeve të vogla.

2.5. Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar.

Në zbatim të pikës ñ5ò, të programit të auditimit Nr. 57/1, datë 18.01.2022, i ndryshuar, u auditua Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ndjekja e procedurave në zbatim të ligjit nr. 107/2014 ñ*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*ò.

U shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni në sistemin ñE lejeò;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;

2.5.1. Auditimi mbi zbatimin e procedurave ligjore në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Plani i detajuar vendor;

2.5.2. Auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e regjistrit të territorit. Organizimi dhe funksionimi i Sistemit GIS;

a) Me dokumentin nr. 1126 prot., datë 08.05.2018, është lidhur marrëveshje ndërmjet Bashkisë Mallakastër, e përfaqësuar nga Kryetari saj z. A. K dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësuar nga Zv. Ministri z. A. Sh, me objekt ñ*Hartimin, Finalizimin dhe Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Mallakastër*ò. Marrëveshja është lidhur në mbështetje të ligjir nr. 107/2014 ñ*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*ò, Vendimit nr. 686, datë 22.11.2017 ñ*Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit*ò, me qëllim përcaktimin e procedurave që do të ndiqen për realizimin dhe miratimin e dokumentit vendor të planifikimit që është *Plani i Përgjithshëm Vendor.*

b) Me urdhrin nr. 156, datë 15.05.2018 të Titullarit të Bashkisë Mallakastër, është ngritur grupi i punës për hartimin e dokumentit të planit të përgjithshëm vendor (PPV) të Bashkisë Mallakastër, i përbërë nga z. H. S (nën kryetar i bashkisë), z. A. R (drejtor ekonomik), znj. R.O (Drejtor Juridik), z. A. Ll. (Drejtor i Çështjeve Sociale), znj. A. N (Drejtor i Planifikimit të Territorit), z. E.A (Drejtor i Mjedisit), z. E.Ç (Drejtor i Infrastrukturës) dhe znj. B.V (specialiste, inxhiniere hidro).

Gy grup pune do të jetë përgjegjës për hartimin e draft dokumentit të PPV-së për territorin administrativ të Bashkisë Mallakastër, në bashkëpunim me studion konsulente për hartimin e këtij plani.

c) Me vendimin nr. 2, datë 15.05.2018 të Titullarit ñ*Për ndërmarrjen e nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Mallakastër*ò, është vendosur ndërmarrja e nismës për hartimin e PPV për të gjithë territorin e kësaj bashkie, dhe ngarkuar grupin e punës për hartimin e draft ï dokumentit të nismës së PPV-së.
ç) Me vendimin nr. 64, datë 18.09.2018 të Titullarit ñ*Për miratimin e dokumentit të nismës për hartimin e PPV-së*ò, është miratuar dokumenti i nismës për hartimin e PPV-së, e cila i hap rrugë procesit të hartimit të PPV-së në përputhje me procedurat e parashikuara në ligj.
dh) Është lidhur kontrata me nr. 10488/7 prot., datë 01.10.2018 ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Operatorit Ekonomik ñAò shpk, me objekt ñ*Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkitë Peqin, Roskovec, Patos, Mallakastër*ò.
e) Me shkresën nr. 2724, datë 05.12.2018, është bërë njoftimi për dëgjesë publike me banorët e gjitha njësive administrative të Bashkisë Mallakastër, dëgjesë e dokumentuar me listëprezencat përkatëse, fotografitë dhe raporte të mbledhjes ndërmjet përfaqësuesve të bashkisë Mallakastër dhe Studios ñAò shpk dhe personave pjesëmarrës në këtë takim.
ë) Në vijim, janë mbajtur edhe dëgjesa tjera publike, të dokumentuara me procesverbalet përkatëse.
f) Janë dërguar raportet e studios ñAò shpk sipas fazave të ndryshme për hartimin e PPV-së të botuara në regjistrin e Bashkisë. (Faza 0 e hartimit të PPV-së, Faza 1 ñAnaliza dhe Vlerësimi i Territoritò, Faza 2 ñStrategjia Territorialeò, etj)
g) Me dokumentin nr. 368, datë 07.02.2019, është njoftuar Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për fillimin e hartimin të PPV-së për Bashkinë Mallakastër, dokumenti ky i rëndësishëm për vlerësimin strategjik mjedisor etj. Në përgjigje të këtij njoftimi, pranë bashkisë është administruar përgjigja e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me nr. 1376/7 prot., datë 21.03.2019 e cila përcakton fazat që duhet të ndjekë Bashkia Mallakastër.
gj) Me shkresën nr. 350 prot., datë 28.03.2019 të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, është njoftuar organizimi i takimit të dytë të Forumit të Bashkërendimit e Planifikimit në Nivel Vendor, në kuadër të PPV-ve.
h) Me dokumentin e datës 12.09.2019 të AKPT, është Raporti i Vlerësimit Teknik.
i) Me shkresën nr. 368, datë 10.10.2019 të Bashkisë Mallakastër drejtuar Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, është kërkuar pajisja me deklaratë mjedisore për implementimin e projektit *"Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor",* shkresë në vijim të përgjigjes të asaj të dërguar nga kjo ministri me nr. 1376/1 prot., datë 21.03.2019 me të cilën përcaktohen fazat që duhet ndjekur nga bashkia Mallakastër lidhur me Vlerësimin Strategjik Mjedisor.
j) Me shkresën nr. 940/5 prot., datë 28.10.2019 të AKPT, drejtuar Konsulentit ñAò shpk dhe Bashkisë Mallakastër, është përcjellë mendimi dhe pëlqimi i Institutit të Monumenteve, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit për draft raportet e PPV-së.
k) Me shkresën nr. 1416 prot., datë 11.12.2019 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, është administruar Deklarata Mjedisore *për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.*
l) Me shkresën nr. 910, datë 23.04.2020 të Bashkisë Mallakastër drejtuar AKPT, është bërë kërkesa për pajisjen me Aktin e Përputhshmërisë të draft dokumentit të PPV ï Bashkia Mallakastër.
ll) Me shkresën nr. 500/01 prot., datë 19.05.2020 të AKPT, është vendosur lëshimi i Aktit të Përputhshmërisë për Dokumentet e Planit të Përgjithshëm Vendore Bashkia Mallakastër, dhe me shkresën nr. 500/02 prot., datë 19.05.2020 të AKPT, është dërguar Akti i Përputhshmërisë dhe Raporti i Vlerësimit Teknik për Dokumentet e PPV-së, Bashkisë Mallakastër.
m)Me shkresën nr. 1084/1, datë 16.06.2020, është bërë kërkesë Këshillit të Bashkisë

Mallakastër për miratimin e PPV-së, kërkesë e cila është miratuar me vendimin nr. 29, datë 24.06.2020 të Këshilli Bashkiak për ñ*Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Mallakastër*ò. Me shkresën nr. 641/1 prot., datë 01.07.2020 të Prefektit të Qarkut Fier, është kthyer përgjigja për ligjshmërinë e vendimit nr. 29, datë 24.06.2020, duke e përcaktuar në përputhje me legjislacionin përkatës.
n)Me shkresën nr. 1498, datë 08.07.2020 të Bashkisë Mallakastër drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë së Zhvillimit të Territorit dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, është bërë kërkesa për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Mallakastër në Këshillin Kombëtar të Territorit.
nj)me vendimin nr. 288, datë 17.08.2020 të Ministrisë së Kulturës, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, është vendosur në parim miratimi i PPV-së Bashkia Mallakastër.
o)Me vendimin nr. 7, datë 14.10.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit, është vendosur Miratimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Mallakastër.
p)Me shkresën nr. 3223, datë 26.10.2020, studio ñAò shpk ka dorëzuar pranë Bashkisë Mallakastër materialin final të PPV-së.
q)Me e-mailin e datës 17.05.2021, njoftohet Bashkia Mallakastër për Botimin në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit të Planit të Përgjithshëm Vendor.

2.5.3. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në marrjen e vendimeve për leje zhvillimore ndërtimi në pronë private dhe publike;
2.5.4. Auditim mbi zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve të përdorimit, hartimi dhe firmosja e procesverbaleve të kolaudimit nga kolaudatori, zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve;
2.5.5. Auditimi mbi mandatpagesat dhe ballafaqimi me fletën e përllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;

a) Për periudhën objekt auditimi janë miratuar 28 leje ndërtimi, ku përfshihen leje për ndërtime të reja, rikonstruksion banesash, ndërtim çatish, rikonstruksion objektesh arsimore, magazina bujqësore etj. Nga këto 28 leje ndërtimi të miratuara, 20 janë për objekte nën 250 m^2 dhe 8 leje për objekte mbi 250 m^2. (Tabela aneks bashkëlidhur)
b) Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë janë 9,472,677 lekë, përllogaritja e së cilës është bërë në përputhje me pikën 1 dhe 2 të nenit 46 ñ*Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja*ò (taksë e llogaritur në 25 raste), ndërkohë që për 3 raste, nuk është aplikuar taksë pasi leja e ndërtimit është lëshuar për ndërtime të reja të zhvilluara me fonde publike, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 46 të sipërcituar.

<u>Titulli i gjetjes:</u>Miratimi i 3 lejeve të ndërtimit pa ju nënshtruar Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
<u>Situata:</u> 1.<u>Sipas regjistrit elektronik nr. 1050</u>në emër të zhvilluesit I.A, me datë aplikimi 23.04.2018, me nr. çështje ne sistemin e lejeve AN230420180039, ZK3191, për objektin *"Magazinë 1 Kt grumbullim dhe tregtim të produkteve bujqësore"* me pasuri me nr. 5/46, Vol.7 faqe 144 me status Arë me sipërfaqe 1565 m^2. Nga auditimi i ushtruar lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit rezultoi se:
a) Raporti i vlerësimit në mjedis (V.N.M) nuk është miratuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në kundërshtim me ligjin 10440, datë 07.07.2011 ñ*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*ò Shtojca II: pika 10 ñ*Prodhime infrastrukturore*ò (a) Projekte për zhvillimin e

pasurive të patundshme industriale.

2. <u>Sipas regjistrit elektronik nr. 1201</u>në emër të zhvilluesit H. M, me datë aplikimi 04.06.2020, me nr. çështje ne sistemin e lejeve AN040620200045, ZK1090, për objektin *"Ndërtim objekti 2 kate me funkosion të përzier"* me pasuri me nr. 7/303, Vol.23 faqe 216 me status Truall me sipërfaqe 414 m^2. Nga auditimi i ushtruar lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit rezultoi se :

a) Mungon raporti dhe relacioni i vlerësimit në mjedis (V.N.M) bashkë me miratimin e vendimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në kundërshtim me ligjin 10440, datë 07.07.2011 ñ*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*ò Shtojca II: pika 10 ñ*Prodhime infrastrukturore*ò (a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale.

3.<u>Sipas regjistrit elektronik nr. 249</u>në emër të zhvilluesit B. H, me datë aplikimi 27.01.2021, me nr. çështje ne sistemin e lejeve AN270120210064, ZK2160, për objektin *"Ndërtim objekti për grumbullim dhe tharje produktesh bujqësore"* me pasuri me nr. 400/1/1, Vol.3 faqe 15 me status Arë me sipërfaqe 7600 m^2. Nga auditimi i ushtruar lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit rezultoi se:

a)Mungon raporti dhe relacioni i vlerësimit në mjedis (V.N.M) bashkë me miratimin e vendimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në kundërshtim me ligjin 10440, datë 07.07.2011 ñ*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*ò Shtojca II: pika 10 ñ*Prodhime infrastrukturore*ò (a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale.

Sa më sipër, personat përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për leje, kanë vepruar në kundërshtim me pikën 6 të nenit 21 ñ*Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor*ò, i cili përcakton se:

6. Në rast se në lidhje me kërkesën për leje duhet të shprehen, paraprakisht, edhe autoritete të
tjera publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, autoriteti vendor përgjegjës ose KKT-ja, sipas fushës së kompetencës, u dërgon atyre kërkesë për mendim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve. Me dërgimin e kërkesës, pezullohet llogaritja e afatit të shqyrtimit të aplikimit, sipas
pikës 4, të këtij neni, deri në dhënien e mendimit/miratimit përkatës. Në mungesë të përgjigjes së autoriteteve publike nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit, brenda 10 ditëve pune, kërkesa konsiderohet e miratuar në heshtje dhe autoriteti përgjegjës i zhvillimit ka detyrimin të vijojë me shqyrtimin e kërkesës për leje.

Punonjësit e DPZHT – Bashkia Mallakastër, duhej të bënin kërkesë për mendim pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit si institucioni përgjegjës për vlerësimin e V.N.M-ve.

<u>Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 179-183</u>

<u>Kriteri:</u> Trajtuar tek situata e gjetjes.

<u>Shkaku:</u> Neglizhencë e strukturave përgjegjëse.

<u>Ndikimi/Efekti:</u>Miratimi i lejeve të ndërtimit pa ju nënshtruar *vlerësimit të ndikimit në mjedis*.

<u>Rëndësia:</u>E lartë

<u>Rekomandim:</u> Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Mallakastër, të marra masa për shqyrtimin e lejeve të ndërtimit, ku të bashkërendohet puna me të gjitha institucionet tjera publike brenda kompetencave që u njeh ligji, duke përfshirë dhe kërkesën drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nëse objektet për të cilat është aplikuar për leje ndërtimi, duhet tëi nënshtrohen apo jo *Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.*

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga personat përgjegjës për administrimin e procesit të lejeve të ndërtimit u paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 57/8 prot., datë 13.05.2022 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:
Në lidhje me mangësinë e pretenduar nga audituesi i KLSH-së , në dokumentacionin e aplikimit ,me nr. elektronik 1050 prot, datë 23.04.2018, nr. aplikimi AN230420180039, për zhvillimin e pasurisë me nr. 5/46, ZK 3191, me zhvillues z.I. A ju sqarojmë:
Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis nuk është paraqitur për miratim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, pasi funksioni i këtij objekti është magazinë për grumbullim dhe tregtim produktesh bujqësore. Në zbatim të Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", neni 8 parashikon , se objektet të cilat duhet ti nënshtrohen procedurës së miratimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të cilët janë objektet e përfshira në shtojcën II.
Objekti i mësipërm është objekt me funksion bujqësor dhe jo infrastrukturor, i cili nuk përfshihet në asnjë nga projektet e paraqitura në shtojcën II: PIKA 1 "Bujqësia, silvikultura dhe akuakultura".
Duke marr parasysh mos përfshirjen e këtij objekti në asnjë nga projektet e listuara në pikën 1 të shtojcës II, nuk është kërkuar miratimi në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.
Si përfundim: objekti ka si funksion vetëm magazinim dhe grumbullim produktesh dhe nuk kryen asnjë proces tjetër të ushtrimit të ndonjë aktiviteti si veprimtari prodhimi etj. Në këto kushte ky objekt, është rast përjashtimor në pikën e parashtruar dhe të pretenduar nga audituesi i klsh-së, referuar ligjit Nr.10440 datë 07.07.2011.

Përsa i përket mangësisë në dokumentacionin e aplikimit ,me nr. elektronik 1201 prot, datë 04.06.2020, nr. aplikimi AN040620200045, për zhvillimin e pasurisë me nr. 7/303, ZK 1090, zhvillues H. M ju sqarojmë:
Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis nuk është kërkuar në dokumentacionin e aplikimit si dhe nuk është paraqitur për miratim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, pasi funksioni i këtij objekti është magazinë dhe ekspozitë (objekt me funksion prodhues industrial). Në zbatim të Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", neni 8 parashikon objektet të cilat duhet ti nënshtrohen procedurës së miratimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të cilët janë objektet e përfshira në shtojcën II.
Objekti i mësipërm është objekt me funksion industrial dhe jo infrastrukturor, i cili nuk përfshihet në asnjë nga projektet e paraqitura në shtojcën II: PIKA 8 "Industria tekstile, e lëkurës, e drurit dhe e letrës".
Duke marr parasysh mos përfshirjen e këtij objekti në asnjë nga projektet e listuara në pikën 8 të shtojcës II, nuk është kërkuar raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe miratimi në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Sa i përket mangësisë në dokumentacionin e aplikimit ,me nr. elektronik 249 prot, datë 27.01.2021, nr. aplikimi AN270120210064, për zhvillimin e pasurisë me nr. 400/1/1, ZK 2160, zhvillues B. H ju sqarojmë:
Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis nuk është kërkuar në dokumentacionin e aplikimit si dhe nuk është paraqitur për miratim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, pasi funksioni i këtij objekti është magazinë për grumbullim dhe tharje produktesh bujqësore. Në zbatim të Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", neni 8 parashikon objektet të cilat duhet ti nënshtrohen procedurës së miratimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të cilët janë objektet e përfshira në shtojcën II.
Objekti i mësipërm është objekt me funksion bujqësor dhe jo infrastrukturor, i cili nuk përfshihet në asnjë nga projektet e paraqitura në shtojcën II: PIKA 1 "Bujqësia, siviakultura dhe akuakultura".
Duke marr parasysh mos përfshirjen e këtij objekti në asnjë nga projektet e listuara në pikën 1 të shtojcës II, nuk është kërkuar miratimi në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 14 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk

merren në konsideratë.

2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).

2.6.1. Nëse punonjësit e punësuar te IMTV kanë përfunduar arsimin e lartë në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, Urbanistikës, Konstruksionit transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit, siç përcaktohet në nenin 11 të ligjit nr. 183/2014 datë 24.12.2014 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme";

2.6.2. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

2.6.3. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative, të listohen në një listë.

2.6.4. Nëse janë kërkuar në Gjykatën Administrative rivendosja në afat të vendimet me gjobë të vendosura gjatë viteve të mëparshme, bazuar në nenet 151 dhe 152 të "Kodit Procedurës Civile në RSH";

2.6.5. Nëse për vendimet e gjobave të paarkëtuara nga IMTV dhe Drejtoria Juridike, kanë kërkuar në Gjykatën Administrative kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv, në zbatim të nenit 24 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative";

2.6.6. Nëse IMTV ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit Territorit të Bashkisë, në pajtim me nenin 81 "Inspektimi", pika 3, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar;

2.6.7. Nëse për vendimet e gjobave e të paarkëtuara brenda afatit ligjor, përveç vlerës së gjobës, janë llogaritur edhe vlerave kamat vonesave në masën 2% të vlerës të gjobës për çdo ditë vonesë deri në 30 ditë, (ose në shumën 60% kamatëvonesë mbi gjobën e vendosur), në zbatim të pikës 3, neni 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative";

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ñ*Për inspektimin e ndërtimit*ò i ndryshuar. Struktura aktuale është miratuar me vendimin nr. 10 datë 14.12.2020 të Kryetarit të Bashkisë dhe përbëhet nga 3 punonjës, nga të cilët 1 Kryeinspektor, 1 jurist, dhe 1 teknik i mesëm ndërtimi. Për vitet 2018-2019, Inspektorati është ngritur dhe ka funksionuar si strukturë në varësi të titullarit, ndërkohë për vitet 2020 ï 2021, Inspektorati është vendosur në varësi të Drejtorisë së Mbrojtjes Civile dhe Territorit, në kundërshtim me nenin 4 të ligjit të mësipërm. Gjatë periudhës objekt auditimi, IMT është drejtuar nga k/inspektor A.X, me profesion inxhinier ndërtimi. Arsimimi i K/inspektit është në përputhje me nenin 11 të ligjit për ñ*Për inspektimin e ndërtimit*ò.

Grupi i auditimit, për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 ï 31.12.2021, kërkoi vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme siç janë dosjet e procedurave të mbajtura nga IMT, në të cilat duhet të përfshihen procesverbalet e konstatimit të mbajtura nga inspektorët, vendimet e gjobave, vendimet e pezullimit, vendimet e prishjeve dhe procesverbalet e ekzekutimit të këtyre prishjeve, kallëzimet penale, kërkesat drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv, informacioni periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT, planet vjetore dhe planet mujore të punës të miratuara nga k/inspektori.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se:

Për periudhën objekt auditimi, rezulton se janë mbajtur 9 procesverbale konstatimi. Në zbatim të tyre janë vendosur 11 gjoba në vlerë totale 2,250,000 lekë, si dhe është nxjerrë për zbatim 1 vendim për prishje objekti. Nuk ka asnjë masë të vendosur për pezullimin e punimeve. Janë përcjellë 2 kallxime penale për ndërtim pa leje. Në mënyrë të detajuar sipas

viteve, situata paraqitet si më poshtë:

1. Për vitin 2018, janë mbajtur 4 procesverbale konstatimi, dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë 6 vendime me gjobë në vlerën 1,350,000 lekë nga të cilat 1 gjoba me vlerë 500,000/gjobë për punime në të cilat kërkohet leje ndërtimi, 3 gjoba me vlerë 100,000/gjobë për punime në shkelje të lejes së ndërtimit, 1 gjoba me vlerë 50,000 lekë për 1 mbikëqyrës punimesh për firmosje situacionesh për punime të pakryera, dhe 1 gjobë me vlerë 500,000 lekë për 1 kolaudator punimesh për mbajtje akti kolaudimi në shkelje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998.
   Është nxjerrë 1 vendim për prishje objekti, i cili nuk është ekzekutuar dhe nuk ka asnjë vendim për pezullim punimesh.
2. Për vitin 2019, janë mbajtur 2 procesverbale konstatimi, dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë 2 vendime me gjobë në vlerën 600,00 lekë nga të cilat 1 gjobë me vlerë 100,000/gjobë për shkelje të afatit për përfundimin e punimeve dhe 1 gjobë me vlerë 500,000 lekë për punime për të cilët nevojitet leja e ndërtimit.
   Nuk ka vendim për prishje objekti si dhe nuk ka vendim për pezullim punimesh. Një rast është referuar komisariatit të Policisë Mallakastër për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm.
3. Për vitin 2020, janë mbajtur 3 procesverbale konstatimi, dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë 3 vendime me gjobë në vlerën 300,000 lekë nga të cilat 3 gjoba me vlerë 100,000/gjobë për shkelje të afatit për fillim/përfundim punimesh.
4. Për vitin 2021, nuk ka asnjë procedurë të mbajtur nga inspektorët e IMTV.

Procedurat Total 01.01.2018 – 31.12.2021

Nr.	Emërtimi	2018	2019	2020	2021	Totali
1	Procesverbale Konstatimi	4	2	3	0	9
2	Vendim Pezullim Punimesh	0	0	0	0	0
3	Vendim Gjobe	6	2	3	0	11
4	Vendim Prishje Objekti	1	0	0	0	1

Titulli i gjetjes: Mos auditimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, ligjshmëria e aktivitetit, dhe arkëtimi i gjobave.

Situata: 1. Nuk është aplikuar në 2 raste konstatimi të ndërtimit pa leje, vendimi për pezullimin e punimeve, veprim ky në kundërshtim me nenin 5 germa (ç) dhe nenit 13 germa (a, b, c, ç) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ñ*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*ò, i ndryshuar, dhe pikës 5 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 ñ*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*ò.

2.Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ñ*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*ò, i ndryshuar dhe nenin 51 ñ*Inspektimi*ò të ligjit nr. 107/2014 ñ*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*ò i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 ñ*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*ò.

3.Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 mujor për IKMT për masat e marra, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ñ*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*ò, i ndryshuar.

4.Nga kontrolli i dokumentacionit, u konstatua se procedurat nuk dispononinfotot e konstatimit, të cilat janë të nevojshme për dokumentimin e kundërvajtjes së kryer. Mungesa e fotografive të kundërvajtjes, është veprim në kundërshtim me nenin 41 ñ*Të drejta të tjera të inspektorit*ò, germa (a) të ligjit me nr. 10433, datë 16.06.2011 ñ*Për inspektimin në Republikën*

*e Shqipërisë*ò, i cili përcakton se:

Inspektori, brenda objektit dhe qëllimit të inspektimit, ka edhe këto të drejta:
a) të kryejë fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjediseve, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, mjediseve, objekteve, mjeteve të transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave, përbërësve dhe çdo sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit.

5.Në lidhje me arkëtimin e gjobave, rezulton se për vitin 2018 nga 1,350,000 lekë në total, janë arkëtuar 300,000 lekë ose 22% e tyre; për vitin 2019 nga 600,000 lekë në total, nuk është bërë asnjë arkëtim i këtyre gjobave; për vitin 2020 nga 300,000 lekë në total, janë arkëtuar 200,000 lekë, ose 66% e tyre. Për vitin 2021 nuk ka asnjë gjobë të vendosur. Në total, rezulton se për periudhën objekt auditimi janë arkëtuar 500,000 lekë ose 22% e vlerës totale të gjobave.

-Për 6 gjobat tjera në vlerën 1,750,000 lekë, situata është si më poshtë:

a)1 gjobë në vlerën 500,000 lekë me kundërvajtës A. Y, është në proces gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, pasi Gjykata Administrative Vlorë ka pranuar kërkesën e këtij shtetasi për shfuqizimin e vendimit të gjobës.

b)1 gjobë ne vlerën 500,000 lekë me kundërvajtës T. Sh. Ky shtetas ka paditur IMT ï Bashkia Mallakastër pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila me vendimin nr. 651, datë 09.11.2020 ka vendosur pranimin e padisë dhe shfuqizimin e aktit administrative të gjobës. Kundër këtij vendimi është paraqitur kërkesa për ankimim nga Bashkia Mallakastër, kërkesë e cila nuk është pranuar me vendimin për ñMos pranim ankimiò me nr. 1849/416 akti, të datës 17.11.2020.

c)1 gjobë në vlerën 500,000 lekë ndaj subjektit G shpk, rezulton se është bërë kërkesa për lëshim urdhri për titull ekzekutiv, kërkesa e cila është pranuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 460 regj., datë 29.07.2019. Lidhur me këtë vendim, rezulton se nuk është dërguar pranë zyrës përmbarimore për kryerjen e veprimeve për arkëtimin e saj, veprim në kundërshtim me nenin 9 të ligjit me nr. 10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò i cili përcakton se:

ñ*Vendimi për kundërvajtjen administrative, sipas këtij ligji, bëhet i ekzekutueshëm nga organi administrativ që e ka nxjerrë atë. Kur organi administrativ që ka nxjerrë vendimin e kundërvajtjes administrative, i cili është bërë i ekzekutueshëm, nuk ka në përbërjen e tij struktura të ekzekutimit me forcë të detyrimeve,* ***për ekzekutimin e vendimit të kundërvajtjes administrative ngarkohet shërbimi përmbarimor, sipas këtij ligji.***ò

Lidhur me mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi përgjegjësi i sektorit juridik, z. N. S.

d)2 gjoba në vlerën 200,000 lekë total me kundërvajtës ñMò shpk dhe ñMò shpk, rezulton se nuk është kryer asnjë veprim për arkëtimin e tyre.

e)1 gjobë në vlerën 50,000 lekë me kundërvajtës ñAò, rezulton se është bërë kërkesë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë por lëshim urdhri ekzekutimi, kërkesë e cila është rrëzuar nga kjo gjykatë. Kundër këtij vendimi është bërë ankimim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Gjithsesi, konstatohet se ky kundërvajtës ka marrë përsipër në vijim kryerje shërbimi për mbikëqyrje të punimeve për punët e prokuruara pranë Bashkisë Mallakastër, dhe në këto kushte, janë krijuar të gjitha kushtet për arkëtimin e këtij detyrimi, por rezulton se nuk janë kryer veprime nga punonjësit e kësaj bashkie.

-Sa më sipër, vlera prej 750,000 lekë, përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Mallakastër, si rezultat e mos arkëtimit të tyre apo ndjekjes së procedurave për të bërë të mundur arkëtimin e tyre.

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 183-188

Kriteri: Trajtuar tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos ushtrimi i përgjegjësive për kontrollin e territorit.

Ndikimi/Efekti: Ndikon në miratimin e lejeve sipas planeve rregulluese, dhe kontrollin e territorit për ndërtimet pa leje. Mungesë të ardhurash nga mos arkëtimi i gjobave.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi 1: Kryeinspektori i IMT, të marrë masa për plotësimin e procedurave, duke vendosur masat e pezullimit për ndërtimet që kryhen pa lejet përkatëse. Të administrohet në dosjet e tyre praktika, duke bashkëlidhur fotografitë e kundërvajtjes ku të pasqyrohet fakti i evidentuar në procesverbalet e konstatimit. Të mbahet korrespodencë me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, ku çdo 3 muaj të përcjellin informacionin periodik të aktivitetit të tyre.
Rekomandimi 2: Kryeinspektori i IMT, të marrë masa kontrollin e objekteve të pajisura me leje ndërtimi, dhe në çdo rast të mbajë aktet e kontrollit ku të pasqyrohet situata e objektit në ndërtim, dhe evidentimin e shkeljeve nëse rast konstatimi.
Rekomandimi 3: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMT në vlerën 750,000 lekë.

2.7. Të ndryshme të dala gjatë auditimit

Në zbatim të pikës ñ7ò të Programit të Auditimit, *"Të ndryshme të dala gjatë auditimit"*, u auditua ankesa e shtetasit C.A e protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 954 prot., datë 28.09.2020.
- Në ankesën e tij, ky shtetas sqaron problematikën lidhur me ujin e rrjetit në fshatin Rromës, Bashkia Mallakastër. Sipas këtij shtetasi, tubacionet e ujit të pijshëm janë tubacione të përdorura për naftë, dhe njëkohësisht përzihen me ujërat e zeza. Në kontrollet e mëparshme të kryera nga punonjësit e Bashkisë, kampionet e ujit të pijshëm janë marrë në burimin e ujit dhe jo në rrjet ku të përcaktohet cilësia dhe standardet e ujit të pijshëm nga banorët e kësaj njësie.
- Në përgjigje të kësaj ankese, grupi i auditimit kërkoi informacion nga përfaqësuesit e Bashkisë Mallakastër, të cilët me shkresën nr. 1160 prot., datë 01.03.2022, kanë bërë kërkesë drejtuar Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Mallakastër, për kryerjen e analizave të ujit në fshatin Rromës.
- Me shkresën nr. 110/1 prot., datë 04.03.2022, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Mallakastër, ka kthyer përgjigje mbi rezultatet e analizave të laboratorit të ujit për fshatin Rromës, ku informojnë se:
Pas marrjes së njoftimit për nevojën e kryerjes së analizave të ujit të pijshëm në fshatin Rromës të bashkisë Mallakastër, ky institucion ka marrë mostrat përkatëse të ujit në këtë fshat për analizimin e treguesve mikrobiologjik dhe fiziko-kimik.
Janë marrë 2 (dy) mostra mikrobiologjike dhe 1 (një) fiziko – kimike të cilat u dërguan në laboratorin e NjVKSh Fier për analiza laboratorike. Këto mostra u morën në pikat fundore të rrjetit të ujësjellësit të këtij fshati.
Nga analizimi dhe përgjigja laboratorike, rezultoi se mostrat e ujit ishin brenda standardit shtetëror sipas kërkesave të VKM-së nr. 379, datë 25.05.2016 "Për miratimin e rregullores së ujit të pijshëm" dhe pa ndotje.
- Janë paraqitur provat laboratorike për analizën bakteorologjike, të marra në 2 kampione me datë 02.03.2022, në shkollën e njësisë dhe në banesën e shtetasit Bushi Avdiaj, të administruara me nr. regjistri 224 dhe 225 datë 04.03.2022, sipas së cilës mikroorganizmat E Coli, Streptokoku fekal dhe C.Perfigens, janë në vlerë absolute 0 (zero).
- Është paraqitur prova laboratorike për analizën kimike të marrë në banesën e shtetasit Bushi Avdiaj me datë 02.03.2022, rezultati i së cilave ka dal brenda parametrave të duhur (pa ngjyrë, pa turbullira, Ph-7.4 etj).

Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit, faqe 188

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, gjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra nëLigjin nr. 10296, datë 8.7.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò i ndryshuar, Manualin e MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 38-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Mallakastër, me atributet e Kryetarit të GMS dhe të Nëpunësit Autorizues të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin strategjisë së risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

1.2. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër, të kryhen investime në programe kompjuterike të liçencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryhen procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimesh për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve për realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Të vendoset një sistem komunikimi, i cili të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

1.3. Rekomandimi:Të kryhen ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit, për ato funksione të cilat me ligj janë kompetencë e institucioneve të tjera duke rishikuar edhe strukturën e bashkisë me qëllim alokimin eficient të burimeve njerëzore.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktivitetit të Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Mallakastër, gjatë periudhës 2018-2021, u konstatua se struktura e njësisë, sa i përket numrit të punonjësve dhe certifikimit të tyre në periudha të caktuara nuk ka qenë në përputhje përcaktimet ligjore, të cituara më sipër rast pas rasti, nuk janë kryer auditime të zbatimit të rekomandimeve, të teknologjisë së informacionit dhe prokurimeve, në raste të caktuara nuk janë zbatuar planet e auditimit, rreth 60% e fushave të aktivitetit të Bashkisë Mallakastër, të vlerësuara me risk të lartë nuk janë mbuluar me auditim. Veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën ñçò në nenin 6, nenin 13, shkronjat ñcò dhe ñçò në nenin 14, shkronja ñeò në nenin 16 të Ligjit nr. 114/2015 ñ*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*ò; Pikën 3 të VKM nr. 83, datë 3.2.2016 ñ*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*ò; Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë ñ*Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016*ò.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 38-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut, ku të planifikojë auditime tematike për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, si dhe të kryejë proçesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.
2.2. Rekomandimi:Të marrë masa për të arkivuar në arkivin e instuticionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA të hartuara gjatë periudhës 2020-2021, u konstatua se:
- Përvitin 2020, buxheti vjetor nuk është miratuar me vendim të veçantë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 9 tëKreut I nëUdhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afat mesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*ò;
- Për PBA 2020-2022 dhe PBA 2021-2023 nukjanëkryerkonsultime me komunitetin dhe grupet e interest të Bashkisë Mallakastër, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën ñçò të nenit 5 nëLigjin nr. 68/2017 ñ*Përfinancat e Vetëqeverisjes Vendore*ò;
- Për PBA 2020-2022 dheBuxhetinvjetor 2020 nuk ka gjetur zbatim për caktimi i bërë nëpikën 1 tënenit 33 tëLigjit nr. 68/2017 ñ*Përfinancat e Vetëqeverisjes Vendore*ò, sivijon: *"Kryetar i injësisë së vetë qeverisjes vendore* ***përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afat mesëm dhe të buxhetit vjetor****, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standard për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afat mesëm qendror e vendor"*;
- Nuk administrohet dokumenti përfundimtari PBA përperiudhën 2021-2023, por në dosje administrohet vetëm VKB që kanë miratuar buxhetin vjetor 2020, PBA 2020-2022 dhe buxhetin vjetor 2021. Lidhur me PBA 2021-2023 nga Bashkia Mallakastër na u vendos në dispozicion dokumenti në formatin EXCEL përpasqyrat e PBA 2021-2023, nëkundërshtim me pikën 6 në Kreun I të Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxheto rafat mesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*ò;
- Për PBA 2020-2022 dhe 2021-2023 nuk administrohet VKB përmiratimin e tavaneve përgatitore dhe përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afat mesëm, në kundërshtim me përcaktimin e bërë pikën 6 nënenin 34 dhe pikën 1 nënenin 37 tëLigjit nr. 68/2017 ñ*Përfinancat e Vetëqeverisjes Vendore*ò;
- Për PBA 2020-2022 dhe 2021-2023 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 tënenit 35 të Ligjit të mësipërm, pasi nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;
- Për PBA 2021-2023 ngaKryetari i Bashkisë nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit Brenda njësisë së vetëqeverisjes vendore, në kundërshtim me përcaktimin e bërënëpikën 29 nëUdhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standard të përgatitjes së programi tbuxhetor afat mesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*ò.
- Për PBA 2020-2022 dhe 2021-2023 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e përcaktuara në shkronjat ña-hò tëpikës 38 në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afat mesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*ò, përdrejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore të Bashkisë Mallakastër, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë proçesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatësetë PBA dhe buxheteve vjetore, nuk administrohet dokumentacion mbi

kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Mallakastër, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;
- Në PBA 2020-2022 dhe 2021-2023, si dhe buxhetet vjetore të vitit 2020 dhe 2021, nuk j anë planifikuar fonde për investime në fondin pyjor, në kundërshtim me përcaktimet e bëranëpikën 5 tënenit 23 nëligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 ñ*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*ò, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe në pikën 3 tënenit 13 nëLigjin nr. 57/2020 ñ*Përpyjet*ò, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 53-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Mallakastër.

3.2. Rekomandimi:Për çdo vit buxhetor të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Mallakastër.

Nëvijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave për investime të Bashkisë Mallakastër, financuar nga Ministria e linjës, konstatohet se, në 4 raste në vlerën 1,113,601,009 lekë, Titullari i Bashkisë ka ndërmarrë angazhime buxhetore duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me operatorë ekonomik, për investime në punë publike, pa pasur në dispozicion fondet e plota për realizimin e kontratës. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 1, 9, 10, 14 dhe 38 të nenit 3, nenin 40, nenin 50, nenin 51 në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar; Pikën 2 të VKM nr. 807, datë 16.11.2016 ñ*Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore*ò, i ndryshuar; nenin 70 dhe nenin 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, i ndryshuar; pikat 81, 142, 155, 165 në Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 53-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli, konstatohet se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele të ulta në vitin 2020, konkretisht në masën 30% dhe në vitin 2021 në masën 54%. Ky mosrealizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Mallakastër në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën ñaò në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò; nenin 47 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 53-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masa që planifikimi i fondeve për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave në vitin paraardhës dhe jo të planifikimit të tyre.

Nëvijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Gjatë periudhës 2020-2021 konstatohet se, në 5 raste Bashkia Mallakastër ka ndërmarrë angazhime të reja buxhetore përtej datës 15 tetor, me vlerë totale 17,693,545 lekë, duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me operator ekonomik, për kryerjen e punimeve publike të ndryshme. Veprime e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 51 në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 53-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, nërolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masat e nevojshme për të eleminuar praktikat e ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore për te jafatitligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likujdimin e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Mallakastër, konkretisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, u konstatua se, në 5 raste për vlerën 1,190,000 lekë, nuk është respektuar rradha e likujdimit të tyre, sipas parimit ñ*hyrje e parë-dalje e parë*ò, nuk janë kryer likujdimet e plota të detyrimeve, megjithëse Bashkia Mallakastër në fund të viteve 2020-2021 ka patur disponibilitete në thesar. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë, si dhe në urdhrin e likujdimit nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime të Bashkisë Mallakastër ndaj palëve të treta.Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 8 dhe 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 1, datë 04.06.2014 ñ*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit*ò.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 53-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

7.2. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet. Gjithashtu për çdo rast të likujdimit të detyrimeve të vendimeve gjyqësore, në urdhrin e autorizimit të shpenzimit, të evidentohet dhe të kërkohet nxjerrja e përgjegjësisë administrative, të punonjësit përgjegjës.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Mallakastër, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2020-2021, ky afat nuk është respektuar në 49 raste

për vlerën 183,825,766 lekë. Gjithashtu sa i përket likujdimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, u konstatua se, në 36 raste nuk është respektuar rradha e likujdimit të tyre, pra fatura e parë likujdohet më parë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 53-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përjashtuar kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë dhe duke respektuar rradhën e likuidimit sipas parimit ñ*hyrje e parë – dalje e parë*ò.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se *për vitin 2018*, të ardhurat nga 336,716 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën 322,925 mijë lekë ose 95.9%, pra me një mosrealizim në shumën 13,791 mijë lekë. *Për vitin 2019*, të ardhurat nga 353,552 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën 156,564 mijë lekë ose 44%, pra me një mosrealizim në shumën 198,988 mijë lekë. *Për vitin 2020*, të ardhurat nga 341,975 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën 117,205 mijë lekë ose 34.3%, pra me një mosrealizim në shumën 224,770 mijë lekë. Për vitin 2021,të ardhurat nga 350,904 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën 209,997 mijë lekë ose 60%, pra me një mosrealizim në shumën 140,907 mijë lekë.

Mosrealizimi ka ndodhur kryesisht si pasojë e mospagesës nga ana e kompanive naftënxjerrëse dhe përpunuese të cilat zënë peshën më të madhe të të ardhurave në Bashkinë Mallakastër, përkatësisht gjatë vitit 2018 për shumën 13,791 mijë lekë, gjatë vitit 2019 për shumën 198,988 mijë lekë, gjatë vitit 2020 për shumën 224,770 mijë lekë dhe gjatë vitit 2021 për shumën 140,907 mijë lekë.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 ñ*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*ò i ndryshuar, neni 5, ñ*Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore*ò, neni 54, ñ*Raportimi financiar*ò nënpika c, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për Sistemin e Taksave Lokale*ò, i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar; UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV ñ*Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave*ò pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6., faqe 53-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit, sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: 1. Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Mallakastër, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në Bashki, vlera është 2,215,499,987 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 1,989,157,450 lekë, me një diferencë prej 226,342,537 lekë më shumë në PF në Bashkinë

Mallakastër. Në vijim, në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra, në PF në Bashki, vlera është 348,120,020 lekë, ndërsa në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra në PF në sistemin e Thesarit vlera është 111,203,912 lekë, me një diferencë prej 236,916,108 lekë më pak në PF në sistemin e Thesarit. Llogaria 520 ñ*DisponibilitetenëThesar*ò, në PF në subjekt ka vlerën 223,825,807 lekë, ndërsa në PF në sistemin e Thesarit ka vlerën 0. Për sa më sipër, këto llogari nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë.

2.Llogaria 468 ñ*Debitorë të ndryshëm*ò në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën debitore 60,528,690 lekë. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari është pakësuar për vlerën 927,617 lekë dhe është shtuar për vlerën 98,599 lekë, me një rritje neto në vlerën 387,002 lekë, shumë e konstatuar nga debitorët për pagesat e tarifave të kopshtit dhe çerdhes.

Nga auditimi i të ardhurve, u konstatua vlera totale debitore 1,255,994,680 lekë, e cila është e pakontabilizuar.

3.Gjendja e llogarisë 210 ñ*Toka, Troje, Terrene*ò në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 309,970 lekë e pandryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Për këtë llogari në Bashkinë Mallakastër nuk disponohet analizë.

4. Gjendja e llogarisë 211 ñ*Pyje kullota plantacione*ò në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 8,560,400 lekë e pandryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Për këtë llogari në Bashkinë Mallakastër nuk disponohet analizë.

5. Gjendja e llogarisë 212 ñ*Ndërtime e konstruksione*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 791,244,840 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 752,534,178 lekë, me një pakësim në vlerën 38,710,662 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është **774,449,870** lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 21,915,692 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.

6. Gjendja e llogarisë 213 ñ*Rrugë, rrjete vepra ujore*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 1,015,556,796 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 850,018,562 lekë, me një pakësim në vlerën 165,538,234 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 834,188,729 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 15,829,833 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.

7.Nga verifikimi i regjistrave, u konstatua se për llogaritë 214 ñ*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*ò dhe 215 ñ*Mjete transporti*ò, etj., paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikat 30 dhe 74 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò.

8.Gjendja e llogarisë 218 ñ*Inventar ekonomik*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 20,174,831 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 20,646,231 lekë, me një pakësim në vlerën 471,400 lekë. Pakësimet në këtë llogari janë për vlerën e amortizimit. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 20,639,700 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 6,531 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 76-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Çështjeve Sociale në Bashkinë Mallakastër, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të

llogarive dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike.

10.2. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

10.3. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 ñ*Toka, troje terrene*ò; 211 ñ*Pyje, Kullota, Plantacione*ò; 212 ñ*Ndërtime e konstruksione*ò; 213 ñ*Rrugë, rrjete, vepra ujore*ò; 214 ñ*Instalime teknike, makineri e pajisje*ò dhe 215 ñ*Mjete transporti*ò. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivit përkatës.

10.4. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 ñ*Debitorë të ndryshëm*ò duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 ñ*Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit*ò.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe QKB-së, u konstatua se Bashkia Mallakastër, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2021 paraqitet si:

- Aksionare me 100% të aksioneve të shoqërisë UKM Sh.a., me NUIS J77517803S, me objekt ñ*Ujësjellës kanalizime*ò, e themeluar në datën 28.02.1997, aktualisht me status ñ*Aktiv*ò. Numri i aksioneve është 19,600 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 19,600,000 lekë.
- Aksionare me 100% të aksioneve të shoqërisë ñ*UKM Sh.a.*ò, me NUIS K47605804N, me objekt ñ*...a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm…, etj.*ò, e themeluar në datën 15.04.2004, me Vendimin nr. 31633 të Gjykatës Tiranë, aktualisht me status ñ*Aktiv*ò. Në aktin e themelimit të kësaj shoqërie anonime, përcaktohet se kapitali themeltar ka qenë 19,600,000 lekë, e ndarë në 19,600 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion. Numri i aksioneve është 621,858 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën **621,858,000 lekë**, e gjitha në pronësi të Bashkisë Mallakastër.

Nga sa më sipër, rezulton se kjo shoqëri rrjedh nga shoqëria e mësipërme, e cila nuk funksionon, por nga ana e Bashkisë Mallakastër nuk janë marrë masat për mbylljen dhe fshirjen e shoqërisë fillestare në regjistrin e bizneseve.

- Aksionare me 25% të aksioneve të shoqërisë ñ*Bylis*ò Sh.a., me NUIS L18407801Q, me objekt ñ*Krijimi i ekipeve zinxhir për sportin e futbollit…*ò. Numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale 20,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 2,000,000 lekë. Partner me 75% të aksioneve është shoqëria ñ*Gjanica*ò. Vlera e kapitalit të zotëruar nga Bashkia Mallakastër është **500,000 lekë**, vlerë e cila nuk është pasqyruar në llogarinë 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ò. Këto të drejta, Bashkia Mallakastër i ka trashëguar nga Bashkia Ballsh.
- Në datën 09.01.2020 është regjistruar në organet tatimore si ent publik ñ*N Sh P, M*ò, me NUIS M07509871Q, me objekt ñ*Shërbime publike, pastrim, gjelbërim, transport...*ò, e cila zotërohet nga Bashkia Mallakastër. Kjo ndërmarrje është krijuar me VKB Mallakastër nr. 97

datë 27.11.2019, me nr. 2913/1 regj., datë 02.12.2019. Nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB-së, u konstatua se kjo shoqëri nuk figuron në regjistrat *online* të QKB-së dhe rrjedhimisht nuk mund të ekstraktohen të dhënat për zotërimin e aksioneve dhe vlerën e kapitalit, por nga Pasqyrat financiare të shoqërisë, konstatohet se vlera e aktiveve është **67,105,362 lekë**.

Për sa më sipër, llogaria 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ò nuk paraqet vlerën reale për shumën **689,463,362 lekë** (621,858,000 lekë nga shoqëria Ujësjellës Kanalizime Mallakastër Sh.a.; 500,000 lekë nga shoqëria ñBylisò Sh.a. dhe 67,105,362 lekënga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Mallakastër), në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 ñ*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*ò, me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñ*Aktivet afatgjata materiale dhe Aktivet afatgjata jo materiale*ò pikat 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 ñ*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*ò.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 76-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

<u>11.1. Rekomandimi:</u>Nga Bashkia Mallakastër, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive: **1.** ñ*U K M Sh.a.*ò, me NUIS K47605804N, për 100% të aksioneve, në vlerën 621,858,000 lekë; **2.** ñ*B*ò Sh.a., me NUIS L18407801Q, për 25% të aksioneve në vlerën 500,000 lekë; **3.** ñ*N Sh P, M*ò, me NUIS M07509871Q, për 100% të aksioneve, në vlerën 67,105,362 lekë, si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive prej **689,463,362 lekë**në debi të llogarisë 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*ò dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

<u>11.2. Rekomandimi:</u>Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të bërë çregjistrimin e shoqërisë ñ*Uk*ò, e themeluar në datën 28.02.1997, aktualisht me status ñ*Aktiv*ò, me NIPT/NUIS J77517803S, kapitali i së cilës rezulton të jetë transferuar i gjithi në shoqërinë ñ*U K K Sha*ò, me NIPT/NUIS K47605804N.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

12. Gjetje nga auditimi: Vlera e prokuruar për investimet në proces gjatë vitit 2021 ka qenë 1,259,818,211 lekë, nga të cilat 1,125,017,874 lekë me fonde të deleguara dhe 134,800,337 lekë nga të ardhurat e veta. Vlera e kontraktuar (me Tvsh), për investimet në proces gjatë vitit 2021 ka qenë 1,177,981,840 lekë, nga të cilat 1,101,002,753 lekë me fonde të deleguara dhe 76,979,087 lekë nga të ardhurat e veta. Planifikimi total për vitin 2021 ka qenë 278,451,257 lekë, nga i cili 198,785,588 lekë me fonde të deleguara, me realizim në vlerën 189,552,711 lekë dhe 79,665,669 lekë nga të ardhurat e veta, me realizim në vlerën 42,501,126 lekë.

Si rregull, këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 ñ*Aktive afatgjata materiale*ò. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Sektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021, sipas aneksit nr. 9 pika 2. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò, kreu II, pikat 6 dhe 15-18, kreu III, pika 33, 36, Aneksi 1, pika 2, ñ*Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël)*ò, ñ*Aktive afatgjata materiale*ò, etj.

Për sa më sipër, zëri ñ*Investime në proces*ò, i përbërë nga llogaritë 230 ñ*Investime për aktive afatgjata jo materiale*ò dhe 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò, në datën 31.12.2020nuk paraqet vlerën reale, janë nënvlerësuar për 991,143,896 lekë, pasi duhet të pasqyronin vlerën 1,177,981,840 lekë, e cila përbëhet nga shuma e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Mallakastër.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 76-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Çështjeve Sociale në Bashkinë Mallakastër të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje active sh afat gjata material dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 ñ*Shpenzime n ëproces që rrritjen e AQT*ò deri në vlerën e plotëdhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës sëkontratave, tôÌ kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 466 ñ*Kreditorë për mjete në ruajtje*ò në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 37,245,475 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 48,822,037 lekë ose me rritje në vlerën 11,576,562 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme.

Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, nuk është bërë zhbllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit, pavarësisht se është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 ñ*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*ò i ndryshuar, Kap II ñ*Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit*ò, të VKM nr. 3, datë 15.2.2001 ñ*Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit*ò i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2001 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike*ò i ndryshuar pikat 42 ï 50 të tij, UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 ñ*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*ò i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 76-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuara.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi:Për vitin 2021 kanë qenë në zbatim 17 kontrata, të lidhura gjatë vitit dhe në vitet ushtrimore të mëparshme, në vlerën totale 1,177,981,840 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Qeveria, FZHR dhe financime të huaja. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për tôu paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivit. Deri

në fund të vitit ushtrimor 2021 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet nëllogarinë 476 ñ*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*ò.
Për këto investime nuk janë kryer veprimet kontabël sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike.
Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò Aneksi 1 ñ*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*ò, Kreu I, ñ*Të përgjithshme*ò, pika 8, Kreu II, ñ*Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, ñ*Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, pika 32.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 76-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
14.1. Rekomandimi:Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresëssëdërguarnga MFE përalokimin e fonditpjesortëvititushtrimortëdetajuarsipasprojektevetëinvestimeve, tëkryhetveprimikontabëlpërshumatpërkatësenëdebitëllogarisë 520 ñ*Disponibilitetenëthesar*ò dhenëkreditëllogarisë 476 ñ*Tëardhuratëcaktuarapërt'upërdorur*ò.
Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situcion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò dhe në kredi të llogarisë 404 ñ*Furnitorë për investime*ò.
Në momentin e pagesave të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 ñ*Furnitorë për investime*ò dhe në kredi të llogarisë 520 ñ*Disponibilitete në thesar*ò.
Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për investimet e papërfunduara/në proçes, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 ñ*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*ò, në kredi të llogarisë 720 ñ*Grant korrent i brendshëm*ò dhe në kredi të llogarisë 4342, ñ*Operacione me shtetin (të drejta)*ò për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.
Me përfundimin e investimit, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 ñ*Aktive afatgjata materiale*ò dhe në kredi të llogarisë 231 ñ*Investime për aktive afatgjata materiale*ò.
Me kapitalizmin e aktivit,(për aktivet e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 ñ*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*ò, në kredi llogarisë 105 ñ*Grante të brendshme kapitale*ò për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 ñ*Shtesa të fondit bazë*ò dhe në debi të llogarisë 105 ñ*Grante të brendshme kapitale*ò për vlerën e aktiveve të blera.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e 15 procedurave me vlera të larta, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kritereve, jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP, ku kriteret nuk janë në përputhje me me natyrën e objektit që prokurohet, si dhe nuk janë argumentuar në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò me ndryshime.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 113-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mallakastër, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe

kritereve, duke dhënë argumente për secilin kriter, të cilat të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kritere të përshtatshme me procedurën dhe duke dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi:1) Gjatë auditimit të procedurave të prokurimit për punë publike, u konstatua se në shumicën e tyre është vendosur kriteri për mjekun e ndërmarrjes, duke mos qenë në kushtet e kërkuara sipas përcaktimit të VKM-së nr. 632, datë 15.07.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 09.02.2011 ñ*Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë në punë*ò, ku përcaktohen grupet e punëdhënësve dhe numri i punonjësve për të kërkuar mjekun e ndërmarrjes. Në asnjë nga rastet e audituara, nuk plotësohet numri i punonjësve për të kërkuar mjekun e ndërmarrjes.
2) Gjatë auditimit të procedurave të prokurimit për punë publike, u konstatua se në shumicën e tyre është vendosur si kriter për punonjësit, dëshmia e sigurimit teknik, bazuar në ligjin me nr. 8734, datë 01.02.2001 ñ*Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike*ò i ndryshuar, ndërkohë që objekti i punëve publike dhe stafi i nevojshëm për kryerjen e këtyre punimeve, nuk është në kushtet për të qenë i pajisur me këtë dëshmi, pasi nuk ka zëra punimesh që lidhen me objektin e ligjit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 113-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
16.1. Rekomandimi: Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit, Bashkia Mallakastër, të marrë masa për shmangien e kritereve të tilla, të cilat nuk mbështeten në bazën ligjore, por krijojnë pengesë dhe kufizojnë numrin e operatorëve ekonomikë për të konkurruar në procedurat e prokurimit publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në auditimin i procedurave të prokurimit për blerje mallrash (karburanti, mjete transporti etj), komisioni i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, nuk ka dokumentuar përllogaritjen e fondit limit, por ka hartuar preventivat pa përcaktuar metodikën e ndjekur për caktimin e vlerës së fondit limit të kontratës. Në disa raste, mungon urdhri i titullarit për ngritjen e këtyre komisioneve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 56, si dhe me pikën 2 të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar me pikën 1 të nenit 73, dhe me pikën 1 të nenit 76 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 113-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
17.1. Rekomandim: Titullari i AK, të krijojë komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, duke angazhuar personel të kualifikuar dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.
Në çdo rast, komisionet e përfshira në procedurat e prokurimit publik, të ngrihen me urdhër titullarit.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e 2 procedurave të prokurimit për blerje mjetesh, rezulton se specifikimet teknike të vendosura janë me diferenca minimaliste apo fikse, në lidhje me parametrat teknikë. Specifikimet teknike për mjetet, të cilat nuk duhet të kenë qenë të targuara, në funksion pune ose shërbimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për vitin 2019, janë kërkesa të cilat pengojnë konkurrencën dhe janë në kundërshtim me nenin 23

të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ñ*Për prokurimin publik*ò.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 113-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
18.1. Rekomandimi: Titullari i AK, të marrë masa që në komisionet e ngritura për procedurat e prokurimit publik, të vendosen persona me kualifikimin e duhur. Të merren masa për vendosjen e specifikimeve teknike të duhura dhe për krijimin e kushteve për konkurrim të barabartëndërmjet kandidatëve ofertues.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit publik, në 4 raste janë evidentuar mangësi lidhur me komisionin e shqyrtimit të ankesave. Titullari i AK, ka ngritur KSHA me personel i cili ka qenë i angazhuar në hartimin e kritereve dhe njëkohësisht ka trajtuar edhe shqyrtimin e ankesave, veprime këto në kundërshtim me pikën 6, germa (a), paragrafi i dytë i nenit 78 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, ndryshuar me pikën 1 të nenit 101 të VKM-në nr. 285/2021.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 113-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
19.1. Rekomandimi: Titullari i AK, në çdo rast kur administrohen ankesa të cilat lidhen me procedurat e prokurimit publik, të marrë masa që në komisionet për shqyrtimin e tyre, të angazhojë personel i cili nuk ka qenë i përfshirë më parë në vendimmarrje për të cilën janë paraqitur ankesat.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi:1. Nga testimi i 25 procedurave për blerje të vogla gjatë periudhës 01.01.2018-31.12.2021, rezulton se Komisioni i Blerjeve të Vogla, nuk ka argumentuar në të gjitha rastet përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò i ndryshuar.
2. Në 2 raste, konkretisht procedurat me objekt ñ*Blerje kamion vetëshkarkues me vinxh*ò, dhe ñ*Blerje korrëse bari*ò, specifikimet teknike janë vënë në mënyrë jo konkurruese, të cilat janë ndikuese në trajtimin e ofertuesve, veprim në kundërshtim me pikën 2 të nenit 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò, i ndryshuar.
3. Në 2 procedura, me objekt blerje produkte ushqimore, nuk është bërë përshkrimi i plotë i mallrave që prokurohen, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 23 të cituar më sipër.
4. Në procedurën me objekt ñ*Blerje tonerë për printer dhe fotokopje*ò, OE i shpallur fitues me të cilin është lidhur kontrata, N. M, rezulton 2 muaj debitor, duke mos përmbushur pikën III/1. d të Ftesës për Ofertë.
5. Në procedurën me objekt ñ*Shërbim interneti dhe telefonie*ò, në kriteret apo specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, rezulton se AK ka kërkuar nga OE ofertues të disponojë si pjesë të stafit teknik, minimalisht 5 punonjës inxhinierë telekomunikacioni/ elektronik ose informatikë. Ky kriter është i ekzagjeruar dhe i paargumentuar nga KBV. Është një numër relativisht i lartë duke marrë parasysh llojin dhe vlerën e kontratës prej 500,000 lekë pa TVSH.
6. Në 11 procedura blerje të vogla, rezulton se likuidimet për faturat tatimore të shitjes janë kryer tej afatit 30 ditor, veprim në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2009 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 113-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
20.1. Rekomandimi: Titullari i AK, në komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, të angazhojë persona të kualifikuar dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.
20.2. Rekomandimi:Në procedurat e ardhshme, të merren masa që hartimi i specifikimeve teknike të mundësojë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët, të rrisë konkurrencën ndërmjet tyre dhe njëkohësisht të bëhet përshkrim sa më i saktë dhe i plotë i objekteve që prokurohen.

20.3. Rekomandimi: Komisioni për blerjet e vogla, të hartojë kriteret në përputhje me objektin e kontratës, duke shmangur kriteret të cilat ulin konkurrencën dhe përbëjnë kufizim për operatorët ekonomikë.
20.4. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Mallakastër, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve të faturave brenda afatit ligjor 30 ditor.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Në auditimin për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, në 3 raste personat përgjegjës që administrojnë procesin në sistemin*e-leje*, kanë miratuar lejet pa kërkuar mendimin paraprak nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për miratimin e VNM-ve, pasi objektet konsiderohen të klasifikueshme për tu pajisur me VNM, sipas ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 ñ*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*ò Shtojca II, pika 10. Detyrimi për të kërkuar mendimin e këtij institucionit, përcaktohet në pikën 6 të nenit 21, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 ñ*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*ò i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 186-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
21.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Mallakastër, të marrë masa për shqyrtimin e lejeve të ndërtimit, ku të bashkërendohet puna me të gjitha institucionet e tjera publike brenda kompetencave që u njeh ligji, duke përfshirë edhe kërkesën drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nëse objektet për të cilat është aplikuar për leje ndërtimi, duhet tõ nënshtrohen apo jo *Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.*

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, u konstatuan mangësitë *si vijon*:
1. Nuk është aplikuar në 2 raste konstatimi i ndërtimit pa leje, vendimi për pezullimin e punimeve, veprim ky në kundërshtim me nenin 5 germa ç) dhe nenin 13 germat a), b), c) dhe ç) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ñ*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*ò, i ndryshuar, si dhe pikës 5 të VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 ñ*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*ò.
2. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se k/inspektori nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5, germa a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ñ*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*ò, i ndryshuar, nenin 51, ñ*Inspektimi*ò, të ligjit nr. 107/2014 ñ*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*ò i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 ñ*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*ò.
3. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se k/inspektori nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 mujor për masat e marra nga IKMTV, në kundërshtim me nenin 5, germa f), të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ñ*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*ò, i ndryshuar.
4. Nga kontrolli i dokumentacionit, u konstatua se disponoheshin fotot e konstatimit të shkeljeve, të cilat janë të nevojshme për dokumentimin e kundërvajtjes së kryer. Mungesa e fotografive të kundërvajtjes, është veprim në kundërshtim me nenin 41 ñ*Të drejta të tjera të inspektorit*ò, germa a), të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 ñ*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*ò.
5.Për një gjobë në vlerën **500,000 lekë** ndaj subjektit G&L shpk, rezulton se është bërë kërkesa për lëshimin e urdhërittë ekzekutimit, e cila është pranuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 460 regj., datë 29.07.2019. Lidhur me këtë vendim, rezulton se nuk është dërguar pranë zyrës përmbarimore për kryerjen e

veprimeve për arkëtimin e saj, veprim në kundërshtim me nenin 9 të ligjit me nr. 10279, datë 20.05.2010 ñ*Për kundërvajtjet administrative*ò.
6.Për dy gjoba në vlerën **200,000 lekë** total me kundërvajtës ñ*M*ò shpk dhe ñ*M – K*ò shpk, rezulton se nuk është kryer asnjë veprim për arkëtimin e tyre.
7.Për një gjobë në vlerën **50,000 lekë** me kundërvajtës ñ*A MK*ò, rezulton se është bërë kërkesë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, kërkesë e cila është rrëzuar nga kjo gjykatë. Kundër këtij vendimi është bërë ankimim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Gjithsesi, konstatohet se ky kundërvajtës ka marrë përsipër në vijim kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve për punët e prokuruara pranë Bashkisë Mallakastër dhe rrjedhimisht janë krijuar të gjitha kushtet për arkëtimin e këtij detyrimi, por rezulton se nuk janë kryer veprime nga punonjësit e kësaj bashkie.
- Sa më sipër, vlera prej **750,000 lekë**, përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Mallakastër, si rezultat e mosarkëtimit të tyre apo ndjekjes së procedurave për të bërë të mundur arkëtimin e tyre.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 190-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
22.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV-së, të marrë masa për plotësimin e procedurave, duke vendosur masat e pezullimit për ndërtimet që kryhen pa lejet përkatëse. Të administrohet në dosjet e tyre praktika, duke bashkëlidhur fotografitë e kundërvajtjes ku të pasqyrohet fakti i evidentuar në procesverbalet e konstatimit. Të mbahet korrespodencë me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, ku çdo 3 muaj të përcillet informacioni periodik i aktivitetit të tyre.
22.2. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV-së, të marrë masa për kontrollin e objekteve të pajisura me leje ndërtimi dhe në çdo rast të mbajë aktet e kontrollit ku të pasqyrohet situata e objektit në ndërtim dhe evidentimi i shkeljeve në rast konstatimi.
22.3. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMT në vlerën **750,000 lekë**.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò neni 15 ñ*Të drejtat e KLSH*ò, shkronja (b) dhe (c) dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 ñ*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*ò, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, dhe pikën 93, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò, nga ana e Titullarit të njësisë publike Bashkia Mallakastër, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi Zbatues të ndiqet procesi me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 847,516 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñ*Ndërtim shëtitore nga shkolla "Odisea" deri tek varrezat e qytetit*ò, Bashkia Mallakastër, me vlerë të kontratës (me tvsh)27,131,706 lekë, realizuar nga BOE ñShò Shpk & ñAò Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 621,602 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1604 prot., datë 17.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër dhe BOE ñShò Shpk, & ñAò Shpk.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.4., faqe 113-186 të Raportit Përfundimtar të

Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **621,602 lekë pa tvsh** nga BOE ñShò Shpk, & ñAò Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1604 prot., datë 17.07.2019, me objekt ñ*Ndërtim shëtitore nga shkolla "Odisea" deri tek varrezat e qytetit*ò, Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñ*Rikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja "5 Shkurti"*ò, Bashkia Mallakastër, me vlerë të kontratës (me tvsh)30,874,884 lekë, realizuar nga OE ñAò Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 225,914 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 462 prot., datë 15.02.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër dhe OE ñAò SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.4., faqe 113-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **225,914lekë pa tvsh** nga OE ñAò Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 462 prot., datë 15.02.2019, me objekt ñRikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja ñ5 Shkurtiò, Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave nga Drejtoria e Financës, ka pasur 5 raste të punonjësve që kanë ankimuar në gjykatë ndaj Bashkisë Mallakastër për largime nga puna pa shkaqe të arsyeshme ligjore, për të cilët ka përfunduar gjykimi dhe vendimi ka marrë formë të prerë për shumën 1,190,000 lekë, një pjesë e të cilave i përkasin periudhave të para këtij auditimi. Për likujdimin e detyrimit të mësipërm janë kryer pagesa pjesore **në vlerën 839,199 lekë, që përbëjnë efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Mallakastër** duke ndikuar në performancën financiare dhe funksionale të institucionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 53-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër të marrë masat e nevojshme për analizimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, duke identifikuar personat përgjegjës dhe vendosjen e masave administrative ndaj tyre, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin Juridik të bashkëveprojnë për shmangien e penalizimeve të tilla financiare.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, Bashkia Mallakastër nuk ka krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku të përcaktohet numri i familjeve dhe sasia e sipërfaqes së banimit që ka secila familje, kujt viteve i përket banesa, para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, nuk është plotësuar rregullisht njoftimi i detyrimit për çdo familje, si për taksën e ndërtesës edhe për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit.

Nga auditimi i taksës së ndërtesës, u konstatua një vlerë debitore prej **18,491,172 lekë**, deri në datën 31.12.2021.
Nga auditimi i tarifës së pastrimit, u konstatua një vlerë debitore prej **7,216,205 lekë**, deri në datën 31.12.2021.
Nga auditimi i tarifës së shërbimit vaditje+kullim, u konstatua një vlerë debitore prej**4,726,474 lekë**, deri në datën 31.12.2021.
Në total, vlera e paarkëtuar nga taksat dhe tarifat vendore të familjarëve, e cila përbën të ardhurave të munguara për Bashkinë Mallakastër është **30,433,851 lekë**. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar.
Nga auditimi, u konstatua se me ligjin 7501 ñ*Për tokën*ò, janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 7,402 familje dhe 10,270 hektarë tokë, për të cilat është planifikuar pagesa e taksës së tokës. Mesatarisht, për të gjithë periudhën objekt auditimi, taksa e tokës është arkëtuar rreth 52%. Nga 7,402 familje të trajtuara me tokë bujqësore, 4,880 familje janë debitore për këtë lloj takse. Shumë pak pagesa bëhen në mënyrë vullnetare, por kryesisht paguajnë familjet të cilat janë paraqitur në zyrat e bashkisë për probleme të ndryshme administrative dhe u është kërkuar kryerja e pagesës në këmbim të marrjes së shërbimit.
Nga auditimi i taksës së tokës, rezultoi vlera totale debitore **68,669,251 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar.
Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, nenet 4, 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj., ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, kreu VIII ñ*Vlerësimi tatimor*ò, ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, etj.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6., faqe 53-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
2.1. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.
2.2. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar/vjelë detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës debitore prej **30,433,851 lekë**.
2.3. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK dhe Qarku Fier). Për familjet fermere debitore të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë periudhën/vlerën e papaguar, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës debitore prej **68,669,251 lekë.**

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të disponueshëm në zyrën e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Mallakastër u konstatua se për vitet 2018-2021 janë arkëtuar të ardhura në formën e tarifave të qirasë nga 211 subjekte që shfrytëzojnë toka bujqësore mbi bazë kontratash, akt-marrëveshjesh dhe kërkesash të depozituara pranë Bashkisë Mallakastër, kryesisht të mbartura nga ish komunat përpara reformës territoriale.
Për vitin 2018 ka pasur gjithsej 211 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave

publike, për një vlerë totale prej 1,384,087 lekë, nga të cilat janë pa likuiduar 83 subjekte, në vlerën progresive 1,641,750 lekë.
Për vitin 2019 ka pasur gjithsej 210 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave publike, për një vlerë totale prej 1,370,087 lekë, nga të cilat janë pa likuiduar 98 subjekte, në vlerën progresive 1,987,751 lekë.
Për vitin 2020 ka pasur gjithsej 210 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave publike, për një vlerë totale prej 1,370,087 lekë, nga të cilat janë pa likuiduar 88 subjekte, në vlerën progresive 1,935,270 lekë.
Për vitin 2021 ka pasur gjithsej 211 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave publike, për një vlerë totale prej 1,384,087 lekë, nga të cilat janë pa likuiduar 88 subjekte, në vlerën progresive 2,218,252 lekë.
Nga auditimi i të ardhurave të krijuara nga përdorimi i aseteve, u konstatua se vlera debitore progresive në datën 31.12.2021 është **2,218,252 lekë**, e cila përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.
Sa më sipër, është në kundërshtim me: ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 ñ*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*ò i ndryshuar; ligjin nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò; ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 ñ*Për tokën*ò, i ndryshuar; ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, ñ*Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*ò, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për tôu lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñ*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*ò; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò, etj.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6., faqe 53-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
3.1. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **2,218,252 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave, (*sipas normës së interesit të Bankës së Shqipërisë, plus tetë pikë përqindje*) për të gjitha rastet e detyrimeve të paarkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për periudhën objekt auditimi, janë dhënë 864 leje legalizimi, për sipërfaqen e ndërtimit 178,768 m^2 ndërtim, e cila duhet të paguante TNI në vlerën totale 28,242,660 lekë. Nga kjo shumë është likuiduar vlera prej 16,707,716 lekë, duke mbetur pa shlyer 381 posedues të lejeve të legalizimit për një sipërfaqeje prej 73,014 m^2 me vlerë 11,534,944 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar.
Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, ñ*Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*ò i ndryshuar, neni 23, me VKM-në nr. 860, datë 10.12.2014 ñ*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*ò, pika 5, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për Sistemin e Taksave Vendore*ò, i ndryshuar, neni 27 ñ*Taksa e ndikimit në infrastrukturë*ò, pika 2/1, sidhe me VKB vjetore përkatëse për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Mallakastër, etj.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6., faqe 53-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
4.1. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër nëpërmjet bashkëpunimit institucional tôi kërkojë ASHK-së, Drejtoria Fier, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet

apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Mallakastër. Drejtoria e administrimit, zhvillimit të territorit dhe kadastrës, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e vlerës **11,534,944 lekë** nga të gjithë individët e listuar si debitorë, bazuar në legjislacionin tatimor.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, rezultoi se në Bashkinë Mallakastër ka **290 subjekte debitore** nga biznesi (18 nga biznesi i madh, 263 nga biznesi i vogël, 2 institucione dhe 7 nga kompanitë e shfrytëzimit dhe përpunimit të naftës). Numri i debitorëve nga biznesi si në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hotelit, truallit, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie dhe kamatëvonesat përkatëse), në fund të vitit 2017 numri i debitorëve ka qenë 327 subjekte në vlerën totale 860,658,401 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 numri i debitorëve ka qenë 290 subjekte dhe vlera progresive ka qenë **1,137,138,382 lekë**, (përfshirë vlerën 57,230,150 lekë, që është në proces gjyqësor dhe kamatëvonesat) e cila përfaqëson taksat dhe tarifat vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Mallakastër. Nga auditimi, u konstatua se nuk është llogaritur dhe kontabilizuar vlera e gjobës (kamatëvonesës) për tatimpaguesit, në masën 0,06% për çdo ditë vonesë, deri në 365 ditë, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, neni 114 ñ*Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit*ò, pika 1. Kjo vlerë debitore, së bashku me kamatëvonesat, është e pakontabilizuar.
Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore*ò, me ndryshime, Kreut XI, ñ*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*ò, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 ñ*Kodi Penal i RSh*ò me ndryshime neni 181, Ligji nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, i ndryshuar neni 9 ñ*Të drejtat dhe përgjegjësitë*ò pika 1.3., neni 35, ñ*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*ò, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6., faqe 53-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
5.1. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pavjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura ndaj **290 subjekteve** debitore në vlerën prej **1,137,138,382 lekë,** duke ndjekur rrugët e mëposhtme:
a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.
b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i tatim-taksave të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.
d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë Ekonomike e Çështjeve Sociale dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Mallakastër, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Mallakastër ushtrojnë aktivitetin 12 subjekte të cilat tregtojnë hidrokarbure, karburante. Subjekte të liçencuar për tregtimin e lëndëve djegëse nuk ka. Aktualisht, detyrimet për pajisjen me autorizim i kanë shlyer sipas përcaktimit në aktet nënligjore subjektet: N Shpk për dy pika shitjeje, L Shpk, K Shpk dhe B- P Shpk.
Për subjektet B Shpk, Sh Shpk, B 2003 Shpk, A 2013, O Shpk dhe E Shpk, është llogaritur pagesa në masën 200,000 lekë, për një periudhë 1 vjeçare, gjë që është e gabuar, pasi pavarësisht se nga autoriteti vendor përcaktohet kohëzgjatja e licencës së tregtimit, pagesa për licencimin nuk ndryshon.
Nga auditimi i pagesave për pajisjen me licenca për tregtimin e hidrokarbureve, u konstatua se nuk është tarifuar ose është tarifuar gabim vlera totale **6,000,000 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.
Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa ñbò, pikat 9, 15.1 dhe 15.2.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6., faqe 53-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifat e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej **6,000,000 lekë**. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 39 procedurave me vlerë kontrate 1,615,821 mijë lekë, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 7 procedura me vlerë kontrate 197,346mijë lekë ose 12% e vlerës së kontratave të lidhura, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E$^{-\text{të}}$)në vlerën **197,346 mijë lekë**, **respektivisht**:
1. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Shtresë tapeti i rrugëve të lagjes "B", të bulevardit qendror deri te shkolla "Odisea"*, viti 2018, me fond limit 55,360 mijë lekë, me fitues BOE ñBò shpk & ñAò shpk me vlerë të ofertës 52,805 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave të DST për kualifikim, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E$^{-\text{të}}$) në vlerën **52,805 mijë lekë.**
2. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ñ*Sistemi i ngrohjes dhe infrastruktura e bashkisë*ò Viti 2018, me fond limit 9,514 mijë lekë, me fitues OE ñShò shpk me ofertë 8,956 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E$^{-\text{të}}$) për vlerën **8,956 mijë lekë.**
3. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objektñ*Ndërtim shëtitore nga shkolla "Odisea" deri te varrezat e qytetit*ò Viti 2019, me fond limit 26,665 mijë lekë, me fitues BOE ñShò shpk & ñAò shpk me ofertë 22,609 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave të DST për kualifikim, me pasojë prokurim të fondeve publikepa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E$^{-\text{të}}$) për

vlerën **22,609 mijë lekë.**
4. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ñ*Materiale të ndryshme, çakull, stabilizant për mirëmbajtje rruge në fshatra*ò Viti 2019, me fond limit 25,000 mijë lekë, me fitues OE ñB 93ò shpk me ofertë 21,990 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave të DST për kualifikim, me pasojë prokurim të fondeve publikepa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E$^{-\text{të}}$) për vlerën **21,990 mijë lekë.**
5. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ñ*Rehabilitimi i rrjetit ujitës Çorrush*ò Viti 2020, me fond limit 28,320 mijë lekë, me fitues BOE ñK.M.Kò shpk & ñ2 Nò shpk me ofertë 21,641 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave të DST për kualifikim, me pasojë prokurim të fondeve publikepa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E$^{-\text{të}}$) për vlerën **21,641 mijë lekë.**
6. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ñ*Blerje materiale të ndryshme, çakull, stabilizant, rërë bituminoze për mirëmbajtje rruge në fshatra, për nevoja të NSHP*ò Viti 2021, me fond limit 40,833 mijë lekë, me fitues OE ñShò shpk me ofertë 34,359 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave të DST për kualifikim, me pasojë prokurim të fondeve publikepa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E$^{-\text{të}}$) për vlerën **34,359 mijë lekë.**
7. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ñ*Rikonstruksion i rrugës Bejar – diga e rezervuarit*ò Viti 2021, me fond limit 59,394 mijë lekë, me fitues BOE ñKò shpk & C- Mò shpk me ofertë 34,986 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave të DST për kualifikim, me pasojë prokurim të fondeve publikepa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E$^{-\text{të}}$) për vlerën **34,986 mijë lekë.**
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ñ*Për prokurimin publik*ò, i ndryshuar, neni 1 ñ*Objekti dhe qëllimi*ò pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 ñ*Parimet e përzgjedhjes*ò shkronja (a), (b) dhe (c), nenin 46 ñ*Kualifikimi i ofertuesve*ò pika 1, dhe nenin 55 ñ*Shqyrtimi i ofertave*ò pika 3.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 113-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E$^{-\text{të}}$), **276,094 mijë lekë** pa TVSH.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñ*Ndërtim shëtitore nga shkolla "Odisea"deri tek varrezat e qytetit*ò, Bashkia Mallakastër, realizuar nga BOE ñShò Shpk & ñAò Shpk, rezultoi se pemët e mbjella, të cilat në projektpreventiv janë përcaktuar ñFV pemë bliri me d=18 cm h>5 mò dhe në ofertë dhe situacion me vlerën **1,440,000 lekë pa TVSH**, rezultojnë të jenë me diametër rreth 10 cm dhe mesatarisht me h ≤ 4 m. Vlera e mësipërme është shpenzim pa efektivitet i fondeve të Bashkisë Mallakastër.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.4., faqe 113-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, në cilësinë e Titullarit të AK, të nxjerrë përgjegjësitë për marrjen në dorëzim të objektit jo sipas projektpreventivit dhe pa plotësuar specifikimet teknike të miratuara dhe të marrë masa që në ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim të objektit, të përcaktohen qartë detyrimet dhe përgjegjësitë për secilin anëtar, në mënyrë që objektet e ndërtuara me financim nga Bashkia, tâ shërbejnë sa më mirë komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 15, shkronja (c), të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò, nenin 58 të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 ñ*Për nëpunësin civil*ò i ndryshuar, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 ñ*Masa Disiplinore*ò, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 ñ*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*ò, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, tâi kërkojë Komisionit Disiplinor pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Për problemet e konstatuara në lidhje me kontabilitetin dhe pasqyrat financiare:

1. A. R, me detyrë Drejtor Ekonomik, me status nëpunës civil, në cilësinë e nëpunësit zbatues, nënshkrues i pasqyrave financiare.
2. R. L, me detyrëspecialist finance, me kod pune

Për anëtarët e Komisionit për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, si më poshtë vijon:

3. M. M, Drejtor Urbanistik, me status nëpunës civil, në cilësinë e anëtarit për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit në 3 raste.
4. B. V, Specialiste Urbanistike, me status nëpunës civil, në cilësinë e anëtarit për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit në 2 raste.

Për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si më poshtë vijon:

5. A. R, me detyrë drejtor Ekonomik, me status nëpunës civil, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 4 raste.
6. A. X, me detyrë Kryeinspektor, me Kod Pune, për 4 raste në cilësinë e anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave, dhe 1 rast në cilësinë e anëtarit për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit.
7. E.B, Funksioni, me funksion drejtor Kabineti i Kryetarit, me Kod Pune, në cilësinë e anëtaritë të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 2 raste.
8. A. I, me funksion nën kryetare, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 1 rast.

Për problematikat e konstatuara në lidhje me të ardhurat, si më poshtë vijon;

9. B.J, me detyrë përgjegjës i zyrës së Tatim-Taksave, me status nëpunës civil;
10. A. M, me detyrë specialist i Tatim-Taksave,me status nëpunës civil;
11. A. Xh, me detyrë specialist i Tatim-Taksave,me status nëpunës civil.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e poshtëpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

1. A. N, ish-drejtor i Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit;
2. H. S, ish-nën kryetar;
3. Q. S, ish-përgjegjës i sektorit të financës;
4. E. Ç, ish-drejtor i Infrastrukturës;
5. E. G, ish-specialist i Tatim-Taksave;
6. Ç. A, ish-specialist i Tatim-Taksave;
7. E.H, ish-specialist i Tatim-Taksave.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

1. J. P, Përgjegjës i Grupit të Auditimit
2. Sh. H
3. K. K
4. A. Z

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

B. D